

POTENCIALI I EFEKTEVE TË TVSH-SË NË EKONOMI RASTI I SHQIPËRISË DHE KOSOVËS

Enver Sele

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Shkenca Ekonomike, me profil Financë, për marrjen e gradës shkencore
“Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. As. Dr. Blerta Dragusha

Numri i fjalëve: 53787

Tiranë, Mars 2019

DEKLARATA E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time personale, deklaroj se ky studim është punë origjinale dhe nuk përmban plagjiaturë. Punimi është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një komisioni tjetër për vlerësim. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe të referuara.

ABSTRAKT

Sistemi i taksave dhe tatimeve luan një rol të rëndësishëm në ekonominë e një vendi. Një nga tatimet indirekte më të përfolura prej më shumë se gjashtëdhjetë viteve është tatimi mbi vlerën e shtuar. Në Shqipëri, nga viti 1996 që është miratuar e deri në vitin 2017, TVSH-ja ka zënë një peshë nga 17.4% deri në 36.8% në totalin e të hyrave qeveritare. Është vlerësuar se do të ishte interesant studimi në një kontekst më të gjerë i këtij tatimi, nga se ndikohet dhe efekti i tij në makroekonomi.

Ky punim është i strukturuar në dy grupe hipotezash, ku grupi i parë studjon ndikimin e hapjes ekonomike dhe rritjes ekonomike në nivelin e rimbursimit të TVSH-së. Ky grup hipotezash është zhvilluar për ekonominë e Shqipërisë dhe Kosovës si një krahasim ndërmjet dy ekonomive me pozicione gjeografike të afërta. Grupi i dytë i hipotezave është i ndarë në katër modele të ndryshme, me variabla të pavarur të cilët ndikojnë tek të ardhurat e TVSH-së në Shqipëri. Modeli i parë përfshin variablat e pavarur: hapjen ekonomike, rritjen e importeve, rritjen e eksporteve dhe volumin tregtar. Modeli i dytë përfshin variablat e pavarur: papunësinë, konsumin e familjeve dhe rritjen e PBB-së për frymë. Modeli i tretë përfshin variablat e pavarur: PBB-në reale, inflacionin dhe shpenzimet qeveritare. Modeli i katërt përfshin variablin e pavarur: indeksin e perceptuar të korrupsionit.

Rëndësia e këtij punimi qëndron në pasqyrimin e ndikimit të variablave të mësipërm në ekonominë e Shqipërisë dhe mundësisë së krahasimit për vendet e tjera sesi ndikojnë këto përcaktues në ekonominë e tyre, por jo vetëm, konkluzionet që paraqet ky punim mund të përdoren si bazë krahasimi edhe për vetë Shqipërinë në periudha të mëvonshme.

Fjalët kyçe: TVSH, të ardhurat e TVSH-së, rimbursimi i TVSH-së, përjashtimi nga TVSH-ja, sektori i farmaceutikës, raporte financiare.

ABSTRACT

Taxation system has a crucial role in the economy of a country. One of the most important indirect tax types for more than sixty years is Value Added Tax. In Albania, since 1996, which has been approved VAT, until 2017, it has occupied a weight of 17.4% to 36.8% of the total government revenue. It would be of a great interest to study this tax in a wider context and determine from which factors it is affected and which are its effects on macroeconomics.

This paper is structured in two groups of hypothesis where the first hypothesis group studies the impact of economic openness and economic growth at the level of VAT reimbursement. This hypothesis group has been developed for the economy of Albania and Kosovo as a comparison between two economies with close geographic positions. The second set of hypotheses is divided into four different models, with independent variables that affect VAT revenues in Albania. The first model includes independent variables: economic openness, increased imports, increased exports and trade volume. The second model includes independent variables: unemployment, household consumption and GDP per capita. The third model includes independent variables: real GDP, inflation and government spending. The fourth model includes the independent variable: the perceived corruption index.

The importance of this paper lies in the reflection of the influence of the above variables in the Albanian economy and the possibility of comparing for other countries how these determinants affect their economy, but not only, the conclusions of this paper can be used as a comparison basis for Albania itself in future periods.

Key words: VAT, VAT revenues, VAT reimbursement, VAT exemption, pharmaceutical sector, financial reports.

Dedikim

Së Shtrenjtës: Familjes time,

Për të gjithë mbështetjen dhe frymëzimin që më kanë dhënë gjithmonë!

FALENDERIME

Për realizimin e këtij rrugëtimi të gjatë në fushën akademike, dëshiroj të falenderoj të gjithë ato që më ndihmuan në arritjen finale të këtij punimi.

Së pari, falenderoj në një mënyrë shumë të veçantë udhëheqësen time *Prof. As. Dr. Blerta Dragusha* për përkushtimin dhe ndihmesën e madhe. I jam mirënjohës për këshillat dhe sugjerimet e vlefshme në lidhje me punimin tim. Një falenderim shkon edhe për të gjithë pedagogët e tjerë të Universitetit Europian të Tiranës për të gjithë mbështetjen, eksperiencën dhe sugjerimet akademike.

Së dyti falenderoj familjen time për mbështetjen dhe përkrahjen e vazhdueshme. Motivimi dhe mbështetja e tyre e pakushtëzuar më kanë nxitur që të finalizoj këtë tezë dokturate.

Faleminderit për zemërsisht të gjithëve!

PËRMBAJTJA E LËNDËS

KAPITULLI	I:
HYRJE.....	Error!
Bookmark not defined.	
1.1 Parathënie.....	1
1.2 Qëllimi i studimit.....	4
1.3 Objektivat e studimit.....	5
1.4 Pyetjet kërkimore.....	5
1.5 Hipotezat e studimit.....	6
1.6 Modelet konceptuale të punimit.....	9
1.7 Metodologjia.....	10
1.8 Rëndësia e punimit.....	13
1.9 Kufizimet e punimit.....	14
1.10 Struktura e punimit.....	15
KAPITULLI II: RISHIKIMI I LITERATURËS.....	19
2.1 Sistemi i taksave dhe tatimeve.....	19
2.1.1 Rëndësia e sistemit tatimor dhe fiskal.....	20
2.1.2 Dizenjimi i sistemit tatimor.....	22
2.1.3 Efikasiteti i administratës tatimore dhe TVSH-së.....	26
2.1.4 Boshlleku tatimor.....	30
2.2 Rëndësia e tatimit mbi vlerën e shtuar.....	30
2.2.1 Stimulimi i rritjes i të ardhurave tatimore nga TVSH-ja.....	34
2.2.2 Diferencimi i TVSH-së.....	37
2.2.3 Ndikimi i rritjes dhe uljes së normës së TVSH-së.....	41
2.2.4 Zgjedhja e nivelit optimal të pragut të regjistrimit të TVSH-së.....	42

2.2.5 Qëndrimet ndaj përjashtimeve të TVSH-së.....	45
2.2.6 Rimbursimi i TVSH-së.....	47
2.3 Ndikimi i TVSH-së tek faktorët makroekonomikë.....	48
2.3.1 Ndikimi i TVSH-së në tregtinë ndërkombëtare	51
2.3.2 TVSH dhe konsumi.....	53
2.3.3 Ndikimi i TVSH-së tek raportet e likuiditetit.....	54
2.4 Faktorët që nxisin shoqërinë për tatimet.....	55
2.4.1 Të dhëna nga përdorimi i TVSH-së në botë.....	56
2.4.2 Evazioni fiskal.....	58
KAPITULLI III: SISTEMI TATIMOR.....	63
3.1 Sistemi tatimor.....	63
3.2 Reformat fiskale në Shqipëri.....	63
3.2.1 Llojet e tatimeve dhe taksave që aplikohen në Shqipëri.....	69
3.3 Tatimi mbi vlerën e shtuar.....	71
3.3.1 Historiku i krijimit të TVSH-së.....	72
3.3.2 Historik i shkurtër i TVSH-së europiane dhe harmonizimit të TVSH-së.....	74
3.3.3 Historiku i TVSH-së në Shqipëri.....	76
3.3.4 Një vështrim mbi aplikimin e TVSH-së në Shqipëri.....	80
3.3.5 Historiku i TVSH-së në Kosovë.....	89
3.3.6 Një vështrim mbi aplikimin e TVSH-së në Kosovë.....	93
3.4 Ambianti fiskal në Ballkan.....	94
3.4.1 Barra tatimore në Ballkan.....	94
3.4.2 Normat tatimore në Shqipëri, Kosovë dhe Ballkan për vitin 2017.....	96
3.4.3 Kostot tatimore në Ballkan.....	100

KAPITULLI IV: ANALIZA E TVSH-SË NË DIMENSIONE TË NDRYSHME....102

4.1 Transformimi i TVSH-së tek barnat dhe ndikimi tek raportet financiare.....	102
4.1.1 Pamje e tregut farmaceutik në Shqipëri.....	102
4.1.2 Ndryshimet ligjore për nivelin e TVSH-së së aplikuar për barnat.....	103
4.1.3 Kriteret e përzgjedhjes së farmacive dhe modeli për studim.....	105
4.1.4 Analiza e raportit të fitimit marxhinal.....	109
4.1.5 Analiza e raportit të keshit.....	115
4.2 Pesha e të ardhurave të TVSH-së që mbliidhen në doganë.....	123
4.3 Produktiviteti i TVSH-së në Shqipëri.....	125
4.4 Efikasiteti i TVSH-së në Shqipëri.....	128
4.5 Sjellja e bizneseve sipas pragut të regjistrimit të TVSH-së në Kosovë.....	129

KAPITULLI V: ANALIZA E RIMBURSIMIT TË TVSH-SË, KRAHASIM SHQIPËRI – KOSOVË.....131

5.1 Kuadri ligjor për rimbursimin në Shqipëri.....	131
5.2 Kuadri ligjor për rimbursimin në Kosovë.....	133
5.3 Rimbursimi i TVSH-së dhe mundësitë për mashtrime e evazion fiskal.....	134
5.3.1 TVSH-ja dhe mundësitë për mashtrime e evazion fiskal.....	135
5.4 Ndikimi i hapjes ekonomike dhe PBB-së reale në rimbursimin e TVSH-së.....	137
5.4.1 Shkalla e hapjes së ekonomisë për Shqipërinë.....	139
5.4.2 Shkalla e hapjes së ekonomisë për Kosovën.....	140
5.4.3 Ecuria e PBB-së reale në Shqipëri.....	141
5.4.4 Ecuria e PBB-së reale në Kosovë.....	143
5.4.5 Ecuria e rimbursimeve në Shqipëri.....	144
5.4.6 Ecuria e rimbursimeve në Kosovë.....	145

5.5 Analiza e modelit të regresionit të shumës.....	147
5.5.1 Modeli i rimbursimit për Shqipërinë.....	146
5.5.1.1 Modeli 1 – Analiza OLS me nivel rëndësie 5%.....	148
5.5.1.2 Modeli 1 i përmirësuar – Analizë OLS me nivel rëndësie 5%.....	149
5.5.1.3 Kontrolli individual për koeficientët e regresionit.....	151
5.5.2 Modeli i rimbursimit për Kosovën.....	152
5.5.2.1 Modeli 2 – Analiza OLS me nivel rëndësie 5%.....	153
5.5.2.2 Modeli 2 i përmirësuar – Analizë OLS me nivel rëndësie 5%.....	155
5.5.2.3 Kontrolli individual për koeficientët e regresionit.....	156
KAPITULLI VI: ANALIZË E NDIKIMIT TË FAKTORËVE TË NDRYSHËM TEK TË ARDHURAT E TVSH-SË, RAST ILUSTRUES SHQIPËRIA.....	159
6.1 Ecuria e variablave të zgjedhur.....	159
6.2 Modelet ekonometrike.....	168
6.2.1 Modeli 1: TA nga TVSH-ja & Tregtia ndërkombëtare.....	168
6.2.1.1 Hedhja e hipotezave dhe lidhjet teorike.....	169
6.2.1.2 Analiza OLS me nivel rëndësie 10%.....	171
6.2.1.3 Kontrolli individual për koeficientët e regresionit.....	174
6.2.1.4 Kontrolli global për koeficientin e determinacionit (R^2).....	176
6.2.1.5 Modeli 1 i përmirësuar – Analizë OLS me nivel rëndësie 5%.....	177
6.2.1.6 Kontrolli individual për koeficientët e regresionit.....	179
6.2.1.7 Kontrolli global për koeficientin e determinacionit (R^2).....	180
6.2.1.8 Autokorrelacioni.....	182
6.2.2 Modeli 2: TA nga TVSH-ja & Papunësia, konsumi, rritja e PBB-së për frymë.....	183
6.2.2.1 Hedhja e hipotezave dhe lidhjet teorike.....	184

6.2.2.2 Analiza OLS me nivel rëndësie 10%.....	186
6.2.2.3 Modeli 2 i përmirësuar – Analizë OLS me nivel rëndësie 5%.....	188
6.2.2.4 Kontrolli individual për koeficientët e regresionit.....	189
6.2.2.5 Kontrolli global për koeficientin e determinacionit (R^2).....	191
6.2.2.6 Autokorrelacioni.....	192
6.2.3 Modeli 3: TA nga TVSH-ja & PBB reale, inflacioni, shpenzimet qeveritare.....	193
6.2.3.1 Hedhja e hipotezave dhe lidhjet teorike.....	194
6.2.3.2 Analiza OLS me nivel rëndësie 10%.....	195
6.2.3.3 Modeli 3 i përmirësuar – Analizë OLS me nivel rëndësie 5%.....	198
6.2.3.4 Kontrolli individual për koeficientët e regresionit.....	199
6.2.3.5 Kontrolli global për koeficientin e determinacionit (R^2).....	201
6.2.3.6 Autokorrelacioni.....	202
6.2.4 Modeli 4: Ndikimi i nivelit të korrupsionit tek të ardhurat e TVSH-së.....	203
6.2.4.1 Modeli i regresionit.....	205
KAPITULLI VII: KONKLUSIONE & REKOMANDIME.....	209
7.1 Konkluzione të përgjithshme.....	209
7.2 Konkluzione nga analizat e modeleve.....	211
7.3 Rekomandime.....	218
7.4 Sugjerime për studime të mëtejshme.....	220
REFERENCAT.....	221
APENDIKS.....	244

LISTA E FIGURAVE

Figura 1- Modeli konceptual për grupin e parë të hipotezave	9
Figura 2 – Modeli konceptual për grupin e dytë të hipotezave.....	10
Figura 3- Efektet e zbritjes së TVSH-së	40
Figura 4-Koha mesatare e nevojshme për të zbatuar TVSH-në në çdo rajon për vitin 2008 dhe 2015 (orë)	58
Figura 5- Deklarata e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar në Shqipëri	88
Figura 6- Barra tatimore në Ballkan 2014-2017 (% e PBB-së)	95
Figura 7- Normat tatimore në Ballkan për vitin 2017.....	97
Figura 8- Kriteret e përzgjedhjes së farmacive	107
Figura 9- Analiza e raportit të fitimit marxhinal.....	115
Figura 10- Analiza e raportit të keshit.....	123
Figura 11- Produktiviteti i TVSH-së për Shqipërinë	127
Figura 12- Efikasiteti i TVSH-së për Shqipërinë.....	129
Figura 13- Ecuria e rritjes reale të Pbb-së në Shqipëri.....	142
Figura 14- Ecuria e rritjes reale të PBB-së në Kosovë.....	144
Figura 15- Rimbursimi i TVSH-së në Shqipëri (Vlerat janë në milionë lekë)	145
Figura 16- Rimbursimi i TVSH-së në Kosovë (Vlerat janë në Euro).....	146
Figura 17- Rregulli për marrjen e vendimit, modeli i rimbursimit për Shqipërinë.....	152
Figura 18 - Rregulli për marrjen e vendimit, modeli i rimbursimit për Kosovën.....	158
Figura 19- Ecuria e importeve, eksporteve dhe volumit tregtar (në miliardë).....	160
Figura 20- Hapja ekonomike.....	161

Figura 21- Ecuria e rritjes së PBB-së për frymë	162
Figura 22- Ecuria e normës së papunësisë	164
Figura 23- Ecuria e konsumit të familjeve (në milionë)	165
Figura 24- Ecuria e normës së inflacionit	167
Figura 25- Ecuria e Shpenzimeve qeveritare (në miliardë)	168
Figura 26- Rregulli për marrjen e vendimit, Modeli i parë i të ardhurave nga TVSH-ja, rasti i Shqipërisë.....	175
Figura 27- Rregulli për marrjen e vendimit për kontrollin global të koeficientit të determinacionit (R^2), Modeli i parë i të ardhurave nga TVSH-ja, rasti i Shqipërisë	177
Figura 28- Rregulli për marrjen e vendimit, Modeli i parë i të ardhurave nga TVSH-ja, i përmirësuar, rasti i Shqipërisë.....	180
Figura 29- Rregulli për marrjen e vendimit për kontrollin global të koeficientit të determinacionit (R^2), Modeli i parë i të ardhurave nga TVSH-ja, i përmirësuar, rasti i Shqipërisë.....	181
Figura 30- Rregulli për marrjen e vendimit, modeli i dytë i të ardhurave nga TVSH-ja, rasti i Shqipërisë.....	190
Figura 31- Rregulli për marrjen e vendimit për kontrollin global të koeficientit të determinacionit (R^2), modeli i dytë i të ardhurave nga TVSH-ja, rasti i Shqipërisë.....	192
Figura 32- Rregulli për marrjen e vendimit, modeli i tretë i të ardhurave nga TVSH-ja, rasti i Shqipërisë.....	200
Figura 33- Rregulli për marrjen e vendimit për kontrollin global të koeficientit të determinacionit (R^2), modeli i tretë i të ardhurave nga TVSH-ja, rasti i Shqipërisë	202
Figura 34- Indeksi i përceptuar i korrupsionit në Shqipëri	205

LISTA E TABELAVE

Tabela 1- Normat e TVSH-së më 01 janar 2018 për vendet anëtare të BE-së (në %)	38
Tabela 2- Të ardhurat nga tatimet dhe doganat për periudhën 1996-2017 (Vlerat në miliardë lekë)	78
Tabela 3- Pësja e TVSH-së ndaj totalit të të ardhurave në buxhetin e shtetit në Shqipëri, (Vlerat janë në miliardë lekë)	80
Tabela 4- Të dhënat e Farmacive të përzgjedhura për analizë	108
Tabela 5- Raporti i fitimit marxhinal për periudhën 2009-2016	109
Tabela 6- Përmbledhje e ndryshimeve të raportit të fitimit marxhinal ndër vite	112
Tabela 7- Raporti i keshit për periudhën 2009-2016	116
Tabela 8- Përmbledhje e ndryshimeve të raportit të keshit ndër vite	120
Tabela 9- Përqindja e të ardhurave të Tvsh-së nga Doganat për vitin 2017 për Shqipërinë (Vlerat janë në mln lekë)	124
Tabela 10- Përqindja e të ardhurave të Tvsh-së nga Doganat për vitin 2017 për Kosovën (Vlerat janë në mijë euro)	125
Tabela 11- Numri i bizneseve nën/mbi pragun e TVSH-së	129
Tabela 12- Shkalla e hapjes së ekonomisë për Shqipërinë (Vlerat janë në mln lekë)	139
Tabela 13- Shkalla e hapjes së ekonomisë për Kosovën (Vlerat janë në Euro)	141
Tabela 14- Modeli 1, Analiza OLS, Vëzhgimet 2007-2017 (T=11) Variabël i varur: Rimbursimet e TVSH-së (Rasti i Shqipërisë)	148
Tabela 15- Përmbledhje e rezultateve për Grupin e parë të hipotezave, rasti i Shqipërisë	149
Tabela 16- Modeli 1 i përmirësuar, Analiza OLS, Vëzhgimet 2007-2017 (T=11) Variabël i varur: Rimbursimi i TVSH-së (Rasti i Shqipërisë)	150

Tabela 17- Modeli 2, Analiza OLS, Vëzhgimet 2007-2017 (T=11) Variabël i varur: Rimbursimet e TVSH-së (Rasti i Kosovës).....	153
Tabela 18- Përmbledhje e rezultateve për Grupin e parë të hipotezave, Rasti i Kosovës..	155
Tabela 19- Modeli 2 i përmirësuar, Analiza OLS, Vëzhgimet 2007-2017 (T=11) Variabël i varur: Rimbursimi i TVSH-së (Rasti i Kosovës)	156
Tabela 20- Statistikat përshkruese të të dhënave (të dhënat në miliardë).....	170
Tabela 21- Modeli 1, Analiza OLS, Vëzhgimet 2005-2017 (T=13) Variabël i varur: TA nga Tvsh-ja.....	171
Tabela 22- Përmbledhje e rezultateve për Grupin e dytë të hipotezave, Modeli i parë, rasti i Shqipërisë.....	174
Tabela 23- Llogaritja e statistikës së kontrollit F.....	177
Tabela 24- Modeli 1 i përmirësuar, Analiza OLS, Vëzhgimet 2005-2017 (T=13) Variabël i varur: TA nga Tvsh-ja.....	178
Tabela 25- Llogaritja e statistikës së kontrollit F.....	181
Tabela 26- Marrja e vendimit për testin Durbin Watson për vlerën ‘d’.....	183
Tabela 27- Statistikat përshkruese të të dhënave (Vlerat janë në milionë).....	185
Tabela 28- Modeli 2, Analiza OLS, Vëzhgimet 2005-2016 (T=12) Variabël i varur: TA nga Tvsh-ja.....	186
Tabela 29- Përmbledhje e rezultateve për Grupin e dytë të hipotezave, Modeli i dytë, rasti i Shqipërisë.....	188
Tabela 30- Modeli 2 i përmirësuar, Analiza OLS, Vëzhgimet 2005-2016 (T=12) Variabël i varur: TA nga Tvsh-ja.....	188
Tabela 31- Llogaritja e statistikës së kontrollit F.....	192
Tabela 32-Statistikat përshkruese të të dhënave (Vlerat janë në miliardë).....	195

Tabela 33-Modeli 3, Analiza OLS, Vëzhgimet 2005-2017 (T=13) Variabël i varur: TA nga Tvsh-ja	195
Tabela 34- Përmbledhje e rezultateve për Grupin e dytë të hipotezave, Modeli i tretë, rasti i Shqipërisë.....	197
Tabela 35-Modeli 3 i përmirësuar, Analiza OLS, Vëzhgimet 2005-2017 (T=13) Variabël i varur: TA nga Tvsh-ja	198
Tabela 36- Llogaritja e statistikës së kontrollit F	202
Tabela 37- Analiza OLS, Vëzhgimet 2002-2017 (T=16)	206
Tabela 38- Përmbledhje e rezultateve për Grupin e dytë të hipotezave, Modeli i katërt, rasti i Shqipërisë.....	208
Tabela 39- Krahasimi i shenjave të variablave, Grupi i parë i hipotezave, Rasti i Shqipërisë	216
Tabela 40- Krahasimi i shenjave të variablave, Grupi i parë i hipotezave, Rasti i Kosovës	216
Tabela 41- Krahasimi i shenjave të variablave, Grupi i dytë i hipotezave, Modeli i parë, Rasti i Shqipërisë	216
Tabela 42- Krahasimi i shenjave të variablave, Grupi i dytë i hipotezave, Modeli i dytë, Rasti i Shqipërisë	217
Tabela 43- Krahasimi i shenjave të variablave, Grupi i dytë i hipotezave, Modeli i tretë, Rasti i Shqipërisë	217
Tabela 44- Krahasimi i shenjave të variablave, Grupi i dytë i hipotezave, Modeli i katërt, Rasti i Shqipërisë	217

LISTA E SHKURTIMEVE

ALL	Albanian lekë
AMLF	Autoriteti i mbikëqyerjes së lojërave të fatit
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BE	Bashkimi European
CIS	Komunuelthi i Shteteve të pavarura
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
HS	Sistemi i Harmonizuar
OLS	Ordinary Least Squares
PBB	Produkti i brendshëm bruto
RFM	Raporti i fitimit marxhinal
RK	Republika e Kosovës
RSH	Republika e Shqipërisë
SITC	Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Tregtisë
Sh.A.	Shoqëri Aksionere
Sh.p.k.	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar
TA	Të ardhura
TVSH	Tatimi mbi vlerën e shtuar

KAPITULLI I: HYRJE

1.1. Parathënie

Një sistem ekonomie sikur ky në ditët e sotme ndikohet nga fenomene dhe situata nga më të ndryshmet. Është pikërisht sistemi i taksave dhe tatimeve ai i cili luan një rol të rëndësishëm në ekonominë e një vendi. Ndryshimet që rrjedhin prej këtij sistemi mund të nxisin rritjen dhe stabilitetin ekonomik në prespektiva afatgjata.

Një nga tatimet indirekte më të përfolura prej më shumë se gjashtëdhjetë viteve është tatimi mbi vlerën e shtuar. Ky tatim është diskutuar edhe në një kohë më të hershme, kur u propozua së pari nga Dr. Wilhelm Von Siemens në Gjermani në vitin 1919. Por aplikimi për herë të parë i TVSH-së daton më më 10 prill 1954 në Francë nga ekonomisti francez Maurice Lauré. Që prej asaj kohe ky tatim u përhap gjithnjë e më shumë edhe në vende të tjera, duke u kthyer në burimet më të rëndësishme të të hyrave qeveritare. Të ardhurat e qeverisë në përgjithësi mund të ndahen në dy të ardhura të mëdha të tilla si të ardhurat tatimore dhe të ardhurat jo-tatimore (Anojan, 2015:2). Një projeksion i kujdesshëm dhe efikas duhet të gjenerojë sa më shumë të hyra nga të dy grupet e të ardhurave për qeverinë. Qeveritë pothuajse në të gjithë botën zhvillojnë projekte të shumta për të mirat publike. Por zhvillimi i këtyre projekteve kërkon financim. (Esmaeel, 2013:9) pohon se rëndësia e rritjes së të ardhurave publike rrjedh nga nevoja e kryerjes së shpenzimeve publike. Mund të thuhet se detyrimisht qeverisë i shtrohet detyra e rëndësishme e sigurimit të fondeve. Pas sigurimit të të hyrave qeveritare, detyra e saj është menaxhimi, shpërndarja dhe investimi në mënyrën më të përshtatshme të mundshme. Meqënëse TVSH-ja në shumë vende mbart pjesën kryesore të të hyrave për qeverinë, analizimi i këtij tatimi në format nga më të ndryshme që arrijnë të prekin fusha shumë dimensionale, të ndikuara nga faktorë të jashtëm

e të brendshëm, është detyrë e studjuesve e analistëve të financës. (Stevanović, Djordje, & Slavko, 2015:111) theksojnë se është e domosdoshme të përcaktohen qartë masat e politikës ekonomike me pjesëmarrjen e të gjitha palëve të interesuara: shteti, komuniteti akademik, taksapaguesit, etj.

Pavarësisht që objektiv i një qeverie mund të jetë rritja e të ardhurave tatimore, kjo rritje nuk është një detyrë e lehtë. Transformimet e një tatimi japin efektet e tyre duke filluar nga familjet, bizneset dhe tek indikatorët makroekonomikë. Një ndryshim tatimor mund të ndikojë drejtëpërsëdrejti ose tërthorazi në mirëqënien e familjeve ose mbarëvajtjen e bizneseve. Duke u ndikuar nga mënyrat e modelet e ndryshuara, mjedisi politik e ekonomik dhe shumë indikatorë të tjerë, efektet dhe ndikimet mund të behen të dukshme edhe në periudhë afatshkurtër. Rendi i ndryshimeve tatimore duhet të jetë i fokusuar edhe tek prespektivat afatgjata për një stabilitet tatimor që siguron përveç të tjerave edhe ambient të favorshëm ekonomik. (Oordt 2016:28) në punimin e tij fokuson vëmendjen se vendet nuk duhet të përforcojnë përpjekjet në rritje të TVSH-së, p.sh. një rritje në normën standarte, por duhet të përmirësojnë edhe mjedisin ekonomik dhe institucional në të cilin TVSH-ja operon.

TVSH-ja si tatim ka avantazhet dhe disavantazhet e saja në përdorim. Tek avantazhet mund të përmendim se ky tatim është një e ardhur shtesë për financimin e qeverisë, ndërsa tek disavantazhet, siç theksohet edhe nga shumë autorë është efekti regresiv i TVSH-së.

Përgjatë pothuajse tre dekadave të fundit, Shqipëria ka pësuar ndryshime të mëdha. Janë pikërisht ndryshimet politike, sociale dhe ekonomike ato të cilat kanë pësuar revolucionet e vërteta dhe kontribuojnë direkt në stabilitetin e një vendi. Hartimi i legjislacionit tatimor në Shqipëri i ka fillimet në vitin 1991, periudhë në të cilën u formalizuan edhe aktet e para

ligjore. Në vitin 1992, që filloi të zbatohet legjislacioni tatimor, një ndër ligjet e hartuara ishte edhe ligji për tatimin mbi qarkullimin si tatim i tërthortë njëfazor, që u zbatua për produktin e gatshëm që hidhej në qarkullim të lirë civil brenda vendit. Ky ishte ligji i cili i paraprinte tatimit mbi vlerën e shtuar. Me dekretin Nr.1096, datë 12.05.1995, u vendos Tatimi mbi Vlerën e Shtuar duke zëvendësuar në këtë mënyrë tatimin mbi qarkullimin. Ky ligj hyri në fuqi në 1 korrik të vitit 1996 dhe shkalla tatimore e këtij tatimi ishte 12.5%. Pas këtij dekreti, në përshtatje edhe me situatën politike dhe ekonomike janë bërë ndryshime të shumta, duke përfshirë edhe normën, kufirin e regjistrimit, si edhe elementë të tjerë. Në vitin 1996 që është zbatuar për herë të parë, Tvsh-ja përbënte 32.4% të të Ardhurave Tatimore nga Tatimet dhe Doganat dhe 21.2% të të Ardhurave Totale Tatimore. Këto vlera kanë pasur luhatje, por të ardhurat nga TVSH-ja kanë zënë përgjithësisht një peshë të konsiderueshme përkundrejt të Ardhurave Totale Tatimore.

Duke parë rëndësinë e këtij tatimi në të hyrat qeveritare, natyrshëm lind diskutimi për të analizuar faktorët të cilët e ndikojnë këtë tatim, ndikimet që sjell tek sektorë të veçantë transformimi i TVSH-së për një seri kohore. Ndryshimet tatimore kanë ndikim tek performanca financiare e firmave, e cila në qoftë se përkeqësohet mund të shkurtojë vendet e punës, të cilat sjellin më pak të ardhura për familjet, ulje të mirëqënies, shfaqje të problemeve socio-ekonomike, etj. Të gjitha këto efekte zinxhir mund të shkaktohen nga administrimi dhe politikat e këtij tatimi.

Në këtë punim baza e studimit në lidhje me potencialin e efekteve të TVSH-së i referohet ekonomisë në Shqipëri. Por për të dhënë një pamje më të plotë të ndërveprimit të këtij tatimi, është marrë si krahasim edhe Kosova. Gjatë punimit është krahasuar historiku dhe aplikimi i TVSH-së në Shqipëri dhe Kosovë. Gjithashtu në një kapitull të veçantë është

kryer analiza e rimbursimit të TVSH-së nëpërmjet testimit të hipotezave. Është konsideruar e rëndësishme metoda e krahasimit për të njohur efektet që ka një tatim në dy ekonomi të ndryshme, për më tepër edhe fqinje.

1.2 Qëllimi i studimit

Qëllimi kryesor i këtij punimi konsiston në evidentimin e faktorëve të cilët ndikojnë në të ardhurat totale të TVSH-së në Shqipëri. Faktorët janë grupuar në katër modele të ndryshme, të cilat kanë të bëjnë me komponentë të tregtisë ndërkombëtare, komponentë të cilët lidhen me konsumin, komponentë të ndryshëm makroekonomikë, si edhe komponentë të evazionit fiskal. Duke testuar ndikimin e këtyreve faktorëve tek të ardhurat e TVSH-së në Shqipëri zbulohet lidhja e varësia që ekziston për ekonominë e Shqipërisë.

Ndërsa nën qëllimi i këtij studimi konsiston në evidentimin e faktorëve që ndikojnë në rimbursimin e TVSH-së si një temë e diskutuar ndërkombëtarisht. Nga analiza e kryer është evidentuar ndikimi i faktorëve të përzgjedhur tek rimbursimi i TVSH-së në Shqipëri. Për krahasim e njëjta analizë është zhvilluar edhe për Kosovën, për të parë ngjashmëritë ndërmjet dy ekonomive me pozicion gjeografik të afërt.

Rezultatet e këtij punimi ofrojnë një tablo të funksionimit dhe ndikimit të tatimit mbi vlerën e shtuar në ekonomi. Këto konkluzione mund t'iu shërbejnë politikbërësve për një administrim më të mirë të TVSH-së për prespektiva afatgjata, të argumentuara akademikisht. Ky punim ju shërben gjithashtu edhe menaxherëve të firmave, të cilët mund të planifikojnë mbarëvajtjen e performacës financiare në rastet e transformimeve të TVSH-së, si edhe të ecurisë së komponentëve të cilët ndikojnë në të ardhurat dhe rimbursimin e TVSH-së.

1.3 Objektivat e studimit

Objektivat e këtij studimi janë të rënditura siç më poshtë:

- Shqyrtimi i literaturës në lidhje me mënyrat se si TVSH-ja ndikon apo ndikohet nga komponentë të ndryshëm.
- Studimi i ndikimit të ndryshimeve ligjore të përjashtimit të barnave ose jo ndër vite, tek raporti i fitimit marxhinal dhe raportit të keshit për një grup farmacish në Shqipëri.
- Analizimin e produktivitetit dhe efikasitetit të TVSH-së në Shqipëri.
- Studimi i ndikimit të sjelljes së bizneseve në rastet e ndryshimeve të pragut të regjistrimit të TVSH-së.
- Studimi dhe krahasimi i ndikimit të hapjes ekonomike dhe PBB-së reale tek rimbursimi i TVSH-së në Shqipëri dhe Kosovë.
- Identifikimin dhe matjen e ndikimit të komponentëve të tregtisë ndërkombëtare tek të ardhurat e TVSH-së.
- Ndikimin e komponentëve të papunësisë, konsumit të familjeve dhe rritjes së PBB-së për frymë tek të ardhurat e TVSH-së.
- Ndikimin e komponentëve të PBB-së reale, inflacionit dhe shpenzimeve qeveritare tek të ardhurat e TVSH-së.
- Ndikimin e indeksit të përceptuar të korrupsionit tek të ardhurat e TVSH-së.

1.4 Pyetjet kërkimore

Siç është argumentuar edhe nga autorët nëpërmjet studimeve të realizuara më parë, ndikimi i taksave dhe tatimeve luan një rol të rëndësishëm në ekonominë e një vendi. Specifikimet e

këtij sistemi të ndërlidhur me faktorë të veçantë krijojnë një dinamikë zhvillimesh të gjithëanshme. Pyetja kërkimore kryesore:

Cilët janë faktorët që ndikojnë në nivelin e të ardhurave të TVSH-së në Shqipëri?

Ndërsa nënpyetja kërkimore e këtij punimi është:

- *Cilët faktorë ndikojnë në rimbursimin e TVSH-së në Shqipëri dhe Kosovë?*

1.5 Hipotezat e studimit

Në çështjen më sipër janë paraqitur pyetja kërkimore kryesore dhe nënpyetja kërkimore.

Për t'iu dhënë përgjigje këtyre pyetjeve kam ngritur hipotezat e mëposhtme.

Në këtë punim duke u nisur edhe nga vetë titulli i temës: “Potenciali i efekteve të TVSH-së në ekonomi”, studimi do të jetë i strukturuar në mënyra të ndryshme se si ky tatim ndikon apo ndikohet nga komponentë të ndryshëm. Hipotezat e studimit janë si më poshtë:

Grupi i parë i hipotezave të këtij punimi, ka si variabël të varur vlerat e rimbursimit të TVSH-së, ndërsa si variabla të pavarur ka hapjen ekonomike dhe PBB-në reale. Ky grup hipotezash synon t'i japë përgjigje nënpyetjes kërkimore. Në këtë grup përveç modelit me të dhënat përkatëse për Shqipërinë është zhvilluar edhe një model me të dhënat e Kosovës. Duke qenë se janë marrë në konsideratë dy shtete të ndryshme mund të nxirren edhe konkluzione mbi trendet ekonomike të këtyre dy vendeve. Si do të jetë ndikimi i variablave të pavarur mbi rimbursimin dhe a vërtetohet pohimi i mësipërm për RSH dhe RK vërtetohet në vijim të punimit. Hipotezat jepen më poshtë:

Hipoteza zero (H_0): Asnjë nga komponentët ekonomik nuk ndikon në rimbursimin e TVSH-së.

Hipoteza alternative (H_a): Të paktën njëri nga komponentët ekonomik ka ndikim në rimbursimin e TVSH-së.

$H_{0,1}$: Hapja ekonomike nuk ka ndikim në rimbursimin e TVSH-së.

$H_{a,1}$: Hapja ekonomike ka ndikim në rimbursimin e TVSH-së.

$H_{0,2}$: PBB-ja reale nuk ka ndikim në rimbursimin e TVSH-së.

$H_{a,2}$: PBB-ja reale ka ndikim në rimbursimin e TVSH-së.

Grupi i dytë i hipotezave është i ndarë në katër modele të ndryshme, me variabla të pavarur të cilët ndikojnë tek të ardhurat e TVSH-së në Shqipëri.

1. Modeli i parë i përcaktuesve të të ardhurave të TVSH-së në Shqipëri:

Hipoteza zero (H_0): Asnjë nga komponentët e tregtisë ndërkombëtare nuk ndikon në të ardhurat e Tvsh-së.

Hipoteza alternative (H_a): Të paktën njëri nga komponentët e tregtisë ndërkombëtare ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

$H_{0,1}$: Hapja ekonomike nuk ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

$H_{a,1}$: Hapja ekonomike ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

$H_{0,2}$: Rritja e importeve nuk ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

$H_{a,2}$: Rritja e importeve ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

$H_{0,3}$: Rritja e eksporteve nuk ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

$H_{a,3}$: Rritja e eksporteve ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

$H_{0,4}$: Volumi tregtar nuk ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

$H_{a,4}$: Volumi tregtar ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

2. Modeli i dytë i përcaktuesve të të ardhurave të TVSH-së në Shqipëri:

Hipoteza zero (H_0): Asnjë nga komponentët e tregut të punës dhe konsumit nuk ndikon në të ardhurat e Tvsh-së.

Hipoteza alternative (H_a): Të paktën njëri nga komponentët e tregut të punës dhe konsumit ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

$H_{0,1}$: Papunësia nuk ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

$H_{a,1}$: Papunësia ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

$H_{0,2}$: Konsumi i familjeve nuk ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

$H_{a,2}$: Konsumi i familjeve ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

$H_{0,3}$: Rritja e PBB-së për frymë nuk ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

$H_{a,3}$: Rritja e PBB-së për frymë ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

3. Modeli i tretë i përcaktuesve të të ardhurave të TVSH-së në Shqipëri:

Hipoteza zero (H_0): Asnjë nga komponentët makroekonomikë nuk ndikon në të ardhurat e Tvsh-së.

Hipoteza alternative (H_a): Të paktën njëri nga komponentët makroekonomikë ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

$H_{0,1}$: PBB reale nuk ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

$H_{a,1}$: PBB reale ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

$H_{0,2}$: Inflacioni nuk ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

$H_{a,2}$: Inflacioni ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

$H_{0,3}$: Shpenzimet qeveritare nuk kanë ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

$H_{a,3}$: Shpenzimet qeveritare kanë ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

4. Modeli i katërt i përcaktuesve të të ardhurave të TVSH-së në Shqipëri:

Hipoteza zero (H_0): Indeksi i përceptuar i korrupsionit nuk ndikon në të ardhurat e TVSH-së.


Hipoteza alternative (H_a): Indeksi i përceptuar i korrupsionit ka ndikim tek të ardhurat e TVSH-së.

1.6 Modelet konceptuale të punimit

Ky punim është i organizuar në dy modele të rëndësishme studimi. Nëpërmjet figurave të mëposhtme janë shpjeguar lidhjet që priten të nxirren nga ky studim. Në figurën 1 jepet modeli konceptual për grupin e parë të hipotezave që ka të bëjë me studimin e ndikimit të hapjes ekonomike dhe PBB-së reale tek rimbursimi i TVSH-së. Ndërsa në figurën 2 jepet modeli konceptual i përcaktuesve të të ardhurave të TVSH-së i ndarë në katër modele të veçanta.

Modeli konceptual për grupin e parë të hipotezave paraqitet më poshtë:


Figura 1- Modeli konceptual për grupin e parë të hipotezave



Burimi: Ilustrim nga autori

Ndërsa modeli konceptual për grupin e dytë të hipotezave, paraqitet më poshtë:

Figura 2 – Modeli konceptual për grupin e dytë të hipotezave



Burimi: Ilustrim nga autori

1.7 Metodologjia

Hapat në të cilat ka kaluar ky studim janë: rishikimi i literaturës, formulimi i pyetjes kryesore kërkimore dhe i nënpyetjes kërkimore, ngritja e hipotezave, identifikimi i modeleve konceptuale, përpunimi dhe analizimi i të dhënave dhe në fund nxjerrja e konkluzioneve dhe rekomandimeve.

Metodologjia e ndjekur gjatë këtij punimi është e bazuar tek metoda deduktive e kërkimit.

Ky punim mbështetet kryesisht në të dhëna sekondare, të cilat konsistojnë në:

- Shfrytëzimin e literaturës në lidhje me konceptet e sistemit tatimor, llojeve të tatimeve, duke u përqëndruar kryesisht tek TVSH-ja me specifikimet dhe aplikimet e saj.
- Shfrytëzimin e literaturës duke iu referuar studimeve të autorëve e analistëve rreth tatimit mbi vlerën e shtuar, modeleve që kanë zhvilluar në përpjekje për të zbuluar përcaktuesit dhe faktorët që e ndikojnë këtë tatim. Gjithashtu i kam kushtuar vëmendje edhe studimeve sesi TVSH-ja ndikon në komponentë specifike. Punimet e tyre janë marrë kryesisht nga librat, faqet e internetit dhe revistat shkencore.

Në këtë punim janë përdorur metodat sasiore. Kjo metodë është konsideruar më efikase sepse në këtë metodë hulumtuesi e di se çfarë është duke kërkuar dhe mbledhja e përpunimi i të dhënave të cilat janë të strukturuar mund të paraqiten në mënyrë numerike.

Këto analiza janë shumë të rëndësishme për t’iu dhënë përgjigje pyetjeve kërkimore nëpërmjet hipotezave të ngritura. Është realizuar një kërkim dhe përpunim i kujdesshëm i të dhënave, në mënyrë të tillë që të kemi rezultate sa më të besueshme dhe të vlefshme.

Për të mbështetur këtë punim, të dhënat që do t’i nënshtrohen përpunimit statistikor, janë siguruar kryesisht nga Instati, QKB-ja, Ministria e Financave RSH, Agjensia e Statistikave të Kosovës dhe Banka Qëndrore e RK-ës. Për përpunimin e të dhënave dhe modeleve është përdorur programi Gretl. Në këtë studim janë përdorur metodat e analizës së regresionit të thjeshtë e të shumëfishtë.

Variabli i hapjes ekonomike është llogaritur për qëllime të këtij punimi, ndërsa të dhënat e variablave të tjerë janë marrë nga institucionet e mësipërme. Janë ndërtuar dy grupe hipotezash për t’iu dhënë përgjigje dy pyetjeve kërkimore.

Grupi i parë i hipotezave i referohet zbulimit të ndikimit të dy variablave tek rimbursimi i TVSH-së në Shqipëri dhe Kosovë dhe ky grup hipotezash i jep përgjigje nënpyetjes së këtij punimi. Tek modeli i rimbursimit është përshkruar ecuria e gjithë variablave të zgjedhur, është kryer analiza OLS dhe kontrolli individual për koeficientët e regresionit.

Grupi i dytë i hipotezave i referohet zbulimit të ndikimit të 11-të variablave, të ndarë në katër modele të veçanta tek të ardhurat e TVSH-së në Shqipëri dhe nga ky model marrim përgjigjen për pyetjen kërkimore kryesore të punimit. Tek modeli i të ardhurave të TVSH-së është përshkruar ecuria e gjithë variablave të zgjedhur. Për tre modelet e para është kryer analiza OLS, kontrolli individual për koeficientët e regresionit, kontrolli global për koeficientin e determinacionit (R^2) dhe autokorrelacioni. Në modelin e katërt kemi përdorur regresionin e thjeshtë duke kryer analizën OLS.

Një analizë e veçantë e këtij punimi është ndikimi i transformimit të TVSH-së tek raportet financiare, ku janë marrë në studim 25 farmaci. Për ndërtimin e raporteve financiare të këtyreve firmave, për një saktësi më të madhe, kam përdorur informacionin e deklaruar të pasqyrave financiare, të publikuara në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB). Kam përdorur të dhënat e bilancit kontabël dhe pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve. Nga këto dy pasqyra kam marrë të dhënat e zërave të nevojshëm për analizë.

Analizat e këtij studimi janë kryer me metodën përshkruese, krahasuese dhe metodën statistikore. Metoda përshkruese është përdorur për të zbuluar shkaqet dhe pasojat, që nga nxjerrja e rezultateve të formulojmë konkluzione të vlefshme.

Nga analiza e kryer me metodën krahasuese është evidentuar ndikimi i faktorëve të përzgjedhur tek rimbursimi i TVSH-së në Shqipëri dhe Kosovë, për të parë ngjashmëritë ndërmjet dy ekonomive me pozicion gjeografik të afërt.

Ndërsa metoda statistikore është pjesë e rëndësishme e këtij punimi, nëpërmjet të cilës i janë dhënë përgjigje pyetjeve kërkimore.

1.8 Rëndësia e punimit

Nisur nga pesha e konsiderueshme që zë TVSH-ja në të ardhurat totale tatimore, është i rëndësishëm studimi i këtij tatimi në një kontekst të gjërë. Një mënyrë efikase është analizimi i përcaktuesve të cilët ndikojnë në rritjen e këtyre të hyrave. Duke njohur ndikimin e faktorëve të ndryshëm që kanë mbi të hyrat e TVSH-së, në bazë të luhatshmërisë së faktorëve planifikohen strategjitë më të mira të mundshme në situatat specifike. Nga testimi i hipotezave do të vihet në pah ndikimi i hapjes ekonomike, rritjes së importeve e eksporteve, volumit tregtar, papunësisë, konsumit të familjeve, rritjes së PBB-së për frymë, PBB-së reale, inflacionit, shpenzimeve qeveritare dhe indeksit të perceptuar të korrupsionit tek të ardhurat e TVSH-së. Përderisa TVSH-ja është një tatim indirekt që paguhet nga konsumatori dhe derdhet në buxhetin e shtetit nga ata persona që janë shitës të produkteve, mallrave e shërbimeve, kjo do të thotë se për grupet e interesit rreth këtij tatimi do të ishte interesant një studim sado i thjeshtë që shpreh ndikimin e komponentëve të mësipërm.

Nëpërmjet hipotezave do të vërtetohet varësia e hapjes ekonomike dhe PBB-së reale me rimbursimet e TVSH-së në Shqipëri dhe Kosovë.

Menaxherët e firmave kanë mundësi të informohen rreth efekteve që sjell një ndryshim ligjor në lidhje me TVSH-në. Më konkretisht, drejtuesit dhe menaxherët e farmacive në Shqipëri do të kenë një studim që tregon efektet e transformimit të TVSH-së në raportet financiare. Ata do të kenë mundësi të bëjnë rregullime dhe ristrukturime financiare për të mos pasur pasoja negative në këto raporte në rastet e ndryshimeve tatimore.

Ky punim do të shtojë vlerë në plotësimin e koncepteve dhe funksionimit të tatimit mbi vlerën e shtuar. Rezultatet e këtij punimi mund të përdoren si baza krahasimi për vendet e tjera sesi ndikojnë këto përcaktues në ekonominë e tyre, por jo vetëm, konkluzionet që paraqet ky punim mund të përdoren si bazë krahasimi edhe për vetë Shqipërinë në periudha të mëvonshme.

Së fundmi, rezultatet e këtij punimi të argumentuara akademikisht duhet t'iu shërbejnë politikbërësve për një administrim më të mirë të TVSH-së për prespektiva afatgjata. Në strategjitë e tyre politike e ekonomike mund të merren në konsideratë ndërveprimet e komponentëve të shumtë që janë paraqitur gjatë punimit.

1.9 Kufizimet e punimit

Kufizim i këtij punimi është numri i periudhave të marra në studim. Nga të gjitha analizat e zhvilluara, numri maksimal ka qenë 16 periudha. Në qoftë se do të kishim më shumë periudha, analiza e studimit mendoj se do të ishte më e plotë.

Kufizim tjetër i punimit është se periudha kur është dorëzuar ky punim është gjatë vitit 2018 dhe në disa analiza kam përdorur si periudhën e fundit kohore vitin 2016, sepse nuk kam mundur të siguroj informacionin e plotë për të gjitha firmat ose komponentët deri në vitin 2017.

Një analizë e bazuar sipas qarqeve besoj se do të ishte interesante për të vënë në pah nëse ka luhatje dhe ndryshime. Por një analizë e tillë kufizohet nga mangësia e gjetjes së informacionit për të gjithë variablat që janë marrë në konsideratë gjatë modeleve, në seri kohore sipas 12-të qarqeve në Shqipëri.

Meqënëse gjatë punimit për llogaritjen e raporteve kam përdorur të dhënat e pasqyrave financiare të deklaruara në QKB, kemi të bëjmë me një kufizim të punimit, sepse në Shqipëri është e njohur tendenca për të mos deklaruar tërësisht informacionin real.

Për shkak të limitimeve të strukturës së punimit, numri i farmacive të marra në studim për ndikimin e transformimit të TVSH-së është vetëm 25 për një seri kohore tetë vite, duke filluar nga viti 2009 deri në vitin 2016. Është e vështirë të zgjerohet më tepër periudha kohore duke qenë se farmacitë të cilat kanë depozituar pranë QKB-së bilancet e vitit 2007 dhe 2008 janë shumë të pakta. Gjithashtu është hasur vështirësi edhe në sigurimin e informacionit kontabël për vitin 2017, i cili ka pasur afat të dorëzohet deri më 31 korrik të vitit 2018, sipas shkronjës “a” të nenit 43/3 të ligjit 9723/2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar. Një kufizim tjetër është se subjektet nuk i kanë të depozituara pranë QKB-së të gjitha pasqyrat financiare për periudhën e zgjedhur për studim.

Shqipëria numëron 1679 farmaci në të gjithë territorin e saj, (Scan, 2018). Meqënëse jam duke studjuar raportin e keshit dhe fitimit marxhinal kam zgjedhur farmacitë me formën ligjore Sh.p.k. ose Sh.A. Gjithashtu vlen të përmendet se nga numri total i farmacive një pjesë e tyre janë të regjistruara në formën ligjore si Person Fizik.

Një sugjerim i imi do të ishte marrja e një numri më të madh farmacish për të analizuar efektin në një numër më të madh firmash të kësaj industrie. Ndoshta kjo çështje mund të studjohet më gjërësisht si një temë me vete.

1.10 Struktura e punimit

Ky punim është i strukturuar në shtatë kapituj siç më poshtë:

Kapitulli i parë fillon me trajtimin e hyrjes, ku kam paraqitur rëndësinë e sistemit të taksave dhe të tatimeve dhe më specifikisht të peshës që mbart tatimi mbi vlerën e shtuar në një ekonomi. Në vijim kam dhënë qëllimin e punimit, objektivat që kam synuar të arrij nga ky punim. Kam dhënë një paraqitje të hipotezave dhe modeleve konceptuale që kam parashtruar gjatë punimit. Kapitulli vazhdon me metodologjinë që kam përdorur për finalizimin e këtij punimi, rëndësinë e punimet si edhe kufizimet për këtë studim.

Kapitulli i dytë paraqet një rishikim të literaturës mbi çështjet teorike dhe paraqitje të studimeve të ndryshme. Në pjesën e parë të këtij kapitulli paraqitet se çfarë simbolizon sistemi i taksave dhe tatimeve, duke dhënë në vijim rëndësinë e këtij sistemi sesi ndikon në stabilitetin ekonomik, në stimulimin e bizneseve të një vendi e në thithjen e bizneseve të huaja, por edhe ndikimin e sistemit tatimor dhe fiskal tek komponentët makroekonomikë. Në vijim jepet dizenjimi i sistemit tatimor e krahasimet nga autorë të ndryshëm të efekteve të tatimeve direkte dhe indirekte. Gjithashtu kam trajtuar rëndësinë e efikasitetit të administratës tatimore në aspekte të ndryshme, por edhe në ndikimin e miratimit të TVSH-së, dhe në fund të pjesës së parë kam trajtuar boshllëkun tatimor.

Në pjesën e dytë kam paraqitur argumentet e rëndësisë së TVSH-së, avantazhet dhe disavantazhet e përdorimit të këtij tatimi, mënyrat dhe efektet e stimulimit të të ardhurave tatimore nga TVSH-ja. Kjo pjesë vazhdon me argumentet e diferencimit të normave të TVSH-së apo përdorimin e një norme të vetme, ndikimet e rritjes dhe uljes së normës së TVSH-së, zgjedhjen e nivelit optimal të pragut të regjistrimit të TVSH-së, qëndrimet ndaj përjashtimit të TVSH-së, si edhe aspekte nga rimbursimi i TVSH-së.

Në pjesën e tretë kam trajtuar ndikimin e TVSH-së tek faktorët makroekonomikë, ndikimin e TVSH-së në tregtinë ndërkombëtare, ndikimin e TVSH-së tek konsumi, si edhe ndikimin e TVSH-së tek raportet e likuiditetit.

Në pjesën e katërt kam trajtuar faktorët që nxisin shoqërinë për tatimet, kam paraqitur të dhëna nga përdorimi i TVSH-së në botë, si edhe diskutime për evazionin fiskal.

Kapitulli i tretë paraqet tablonë e sistemit tatimor, zhvillimin e refomave fiskale dhe llojet e tatimeve dhe taksave që aplikohen në Shqipëri. Në pjesën e dytë jepet një trajtim i tatimit mbi vlerën e shtuar, si lindi aplikimi i këtij tatimi në botë, e pastaj kam trajtuar edhe historikun e TVSH-së europiane dhe harmonizimit të TVSH-së. Kapitulli vazhdon me historikun e zhvillimit dhe aplikimit të këtij tatimi në Shqipëri. Meqënëse gjatë këtij punimi kam përdorur për krahasim modelet e gjeneruara nga ekonomia e Kosovës, kam trajtuar edhe historikun e Tvsh-së në Kosovë, si edhe një vështrim mbi aplikimin e tij tek ky vend. Gjithashtu në pjesën e fundit të këtij kapitulli kam dhënë një tablo të ambientit fiskal, barrës tatimore, normave tatimore në Shqipëri, Kosovë dhe Ballkan për vitin 2017, si edhe krahasim të kostove tatimore në Ballkan.

Kapitulli i katërt paraqet analiza të TVSH-së në dimensione të ndryshme. Kapitulli fillon me efektet e transformimit të TVSH-së për barnat tek raportet financiare. Kam dhënë një panoramë të tregut farmaceutik në Shqipëri, ndryshimet ligjore për përjashtimin ose jo të barnave në vite, kriteret e përzgjedhjes së farmacive dhe ndërtimin e modelit për studim. Në vazhdim kam kryer analizën e raportit të fitimit marxhinal dhe raportit të keshit për 25 farmaci që operojnë në RSH.

Në vijim të këtij kapitulli kam studjuar çështjet e peshës së të ardhurave të TVSH-së që mbledhen në doganë, analizë të produktivitetit dhe efikasitetit të TVSH-së në Shqipëri dhe në fund kam trajtuar sjelljen e bizneseve sipas pragut të regjistrimit të TVSH-së në Kosovë.

Kapitulli i pestë paraqet analizën e modelit të rimbursimit të TVSH-së. Në këtë kapitull synohet të vërtetohet hipoteza se a ndikojnë hapja ekonomike dhe PBB-ja reale në rritjen e rimbursimit të TVSH-së. Kam paraqitur në pjesën e parë kuadrin ligjor për rimbursimin në Kosovë dhe Shqipëri. Në vijim kam paraqitur mundësitë për mashtrime e evazion fiskal që vijnë nga skema e rimbursimit të TVSH-së. Kapitulli vazhdon me trajtimin e ecurisë së variablave të pavarur dhe të varur për secilin nga shtetet e zgjedhura për studim. Dhe së fundmi kam kryer analizat e modelit të regresionit të shumës për të parë ndikimet e variablave në një kontekst krahasues ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës.

Kapitulli i gjashtë paraqet analizën e modelit të ndikimit të përcaktuesve të ndryshëm tek të ardhurat e TVSH-së. Në këtë kapitull do të vërtetohen hipotezat e ndikimit të variablave të pavarur të grupuar në katër modele. Në modelin e parë kam studjuar ndikimin e hapjes ekonomike, rritjes së importeve, rritjes së eksporteve dhe volumit tregtar tek të ardhurat e TVSH-së. Në modelin e dytë kam studjuar ndikimin e papunësisë, konsumit të familjeve dhe rritjes së PBB-së për frymë tek të ardhurat e TVSH-së. Në modelin e tretë kam studjuar ndikimin e PBB-së reale, inflacionit dhe shpenzimeve qeveritare tek të ardhurat e TVSH-së. Ndërsa në modelin e katërt kam studjuar ndikimin që ka indeksi i perceptuar i korrupsionit tek të ardhurat e TVSH-së.

Kapitulli i shtatë paraqet konkluzionet e përgjithshme të arritura nga analizat e shumta të këtij punimi dhe rekomandimet e mia për temën e studjuar. Në fund të këtij kapitulli kam dhënë sugjerimet e mia për studime të metejshme.

KAPITULLI II: RISHIKIMI I LITERATURËS

2.1 Sistemi i taksave dhe tatimeve

Shumë autorë janë shprehur se vendosja e taksave në vetvete është një transferim i burimeve që nis që nga familjet, e pastaj edhe nga bizneset, për të mbërritur tek të hyrat e qeverisë.

Sipas Benjamin Franklin: “Në botën tonë asgjë nuk është e sigurtë përveç vdekjes dhe taksave”. Taksat dhe tatimet janë një nga mjetet kryesore të përdorura nga qeveria në financimin e administratës publike, menaxhimin e politikës monetare, financimi i shërbimeve sociale e ekonomike, si edhe mirëmbajtjen e shtetit të mirëqenies, (Juddoo, 2014:500).

Taksimën disa autorë e konsiderojnë edhe si një art me vete. (Bird & Gendron, 2007:141) shprehen se ndryshimet në strukturën tatimore vijnë si pasojë e ndryshimeve administrative dhe si objekt i qëllimeve politike. Ata pohojnë se sistemet e hershme tatimore në të gjitha vendet vareshin kryesisht nga taksat mbi artikujt fizikë, (kontrollin, numërimin dhe verifikimin).

Autorë të ndryshëm kanë dhënë mendime të ndryshme mbi funksionet dhe qëllimet e sistemit të taksave dhe tatimeve. (Kindsfaterienė & Lukaševičius, 2008:70) pohojnë se sistemi i taksave është një nga mekanizmat më themelore që përcaktojnë zhvillimin e ekonomisë dhe sigurojnë që funksionet më të rëndësishme të një shteti të ekzekutohen. Nga ana tjetër ata argumentojnë se financimi i sektorit publik varet nga efektiviteti i sistemit të taksave dhe nivelit ekonomik të shtetit.

Anna Moździerz në punimin e saj argumenton:

Taksat u japin autoriteteve fiskale mjete për të ndikuar në çmimet. Rindërtimi i sistemit tatimor drejt një shpërndarjeje të barabartë të tatimit ndërmjet taksave të drejtëpërdrejta dhe indirekte do të ndihmonte në zvogëlimin e presioneve inflacioniste (Moździerz, 2017:265).

Autorja e mësipërme lidh funksionin e sistemit tatimor në efektin e indikatorëve makroekonomikë, siç është inflacioni. Ndërsa (Kalaš, Milenković, Pjanić, Andrašić & Milenković, 2017:122) pohojnë se taksat reflektojnë një mjet të rëndësishëm për qeverinë dhe funksioni i tyre kryesor është për të mbledhur fonde për të financuar dhe mbuluar shpenzimet publike.

2.1.1 Rëndësia e sistemit tatimor dhe fiskal

Sistemi tatimor dhe ai fiskal kanë një rëndësi të madhe në ekonominë e një vendi, e ndërlidhur në dimensione të ndryshme. (Kindsfaterienė & Lukaševičius, 2008:75) kanë arritur në përfundimet e mëposhtme në lidhje me rëndësinë e sistemit tatimor:

- Vendimet lidhur me investimet e bizneseve janë shpesh të kushtëzuara nga faktorë ekonomikë, të tilla si liberalizimi i politikës tatimore, madhësia e barrës totale tatimore, niveli i tatimit mbi të ardhurat.
- Një sistem i balancuar i taksave është i rëndësishëm për formimin e një mjedisi miqësor për investime dhe motivimin e biznesmenëve.
- Madhësia e tatimit mbi fitimin është një përcaktues i rëndësishëm i vendimeve të një sipërmarrësi në lidhje me zhvillimin, zgjerimin e efikasitetit, shpërndarjen e fitimit dhe investimet tek një biznes.

- Normat më të larta tatimore nuk garantojnë të hyra më të larta tatimore, por përkundrazi i nxit sipërmarrësit për të fshehur të ardhurat reale të firmave.
- Normat e ulëta tatimore nxisin zhvillimin intensiv të ekonomisë. Një fakt i tillë sipas autorëve të mësipërm pasqyrohet në Lituanë, ku përmirësimi i mjedisit të biznesit nga përmirësimet e sistemit tatimor dhe masat e tjera krijuan parakushte për ritmet e larta të rritjes së prodhimit të brendshëm bruto, të cilat ishin më të larta se mesatarja e BE-së dhe nivel më të lartë të rritjes ekonomike.

Ndikimi i taksimit duhet të studjohet edhe në kontekstin e ndikimeve makroekonomike. (Gacanja 2009:41-42) kreu një studim me qëllim për të zbuluar nëse ekzistonte ndonjë marrëdhënie ndërmjet taksimit dhe rritjes ekonomike dhe më tej të përcaktojë shkakun midis variablave të të ardhurave në rekomandimet e politikave fiskale. Rezultatet e studimit zbuluan një marrëdhënie pozitive midis rritjes ekonomike dhe taksimit. Të gjitha variablat tatimorë kanë treguar një efekt pozitiv në PBB-në duke filluar me tatimin mbi të ardhurat, i cili reflekton më shumë efekt, i ndjekur nga raporti i tatimit në shitjet me TVSH-në, pastaj akciza dhe në fund detyrimet e importit që japin një efekt më të ulët. Gjithashtu u konkludua se ekziston një marrëdhënie afatgjatë midis rritjes ekonomike dhe taksimit. Duke parë rëndësinë e sistemit tatimor në prespektiva afatgjata, siç është rritja ekonomike, përpara politikbërësve shtrohet problemi i një rregullimi dhe bashkërendimi i sistemit tatimor në mënyrë sa më efektive.

Nga ana tjetër (Mehrara & Farahani 2015:54), në studimin e kryer kanë konstatuar se të ardhurat më të larta tatimore kanë një efekt pozitiv në stabilitetin ekonomik dhe evazionin më të lartë të taksave ka një ndikim negativ në stabilitetin ekonomik. Kjo tregon se vendet me nivel më të lartë tatimesh përjetojnë një ekonomi më të qëndrueshme. Më tej shton se

meqenëse këto vende kanë sistem buxhetor të bazuar në tatim, gjatë periudhave të recesionit, qeveritë mund të manipulojnë politikën tatimore si përjashtimet tatimore, kreditë tatimore dhe zbritjet tatimore si stimuj ekonomikë për të kompensuar efektet negative të recesionit.

Rëndësinë e politikës fiskale si një mjet i rëndësishëm ekonomik me të cilën qeveria mund të stimulojë zhvillimin ekonomik, e kanë përkrahur shumë autorë. (Hajdúchová, Sedliačiková & Viszlai, 2015:676) pohojnë se instrumenti bazë i politikës fiskale të shtetit është buxheti i shtetit, i cili akumulon të ardhurat e qeverisë dhe i transformon ato në shpenzime qeveritare. Përveç taksave, të cilat paguhen nga individë dhe persona juridikë, në të ardhurat e shtetit përfshihen gjithashtu të ardhurat nga tatimet, kontributet, detyrimet, importet dhe eksportet, tarifatat, të hyrat nga shitjet e letrave me vlerë të qeverisë etj. (Harumová, 2002)¹.

Rezultatet e analizës së kryer nga (Hajdúchová, Sedliačiková & Viszlai, 2015:680), tregojnë një tendencë në rritje të të ardhurave tatimore në proporcion me buxhetin e shtetit. Në çdo vend mënyra se si menaxhohen të ardhurat qeveritare dhe sa më e lartë do të jetë pjesa e fondeve të përdorura për investime në zhvillimin e biznesit mund të arrihet në rritjen ekonomike dhe rritjen e punësimit (Hajdúchová, Sedliačiková & Viszlai, 2015:681).

2.1.2 Dizajnimi i sistemit tatimor

Dizajnimi i sistemit tatimor në një kontekst të gjërë do të krijonte lehtësira për grupe të ndryshme, duke filluar nga mirëfunksionimi deri tek stabiliteti në shumë drejtime. (Kalaš, Milenković, Pjanić, Andrašić & Milenković, 2017:122) shprehen se një mënyrë e

¹ Marrë nga: Hajdúchová I., Sedliačiková M., and Viszlai I., (2015) “*Value-added Tax Impact on the State Budget Expenditures and Incomes*” *Procedia Economics and Finance* 34, 677.

përshtatshme e dizenjimit të sistemit tatimor, e përcaktuar në mënyrë optimale lehtëson funksionimin e ekonomisë dhe kontribuon në rritjen ekonomike. Një nga synimet e sistemit tatimor është mbledhja e të ardhurave. Por pasi këto të ardhura mbledhen shtohet çështja se si do të shpërndahen në mënyrë optimale.

Carlotta Greci në punimin e saj pohon se:

Dizajni i një sistemi tatimor dhe modelimi i reformave tatimore janë gjithmonë rezultat i një kompromisi midis objektivave të të ardhurave dhe çështjeve të shpërndarjes me të cilat ballafaqohen politikëbërësit. Balanca midis këtyre dy objektivave përcakton fushëveprimin e ndërhyrjes së taksave dhe kërkon metoda adekuate për të vlerësuar efikasitetin e përgjithshëm të sistemit të preferuar të taksave në arritjen e qëllimeve të tij, (Greci, 2015:5).

Përsa i përket kufizimeve institucionale dhe rëndësinë e tyre, Åsa Hansson, Susan Porter dhe Susan Perry Williams argumentojnë se:

Vendet me nivele të larta të kufizimeve institucionale kanë më shumë gjasa të përdorin stimujt e taksave për të stimuluar sektorin e biznesit, ndërsa të gjitha aspektet e kostove të transaksioneve qeveritare ndikojnë në normën e tatimit ligjor. Ky studim thekson rëndësinë e marrjes parasysh të të dyja aspekteve politike dhe faktorët ekonomikë gjatë ekzaminimit të taksave ndër-shtetërore. Këto faktorë mund të jenë thelbësorë për tërheqjen e investimeve të huaja direkte, për qëndrueshmërinë dhe rritjen e biznesit vendas, si edhe për një konkurrim denjitoz ndërkombëtarisht, (Hansson, Porter & Williams 2012:19).

Në një këndvështrim tjetër sistemi tatimor mund të krijojë efekte dhe stimuj tek bizneset. (Chen, 2015:5) pohon se stimujt e taksave mund të ndihmojnë në kompensimin e

projekteve të investimit që mund të prodhojnë ekstranalitete pozitive për shoqërinë. Gjithashtu ata mund të jenë një mjet i qartë që synon vetëm industrinë e re dhe të ndyshueshme që janë shumë të ndjeshme ndaj konkurrencës tatimore pa shkaktuar humbje të ardhurash aktiviteteve ekzistuese kryesore dhe të paluajtshme.

Tatimet dhe taksat duhet t'i përgjigjen katër parimeve:

- Parimit të *ligjshmërisë*, sipas të cilit rregullat, vlerat dhe mënyrat e mbledhjes së tatimeve e taksave të të gjitha llojeve duhet të fiksohen nëpërmjet ligjit, domethënë të votohen në parlament.
- Parimit të *vjetor*, sipas të cilit parlamenti duhet t'i jap çdo vit qeverisë autorizimin e mbledhjes së tatimeve e taksave.
- Parimit të *barazisë*, sipas të cilit kontributi i përbashkët duhet të jetë gjithashtu i shpërndarë midis qytetarëve për shkak të mundësive të tyre.
- Parimit të *nevojës*, (Shtetiweb, 2012).

Sipas përkufizimeve të literaturës së financave publike tatimet dhe taksat ndahen në dy grupe: tatimet e taksat direkte dhe tatimet e taksat indirekte. Në grupin e parë përfshihen ato tatime e taksa që llogariten mbi të ardhurat, fitimet, pasuritë e paluajtëshme dhe shërbimet publike të personave konkret fizik e juridik dhe duhet të derdhën në buxhetin e shtetit po prej tyre. Në këtë grup përfshihen tatimi mbi të ardhurat, tatimi mbi fitimin, tatimi mbi pasurinë etj. Tatimet dhe taksat direkte mund të vendosen në mënyrë *proporcionale* (të njëjtën përqindje për të gjithë kontribuesit) ose progresive (përqindja rritet në përputhje me shumën që tatohet).

Ndërsa nga ana tjetër *tatimet dhe taksat indirekte* janë ato tatime dhe taksa që përfshihen në madhësinë e çmimit të produkteve, të mallrave e të shërbimeve të ndryshme, dhe paguhen

si pjesë e këtyre çmimeve nga konsumatorët dhe derdhen në buxhetin e shtetit nga ata persona që janë shitës të produkteve, mallrave e sherbimeve. Në tatimet dhe taksat indirekte bëjnë pjesë: tatimi mbi vlerën e shtuar, taksat doganore, akciza, etj.

Duke qenë dy lloje tatimesh dhe taksash të ndryshme ata japin efekte të ndryshme në ekonomi. Ndryshueshmëria e tyre është bërë iniciativë për autorë të ndryshëm për të kryer analiza dhe studime të thelluara.

(Stoilova & Patonov, 2012:1038) kanë kryer një krahasim ndërmjet ndikimeve të të ardhurave tatimore të akumuluar nga dy llojet e taksave, direkte dhe indirekte. Rezultatet e tyre tregojnë për një efikasitet më të ulët të taksave indirekte si një metodë e akumulimit të të ardhurave buxhetore. Autorët argumentojnë se ky fakt vjen për shkak të shtrirjes së konsiderueshme të pabarazisë të taksave indirekte dhe uljen e efekteve në prodhim dhe shitje. Ata mbrojnë idenë se struktura tatimore e bazuar në taksat direkte është më efikase në drejtim të mbështetjes së rritjes së ekonomisë në vendet e BE-së. Megjithatë nisur nga analizat e shumta të taksave autorët konkludojnë se është e vështirë për të arritur konkluzione përfundimtare.

Nga ana tjetër (Aamir, Qayyum, Nasir, Hussain, Khan & Butt, 2011:177) në punimin e tyre krahasues të të ardhurave tatimore nga taksimi direkt dhe indirekt për Pakistanin dhe Indinë arritën në përfundimin se Pakistani ka një politikë të favorshme për përdorimin e taksave indirekte ndërkohë që India gjeneron më shumë të ardhura nëpërmjet taksave direkte. Autorët japin sugjerime për veprime korrigjuese për Pakistanin drejtuar analistëve të taksave të planifikimeve afatgjata. Për të zvogëluar evazionin fiskal, autorët sugjerojnë se baza tatimore duhet të rritet për të gjeneruar më shumë të ardhura dhe korrupsionit duhet t'i kushtohet një vëmendje e lartë si një problem kryesor për ekonominë.

Siç u përmend edhe më sipër në klasifikimin e taksave dhe tatimeve TVSH-ja përfshihet në grupin e taksave indirekte. Përkatësia në këtë grup i jep këtij tatimi një efekt tjetër në ekuilibrin e tregut.

Alberts Auziņš, Aleksejs Nipers & Vulfs Kozlinskis në punimin e tyre kanë arritur në përfundimin se:

TVSH ka një efekt mjaft të veçantë në ekuilibrin e tregut. Mekanizmi i TVSH-së që ndikon në ekuilibrin e tregut ndryshon nga efekti i taksave direkte dhe indirekte. Kjo vjen si pasojë e ndikimit të TVSH-së në ekuilibrin e tregut, në rastin e konsumatorëve, duke ndikuar në të ardhurat marginale të firmës (shitësit) pa ndikuar në vetë kërkesën, (Auziņš, Nipers & Kozlinskis, 2008:21).

2.1.3 Efikasiteti i administratës tatimore dhe TVSH-së

Pikësynimet e qarta janë thelbësore për mbarëvajtjen e çdo projekti apo politike. Në rastin e masave të politikës ekonomike dhe tatimore qëllimet e mirëfokusuara janë thelbësore. (Mirjana, Djordje & Slavko, 2015:111) theksojnë se është e domosdoshme të përcaktohen qartë masat e politikës ekonomike me pjesëmarrjen e të gjitha palëve të interesuara: shteti, komuniteti akademik, taksapaguesit, etj. Më tej ata ngrenë pyetjen se a duhet të bëhet një analizë e detajuar e politikave të mëparshme ekonomike dhe tatimore, si dhe rezultatet që ata kanë prodhuar realisht. Çfarë reformash tatimore duhen të zbatohen për stabilizimin e financave publike dhe rrjedhje më të mëdha të të ardhurave tatimore. Kthimi prapa në histori është një mënyrë efikase për të nxjerrë tiparet më të mira të politikës ekonomike dhe tatimore në vite, sepse është pikërisht e kaluara e cila mund të nxjerr leksionet për të ardhmen e tatimeve.

(Mirjana, Djordje & Slavko, 2015:111) sugjerojnë se për të pasur stabilitet dhe siguri në operacionet e biznesit duhen institucione të forta shtetërore, legjislacion që duhet të zbatohet në mënyrë të barabartë (jo selektive) për të gjithë pjesëmarrësit dhe jetën ekonomike të shtetit, një taksim i qëndrueshëm, si dhe një administratë efikase tatimore. Me këto parakushte do të ketë një efikasitet në grumbullimin e taksave, tërheqje të investimeve të huaja direkte, një mjedis të favorshëm për bizneset, mundësi për krijimin e firmave të reja etj.

Shumë autorë kanë dhënë argumentet e tyre mbi atë se çfarë ofron një sistem i mirë tatimor. Një dimension është se tatimi duhet të jetë efikas, pra nuk duhet të shkaktojë shtrembërime shumë të mëdha në ekonomi (Jansen & Calitz, 2015:2).

Mbledhja e taksave në mënyrë efektive sjell të hyra më të mëdha për ekonominë e një vendi. Por, (Khwaja & Iyer 2014:22) argumentojnë se mbledhja e taksave në çdo vend ndikohet nga një numër faktorësh. Më tej autorët argumentojnë se në përgjithësi, vendet me të ardhura të larta kanë aksione më të larta tatimore si pjesë e PBB-së, megjithëse kjo mbetet një zgjedhje politike dhe disa vende me të ardhura të larta zgjedhin të vendosin taksa më të ulëta. Për më tepër, ekonomitë me një pjesë më të madhe të ekonomisë së zezë zakonisht mbledhin tatime më të ulëta sesa ka realisht ai vend potencial për të mbledhur. Përveç kësaj, natyra e politikave tatimore, administratat tatimore joefikase, institucionet e dobëta dhe cilësia e dobët e qeverisjes ndikojnë në mbledhjen e taksave. Maiga (2015) pohon gjithashtu se të ardhurat nga taksat përdoren për financimin e një sërë projektsh, si edhe pagesa të ndryshme siç janë pagesat për familjet me të ardhura të ulëta².

² Marrë nga: Bonga W. G., (2017). *Empirical Examination of the Link between Value Added Tax and Total Tax Revenues in Zimbabwe*. Dynamic Research Journals, Journal of Economics and Finance, fq. 5.

Efikasiteti i çdo forme taksimi qëndron në aftësinë e tij për të maksimizuar aftësinë e rritjes së të ardhurave të qeverisë, duke minimizuar kostot që lidhen me mbledhjen e taksave. Për më tepër, çdo sistem taksash duhet të minimizojë koston e përputhshmërisë (Jitsing & Stern, 2008:6).

Duke konsideruar rëndësinë e TVSH-së, efikasiteti i këtij tatimi është objekt diskutimesh nga studjues të ndryshëm.

Meqënëse TVSH ka pjesën më të madhe të të ardhurave të buxhetit të shtetit, kjo është një arsye pse efektiviteti i mbledhjes së taksave është detyrë kryesore e çdo qeverie (Hajdúchová, Sedliačiková & Vízslai, 2015:680). Më tej autorët argumentojnë se efektiviteti i grumbullimit të taksave dhe zvogëlimi i evazionit fiskal luajnë një rol të madh në përmbushjen e buxhetit të shtetit.

Gjithashtu edhe (Yesegat, 2008:161) pohon se TVSH ka një rol të rëndësishëm në sistemin e të ardhurave të qeverisë etiopiane dhe do të ishte e nevojshme që të ardhurat nga ky tatim të rriten në mënyrë sa më efikase për financimin e qeverisë. Në këtë punim sugjerohet se një administratë e mirë e taksave është e rëndësishme për të arritur objektivat politike të një qeverie.

Për më tepër, (Radeke, Petersen & Giucci, 2015:18) shprehen se një administratë efikase e taksave është një parakusht për suksesin e futjes së TVSH-së dhe parandalimin e veprimtarisë mashtruese.

Në vendet në zhvillim, administrata dhe zbatimi i dobët i taksave shpesh citohen si pengesa kryesore për miratimin e TVSH-së, duke pasur parasysh se kjo e fundit kërkon më shumë informacion dhe aftësi të veçanta për t'u administruar në mënyrë efektive (Boadway &

Sato, 2008:29). Gjithashtu edhe sipas (Macharia, 2014:84) niveli i angazhimit të menaxhimit është provuar të ndikojë në adoptimin e TVSH-së.

Duke qenë se në dogana mblidhet një pjesë e rëndësishme e të ardhurave të TVSH-së, është prioritet që edhe në këto institucione të punohet me efektivitet në kryerjen e detyrave përkatëse. (Jitsing & Stern, 2008:6) argumentojnë se shtrirja e administratës dhe efektshmëria operationale brenda një vendi varet gjithashtu nga efektiviteti i administrimit të TVSH-së në kufi.

(Macharia, 2014:84) vijon argumentin e saj se personeli është komponenti më kritik i burimeve njerëzore në departamentin e TVSH-së, të cilit i është ngarkuar përgjegjësia e sigurimit të pajtueshmërisë së taksave. Prandaj sipas autores stafi dhe palët e tjera të interesit kanë nevojë të pajisen me aftësitë e përditësuara për të rritur pajtueshmërinë e TVSH-së përmes mediave sociale. Në punimin e saj u konkludua gjithashtu se trajnimi i stafit të punonjësve ka ndikim në miratimin e TVSH-së.

Për një efikasitet të administratave tatimore teknologjia e informacionit është sot gjithnjë e më shumë një mjet i rëndësishëm. Madje (Shojaee, 2016:1892) vërtetoi hipotezën se teknologjia e informacionit ndikon në efikasitetin e sistemit tatimor me nivel besueshmërie 95%. Autori shton se përdorimi i teknologjisë së informacionit ndihmon auditorët dhe ekspertët e taksave në analizimin dhe vendimmarrjen dhe krijon sisteme menaxheriale më efikase në organizata.

Por, (Daude, Gutiérrez, & Melguizo, 2012:13), shprehen se në përgjithësi, literatura konfirmon rëndësinë e largimit nga rekomandimet mekanike mbi administrimin e taksave dhe prodhimin e analizave të freskëta mbi marrëdhëniet midis moralit tatimor, karakteristikave individuale dhe kënaqësisë e besimit në qeveri për vendet në zhvillim.

2.1.4 Boshlleku tatimor

(Khwaja & Iyer 2014:22) kanë kryer një studim duke përdorur një qasje të dyfishtë në potencialin e të ardhurave. Ai mbështetet në dy grupe të potencialeve ‘të mundshëm’ të potencialeve të të ardhurave dhe të ardhurat potenciale ‘ligjore’. Dallimi midis potencialit të të ardhurave ligjore dhe të ardhurave aktuale të mbledhura zakonisht kuptohet si boshllëk tatimor. Dallimi midis potencialit të të ardhurave (ekonomike) dhe të ardhurave aktuale të mbledhura referohet nga autorët si hapësira e taksave. Rezultatet e tyre tregojnë se potencialet e të ardhurave ligjore zakonisht janë më të larta se potencialet e të ardhurave ekonomike.

2.2 Rëndësia e tatimit mbi vlerën e shtuar

Rëndësia e tatimit mbi vlerën e shtuar si burim i të ardhurave të qeverisë është një sfidë që diskutohet së tepërmi dekadat e fundit. Mënyrat e përfshirjes së saj në ekonominë e një vendi, mënyrat e llogaritjes, ndikimet tek madhësitë e sektorëve dhe shumë dimensione të tjera diskutohen nga analizues të ndryshëm të financave dhe tatimeve.

Vlera e shtuar duhet të kuptohet si “vlera” që një prodhues (qoftë prodhues, shpërndarës) i shton materialeve të tij të para ose blerjet para se të shesë produktin ose shërbimin i ri ose të përmirësuar për përdoruesit (Tripathi, Sinha & Agarwal, 2011:32). Tatimi u propozua së pari nga Dr. Wilhelm Von Siemens në Gjermani në vitin 1919. Edhe pse ky sistem tatimor ishte aplikuar për herë të parë në Francë, u miratua së shpejti nga një numër i konsiderueshëm i vendeve të tjera evropiane dhe aziatike.

(Ravindra Tripathi, Ambalika Sinha, dhe Sweta Agarwal) në punimin e tyre pohojnë se:

Rëndësia e TVSH-së në Indi dhe në vendet e tjera qëndron për shkak të standardeve të mëposhtme të kontabilitetit të cilat përfshijnë:

- *Strukturë të thjeshtë tatimore dhe transparencë;*
- *Neutralitet i tatimit në lidhje me sjelljen e konsumatorit dhe të prodhuesit;*
- *Transparencë e shumës tatimore në koston e mallrave dhe normë zero e tatimit mbi eksportet dhe është lehtësisht i identifikueshëm.*
- *Aftësia për të siguruar të ardhura të njëjta për qeverinë me norma më të ulëta tatimore, (Tripathi, Sinha & Sweta Agarwal, 2011:33,34).*

Në një këndvështrim tjetër lidhur me rëndësinë e TVSH-së, Alena Andrejovská & Lucia Mihóková, në punimin e tyre kanë konkluduar se:

Rëndësia e taksës së vlerës së shtuar është vazhdimisht në rritje, e cila jepet jo vetëm nga qëllimi i saj në funksionimin e tregut të brendshëm me konkurrencë të drejtë dhe arritjen e thjeshtësisë dhe neutralitetit të tatimeve, por edhe nga shkaqet financiare si një nga burimet kryesore të grumbullimit të taksave për rritjen e të ardhurave buxhetore, (Andrejovská & Mihóková, 2015:495).

Në rast të luhatjeve ciklike të ekonomisë, është sistemi i tatimit së vlerës së shtuar që përdoret kryesisht për të stabilizuar të ardhurat e shtetit dhe për të siguruar performancën e funksioneve publike (Bikas & Andruskaite, 2013:41).

(Keen & Lockwood, 2007:26) në punimin e tyre analizojnë efikasitetin e miratimit të TVSH-së në një ekonomi. Sipas tyre mund të ndodhë që TVSH-ja të përmirësojë ndjeshëm efikasitetin e përgjithshëm të sistemit tatimor, por gjithashtu duhet të kemi një përdorim të reduktuar të taksave të tjera.

Gjithashtu (Ebeke & Ehrhart, 2011:15), kryen një studim për të evidentuar sesi ka ndikuar miratimi i TVSH-së gjatë 20 viteve të fundit, në stabilizimin e të ardhurave tatimore të

vendeve në zhvillim. Në studimin e tyre ata gjetën prova të forta se prania e TVSH-së çon në një përmirësim në stabilitetin e të ardhurave tatimore.

Bangladeshi si një nga vendet në zhvillim u përball në vitet '90 me probleme të shumta për ngritjen e saj ekonomike dhe të ardhura të pamjaftueshme për të financuar zhvillimin e saj ekonomik dhe social. Për të zgjidhur këtë problem dhe për të përmirësuar efikasitetin ekonomik dhe rritjen ekonomike, u hartua një program i madh reformash tatimore, i cili në vitin 1991 u përqendrua në futjen e një takse me vlerë të shtuar (TVSH) për të zëvendësuar një sërë taksash të ngushta të konsumit (Smith, Islam & Moniruzzaman, 2011:1).

(Chigbu & Ali, 2014:31) kanë analizuar në mënyrë empirike marrëdhëniet midis TVSH-së dhe rritjes ekonomike në Nigeri. Ata përdorën të dhënat vjetore për periudhën 1994-2012 dhe rezultatet treguan se TVSH-ja ka ndikim pozitiv në rritjen ekonomike të përcaktuar nga PBB-ja reale. Gjithashtu autorët gjetën një mungesë të marrëdhënieve afatshkurtra dhe afatgjata midis TVSH-së dhe PBB-së. Prandaj qeveria duhet të marrë masa për të rritur produktivitetin në mënyrë që të rrisë kontributin e TVSH-së në rritjen ekonomike në Nigeri. (Laborda & Peña, 2016:23) analizuan ndikimin e taksimit të shërbimeve financiare në lidhje me TVSH-në përkundrejt madhësisë së sektorit financiar. Autorët kanë përdorur të dhëna për 36 vende të BE-së, për serinë kohore 1961-2012. Ata kanë trajtuar rastin e quajtur “tatimi i diferencuar”, që përfshin situata hipotetike të taksave veçmas nëpërmjet disa metodave financiare mbi TVSH-në. Rezultatet u lejojnë atyre për të mbështetur analizën teorike që tregon se TVSH-ja financiare nuk ka efekt të rëndësishëm në zhvillimin e sektorit financiar, duke qenë neutral në lidhje me këtë variabël. Duke arritur në përfundimin e mungesës së një marrëdhënieje të tillë autorët konkludojnë se TVSH-ja nuk

është një instrument i mirë për t'u përdorur për shmangien e rreziqeve sistematike të shkaktuara nga madhësia e madhe e sektorit bankar.

(Carroll, Cline, Ernst, Diamond & Zodrow, 2010:46) në studimin e tyre tregojnë se reduktimi i defiçitit dhe borxhit kombëtar nuk është një detyrë e lehtë për t'u arritur.

Autorët më tej argumentojnë:

Zvogëlimi i TVSH-së shoqërohet me përfitime dhe kosto. Reduktimet në konsumin dhe vendet e punës janë rezultat i drejtpërdrejtë i përdorimit të një takse të bazuar në konsumin për të reduktuar defiçitin. Zvogëlimi i defiçitit përmes TVSH-së shtesë, krahasuar me një ulje në transfertat qeveritare, prodhon rezultate që janë më të pafavorshme për ekonominë: PBB-ja bie menjëherë, vendet e punës zvogëlohen dhe konsumimi bie në një masë më të madhe, (Carroll, Cline, Ernst, Diamond & Zodrow, 2010:46).

Gjithashtu autorët e mësipërm tregojnë nëpërmjet një modeli dinamik të ekuilibrit të përgjithshëm se normat e ulëta të interesit kanë tendencë të reduktojnë të ardhurat e familjeve më të pasura dhe kështu të kompensojnë efektet makroekonomike të një tatimi mbi vlerën e shtuar. Rritja e industrisë masive dhe zhvillimi i sistemit financiar çoi në dominimin e mbajtjes në burim në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe pastaj tek tatimi i konsumit ekuivalent i mbajtjes në burim TVSH-ja.

TVSH dëshmon të jetë një mjet efikas për mbledhjen e të ardhurave, performanca e saj ka ndikim të drejtpërdrejtë në mobilizimin fiskal, stabilitetin makroekonomik dhe zhvillimin, (Le, 2003:1).

Okoli (2015) theksoi një rishikim të vazhdueshëm të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar i drejtuar nga nevoja për të mbështetur ekzistencën e qeverisë³.

Avantazhet e përdorimit të TVSH-së të rënditura nga (Shahrian & Hamedpoor, 2017:180) janë:

- Të ardhura të reja për të plotësuar kostot e shtetit;
- Evazioni minimal i taksave;
- Lehtësimi i hyrjes në konventat lokale;
- Modernizimi dhe ndryshimi i sistemit tatimor;
- Lehtësia e kontrollit dhe auditimit;
- Ndikim negativ minimal.

Ndërsa disavantazhet e përdorimit të TVSH-së sipas (Shahrian & Hamedpoor, 2017:180) janë:

- Efekti regresiv i TVSH-së;
- Efekti i TVSH-së në rritjen e niveleve të çmimeve.

Në punimin e tyre Sepideh Shahrian & Zeinab Hamedpoor pohojnë se:

Problemet më të rëndësishme të sfidave ekzekutive në zbatimin e TVSH-së, janë mënyra e trajtimit të shitësve me pakicë dhe mënyra e trajtimit të ushqimeve bujqësore, (Shahrian & Hamedpoor, 2017:181).

2.2.1 Stimulimi i rritjes i të ardhurave tatimore nga TVSH-ja

Të ardhurat e qeverisë në përgjithësi mund të ndahen në dy të ardhura të mëdha të tilla si të ardhurat tatimore dhe të ardhurat jo-tatimore (Anojan, 2015:2).

³ Marrë nga: Bonga W. G., (2017). *Empirical Examination of the Link between Value Added Tax and Total Tax Revenues in Zimbabwe*. Dynamic Research Journals, Journal of Economics and Finance, 5.

Qeveritë në pjesën më të madhe të botës zhvillojnë projekteve të shumta publike, të tilla si sigurimi social, mbrojtja, shërbimet si energjia elektrike, furnizimi me ujë, hekurudhat, energjia atomike, lehtësira në formë të arsimit, kujdesit shëndetësor dhe shërbimeve publike. Nisur nga nismat e tilla financimi i qeverisë është një shqetësim i rëndësishëm dhe universal shprehet (Esmaeel, 2013:8) në punimin e tij. Rezultatet e studimit të (Onalapo, Aëoremi & Ajala 2013:224) tregojnë se nëse tatohen më shumë mallra dhe shërbime, baza e të ardhurave të vendit do të rritet.

Rëndësia e rritjes së të ardhurave publike rrjedh nga nevoja e kryerjes së shpenzimeve publike (Esmaeel, 2013:9). Shpenzimet publike janë në rritje nga viti në vit sepse qeverisë qëndrore e shpërndarë më njësitë lokale i duhet të sigurojë mirëqënien e banorëve të vendit. Qytetarët paguajnë taksat e tyre në këmbim të shërbimeve dhe mallrave publike, (Daude, Gutiérrez, & Melguizo, 2012:5). Por autorët argumentojnë më tej se në vendet në zhvillim lidhja midis të drejtave dhe detyrimeve të aktorëve të ndryshëm shpesh është e dobët. Kjo lidhje e dobët prek ekuilibrin politik dhe karakterizohet nga nivele të ulëta të të ardhurave tatimore dhe rrjedhimisht të mallrave dhe shërbimeve të pamjaftueshme publike (si në sasi, ashtu edhe në cilësi).

Fokusi tek mbajtja e ekuilibrit mbart me vete politika strategjike. Argumentohet shpeshherë se si të rriten të ardhurat e TVSH-së, me çfarë instrumentesh, politikash apo edhe ideologji të veçanta. (Oordt 2016:28) në punimin e tij fokuson vëmendjen se vendet nuk duhet të përforcojnë përpjekjet në rritje të TVSH-së, p.sh. një rritje në normën standarte, por duhet të përmirësojnë edhe mjedisin ekonomik dhe institucional në të cilin TVSH-ja operon. Në punimin e tij tregohet empirikisht se qeverisja është statistikisht e rëndësishme drejt rritjes së performancës së TVSH-së. Për vendet në zhvillim, përmirësimi i sundimit të ligjit dhe

llogaridhënies mund të çojë në sasi të konsiderueshme të të ardhurave shtesë nga TVSH-ja. Ndërsa për vendet në tranzicion dhe të zhvilluara argumentohet se stabiliteti politik, zvogëlimi i dhunës dhe korrupsionit mund të rrisë të ardhurat e TVSH-së.

(Bikas & Andruskaite, 2013:48) argumentojnë se sipas strukturës së TVSH-së, vlera e shtuar është krijuar në secilën fazë të procesit të prodhimit, kështu që çdo fazë realizon të ardhura në buxhetin e qeverisë. Duke pasur parasysh këtë mekanizëm është e rëndësishme të stimulohet rritja e të ardhurave nga TVSH-ja.

Për të rritur të ardhurat tatimore (Nyaga & Omwenga, 2016:13,14) kanë dhënë rekomandimet e mëposhtme:

- Qeveria duhet të punësojë më shumë staf si një mënyrë për të përmirësuar sistemin e ofrimit të shërbimeve. Në përputhje me këtë, promovimi i stafit ekzistues duhet të bëhet edhe përmes meritave, kontratave të performancës dhe vlerësimet e stafit.
- Duhet të vendosen dënime të rrepta në rastet e evazionit tatimor, si një mënyrë për shmangien e veseve.
- Kapaciteti shtesë duhet të kërkohet në fusha të tilla si: automatizimi, auditimi, profilizimi i riskut dhe zhvillimi i aftësive të përgjithshme.
- Autoriteti tatimor duhet të paguajë më shumë vëmendje për edukimin e taksapaguesve, pajtueshmërinë dhe auditimin e taksave për të dhënë një proces tatimor me një racionalitet të pranueshëm.

Nga ana tjetër (Jitsing & Stern, 2008:6) pohojnë se kostoja ekonomike e mbledhjes së të ardhurave ulet me rritjen e bazës së TVSH-së.

(Keen & Smith, 2007:11) pohojnë gjithashtu se normat e larta të TVSH-së ka të ngjarë të inkurajojnë informalitetin. Në rastin e Shqipërisë dhe Kosovës, të dyja vendet përveç

normës bazë përdorin edhe normë të reduktuar TVSH-je, përkatësisht 6% dhe 8%. Në dhjetë shtetet e Ballkanit të marra në analizë në çështjen 3.4.2 të këtij punimi, Federata e Bosnjë-Hercegovinës dhe Republika Srpska zbatojnë një normë të vetme TVSH-je, ekzaktësisht 17%.

2.2.2 Diferencimi i TVSH-së

Një strukturë e normave të diferencuara të TVSH-së është adoptuar historikisht me qëllim të zbutjes së impaktit regresiv të TVSH-së në familjet me të ardhura të ulëta, duke siguruar një burim të qëndrueshëm të ardhurash fiskale që vijnë nga konsumi final i tatimpaguesve (Greci, 2015:79).

Një studim i kryer nga (Boeters, Böhringer, Büttner & Kraus, 2006:19-20) arriti në konkluzionin se diferencimi i TVSH-së vështirë se mund të konsiderohet si një mjet i përshtatshëm për politikën e rishpërndarjes. Ndryshimet e nxitura nga politikat në treguesit makroekonomikë si PBB, punësimi, përdorimi i kapitalit vendas, ose konsumi agregat pasqyrojnë rënditjen e mirëqenies së instrumenteve tatimore. Ndërsa efektet shpërndarëse të reformave të TVSH-së janë brenda një game relativisht të ngushtë, efektet sektoriale (në aspektin e ndryshimeve në prodhimin sektorial) janë shumë më të theksuara. Kjo tregon se diferencimi i normës së TVSH-së duhet të shihet kryesisht si një subvencion sektorial sesa një instrument i rishpërndarjes.

Shkalla e shumëfishtë e normave të TVSH-së krijon hapësirë për mashtrime dhe është e ekspozuar ndaj evazionit fiskal (Keen & Smith, 2007:10).

Gjithashtu (Palczewska, 2016:415) në punimin e saj pohon se një nga mënyrat e përmirësimit të performancës së TVSH-së në Poloni është të aplikohet një normë e vetme e TVSH-së.

Dilema e sistemit tatimor që a duhet të ketë TVSH-ja një normë të vetme në një vend të caktuar, apo të ekzistojnë norma të shumëfishta të TVSH-së nxit analistët të kryejnë studime dhe të japin rekomandimet e tyre për performacën më të mirë të këtij tatimi. Përveç diskutimit a duhet të ketë një normë apo një sistem me norma të shumëfishta të TVSH-së, një diskutim me vete është edhe fakti se a duhet të ekzistojë norma zero e TVSH-së?

(Jansen & Calitz, 2015:6) argumentojnë se heqja e normës zero të TVSH-së do të reduktonte shtrebmërimet në ekonomi dhe mund të na lejonte të përqendrohemi në ato masa (siç janë qëllimet sociale) ku fitimet e kapitalit janë shumë më të larta.

Megjithë argumentet e mësipërme dhe të autorëve të tjerë, shtete të ndryshme kanë ndjekur politika të ndryshme. Në tabelën e mëposhtme jepen normat e TVSH-së për vendet anëtare të BE-së në datën 01 janar 2018:

Tabela 1- Normat e TVSH-së më 01 janar 2018 për vendet anëtare të BE-së (në %)

Nr.	Shteti	Norma super e reduktuar	Norma e reduktuar	Norma standarte	Norma e parkimit
1	Belgjika	-	6; 12	21	12
2	Bullgaria	-	9	20	-
3	Republika Çeke	-	10;15	21	-
4	Danimarka	-	-	25	-
5	Gjermania	-	7	19	-
6	Estonia	-	9	20	-
7	Irlanda	4,8	9; 13.5	23	13.5
8	Greqia	-	6; 13	24	-
9	Spanja	4	10	21	-
10	Franca	2,1	5.5; 10	20	-
11	Kroacia	-	5; 13	25	-
12	Italia	4	5; 10	22	-
13	Qipro	-	5; 9	19	-
14	Letonia	-	12	21	-
15	Lituania	-	5; 9	21	-
16	Luksemburg	3	8	17	14

17	Hungaria	-	5; 18	27	-
18	Malta	-	5; 7	18	-
19	Hollanda	-	6	21	-
20	Austria	-	10; 13	20	13
21	Polonia	-	5; 8	23	-
22	Portugalia	-	6; 13	23	13
23	Rumania	-	5; 9	19	-
24	Sllovenia	-	9.5	22	-
25	Sllovakia	-	10	20	-
26	Finlanda	-	10; 14	24	-
27	Suedia	-	6; 12	25	-
28	Mbretëria e Bashkuar	-	5	20	-

Burimi: European Commission, 2018.


Nga tabela e mësipërme vihet re se Irlanda, Spanja, Franca, Italia dhe Luksenburg përdorin norma super të reduktuara të TVSH-së. Danimarka është i vetmi shtet i cili nuk përdor norma të reduktuara. Bullgaria, Gjermania, Estonia, Letonia, Hollanda, Sllovenia, Sllovakia dhe Mbretëria e Bashkuar përdorin vetëm një një normë të reduktuar. Normën më të ulët standarte të TVSH-së e ka Luksenburg në vlerën 17%, ndërsa normën më të lartë e ka Hungaria, në vlerën 27%.

Belgjika, Irlanda, Luksenburg, Austria dhe Portugalia përdorin edhe normën e parkimit. Norma e parkimit (Parking rate) aplikohet për ato mallra dhe shërbime për të cilat disa nga shtetet e Bashkimit Europian kanë përdorur norma të reduktuara, shumë të reduktuara ose zero në 1 janar 1991. Këto shtete u lejuan të vazhdonin të përdornin këto norma në vend të normës standarde, (European Commission, 2003). Komisioni Europian pohon se kjo masë u përdor si një marrëveshje tranzicioni për të zbutur levizjen nga norma e reduktuar në normën standarde kur tregu i brendshëm hyri në fuqi me 1 janar 1993: ai kishte për qëllim

të hiqej gradualisht. Duke qenë se është aplikuar për më shumë se 10 vite tani është propozuar që kjo marrëveshje tranzicioni të hiqet.

Ndryshimi i normave bazë ose të reduktuara në sektorë të veçantë ose në kontekst më të gjërë do të ketë ndikime të gjëra në ekonomi dhe komponentët makroekonomikë. Një rast i tillë është për shembull ndryshimi ligjor në korrik të vitit 2011, në Irlandë, për kategoritë e lidhura me turizmin, të cilat pësuan një ulje të TVSH-së nga 13.5% në 9%, Fáilte Ireland (2014). Deloitte (2014) ka kryer një analizë për të zbuluar ndikimin e rënies së TVSH-së mbi turizmin irlandez dhe punësimin brenda sektorit të turizmit. Efektet e zbritjes së TVSH-së jepen të ilustruara në figurën e mëposhtme:

Figura 3- Efektet e zbritjes së TVSH-së



Burimi: Deloitte, 2014 & përshtatje nga autori

Lidhja e parë në zinxhirin është se reduktimi i TVSH-së së paku pjesërisht kalon tek konsumatorët, duke rezultuar në çmime më të ulëta për produktet dhe shërbimet e rëndësishme të lidhura me turizmin si për shembull strehimi. Sipas teorive ekonomike ndryshimi i një tatimi do të ndryshojë sipas produktit dhe kategorisë të shërbimit. Nëse pika e parë e pasojave të uljes së TVSH-së kalonte tek konsumatorët, atëherë pritet të rritet konkurrenca relative e ofrimit të turizmit irlandez. Së dyti Irlanda do të shihet në sytë e turistave vendas dhe të huaj si një destinacion me çmime shumë konkurruese. Rritja neto e numrit të turistave do të ketë si rezultat edhe rritjen e shpenzimeve për vizitor e si rrjedhojë do të kemi rritje të të ardhurave turistike. Rritja e turistave vendos bizneset përballë hartimit të strategjive të reja për menaxhimin e rritjes së fluksit, e cila realizohet nëpërmjet shtimit të stafit, duke rritur kështu edhe punësimin në vend.

2.2.3 Ndikimi i rritjes dhe uljes së normës së TVSH-së

Ndryshimi i normës së TVSH-së shoqërohet me efekte në aspektet e ndryshme ekonomike. (Barrell & Weale, 2009:10) pohojnë se nëse ulja e taksave ka një efekt të favorshëm të të ardhurave, në rastet kur ndodh rritja e ardhshme e taksave, duhet të ketë një ndikim të pafavorshëm. Një pohim i tillë shtrон përpara politikbërësve një çështje të rëndësishme për rastet e ndryshimeve tatimore. Një situatë më e ndërlikuar paraqitet në rastet e krizave financiare, për masat që duhen të ndërmerren.

Në kërkim të instrumenteve të politikës ekonomike që mund të zbusin pasojat e krizës, ndryshimet e normave të TVSH-së janë mjete të përdorura gjerësisht të politikës fiskale, (Andrejovská & Mihóková, 2015:496). Autoret shprehen më tej se duke pasur parasysh këtë, TVSH konsiderohet si "taksë miqësore për rritje" që përdoret për rritjen e të ardhurave të buxhetit të shtetit për të lehtësuar defiçitet e financave publike të shteteve të BE-së.

(Sekwati & Malema, 2011:54) argumentojnë se ndikimi i rritjes së TVSH-së ka më shumë gjasa për të pasur një ndikim të thellë tek familjet e varfëra. Duke pasur parasysh se shumica e të varfërve janë në zonat rurale, kjo rritje do të jetë mjaft negative në nivelet e konsumit të familjet e varfëra.

Në këndvështrimin tjetër (Gaarder, 2016:31) konstaton se ulja e TVSH-së në ushqime zbut pabarazinë në mirëqenien e konsumatorit pjesërisht, sepse familjet rregullojnë modelet e tyre të shpenzimeve si përgjigje ndaj ndryshimeve të çmimeve.

(Kearney, 2003:158) pohon se ulja e TVSH-së duhet të merret në konsideratë e kombinuar me një strategji për zëvendësimin e të ardhurave, siç është rritja e taksave direkte. Gjithashtu zvogëlimi i normës ligjore të TVSH-së mund të sjellë rritje dhe punësim. Por, ulja e normës së TVSH-së do të rezultojë në një rishpërndarje më të padrejtë të të ardhurave dhe pasurisë.

(Mustapha, Koh, Chan & Ramly, 2017:466) arritën në rezultatin se ekziston një efekt diferencial i TVSH-së në varësi të nivelit të pabarazisë e të ardhurave në çdo vend.

Interesante janë rezultatet e hulumtimit të (Vijil, 2017:19), të cilat tregojnë se ka paragjykime të nënkuptuara në strukturën e TVSH-së në Nikaragua⁴ e cila rezulton në një lidhje pozitive midis përbërjes së raportit gjinor dhe rastit të TVSH-së, prandaj tatimi paraqet barrë më të madhe për familjet me shumicë femërore, në të dyja zonat rurale dhe urbane.

2.2.4 Zgjedhja e nivelit optimal të pragut të regjistrimit të TVSH-së

Niveli i pragut të regjistrimit të TVSH-së shoqërohet me diskutime të shumta kur pëson ndryshime. Nga data 1 prill e vitit 2018, në Shqipëri, pragu i regjistrimit të TVSH-së u ul

⁴ E pozicionuar në Amerikën Qëndrore.

nga 5 milionë lekë të reja, në 2 milion lekë të reja. Një ndryshim i tillë tatimor përveçse është shoqëruar me protesta të shumta, ekonomistë të ndryshëm kanë shprehur mendimet e tyre për impaktin ekonomik.

Në një deklaratë të Ministrit të Financave, Arben Ahmetaj, ai pohoi :

“Qëllimi është fokusi tek biznesi i madh, qartësia e transaksionit në funksion të mbledhjes më shumë TVSH nga biznesi i madh. Nuk synohet që biznesi i vogël të jetë gjenerator i të ardhurave të TVSH-së”, (Ahmetaj, 2018).⁵

Më tej, Ministri deklaroi se nga bizneset e vogla arkëtohen rreth 1 miliard lekë nga TVSH, që përfaqëson vetëm 0.08 për qind të totalit. Pjesa tjetër, thotë ai, janë të mbledhura nga biznesi i madh. Numri i sipërmarrjeve që do të detyrohen të deklarojnë nga 2 deri në 5 milion është 9900 sipërmarrje të vogla, nën 2 milion janë 60 mijë sipërmarrje të vogla. Ndërkohë ai ftoi bizneset në bazë të vetëdeklarimit, (Shekulli, 2018).

Ulja e pragut të TVSH-së jo gjithmonë krijon efektet e duhura. Duke marrë shkas nga miratimi i pragut të TVSH-së në vitin 2003 në Etiopi, (Gebresilasse & Sow, 2015:10), gjetën se firmat kanë raportuar më pak të ardhura se ato realet për të mos arritur pragun e regjistrimit të TVSH-së. Ky duhet të shërbejë si një sinjal për qeveritë për të arritur në zgjedhjen optimale të pragut të duhur të regjistrimit të TVSH-së.

(Asatryan & Peichl, 2016:31) tregojnë se nivelet administrative ndikojnë në stimujt që ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të rriten përtej nivelit, pasi krijojnë kosto më të larta të përmbushjes së taksave për ato. Autorët sugjerojnë më tej se mekanizmat nxitës që iu drejtohen ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme duhet të shoqërohen me strategji të

⁵ Marrë nga: http://shekulli.com.al/ahmetaj-tvsh-e-__biznesit-te-vogel-per-ta-vjele-nga-biznesi-i-madh/

optimizuarat të auditimit, të cilat duhet të synojnë firmat dhe sektorët, të cilët kanë stimuj më të lartë për të nënraportuar të ardhurat e tyre.

Masa të tilla të ndërmarra rrisin efikasitetin e tatimeve dhe duhen të promovohen sa më shumë jo vetëm tek bizneset e vogla e të mesme, por edhe tek bizneset e mëdha, për të shmangur raportimin e të ardhurave joreale.

Për më tepër, sipas (Feld, Frey & Torgler, 2006:20), studimi i ndikimit të shpërblimeve, është i rëndësishëm për të hetuar një sërë strategjish që qeveritë dhe administratat tatimore mund të ndjekin për të rritur përputhshmërinë e taksave.

(Le, 2003:51) pohon se një prag i arsyeshëm i TVSH-së varion nga vende të ndryshme, në varësi të fazës së zhvillimit, kapacitetit të administratës tatimore dhe kulturës tatimore të një vendi të caktuar. Zgjedhja e nivelit optimal të pragut të regjistrimit të TVSH-së kërkon një ideologji të thelluar, duke planifikuar edhe për efektet në periudha afatgjata.

(Kanbur & Keen, 2014:6) shprehen se një prag krijon një dallim të dukshëm midis atyre që përfundojnë mbi pragun dhe ato të cilët përfundojnë më poshtë. Por autorët sugjerojnë se ka mënyra të ndryshme për t'u përshtatur poshtë pragut për të shmangur taksat.

(Gebresilashe & Sow, 2015:2) pohojnë se qeveritë shpesh e kanë të vështirë të zgjedhin nivelin optimal të pragut të qarkullimit në lidhje me TVSH-në, në të cilin firmat janë të detyruara të regjistrohen, zgjedhje e cila është vendimtare për zbatimin e TVSH-së.

Nga ana tjetër e argumenteve, (Goyette, 2012:31) shpreh se përkrahësit e TVSH argumentojnë se një avantazh i rritjes së pragut të TVSH-së është se ai redukton kostot administrative.

2.2.5 Qëndrimet ndaj përjashtimeve të TVSH-së

Që nga aplikimi për herë të parë i TVSH-së në vitin 1954 e deri më sot sistemet e TVSH-së janë bërë pjesë e paketës fiskale në shumë vende rreth botës.

Shumica e regjimeve të TVSH-së karakterizohen nga një bazë tatimore e konsumit me normat e shumta tatimore, përjashtimet e shumëfishta dhe metoda e rimbursimit (Giesecke & Nhi, 2009:2). Këto karakteristika janë bërë objekt i studimeve të ndryshme. Duke qenë se këto janë karakteristikat kryesore është e domosdoshme që të studiohen.

(Le, 2003:50) argumenton se dizajni i TVSH-së duhet të minimizojë deri në masën e mundshme numrin e përjashtimeve për një sistem efikas.

(De la Feria & Krever 2012:27) në studimin e tyre konkludojnë se faktorët historikë që çuan në nivele të shumëfishta dhe përjashtime të shumta në TVSH-në tradicionale evropiane nuk ishin të pranishme në shumicën e juridiksioneve jashtë BE-së dhe adoptuesit e një modeli modern të TVSH-së ishin në gjendje të shmangnin këto veçori të TVSH-së tradicionale, për pjesën më të madhe duke adoptuar norma të vetme dhe substancialisht kufizimin e numrit të përjashtimit. Autorët shprehen se përjashtimet më të kufizuara kanë imponuar ndryshime në kostot ekonomike dhe administrative, megjithatë, duke nxitur disa prej juridiksioneve moderne të TVSH-së për të eksploruar alternativat më moderne, veçanërisht në sferën e shërbimeve financiare, por edhe në lidhje me furnizimet nga ndërmarrjet e vogla e të mesme, si dhe pragjet e regjistrimit.

Shumë shërbime financiare janë të liruar nga tatimi mbi vlerën e shtuar, edhe pse mund të kërkohej, ka vështirësi teknike në zbatimin e TVSH-së për këto shërbime (Sørensen, 2017:5). Shërbimet financiare tradicionalisht janë përjashtuar nga tatimi mbi vlerën e shtuar sepse askush nuk ka gjetur një mënyrë sistematike dhe të lehtë për të taksuar këto shërbime,

pjesërisht për shkak të vështirësive në përcaktimin e natyrës së shërbimeve të ofruara, (Encyclopedia.com, 2009).

Për herë të parë u shqyrtua analitikisht problemi i përjashtimit të TVSH-së nga Gottfried dhe Wiegard (1991)⁶, të cilët supozojnë se përjashtimet zbatohen për të gjithë përdoruesit. Në shumë vende shërbimet financiare, telekomunikacioni dhe shërbimet mjekësore përjashtohen nga TVSH. Kjo është për shkak se është e vështirë të vlerësohet vlera e shtuar në çdo fazë të prodhimit të këtyre shërbimeve (Jitsing & Stern, 2008:7).

Të tjerë studjues përpiqen të gjejnë një mënyrë efektive për tatimin e shërbimeve financiare, (Boadway & Keen (2003), Jack (2000), Huizinga (2002)), ndërsa disa argumentojnë se TVSH duhet të zbatohet për shërbimet financiare në të njëjtën mënyrë si në mallra të tjerë (Auerbach & Gordon (2002))⁷.

Nga analistët e shumtë diskutohet edhe përjashtimi i TVSH-së në sektorin e bujqësisë. Por (Le, 2003:51) argumenton se specifikimet e përjashtimeve të TVSH-së në sektorin e bujqësisë kthehen në një problem për administratën, sepse është teknikisht e vështirë të dallosh bujqësinë nga inputet jo-bujqësore. Më tej, autori arsyeton se do të ishte më mirë që bujqësisë t'i ofroreshin subvencione të drejtpërdrejta selektive nëse është e nevojshme, sesa të përjashtohet nga TVSH-ja. Ndërsa për vendet që ende e përjashtojnë bujqësinë, për çdo arsye të pashmangshme, është e këshillueshme që ato të kufizojnë përjashtimet për inputet kritike dhe të pastra për bujqësinë, siç janë plehrat dhe farërat.

⁶ Marrë nga: Giesecke J. A. & Nhi T. H. (2009). Modelling Value-Added Tax in the Presence of Multiproduction and Differentiated Exemptions. General Paper No. G-182, The Centre of Policy Studies, 5.

⁷ Marrë nga: Sørensen C. (2017). Taxing value added in the financial sector, *An input-output approach and effects of the Norwegian VAT*. Tezë Masteri: Universiteti i Oslo-s, Departamenti i Ekonomisë, fq. 1.

2.2.6 Rimbursimi i TVSH-së

Literatura i ka kushtuar rëndësi edhe rimbursimit të TVSH-së. Dy kategori kryesore të tatimpaguesve që marrin rimbursimet e TVSH-së mund të diferencohen: eksportuesit (për sa kohë që zbatohen destinacioni) dhe investitorët mund të përfshijnë edhe ndërmarrjet e reja), të cilët janë shumë të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik (Legeida & Sologoub, 2003:4).

Autorët e mësipërm pohojnë gjithashtu:

- *Sistemi polak i TVSH-së vuan nga një sasi e madhe e përjashtimeve të TVSH-së.*
- *Për Rusinë problemi i rimbursimit të TVSH-së është aktual. Shumë kompani vendase dhe të huaja në Rusi të angazhuar në operacionet e eksportit u ankuan se nuk arritën të marrin rimbursimin e TVSH-së. Në të njëjtën kohë problemi i mashtrimit të rimbursimit të TVSH shfaqet edhe në përmasa të tjera. Pagesat e TVSH-së në buxhet janë të mëdha për shkak të mos pagesave të ndërmarrjeve,* (Legeida & Sologoub, 2003:5-6).

Rimbursimet e TVSH-së shoqërohen me problematika të shumta dhe një nga ato janë edhe vonesat në procedurat e rimbursimeve. Vonesat në procedurat e rimbursimeve ndodhin edhe kur buxhetet shtetërore janë nën presion dhe kur objektivat e grumbullimeve tatimore nuk përmbushen, (Harrison & Krelove, 2005:5). Autorët argumentojnë se këto raste ndodhin atëherë kur autoritetet tatimore dhe ministritë e financave nuk kanë sisteme të përshtatshme të parashikimit dhe monitorimit, për të parashikuar nivelet e rimbursimit dhe duke mos i lënë mënjane fondet e mjaftueshme për të plotësuar pretendimet legjitime të rimbursimit kur ato ndodhin.

2.3 Ndikimi i TVSH-së tek faktorët makroekonomikë

TVSH-ja ka më shumë se 60 vite që është implementuar dhe duke parë rëndësinë e këtij tatimi dhe funksionit të tij, literatura i ka kushtuar shumë energji të kuptuarit të përcaktuesve të tij kryesorë.

Nëpërmjet një analize që kreu (Erero, 2015:15-16) arriti në përfundimin se rritja e normës së TVSH-së rezultoi në një rritje marginale të PBB-së dhe me një rritje të lehtë të të ardhurave të qeverisë, të cilat mund të përdoren për rishpërndarjen dhe zbutjen e varfërisë. Ai sugjeron se këto rezultate mund të jenë interesante për politikbërësit dhe nëse këto të ardhura mund të përdoren për subvencionimin e punës së pakualifikuar. Por çfarë ndikimit mund të ketë niveli i zhvillimit ekonomik tek të ardhurat tatimore?

(Daude, Gutiérrez, & Melguizo, 2012:7), pohon se janë disa arsye ekonomike që të pritët një korrelacion pozitiv midis nivelit të zhvillimit ekonomik dhe të ardhurave tatimore. Kjo do të thotë që në vendet me ekonomi të zhvilluara të kemi të ardhura tatimore më të larta. Rasti i kundërt është në rastin e vendeve me një nivel të dobët të zhvillimit ekonomik. Më tej, literatura ka hulumtuar në verifikimin e lidhjeve specifike për tatime e taksa të veçanta. TVSH-ja e konsideruar si tatimi që grumbullon më shumë të ardhura qeveritare në vendet që e kanë bërë pjesë të paketës së tyre fiskale, është studjuar në ndërveprim me komponentë të shumtë.

Autorë të ndryshëm kanë arritur në konkluzione të ndryshme për marrëdhënien ndërmjet TVSH-së dhe PBB-së. Analizat e kryera në dimensione dhe ekonomi të ndryshme japin një panoramë të lidhjes mes këtyre dy variablave.

(Wulandari & Andyarini, 2015:5155) arritën në përfundimin se PBB-ja ndikon dukshëm në të ardhurat e TVSH-së në Indonezi. Për më tepër ata zbuluan një marrëdhënie pozitive ndërmjet këtyre variablave.

(Kalaš & Milenković, 2017:76) gjetën një koeficient korrelacioni midis TVSH-së dhe PBB-së në vlerën 0.9778, e cila pasqyron marrëdhënien e tyre të lartë dhe të fortë pozitive.

(Kalaš, Milenković, Pjanić, Andrašić & Milenković, 2017:122) gjetën se TVSH-ja ka një ndikim pozitiv në PBB-në dhe është statistikiisht e rëndësishme në Serbi. Rezultatet e arritura nga (Bikas & Andruskaite, 2013:48) tregojnë se ekzistojnë marrëdhënie të besueshme dhe të forta midis raporteve që karakterizojnë kushtet ekonomike (PBB, PBB për frymë, konsumi, konsumi familjar, importi dhe eksporti) dhe të ardhurave nga TVSH-ja.

Bazuar në rezultatet e (Zimmermannova, Skalickova & Siroky, 2016:126), e kryer për rajonet e Republikës Çeke kemi marrëdhënie pozitive statistikiisht të rëndësishme midis të ardhurave rajonale të TVSH-së dhe vlerës së PBB-së rajonale dhe marrëdhënie statistikiisht domethënëse negative mes tatimeve mbi të ardhurat rajonale dhe papunësisë rajonale. Nga ana tjetër, marrëdhënia midis kthimeve rajonale të TVSH-së dhe vlerës së PBB-së rajonale nuk është statistikiisht e rëndësishme. Autorët sugjerojnë se rezultatet e arritura mund t'iu shërbejnë politikbërësve në nivel vendor ose lokal.

Nga ana tjetër (Njogu, 2015:27) gjeti një marrëdhënie negative mes normave të TVSH-së dhe PBB-së. Prandaj, sipas autorit, qeveria Keniane duhet të përpiket të zvogëlojë ose të mbajë një normë të ulët të TVSH-së për të rritur PBB-në e përgjithshme.

(Ironkwe & Peter, 2015:85-86) në studimin e tyre kanë arritur në konkluzionin se TVSH-ja ka një ndikim negativ në performancën financiare të agrobizneseve në Nigeri. Konkretisht,

autorët konkluduan se një rritje në TVSH është përgjegjëse për rreth një rënie prej 10.5% në fitimin pas tatimit, një rënie prej 15% në kthimin e investimeve dhe një ulje prej 26.6% në kthimin mbi kapitalin.

Hulumtimi i kryer nga (Wulandari & Andyarini, 2015:5155) konstaton se inflacioni i ndryshueshëm nuk ndikon dukshëm në të ardhurat e TVSH-së.

(Njogu, 2015:27) gjeti se ekziston një marrëdhënie pozitive, por jo e rëndësishme ndërmjet normave të TVSH-së dhe inflacionit. Nga ana tjetër ai arriti në përfundimin se ekzistojnë marrëdhënie pozitive të rëndësishme ndërmjet shkallës së papunësisë dhe normave të TVSH-së.

Rezultatet e (Nartey, 2011:43) treguan se dinamika inflacioniste nuk ka në të vërtetë ndonjë ndikim të rëndësishëm në të ardhurat e TVSH-së në afat të gjatë.

(Adejare & Akande, 2017:650) kanë kryer një studim duke vlerësuar efektet e tatimit mbi vlerën e shtuar mbi investimet private në Nigeri nga viti 1994 deri në vitin 2015. Nëpërmjet teknikave e analizave të shumëfishta të regresionit u arrit në përfundimin se TVSH-ja ka ndikim pozitiv mbi investimet private në Nigeri. Gjithashtu u zbulua një lidhje negative e rëndësishme ndërmjet inflacionit dhe investimeve private në Nigeri.

(Nartey, 2011:42) arriti në konkluzionin se koeficienti i shpenzimeve qeveritare është pozitiv dhe i rëndësishëm, duke nënkuptuar që shpenzimet e qeverisë në mënyrë të konsiderueshme përcaktojnë të ardhurat e TVSH-së në periudhë afatgjatë.

(Nartey, 2011:43) konkludoi gjithashtu se edhe pse koeficienti afatgjatë i normës së tatimit në TVSH është pozitiv, ai është i parëndësishëm, duke nënkuptuar se norma e TVSH-së nuk ka ndonjë ndikim të rëndësishëm afatgjatë në të ardhurat e TVSH-së.

2.3.1 Ndikimi i TVSH-së në tregtinë ndërkombëtare

Kumari Juddoo në punimin e tij pohon:

Tarifat e importit dhe akcizat shpesh përbëjnë burimet më të rëndësishme të të ardhurave në shumë vende në zhvillim. Ky trend është përballur me një sfidë të kohëve të fundit, siç janë shumë nga vendet në zhvillim duke ulur taksat e tyre tregtare ose duke zëvendësuar ato me vlerën e konsumit. Më tej autori argumenton se ky ndryshim ndihmon në reduktimin e shtrembërimit ekonomik të shkaktuar nga tarifat e tregtisë që janë aplikuar tani kryesisht në ekonominë botërore moderne dhe që janë gjithnjë e më shumë të rregulluara nga Organizata Botërore e Tregtisë (OBT). (Juddoo, 2014:500).

Në një dokument të përgatitur për Konferencën Ndërkombëtare të Dialogut të Taksave mbi TVSH-në në Romë⁸, në vitin 2005, në përmbledhjen e punimit argumentohet se TVSH-ja ka shërbyer për të stabilizuar dhe për të forcuar mobilizimin e të ardhurave në shumë vende duke kontribuar rritjen e efikasitetit ekonomik. Për më tepër, kompleksiteti i taksave indirekte së TVSH-së ka zëvendësuar shqetësimin se TVSH është në thelb "tepër komplekse" për vendet në zhvillim. Analiza empirike tregon se rëndësia e tregtisë ndërkombëtare, shkathtësia e lartë dhe kohëzgjatja e TVSH-së ka rritur të ardhurat e TVSH-së.

Efektet e TVSH-së në tregtinë ndërkombëtare janë të varura gjithashtu edhe nga zhvillimi i vendeve dhe mjedisi i ndërveprimit të firmave ndërkombëtare.

⁸ Dokumenti është përgatitur nga stafi i FMN-së, OECD-së dhe Banka Botërore. Konferenca është mbajtur në Romë me 15-16 Mars 2005 në lidhje me rëndësinë e përhapjes së TVSH-së, si zhvillimi më i rëndësishëm në sistemin e tatimeve.

Sipas (Desai & Hines, 2005:20,21) efektet negative të TVSH-së në tregtinë ndërkombëtare janë më të theksuara në vendet me të ardhura të ulëta, megjithëse ata janë të pranishëm edhe në vendet me të ardhura të larta dhe tek sjellja e firmave shumëkombëshe. Gjithashtu ata shtojnë se arsytet që TVSH-ja pengon tregtinë ndërkombëtare është se ky tatim ka prirjen të jetë i vendosur më së shumti në sektorët e tregtuar të ekonomive, qeveritë shpesh nuk arrijnë të ofrojnë vlera të përshtatshme të TVSH-së për eksportet, TVSH-të zëvendësojnë tatimet e tjera që mund të ndikojnë në tregtinë.

Për më tepër, gjetjet e studimit të (Epaphra, 2015:43) treguan se liberalizimi i tregtisë është një burim potencial i paqëndrueshmërisë fiskale në Tanzani, sepse ajo mbështetet shumë në të ardhurat nga tregtia ndërkombëtare. Autori shton se meqënëse liberalizimi i tregtisë rezulton në reduktimin e të ardhurave nga detyrimet e importit, për rrjedhojë, do të rritet vështirësia e çështjeve fiskale nëse nuk janë ndërmarrë hapa të përshtatshëm për të forcuar sistemin e taksave vendore.

Dinamika e zhvillimit të tregtisë ndërkombëtare implikon edhe sistemin e TVSH-së. (Jitsing & Stern, 2008:12) argumentojnë se tregtia ndërkombëtare paraqet sfida për çdo sistem të TVSH-së: zakonisht ekziston një shkëmbim ndërmjet përfitimeve të mundshme të efikasitetit nga mbledhja e taksave bazuar në përcaktimin dhe parandalimin e shmangies së taksave dhe mashtrimit.

Tregtia ndërkombëtare jep efektet në një ekonomi edhe nëpërmjet raporteve dhe treguesve që dalin prej saj.

(Hansson, Porter & Williams 2012:1) kryen një studim në 19 vende të zhvilluara për vitet 1979 deri në 2005 për faktorët që ndikojnë në normën e tatimeve ligjore të vendosura mbi bizneset nga qeveritë.

Rezultatet e studimit të Åsa Hansson, Susan Porter & Susan Perry Williams treguan se:

Hapja ekonomike ka një ndikim negativ në nivelin e stimujve tatimorë. Niveli i lartë i papunësisë dhe normat e interesit janë të lidhura negativisht me normën e tatimit, duke treguar që qeveritë ulin normat tatimore për të stimuluar ekonominë gjatë rënies ekonomike. Shuma totale e shpenzuar nga qeveritë nuk ndikon në normat e taksave, ndërsa një popullsi e plakur dhe niveli i borxhit kanë një efekt të rëndësishëm pozitiv në normat e taksave (Hansson, Porter & Williams 2012:18).

2.3.2 TVSH dhe konsumi

Ndryshimet ligjore në lidhje me TVSH-së, ka raste që prekin dhe ndikojnë konsumin. Ndikimi në konsum është i pritshëm nga vetë lloji i tatimit në fjalë. (Bikas & Andruskaite, 2013:41) argumentojnë se barra e taksës së vlerës së shtuar të shkaktuar nga sistemi i çmimeve transferohet tek të gjithë konsumatorët, pavarësisht nga statusi i tyre ligjor, mundësitë e aftësisë paguese apo faktorë të tjerë. Nga ky pohim i autorëve kuptohet pak a shumë dinamika e veprimit të ndryshimit të TVSH-së. Megjithatë autorë të ndryshëm janë përpjekur ta analizojnë në aspekte të ndryshme, grupe të caktuara për të parë ndikimin real. (Dijkstra, 2013:12) argumentoi se rritja e normës së TVSH-së e pasuar me rritjen e çmimeve të konsumit ndikohet nga disa mekanizma. Së pari shkalla në të cilën kalon kjo rritje e TVSH-së varet nga vendosja e konkurrencës. Për më tepër, ndikimi i ndryshimit të TVSH-së në nivelin e çmimeve varet nga elasticiteti i kërkesës. Gjithashtu disa konsiderata praktike mund të ndikojnë në shtrirjen e zhvendosjes së taksave, si për shembull: kostot e rregullimit dhe konceptet e ndryshme mbi reagimin e firmave të tjera në treg, karakteristikat e kaluara të recensionit, pasiguria mund të kenë ndikim në kalimin e rritjeve të çmimeve të konsumit nga rritja e normës së TVSH-së.

(Alm & El-Ganainy, 2012:124) kanë kryer një analizë duke përdorur një mostër prej pesëmbëdhjetë vendeve të BE-së gjatë periudhës 1961-2005 dhe gjetën se shkalla e tatimit efektiv të TVSH-së lidhet negativisht me nivelin e konsumit agregat.

Efekti i ndryshimit të normës së TVSH-së duhet parë para dhe pas ndryshimit ligjor. (Buettner & Madzharova, 2016:19) nëpërmjet analizës së tyre treguan se reformat e TVSH-së europiane në vitet e fundit kanë rezultuar me çmime më të larta të produkteve dhe kanë nxitur rritjen e shitjeve në periudhën para rritjes së taksave. Rezultatet empirike sugjerojnë se rritja e TVSH-së për 1 pikë përqindje shkakton një rritje të shitjeve në muajin para rritjes së TVSH-së me rreth 1 deri në 5 për qind në varësi të grupit të produkteve.

2.3.3 Ndikimi i TVSH-së tek raportet e likuiditetit

Taksat dhe tatimet që ndikojnë veprimtarinë e një biznesi, duhet të studjohen mirë përpara implementimit të tyre. Në qoftë se ndryshimet janë të mëdha, do të ishte mirë që të deklaroheshin në një kohë përpara, që drejtuesit financiarë të kenë kohën e mjaftueshme për ndërmarrjen e nismave të brendshme që aktiviteti i tyre të mos dëmtohet nga ndryshimet tatimore dhe fiskale. Një nga çështjet që duhet pasur parasysh vazhdimisht nga financierët dhe menaxherët është ndikimi që mund të ketë politika fiskale tek raportet financiare të firmave që drejtojnë. Një nga raportet e rëndësishme për një firmë janë raportet e likuiditetit. (Hiadlovský, Rybovičová & Vinczeová, 2016:802) pohojnë se kompanitë duhet të kenë rrjedhje të mjaftueshme të parasë për të kryer veprimet e tyre me qëllim që të minimizojnë rrezikun e pamundësisë për të përmbushur detyrimet e tyre afatshkurtra.

(Bubić, Mladineo & Šušak, 2016:163) e kanë studiuar ndikimin e taksave në një tjetër këndvështrim. Ata pohojnë se likuiditeti i kompanive në Kroaci është ndikuar fuqimisht nga shumë faktorë të brendshëm dhe të jashtëm. Hulumtimet e kryera i kanë çuar në

përfundimin se ekziston një marrëdhënie e konsiderueshme midis ndryshimit të normës së TVSH-së dhe raporteve të likuiditetit. Ata arritën në përfundimin se ndryshimi i normës së TVSH-së për kompanitë e falimentuara kishte një ndikim të rëndësishëm në Raportin e Keshit. Horizonti kohor i shkurtër për rregullime dhe ristrukturime financiare bëri që ekuilibri i likuiditetit në këto kompani të krijonte shqetësime. Ndërsa për firmat të cilat vazhduan aktivitetin e tyre ekonomik edhe pas ndryshimeve tatimore, autorët nuk gjetën ndonjë ndikim të konsiderueshëm.

Menaxhimi i likuiditetit të aseteve aktuale dhe detyrimet aktuale të bilancit në një nivel të duhur është një kusht i rëndësishëm për përmirësimin e performancës së kompanisë dhe zgjerimin e vlerës së saj, (Hiadlovský, Rybovičová & Vinczeová, 2016:802). Gjithashtu autorët theksojnë se në kuadrin e pohimit të mësipërm, përmirësimi i likuiditetit ka një ndikim pozitiv të drejtëpërdrejtë në performancën e kompanisë.

Duke parë ndikimin që ka politika fiskale në ekonomi dhe në raportet financiare, ndryshimet e saj duhet të analizohen me kujdes për prespektiva afatgjata.

2.4 Faktorët që nxisin shoqërinë për tatimet

(Shojaee, 2016:1884-1885) pohon se faktorët që prekin njerëzit dhe aftësinë e shoqërisë për tatime përcaktohen nga faktorët strukturorë dhe vullnetarë. Tek faktorët më të rëndësishëm strukturorë që ndikojnë në aftësinë e njerëzve për të paguar taksat autori përmend se mund të jenë të ardhurat për frymë, rëndësia e llojeve të ndryshme të aktiviteteve ekonomike dhe politikat makroekonomike të marra nga qeveritë. Ndërsa tek faktorët vullnetarë autori pohon se përfshihen zhvillimi i kulturës tatimore në shoqëri, pikëpamja e përgjithshme e sistemit tatimor, si edhe opinioni i qytetarëve për qeverinë që mund të ndikohet nga cilësia e shërbimeve publike dhe mënyra e shpenzimit të të ardhurave tatimore.

Taksat kanë efekte makro dhe mikro ekonomike në një ekonomi moderne (Esmaeel, 2013:10). Çdo ndryshim që lidhet me sistemin tatimor do të ketë ndikim dhe efekt tek tatimpaguesit. Ndryshimet që ndërmerren nga institucionet përkatëse duhet të studjohen në një kontekst më të gjërë nga institucionet përkatëse se si mund të reagojë aftësia tatimpaguese. Cili do të jetë motivimi i një tatimpaguesi për të punuar më shumë për një shtesë tatimi tek të ardhurat e tij?

Përderisa tatimpaguesit janë ato të cilët sigurojnë të hyrat tatimore është e rëndësishme të analizohen dhe studjohen prespektivat e tyre. Gjetjet e (Gerger, Gerçek, Taşkın, Bakar & Güzel, 2014:26) tregojnë se drejtësia, besimi dhe të drejtat e tatimpaguesve janë përcaktues thelbësorë të prespektivës së tatimpaguesve. Përveç kësaj, gjetjet e tjera të këtij studimi tregojnë se rezistenca, respekti dhe përdorimi i teknologjisë ndikojnë pozitivisht në prespektivat e tatimpaguesve. Rezultatet e tyre u bazuan në të dhënat empirike të mbledhura nga një sondazh i 680 të anketuarve në Turqi.

2.4.1 Të dhëna nga përdorimi i TVSH-së në botë

Gjetjet kryesore sipas Pagesave të Taksave për vitin 2017⁹ janë të përmbledhura më poshtë:

1. Tatimi mbi vlerën e shtuar është sistemi më i përdorur rreth botës me një shpërndarje në 162 ekonomi të ndryshme sipas “Pagimit të Taksave 2017”.
2. Që nga viti 2008, 15 ekonomi kanë përfshirë në paketën e tyre një sistem të ri të TVSH-së dhe kjo listë pritet të rritet më tej me futjen e TVSH-së në Indi në 2017-ën dhe në Gulf States në vitin 2018.


⁹ Për më tepër: <https://www.pwc.at/de/publikationen/umsatzsteuer/vat-compliance-paying-taxes2017.pdf>

3. Sipas Pagesave të Taksave 2017, koha vjetore për të zbatuar TVSH-në për rastin e kompanive të studjuara shkon nga 8 orë për vit në Zvicër në 1,189 orë në Brazil, e cila është ekuivalente me një dite pune në Zvicër dhe gati 30 javë në Brazil.
4. Koha për t'u zbatuar ndryshon edhe midis vendeve me një nivel zhvillimi të ngjashëm dhe me sistemet e TVSH-së që janë të ngjashme në parim, si për shembull shtetet anëtare të BE-së. Në Luksemburg, pagesa e taksave të kompanive të studjuara ka nevojë vetëm 22 orë në vit për të zbatuar TVSH-në krahasuar me 165 orë në Bullgari.
5. Koha për të zbatuar detyrimet e TVSH-së varet nga niveli i zhvillimit të një ekonomie. Në qoftë se sistemet e paraqitjes dhe të raportimit do të ishin në kohë reale, si do të reagonin bizneset ndaj këtij ndryshimi teknologjik?
6. Mesatarisht 27% më pak kohë shpenzohet në lidhje me detyrimet e TVSH-së në vendet ku bizneset paguajnë dhe depozitojnë deklaratën e TVSH-së online. Që nga viti 2008, 26 vende më shumë kanë miratuar paketën elektronike dhe sistemet e pagesave për të bërë pajtueshmërinë e TVSH-së më efikase dhe për të ndihmuar në uljen e mashtrimit dhe evazionit.
7. Edhe pse koha e zbatimit është reduktuar mesatarisht, në BE, koha e zbatimit rritet në rastet e kthimeve, kur kërkohen edhe dokumente shtesë siç janë faturat.
8. Koha për të marrë një rimbursim varion nga pak mbi 3 javë në rreth 106 javë me një mesatare globale prej 21.6 javësh.

Sipas Pwc, Analizës së Pagesës së Taksave koha mesatare globale e zbatimit të TVSH-së për vitin 2008 është 128 orë, ndërsa, për vitin 2015, mesatarja globale është 106 orë, pra kemi një rënie afërsisht 17% të kohës së zbatimit. Ndërsa koha mesatare e nevojshme (e

shprehur në orë), për të zbatuar TVSH-në në çdo rajon për vitin 2008 dhe 2015 është ilustruar në figurën e mëposhtme.

Figura 4-Koha mesatare e nevojshme për të zbatuar TVSH-në në çdo rajon për vitin 2008 dhe 2015 (orë)



Burimi: Pwc, Paying Taxes 2017.

2.4.2 Evazoni fiskal

Kuptimi i shprehjes evazion fiskal, sipas shkencës së financave, lidhet me të gjitha ato veprime që kanë për qëllim të zvogëlojnë ose të eliminojnë kontributin fiskal në arkën e shtetit prej qytetarëve ose subjekteve, duke shkelur dispozita dhe norma fiskale specifike, (Shtetiweb, 2014). (Hashimzade, Myles & Binh, 2010:2) e përcaktojnë evazionin fiskal si fshehja e paligjshme e një aktiviteti të tatueshëm. Dukuria e evazionit fiskal përveç të

ardhurave më të ulëta që i shkakton qeverisë, ajo është gjithashtu edhe një goditje ndaj politikës fiskale.

Mënyrat e kryerjes së evazionit fiskal janë të ndryshme. Disa prej tyre janë të përmendura më poshtë:

- Në rastin e kryerjeve të transaksioneve të shitjes së mallrave ose shërbimeve, pa lëshuar faturën e rregullt sipas legjislacionit, ose lëshimin e kuponit tatimor.
- Në rastin e kontratave të qerave, shpesh herë vlera e pagesës së qerasë sipas periudhës së caktuar, vendoset në një vlerë më të ulët, për të paguar një tatim në burim, në lidhje me qeranë më të ulët sesa është realisht. Kjo kryhet në marrëveshje joligjore për përfitime të dyanshme ndërmjet qeramarrësve dhe qeradhënësve.

Në zbatim të ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” neni 8 dhe 9, këto të ardhura janë të tatueshme me shkallë tatimore 15%. Drejtoria e përgjithshme e Tatimeve dhe Taksave udhëzon se bazuar në pikën 2.6.4, të Udhëzimit të Ministrit të Financave, për të ardhura të paguara nga persona, të cilët nuk mund të bëjnë mbajtjen e Tatimit mbi Burim për llogari të organeve tatimore shqiptare, përfituesi i të ardhurave është i detyruar të deklarojë dhe të paguajë tatimin në masën 15% të të ardhurave, të realizuara jo më vonë se data 20 e muajit që pason kohën kur është kryer pagesa. Për t’u regjistruar për këtë përgjegjësi tatimore subjektet duhet të paraqiten pranë drejtorive tatimore përkatëse rajonale. Për të shmangur këtë mënyrë të evazionit fiskal nga administrata tatimore kryhen kontrole në subjekte në qoftë se kanë dokument pronësie për objektin e tyre tregtar, ose nëse e kanë marrë me qera duhet t’iu demonstrohet kontrata e qerasë. Agjentët

tatimore kryejnë matjet e ndërtesës ose objektit dhe konkludojnë nëse çmimi për metër katror është në përputhje me legjislacionin dhe vlerën e shënuar në kontratë qeraje. Në rast të konstatimit të shkeljeve ligjore vendosen edhe gjobat përkatëse.

- Marrëveshjet ndërmjet punëdhënsve dhe punëmarrësve janë një tjetër mënyrë e kryerjes së evazionit fiskal. Rasti më ekstrem është mos sigurimi i punonjësve për kontribute shoqërore dhe shëndetësore. Ndërsa raste të tjera janë deklarimi i një page më të ulët sesa është realisht, dhënia e shpërblimeve shtesë punonjësve në një mënyrë joligjore.
- Marrëveshjet e fshehta me klientët duke shitur mallra dhe shërbime për efekt zvogëlimi fiskal nga ana e shitësit. Ndërkohë që blerësit mund të mos i interesojë marrja e faturës, sepse fatura e rregullt i kontabilizon mallrat dhe shërbimet e blera. Krijohet një efekt zinxhir sepse edhe blerësi mund ta rishesi pa fatura të rregullta tatimore, duke shmangur në këtë mënyrë gjendjen reale të inventarit sipas kontabilitetit, ndërkohë që magazinat tregojnë një sasi më të ulët. Kontrollat efikase të tatimeve janë ato të cilat mund t'i shmangin ose të reduktojnë kryerjen e këtyre transaksioneve.

Këto ishin vetëm disa nga mënyrat e kryerjes së evazionit fiskal. Këto veprime prodhojnë efekte negative për ekonominë e një vendi. Mbledhja e të ardhurave më të ulëta krijon vështirësi në shpërndarjen e këtyre burimeve për financimin e shërbimeve publike. Në një deklaratë të muajit shkurt 2018, kryeprokurorja e Shqipërisë Arta Marku deklaroi:

Fshehja e të ardhurave nuk mund të realizohet nga subjektet tregtare pa patur ndihmën dhe bashkëpunimin e nëpunësve të administratës tatimore, të cilët shpeshherë misionin e tyre, atë të mbledhjes së të ardhurave për Buxhetin e Shtetit,

e shkëmbejnë me përfitime personale. Ndaj krahas hetimeve ndaj subjekteve që priren të kryejnë evazion fiskal duhet përqëndruar vëmendja te nëpunësit publikë të administratës tatimore, (Marku, 2018).¹⁰

Gjatë vitit 2017 në Shqipëri janë konstatuar 165 skema të evazionit fiskal nga bizneset të cilat janë referuar për hetime të mëtejshme në prokurori. Sipas të dhënave zyrtare të Drejtorisë së Tatimeve në total dëmi i konstatuar si pasojë e skemave mashtruese arrin në 6.2 miliardë lekë të cilat mungojnë në buxhetin e shtetit. Hetimi tatimor ka konstatuar se rastet më të shumta të abuzimeve janë vërejtur sidomos në mos pagesën e taksave dhe tatimeve, fshehje e të ardhurave dhe në krijimin e skemave mashtruese me TVSH-në. Krijimi i skemave fiktive për marrjen e rimbursimit të TVSH-së ka edhe numrin më të lartë të bashkëpunëtorëve, ndërsa dëmi prej kësaj skeme arrin në 1.3 miliardë lekë. Ndërsa mos pagesa e taksave dhe tatimeve ka edhe shifrën më të lartë të demit të konstatuar prej mbi 3 miliardë lekësh e ndjekur nga fshehja e të ardhurave, (Ora News, 2018).

(Harrison & Krelove, 2005:16) pohon se një sasi e madhe e të ardhurave nga TVSH humbet si pasojë e abuzimit të rimbursimit të TVSH-së.

(Terzić, 2017:57) konkludon se faktorët e normës së taksave, gjobave, moralit tatimor dhe kultura e tatimpaguesve kanë një rëndësi të madhe në efektet e evazionit fiskal. Përveç këtyre, shtrëngimi i politikave penale do të kontribonte në shtypjen dhe më efikase kundër të gjitha llojeve të evazionit fiskal. Rritja e moralit tatimor dhe kulturës së taksapaguesve duhet të kontribojnë në përmirësimin e përputhshmërisë së taksave nga njëra anë dhe

¹⁰ Për më tepër: <http://top-channel.tv/2018/02/09/evazoni-fiskal-marku-hetim-jo-vetem-subjektit-por-dhe-zyrtareve-te-tatimeve/>

autoritetet tatimore duhet, nga ana tjetër, të përdorin masat e tyre për të rritur moralin dhe kulturën e taksapaguesve sugjeron autori.

(Luttmer & Singhal, 2014:155) pohojnë se morali i taksave përdoret zakonisht si një koncept i vetëm, por mund të jetë më i saktë i menduar si një grup motivimesh themelore për përputhjen e taksave. Për më tepër autorët shtojnë se identifikimi i kanaleve përmes të cilave funksionon morali i taksave është i rëndësishëm për të kuptuar preferencat individuale dhe për hartimin e përgjigjeve të përshtatshme të politikave.

(Sarmiento, 2016:95) pohon se një nivel më i ulët i korrupsionit dhe një sistem më i mirë ligjor dhe gjyqësor tentojnë të ndikojnë pozitivisht në të ardhurat e TVSH-së. Në vendet në zhvillim, firmat joformale përbëjnë deri në gjysmën e aktivitetit ekonomik, (La Porta & Shleifer, 2014:109).

Sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve rreth 8,700 individë dorëzuan në fund të muajit prill Deklaratën Individuale Vjetore të të Ardhurave (DIVA), një detyrim vjetor që në Republikën e Shqipërisë e kanë si rezidentët, ashtu edhe jo rezidentët, të cilët realizojnë të ardhura në shumën mbi 2 milionë lekë. Kjo shifër është rreth 5% më e lartë se numri i deklaruesve të vitit paraardhës. Për vitin 2017, vlera e paguar nga individët, të cilët bënë deklarinimin e të ardhurave vjetore u rrit me 118%, krahasuar me pagesat e kryera për vitin 2016. Thënë ndryshe, pagesa totale e derdhur nga këta individë në buxhetin e shtetit është në vlerën e rreth 275 milionë lekëve, (Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve, 2018).¹¹

¹¹ Për më tepër: (Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve, 2018). Marrë nga: <https://www.tatime.gov.al/d/8/45/0/590/deklarimi-individual-vjetor-i-te-ardhurave-ne-2018-mbi-8700-individe-dorezuan-deklaraten->

KAPITULLI III: SISTEMI TATIMOR

3.1 Sistemi tatimor

Në marrjen e vendimeve ekonomike një biznes ndikohet nga sistemi tatimor i vendit ku operon. Sistemi tatimor në kuptimin e përgjithshëm përbëhet nga tërësia e tatimeve dhe taksave, që vendos shteti me anë të akteve ligjore dhe nënligjore tatimore, për t'u paguar nga subjektet e ndryshme tatim e taksapaguese dhe nga institucionet përkatëse për grumbullimin e tyre, (Dhamo, 2010:471). Në bazë të Nenit 3 të ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore Në Republikën E Shqipërisë”: Legjislacioni tatimor në Shqipëri përbëhet nga marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi, ligjet tatimore dhe aktet nënligjore të miratuara në mbështetje të ligjeve tatimore.

Taksat dhe tatimet janë një mënyrë që përdor shteti për grumbullimin e të ardhurave për shpenzimet korrente për pagat e administratës, fondet e veçanta dhe fondet e reja të pagave; për pagesat e interesave të brendshme e të huaja si edhe për kontigjencën për risqet e borxhit; shpenzimet operative të mirëmbajtjes; subvencionet; shpenzimet për fonde speciale; shpenzimet për buxhetin vendor; shpenzime kapitale; huadhënie, fonde shpronësimi e shpenzime të tjera.

3.2 Refomat fiskale në Shqipëri

Përgjatë pothuajse tre dekadave të fundit, Shqipëria ka pësuar ndryshime të mëdha. Ndryshimet kanë prekur fusha të ndryshme të këtij shteti, por më të rëndësishmet janë ndryshimet politike, sociale dhe ekonomike. Kriza ekonomike në vitet '90 krijoi nevojën urgjente për rishikimin e politikave buxhetore dhe fiskale. Rishikimi i këtyre politikave ishte një domosdosshmëri që kërkonte zgjidhje të shpejtë. Por vështirësitë ishin të shumta,

mungonte një kuadër rregullues në fushën ekonomike dhe për më tepër formimi dhe aftësitë në fushën e ekonomisë dhe financës shfaqej si një barrierë.

Në Shqipëri hartimi i legjislacionit tatimor i ka fillesat në vitin 1991 dhe u shpall në janar të vitit 1992, i cili u pasua me nxjerrjen e ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat” më 14 korrik 1992. Pikërisht në këtë periudhë kemi edhe aktet e para ligjore. Përcaktimi i llojit të ligjit, bazës së taksueshme e tarifave tatimore dhe në përgjithësi i vendosjes së kornizave të legjislacionit fiskal i përkasin fundit të vitit 1991 dhe fillimit të 1992. Parlamenti, në janar 1992, miratoi një paketë ligjore tatimore, e cila krijoi bazën e nevojshme ligjore në fushën e tatimeve dhe taksave. Ajo krijoi një instrument të ri fiskal të domosdoshëm, i cili ofronte mundësi për sigurimin e të hyrave publike dhe ndaljen e krizës që po përjetonte vendi. Legjislacioni tatimor, i cili filloi të zbatohet në vitin 1992, mund të konsiderohet si themeli i sistemit tatimor modern. Në këtë periudhë krahas tatimeve të tilla si akcizat, tatimi mbi qarkullimin, tatimi mbi fitimin dhe mbi biznesin e vogël, filloi dhe implementimi i tatimit mbi të ardhurat personale (TAP), kryesisht nga pagat. Ligjet e hartuara në këtë periudhë ishin të thjeshtë dhe jo të komplikuar. Fillimisht u hartuan këto ligje:¹²

1. Ligji mbi fitimin i miratuar në janar 1992, përmirësuar në mars 1993, në të cilin u implementua për herë të parë sistemi proporcional i vjeljes së tatimeve, që teorikisht dhe praktikisht njihet se synon nxitjen dhe zhvillimin e veprimtarisë së lirë ekonomike dhe private.

¹² Marrë nga: Vadinaj E., (2017). Modelet E Dyfishta Të Raportimit Kontabël Dhe Fiskal. Tezë Doktrature: Universiteti Aleksandër Moisiu., fq. 38.

2. Ligji për tatimin mbi qarkullimin si tatim i tërthortë njëfazor, që u zbatua për produktin e gatshëm që hidhej në qarkullim të lirë civil brenda vendit. Ky ligj i paraprinte TVSH (tatimit mbi vlerën shtuar).
3. Ligji për Investimet e Huaja, miratuar në nëntor të vitit 1993, i cili trajtonte në mënyrë të barabartë investitorët të huaj dhe vendas.

Sipas Mateli (2013) dhe Ngjela (2015), ndryshimet në legjislacionin tatimor që kanë ndodhur në Shqipëri prej më shumë se dy dekadash, reformat fiskale mund të grupohen në gjashtë periudha¹³:

Periudha 1991-1993: fillimet e sistemit tatimor, hartimi dhe miratimi i paketës fiskale dhe futja e instrumenteve të ekonomisë së tregut në ekonominë e vendit. Karakteristikë për vitet e para të kësaj periudhe ishte mungesa e politikave tatimore dhe sistemit tatimor, mungesa që duheshin kapërcyer me synim zgjerimin e sektorit privat dhe nxitjen e reformës tatimore. Në mënyrë të përmbledhur karakteristikat e kësaj periudhe paraqiten si më poshtë:

- Mungesë e legjislacionit tatimor dhe mungesë e procedurave të shkruara të punës për t'u ndjekur nga punonjësit e administratës tatimore.
- Mungesë e specializimit në administratën tatimore.
- Përmbushja e objektivit të mbledhjes së të ardhurave tatimore pa një bazë të dhënash ose në të dhëna të kufizuara, sepse mungon dokumentacioni për evidentimin e tyre.
- Menaxhimi i mbledhjes së tatimeve fokusohet në rezultatet afatshkurtra dhe jo afatmesme dhe afatgjata.

¹³ Marrë nga: Vadinaj E., (2017). Modelet E Dyfishta Të Raportimit Kontabël Dhe Fiskal. Tezë Doktrature: Universiteti Aleksandër Moisiu., fq. 38-40.

- Ekziston një ekonomi e konsiderueshme “jo formale” me një përqindje të lartë veprimtarie nga tatimpagues të pa regjistruar dhe tatimpagues të regjistruar që raportojnë dhe deklarojnë më pak të ardhura, qarkullim apo fitim.
- Mungesë e dokumentacionit dhe infrastrukturës së nevojshme.
- Llogaritja e të ardhurave dhe vendosja e tatimit bëhet nga punonjësit e tatimeve dhe ka pak interes për zbatimin e sistemit të vetllogaritjes së tatimit.
- Mungesë kontrolli për parandalimin e korrupsionit.
- Vendndodhja e administratës tatimore dhe numri i punonjësve përgjithësisht trashëgohet dhe krijohet sipas ndarjes administrative të sistemit të mëparshëm.
- Bashkëpunimi ndërmjet administratës tatimore dhe organeve të tjera shtetërore ishte i ulët. Mungesë edukimi dhe ndihme për tatimpaguesin.
- Mungesë trajnimi.
- Mungojnë matësit e efektivitetit të punës.

Meqënëse ishte edhe periudha e parë e reformave fiskale nëse mund ta quajmë kështu, por duke pasur parasysh edhe situatën politike të krijuar asokohe një performancë e ulët në reformat fiskale ishte e pritshme. Kjo vërehet tek mungesa e specializimit dhe trajnimit të administratës, nismat e ulëta për parandalimin e korrupsionit, lulëzimin e shumë bizneseve informale. Pikë e dobët ishte bashkëpunimi ndërmjet administratës tatimore dhe institucioneve të tjera shtetërore. Në vitin 1993 të ardhurat nga tatimet dhe taksat përbënin 80.8% të të ardhurave totale tatimore.

Periudha 1994-1996: implementimi i legjislacionit tatimor dhe vendosja e tatimeve dhe taksave. Karakteristikat e kësaj periudhe paraqiten shkurtimisht si më poshtë:

- Ruajtje e tipareve të sistemit tatimor të viteve 1991-1993.

- Riorganizimi organeve tatimore dhe implemetimi i funksioneve të reja.
- Ndryshime dhe përmirësime në legjislacionin tatimor.
- Rritje e numrit të subjekteve të regjistruara.
- Rritje e barrës tatimore.
- Vendosje e elementëve të rinj në taksim.
- Falje e detyrimeve të papaguara.
- Përmirësime të metodave të mbledhjes së tatimeve.

Periudha e dytë e reformave fiskale ishte një vazhdimësi e periudhës së parë, por që ka njohur përmirësime. Të ardhurat tatimore u rritën me 10.3% në vitin 1995 dhe me 7.8% në vitin 1996. Ndërkohë të ardhurat nga tatimet dhe doganat u rritën me 1.8% në vitin 1995 dhe rënë me 2.4% në vitin 1996.

Periudha 1997-1998: stabilizimi i të ardhurave tatimore me objektiv frenimin e rënies së tyre, kapërcimin e krizës ekonomike dhe financiare të krijuar nga firmat piramidale në vitin 1997. Një nga reformat e marra në këtë periudhë ishte rritja e shkallës së TVSH-së nga 12.5% në 20%. Në vitin 1997 të ardhurat nga Tvsh-ja u rritën me 72.5%. Në vitin 1998 të ardhurat nga tatimi mbi fitimin u rritën me 79.17%, të ardhurat nga akciza u rritën me 122.73%, të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale u rritën me 50%, të ardhurat nga taksat nacionale dhe të tjera u rritën me 43.5% dhe të ardhurat nga taksat doganore u rritën me 40%. Të ardhurat totale tatimore arritën në vitin 1998 në 72.6 miliardë lekë. TVSH-ja gjatë kësaj periudhe ka zënë një peshë ndaj të ardhurave totale tatimore rreth vlerave 34.3% dhe 39.6%.

Periudha 1999-2001: konsolidimi i sistemit tatimor dhe të ardhurave tatimore, të cilat rënë ndjeshëm pas ngjarjeve të vitit 1997. Paketa ligjore që zbatoi shteti shqiptar gjatë këtyre

viteve, në thelb dhe përmbajtje përmirësoi sistemin tatimor të mëparshëm, duke aplikuar elementë të sistemit tatimor modern dhe metoda të reja në fushën e tatimeve dhe taksave. Paketa ligjore u konceptua duke ruajtur sistemin e mëparshëm tatimor që mbështetej në themelin e dy grupeve të rëndësishme të tatimeve; tatimet indirekte dhe tatimet direkte. Kjo periudhë karakterizohet nga:

- Hartimi i një legjislacioni tatimor modern me ndihmën e asistencës së huaj.
- Rritje e efektivitetit të administratës tatimore dhe përmirësim të saj.
- Qëndrueshmëri dhe rritje e të ardhurave publike.

Të ardhurat totale tatimore u rritën me 24.5% në vitin 2000, ndërsa në vitin 2001 patën një rritje më të ulët, konkretisht 9.8%. Elementët e të ardhurave tatimore nga tatimet dhe doganat kanë pësuar rritje në vitet 2000 dhe 2001, duke pasqyruar një qëndrueshmëri fiskale dhe tatimore. TVSH-ja gjatë kësaj periudhe ka zënë një peshë ndaj të ardhurave totale tatimore rreth vlerave 35.7% dhe 36.6%.

Periudha 2002-2006: Krijimi i klimës makroekonomike për zhvillim dhe rritjen e të ardhurave nëpërmjet përmirësimit të marrëdhënieve me biznesin dhe rritjen e shërbimit të administratës tatimore ndaj tatimpaguesve dhe publikut. Me asistencë të PriceWaterhouseCoopers u hartua dhe miratua ligji Nr.8976, datë 12.02.2002 “Për akcizat”. Ndryshimet që ndodhen në sistemin tatimor, falë ndihmës dhe asistencës së huaj, i dhanë një pamje më të plotë dhe të re legjislacionit fiskal duke krijuar lehtësi më të mëdha për investimet në vend dhe biznesit në tërësi. Gjithashtu u përmirësua ndjeshëm administrimi tatimor nëpërmjet futjes dhe përdorimit të metodave të reja moderne, të informatizimit dhe kontrollit tatimor. Në periudhën e pestë të reformave fiskale përqindja më e lartë e rritjes së të ardhurave totale tatimore ka ndodhur në vitin 2004, konkretisht 14.17% dhe përqindja më e ulët e të

ardhurave totale tatimore ka ndodhur në vitin 2005, me vetëm 10.7% rritje totale. TVSH-ja gjatë kësaj periudhe ka zënë një peshë ndaj të ardhurave totale tatimore rreth vlerave 34.8% dhe 36.1%.

Periudha 2007-2015: ristrukturimi dhe modernizimi i sistemit tatimor duke synuar:

- Sigurimin e të ardhurave sipas deklaramit vullnetar.
- Reduktimin e korrupsionit nëpërmjet futjes së deklaramit elektronik.
- Ngritjen e strukturës antikorrupsion.
- Rritjes së informacionit dhe ndihmës teknike për tatimpaguesit, duke përmirësuar klimën me biznesin në Shqipëri.
- Hartimin e një ligji të ri për procedurat tatimore.

Në periudhën e gjashtë të reformës fiskale të ardhurat totale tatimore kanë njohur rritje përveç vitit 2012 dhe 2013, ku të ardhurat totale tatimore kanë rënë përkatësisht me 1% dhe 0.3%. Gjatë kësaj periudhe rritjen më të lartë të të ardhurave totale tatimore e ka pasur viti 2008, respektivisht 15.9%. Në vitet 2012 dhe 2013 ka pasur gjithashtu rënie të të ardhurave nga TVSH-ja, përkatësisht me 2.2% dhe 3.9%.

3.2.1 Llojet e tatimeve dhe taksave që aplikohen në Shqipëri

Përsa i përket llojeve të tatimeve dhe taksave që aplikohen në Shqipëri janë të renditura më poshtë:

 *Tatime dhe taksa kombëtare ku përfshihen:*

- a) Tatimi mbi vlerën e shtuar - Ligji Nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton se: Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) është një tatim i përgjithshëm mbi konsumin e mallrave dhe shërbimeve,

proporcional me çmimin e tyre, që i ngarkohet në çdo fazë të prodhimit dhe procesit të shpërndarjes çmimit pa tatimin.

b) Tatimi mbi të ardhurat – Me Ligjin Nr. 8438, Datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat në Republikën e Shqipërisë i Ndryshuar”, rregullohen marrëdhëniet që lindin në fushën e tatimit mbi të ardhurat personale, tatimit mbi fitimin si dhe të tatimit të mbajtur në burim të të ardhurave.

c) Akciza; - Është një tatim i tërthortë i një lloji të veçantë për konsumin e të mirave të luksit.

ç) Tatimi për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet – Ky tatim i referohet një kategorie të caktuar lojërash fati sipas kushteve dhe kriterëve referuar legjislacionit. Organi publik i ngarkuar me ligj për monitorimin dhe kontrollin e ligjshmërisë së funksionimit të subjekteve tatimpagues që ushtrojnë aktivitet në këtë fushë është Autoriteti për Mbikëqyrjen e Lojrave të Fatit, institucion në varësi të Ministrisë së Financave. Në ligjin Nr. 140/2016 “Për Disa Ndryshime në Ligjin Nr. 155/2015 Për Lojërat E Fatit Në Republikën E Shqipërisë” është shtyrë afati nga 31 Dhjetor 2016 në 31 Dhjetor 2018 për organizatorët që ushtrojnë veprimtarinë pranë këtyre institucioneve, duhet të marrin masat për ndryshimin e vendndodhjes. Në rast se brenda kësaj periudhe shoqëritë nuk kanë ndryshuar vendndodhje, AMLF-ja procedon me masa administrative deri në heqjen e licencës.

d) Taksat kombëtare – Kanë pësuar ndryshime të kushtëzuara referuar etapave të zhvillimit ekonomik në përgjigje të politikave fiskale dhe nevojave të komunitetit të biznesit.

dh) Tatime të tjera, të cilat janë përcaktuar të tilla me ligj të veçantë.

Tatime dhe taksa vendore

Tatimet dhe taksat vendore përcaktohen në ligjin për sistemin e taksave vendore. Ligji Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore i ndryshuar” përcakton rregullat për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe të detyrave nga organet e qeverisjes vendore, për vendosjen e taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre. Ligji përveç strukturimit, detajon çdo lloj takse të administruar nga organet vendore të administrimit, përcakton qartë edhe administrimin e saj duke filluar me mënyrën e llogaritjes, personat përgjegjës të pagimit të taksës dhe ato të mbledhjes së saj.

Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore përcaktohen në ligjin për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Ligji për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë dhe Ligji për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë, përcaktojnë rregullat për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe të kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shëndetësore, vendosjen dhe zbatimin e skemës së sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor etj.

3.3 Tatimi mbi vlerën e shtuar

Në një nivel më të thellë, taksat dhe politikat fiskale janë në thelb të kontratës shoqërore të çdo shoqërie, (Daude, Gutiérrez, & Melguizo, 2012:5). Nisur nga ky pohim, presim që çdo vend të ketë politikën e vet fiskale, por ajo që dallon vendet e ndryshme është përbërja e politikës fiskale dhe mënyra e menaxhimit të saj.

Në këtë tezë dokturate do të diskutohet më së shumti tatimi mbi vlerën e shtuar, si pjesë e politikës fiskale. (Dobrowolska, 2008:80) e ka përcaktuar TVSH-në si një taksë neto e shitjes me shumë faza që takson të gjithë pjesëmarrësit e tregtisë së biznesit. TVSH-ja vazhdoi të përhapej në të gjithë botën gjatë viteve 1980, 1990 dhe 2000, (Encyclopedia.com, 2009). Shumë vende në zhvillim miratuan sistemin e TVSH-së për shkak të avantazhit të perceptuar në procesin e grumbullimit, (Ofishe, 2015:34).

Në çështjet më poshtë do të trajtoj një historik të shkurtër të krijimit dhe lindjes së tatimit mbi vlerën e shtuar në botë, historikun e TVSH-së europiane dhe harmonizimit të TVSH-së. Në vazhdim do të trajtoj historikun dhe mënyrën e aplikimit të TVSH-së në Shqipëri dhe Kosovë.

3.3.1 Historiku i krijimit të TVSH-së

Sipas përkufizimit të Ligji Nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar: Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) është një tatim i përgjithshëm mbi konsumin e mallrave dhe shërbimeve, proporcional me çmimin e tyre, që i ngarkohet në çdo fazë të prodhimit dhe procesit të shpërndarjes çmimit pa tatimin.

Megjithëse ka më shumë se gjashtëdhjetë vite që aplikuar, ky tatim është diskutuar edhe në një kohë më të hershme, kur u propozua së pari nga Dr. Wilhelm Von Siemens në Gjermani në vitin 1919.

Tatimi mbi vlerën e shtuar është aplikuar për herë të parë në Francë më 10 prill 1954, nga ekonomisti francez Maurice Lauré, drejtor i përbashkët i Autoritetit Francez Tatimor i Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave. Fillimisht u aplikua mbi bizneset e mëdha dhe pastaj u zgjerua për të gjithë sektorët e biznesit. Ky lloj tatimi në Francë është kthyer në burimin më të rëndësishëm të financimit të buxhetit, që përbën një pjesë të konsiderueshme të të

ardhurave të shtetit. Shumë vende në Afrikë, Azi dhe në Amerikën e Jugut gjithashtu e kanë përfshirë në paketën e tyre fiskale këtë lloj tatimi.

Në vitin 1968, Këshilli i Komunitetit European, ka miratuar direktivën e parë lidhur me TVSH-në, sipas së cilës, vendet e reja që dëshirojnë të aderojnë në gjirin e BE-së, një nga kushtet që duhet të plotësojnë është instalimi i një sistemi tatimor të krahasueshëm me atë të TVSH-së franceze, (Bundo, 2012:121).

Faza e dytë e miratimit të TVSH-së ka ndodhur nga fundi i viteve 1980 me futjen e TVSH-së në disa industri të profilit të lartë të industrializuar në vende jashtë BE-së, si Australia, Kanadaja, Japonia dhe Zvicra, (James, 2011:17). Gjithashtu kjo fazë dëshmoi një zgjerim masiv të TVSH-së në ekonomitë në tranzicion dhe në zhvillim, më së shumti në Afrikë dhe Azi.

Deri në fillim të viteve 2000, TVSH-ja ishte bërë një komponent kyç i sistemeve tatimore në më shumë se 120 vende, me norma tatimore që ndryshonin nga 5 në 25 për qind, (Encyclopedia.com, 2009).

Nga shfletimi i literaturës pohohet se barra e TVSH-së, ashtu si taksat e tjera të konsumit tenton t'i kalojë konsumatorit. Meqënëse ky tatim ka efektin regresiv, njerëzit me të ardhura më të ulëta kanë barrën më të madhe. Për të shmangur këtë, sistemet tatimore tentojnë të tatojnë në një nivel më të ulët produktet dhe shërbimet e domosdoshme, përkundrajt sendeve të luksit.

Avantazhet dhe disavantazhet që e shoqërojnë këtë tatim, kanë bërë që shumë autorë dhe analistë të argumentojnë bazuar në fakte se a ndikon në rritjen e pabarazisë TVSH-ja. Disa autorë TVSH-në e konsiderojnë si një tatim të rëndësishëm të sistemit tatimor, efikas dhe kontribues i të hyrave qeveritare. Nga ana tjetër, disa të tjerë e konsiderojnë këtë tatim si

një mjet që thellon pabarazinë e një vendi, duke qenë se ato që kanë të ardhura më të ulëta, kanë më pak aftësi për ta përballuar. Ndoshta këto rezultate nuk mund të jenë krejtësisht të sakta, sepse horizonti i studimit është i gjërë dhe paraqet komplikime në tërësinë e tij. (Alavuotunki, Haapanen & Pirttilä, 2018:15), nëpërmjet modelit OLS treguan se adoptimi i TVSH-së nuk ka sjellë domosdoshmërisht rritje të pabarazisë. Gjithashtu autorët kanë gjetur prova të forta se kur pabarazia matet bazuar në të ardhurat e disponueshme, vendet me TVSH kanë përjetuar rritje të pabarazisë, ndërsa në vendet ku pabarazia matet në bazë të konsumit, pabarazia nuk ka pësuar rritje pas miratimit të TVSH-së.

3.3.2 Historiku i shkurtër i TVSH-së europiane dhe harmonizimit të TVSH-së

Përsa i përket historisë së harmonizimit të TVSH-së europiane, dokumenti i parë që përmendi konvergjencën e strukturave të taksave evropiane ishte tashmë Traktati i Romës (EEC, 1962), i aprovuar në epokën e pionierit të Bashkimit Evropian (1957), (Kabátek, 2009:3). Ky dokument përbëhej nga rekomandime të gjera politike dhe garanci ndërkombëtare që synonin integritet më të fortë dhe bashkëpunimin e përgjithshëm midis shteteve evropiane. Natyrisht, politikat fiskale nuk u eliminuan në rezolutë. Deklaratat themeluese për ngushtimin e ndarjeve tatimore ishin të guximshme, por me baza të shëndoshta, duke iu referuar qasjes unike evropiane ndaj politikës tatimore. Një karakteristikë tjetër ishte se për harmonizimin e udhëzimeve të hershme, mbulimi i TVSH-së dhe përcaktimi i normave ende duhej të përcaktoheshin nga vetë shtetet anëtare. Skemat e gjera dhe skemat specifike të vendit me shumë përjashtime kishin shkaktuar që

harmonizimi të ndodhte më shumë në letër sesa në realitet (Ebrill, 2001)¹⁴. Thelbi për harmonizimin e TVSH-së u bë me direktivën e gjashtë në vitin 1977, i cili rregullon praktikisht të gjitha anët e aplikimit të TVSH-së (Bikas & Andruskaite, 2013:48).

(Kabátek, 2009:42) në punimin e tij është përpjekur të gjejë hendekun në diskutimet akademike në lidhje me harmonizimin e TVSH-së evropiane dhe të sjellë dëshmi të caktuara ekonomike për efektet e konvergjencës. Ai ka përdorur një panel prej 14 shtetesh anëtare të BE-së, duke treguar se harmonizimi i TVSH-së është i prirur për të rritur eficiencën e përgjithshme të skemave tatimore evropiane, duke rritur shumën totale të të ardhurave të TVSH-së, duke mbajtur barrën mesatare tatimore në të njëjtin nivel.

Ai arriti në përfundimin se harmonizimi i TVSH-së mund të sjellë efekte të tjera pozitive në skemën e taksave evropiane, veçanërisht në lidhje me deficietet aktuale të saj, p.sh. mashtrimet ndër-kufitare dhe mashtrimet Carousel. TVSH-ja evropiane është e ndjeshme ndaj mashtrimit për shkak të kompleksitetit të saj dhe ndarjes fiskale me bazë shtetërore brenda BE-së, (Yan, 2011:30).

Procesi i harmonizimit u ndikua dukshëm nga periudha e krizës, e cila është demonstruar, jo vetëm nga rritja e hendekut në të gjitha vendet e BE-së, por edhe në ndryshimet në normat standarde dhe të reduktuara të TVSH-së, (Andrejovská & Mihóková, 2015:496).

Qëllimi kryesor i harmonizimit të taksave indirekte në vendet e Bashkimit European ishte dëshira për të siguruar neutralitetin e taksave brenda tregtisë së brendshme, (Dobrowolska, 2008:92).

¹⁴ Marrë nga: Kabátek J. (2009). The effects of VAT harmonisation on taxrevenue in the European Union. Tezë Bachelor-i: Universiteti Charles në Pragë, Fakulteti i Shkencave Sociale, Instituti i Studimeve Ekonomike, fq.4.

FMN ka luajtur një rol të rëndësishëm në përhapjen e TVSH-së (Keen & Lockwood, 2007:19). Duke përdorur një mostër prej pesëmbëdhjetë vendeve të BE-së gjatë periudhës 1961-2005 (James & El-Ganainy, 2012:124), konstatuan se shkalla e tatimit efektiv të TVSH së lidhet negativisht me nivelin e konsumit agregat. Më saktësisht, një rritje me një pikë përqindjeje në normën e TVSH-së çon në një reduktim prej një për qind në nivelin e konsumit agregat për frymë. Kostoja marginale e fondeve për TVSH është më e lartë për familjet me të ardhura të ulëta sesa për familjet me të ardhura të larta (Go, Kearney, Robinson & Thierfelder, 2005:19).

Shkalla e tatimit mbi vlerën e shtuar ndryshon sipas vendeve. (Terfa, Ereso, Kebede, Rajendran & Nedelea, 2017:2) në studimin e tyre pohojnë se në shtetet europiane shkalla e TVSH-së varion nga 12.5% në 25%, ndërsa në vendet afrikane, përfshirë Komunitetin e Zhvillimit të Afrikës Jugore (SADC), ndryshon midis 5% dhe 20%.

Një studim mbi efektet ekonomike të strukturës aktuale të TVSH-së, i përgatitur nga Komisioni European në vitin 2013 tregon se familjet përbëjnë 60% të të gjitha detyrimeve të TVSH-së në të gjithë vendet e BE-së. Ata gjejnë se familja mesatare e BE-së përballlet me një faturë të TVSH-së që përbën 11% të totalit të tyre shpenzimeve. Ky raport është më i lartë në Rumani dhe Hungari (17.8% dhe 17.5%), pasuar nga Letonia (15.3%), Lituania (14.7%) dhe Sllovakia (13.7%).

3.3.3 Historiku i TVSH-së në Shqipëri

Me dekretin Nr.1096, datë 12.05.1995, u vendos Tatimi mbi Vlerën e Shtuar duke zëvendësuar në këtë mënyrë tatimin mbi qarkulimin. Ky ligj hyri në fuqi në 1 korrik të vitit 1996 dhe shkalla tatimore e këtij tatimi ishte 12.5%. Zëvendësimi i tatimit mbi qarkullimin me TVSH-në, u krye edhe në Shqipëri, si një metodë e adoptuar nga vendet e tjera.

(Fjeldstad, 1995:4) liston katër arsytet e mëposhtme se përsë TVSH-ja preferohet më shumë:

- Mbulimi i mundshëm i tatimit;
- Aftësinë e këtij tatimi për të dalluar mallrat e prodhimit nga mallrat e konsumit;
- Aftësia e tatimit të korrigjojë rregullimet e taksave kufitare;
- Fizibiliteti administrativ.

Mungesa e përvojës fiskale dhe situata politike jo shumë e favorshme bëri që ky ligj të kishte disa ndryshime të vazhdueshme gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 1996. Nga viti 1996 e deri në vitin 2012 ligjit bazë i janë bërë 37 ndryshime.¹⁵

Në vitin 1997 të ardhurat totale tatimore u rritën vetëm me 5.6%. Ky nivel i ulët realizimi të ardhurash tatimore vjen si rrjedhje e ngjarjeve politike, krijimi dhe mbyllja e firmave piramidale të cilat frenuan zhvillimin ekonomik të vendit. Për të mos lejuar një rënie të mëtejshme me Dekretin nr.140, datë 20.9.1997, u vendos që Neni 30 i ligjit nr.7928, datë 27.04.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar" të ndryshojë nivelin e shkallës tatimore nga 12.5% në 20%. Ky ligj ka hyrë në fuqi me datën 1 Tetor 1997. Ndryshimi i shkallës tatimore me 60% u realizua me synimin për të nxjerrë vendin nga kriza ekonomike dhe me rritjen e vëllimit të tatimeve të parandalohet situata emergjente e cila po krijohet. Në vitin 1998 të ardhurat totale tatimore u rritën me 59.21%, ndërsa të ardhurat nga TVSH-ja u rritën me 83.44%.

Në janar 1998, kufiri i regjistrimit u rrit nga 2 milion në 5 milion lekë. Në 1 janar 2001, pragu i regjistrimit u rrit nga 5 milion në 8 milion. Në janar 2010, pragu i regjistrimi u ul

¹⁵ Ligji nr. 7928, dt. 27.04.1995, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar".

nga 8 milion në 5 milionë. Nga 1 prilli 2018 pragu i regjistrimit të Tvsh-së u ul në nga 5 milion në 2 milion lekë.

Sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Ligji Nr.92/2014 datë 24.7.2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar” është hartuar në kuadër të Projektit IPA 2007 “Mbështetje për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve” të Shqipërisë për përafrimin e legjislacionit vendas me Acquis Communautaire.

Në tabelën e mëposhtme jepen specifikime për totalin e të ardhurave nga tatimet dhe doganat për serinë kohore 1996-2017.

Tabela 2- Të ardhurat nga tatimet dhe doganat për periudhën 1996-2017 (Vlerat në miliardë lekë)

Viti	TVSH	Tatimi mbi Fitimin	Akcizat	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	Taksa Nacionale dhe të tjera	Taksa Doganore	Totali i të ardhurave nga tatimet dhe doganat
1996	9.1	3.4	4.9	0.6	2.3	7.7	28
1997	15.7	2.4	2.2	0.8	2.3	9	32.3
1998	28.8	4.3	4.9	1.2	3.3	12.6	55.1
1999	29.8	6	7	3.1	6	11.4	63.3
2000	38.1	8.1	9.2	4.6	7.6	13.5	81.1
2001	41.1	10.2	9.5	6.3	7.7	12.8	87.8
2002	46.1	12.2	9.3	6.1	10.9	13.4	98.1
2003	50.6	13.1	12.3	6.4	12.5	13.9	108.8
2004	58.2	16.3	15.8	6.9	12.1	13.9	123.1
2005	64.5	19.2	18.5	7.4	12.3	13.6	135.6
2006	74.3	22.3	23	8.6	13	14	155.1
2007	87.8	21.1	28.7	14.8	14.5	9.8	176.8
2008	107.1	18.1	32.5	24.5	14.4	8.7	205.3
2009	110.1	17.1	33.5	26.8	13.4	7.9	208.9
2010	114	17.6	38.8	27.1	18.3	7.3	223
2011	119.2	19.7	40.4	28	21.4	6.9	235.5

2012	116.5	16.9	36.4	28	28.7	6.1	232.6
2013	111.9	15.1	38.2	29.6	28.5	5.8	229
2014	123.7	21.5	40.9	28.9	32.6	5.9	253.4
2015	125.8	25	39	29.7	33.6	5.8	258.9
2016	131.4	29.2	41.9	31.4	35.8	6.1	275.8
2017	139.5	31.6	45.1	32.1	38.5	6.5	293.4
Totali	1,758.80	359.7	556.3	354.1	379.2	228.7	3,636.80

Burimi: Ministria e Financave RSH & Përshtatje nga autori

Në vitin 1996 që është zbatuar për herë të parë, Tvsh-ja përbënte 32.4% të të Ardhurave Tatimore nga Tatimet dhe Doganat dhe 21.2% të të Ardhurave Totale Tatimore.¹⁶ Përqindja e të ardhurave të TVSH-së përkundrejt të Ardhurave Totale Tatimore ka qenë në rritje deri në vitin 1998, përkatësisht me 39.6%. Në vitin 1999 vlera totale Tvsh-së ishte 29.8 miliard lekë dhe përbënte 35.7% të të Ardhurave Totale Tatimore. Nga viti 2000 deri në vitin 2007 vlera e Tvsh-së është luhatur ndërmjet vlerave 34- 38%, duke arritur vlerën maksimale në vitin 2009 me 40.6%. Në vijim deri në vitin 2017, vlera ka qenë në zbritje deri në nivelin 35%. Duke analizuar peshën që zë ky tatim në totalin e të ardhurave tatimore është vlerësuar se do të ishte interesant studimi në një kontekst më të gjerë i këtij tatimi, nga se ndikohet dhe efekti i tij në makroekonomi.

(Palczewska, 2016:410-411) në punimin e saj ka ilustruar një krahasim të peshës që zënë të ardhurat e TVSH-së, ndaj totalit të të ardhurave të buxhetit të shtetit. Në analizën e kryer për vitet 2004-2012, të ardhurat nga TVSH-ja për Poloninë, luhaten ndërmjet vlerave 36.1% dhe 43.7%. Në vijim të punimit të saj, ajo ka paraqitur për të njëjtën periudhë kohore, peshën që zënë të ardhurat nga TVSH-ja për vendet anëtare të BE-së. Mesatarja për

¹⁶ Vlerat e të Ardhurave Totale Tatimore janë marrë nga Ministria e Financave.

vendet e BE-së luhatet ndërmjet vlerave 30.4% dhe 31.8%¹⁷. Në tabelën e mëposhtme kam llogaritur raportin e të ardhurave të TVSH-së ndaj totalit të të ardhurave në buxhetin e shtetit në Shqipëri, për të njëjtën seri kohore sikurse autorja e mësipërme.

Tabela 3- Pesha e TVSH-së ndaj totalit të të ardhurave në buxhetin e shtetit në Shqipëri, (Vlerat janë në miliardë lekë)

Viti	Totali i të ardhurave	TVSH	Pesha TVSH/TA Totale
2004	184.4	58.2	31.5%
2005	204.2	64.5	31.6%
2006	229.4	74.3	32.4%
2007	251.6	87.8	34.9%
2008	291.2	107.1	36.8%
2009	299.0	110.1	36.8%
2010	324.7	114.0	35.1%
2011	330.5	119.2	36.1%
2012	330.4	116.5	35.3%

Burimi: Ministria e Financave RSH, (Totali i të ardhurave & TVSH) & llogaritje të autorit

Nga rezultatet, vëmë re se pesha e TVSH-së ndaj ndaj totalit të të ardhurave në buxhetin e shtetit në Shqipëri është më e lartë se mesatarja e vendeve anëtare në BE. Në Shqipëri vlerat luhaten ndërmjet 31.5% dhe 36.8%.

3.3.4 Një vështrim mbi aplikimin e TVSH-së në Shqipëri

Tatimit mbi vlerën e shtuar i nënshtrohen të gjitha furnizimet e mallrave dhe shërbimeve, të kryera kundrejt pagesës, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, nga një person i tatueshëm që vepron si i tillë dhe të gjitha importet e mallrave në territorin e Republikës së Shqipërisë.

¹⁷ Për më tepër shih: *Palczewska O. (2016). Value Added Tax in Poland – Basis of Functioning and its Efficiency. Athens Journal of Business & Economics - Volume 2, Issue 4, 411.*

Në bazë të nenit 3 të ligjit Nr. 92/2014, “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar: Person i tatueshëm konsiderohet çdo person, pavarësisht nga forma e organizimit të tij, i cili në mënyrë të pavarur kryen veprimtari ekonomike, cildo qoftë vendi dhe qëllimi ose rezultati i kësaj veprimtarie.

Në nenin 7 të këtij ligji: Me furnizim mallrash kuptohet transferimi i së drejtës për të disponuar si pronar pasurinë e trupëzuar. Si “Furnizim malli” konsiderohen edhe transaksionet e mëposhtme:

- a) transferimi kundrejt pagesës i pronësisë së pasurisë, me urdhër nga/apo në emër të një autoriteti publik apo në zbatim të ligjit;
- b) dorëzimi i mallrave në bazë të një kontrate, ku parashikohet dhënia me qira e mallit për një periudhë të caktuar ose shitja me këste e mallit, kalimi i pronësisë i të cilit bëhet me pagesën e kështit të fundit;
- c) transferimi i mallrave bazuar në një kontratë, sipas së cilës paguhet komision për blerjen apo për shitjen.

Furnizimi i energjisë elektrike, ujit, gazit, energjisë për ngrohje ose ftohje dhe të tjera të ngjashme trajtohet si furnizim malli i trupëzuar.

Në nenin 10 të ligjit të mësipërm me furnizim shërbimesh kuptohet çdo transaksion që nuk është furnizim mallrash, përveç rasteve që në këtë ligj përcaktohet ndryshe. Ndërsa Neni 14 përcakton se me termin “importimi i mallrave” kuptohet çlirimi për qarkullim të lirë i mallrave në territorin e Republikës së Shqipërisë, siç përcaktohet në legjislacionin doganor në fuqi. Lindja e tatimit ndodh dhe TVSH-ja bëhet e kërkueshme kur importimi i mallrave është kryer në kuptim të nenit 14, të këtij ligji.

Në vlerën e tatueshme përfshihen tatimet, taksat, detyrimet, tarifat dhe pagesa të ngjashme, me përjashtim të TVSH-së; shpenzimet dytësore, të tilla si shpenzimet komisionere, të ambalazhimit, të transportit dhe të sigurimit që furnizuesi ia ngarkon blerësit ose klientit. Gjithashtu konsiderohen si shpenzime dytësore në qoftë se janë përcaktuar në marrëveshje të veçanta.

Në vlerën e tatueshme të furnizimit përfshihet vlera e ambalazheve kur ato janë të pakthyeshme. Vlera e ambalazheve të kthyeshme nuk përfshihet në vlerën e tatueshme të furnizimit, përveç kur ambalazhet e kthyeshme nuk janë kthyer nga blerësi. Përveç të tjerave në qoftë se elementet që përcaktojnë vlerën e tatueshme ose vlera e tatueshme është e shprehur në një monedhë të ndryshme nga monedha kombëtare e Republikës së Shqipërisë, i cili është vendi në të cilin bëhet vlerësimi, vlera e tatueshme shprehet në monedhën kombëtare ekuivalente me kursin e këmbimit të zbatuar nga Banka e Shqipërisë në momentin, në të cilin tatimi bëhet i kërkueshëm.

Shkallët e TVSH-së

Shkalla standarte e TVSH-së e cila aplikohet si një përqindje e vlerës së tatueshme, është 20 për qind. Me ndryshimin ligjor të datës 22 maj 2017 përveç shkallës standarde të TVSH-së, kur parashikohet në këtë ligj, mund të aplikohet shkalla e reduktuar e TVSH-së, e cila aplikohet si një përqindje e vlerës së tatueshme. Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e shërbimit të akomodimit në strukturat akomoduese, “Hotel/Resort me pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “brand name” është 6 për qind.

Përveç shkallës standarte dhe shkallës së reduktuar ligji përcakton edhe furnizimet në shkallën zero për qind të TVSH-së. Në këtë kategori përfshihen eksportet: furnizimi i mallrave të dërguara ose të transportuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nga shitësi ose për llogari të tij; furnizimi i shërbimeve që konsistojnë në punime mbi mallra të luajtshme të importuara për t'u bërë atyre punime në Republikën e Shqipërisë dhe të dërguara apo të transportuara sërish jashtë Republikës së Shqipërisë nga furnizuesi i shërbimit apo nga destinuesi i shërbimeve, të cilët nuk janë vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë ose për llogari të tyre. Mallrat në bagazhin personal të udhëtarit përcaktohen në nenin 58 dhe në nenin 59 jepen specifikimet e përjashtimit nga TVSH-ja për disa transaksione të transportit ndërkombëtar.

Gjithashtu Trajtohet si furnizim me shkallën e TVSH-së 0 për qind furnizimi i arit ndaj Bankës së Shqipërisë. Objekt i rëndësishëm i ligjit për TVSH-në është edhe e drejta e zbritjes së TVSH-së, e cila specifikohet nga disa transaksione të veçanta.

Furnizimet e përjashtuara nga TVSH-ja të cilësuar si transaksione me interes të përgjithshëm dhe jo vetëm përcaktohen në bazë të nenit 51, 52, 53 dhe 54. Në nenin 56 përshkruhen përjashtime të veçanta në import. Në nenin 59 jepen specifikimet se cilat janë furnizimet me shkallë zero të TVSH-së të transaksioneve të transportit ndërkombëtar.

Një seksion i veçantë i ligjit të mësipërm është lindja dhe aplikimi i së drejtës së zbritjes së TVSH-së. Parimi i përgjithshëm në bazë të nenit 68 është se: E drejta e zbritjes lind kur TVSH-ja e zbritshme bëhet e kërkueshme.

Neni 74 përcakton kufizimet e të drejtës së zbritjes. Ndërsa neni 84 ka përcaktuar veprimet në rastet e borxhit të keq dhe konkretisht në bazë të pikës 1:

Kur një pagesë nuk është marrë plotësisht apo pjesërisht për një furnizim të tatueshëm prej furnizuesit dhe është shpallur si i pambledhshëm nga organet gjyqësore, lejohet zbritja e TVSH-së përkatëse, e cila është TVSH e zbatuar në përputhje me këtë ligj për shumën e paarkëtuar të borxhit të keq. Ndërsa pika 2 e nenit të mësipërm pohon se: Zbritja e TVSH-së lejohet në çdo periudhë tatimore pasi borxhi bëhet borxh i keq dhe fillon, të paktën, gjashtë muaj pas mbylljes së periudhës tatimore, për të cilën TVSH-ja ishte zbatuar në lidhje me furnizimin.

Regjistrimi dhe çregjistrimi i personit të tatueshëm

Çdo person i tatueshëm duhet të deklarojë fillimin e veprimtarisë së tij ekonomike dhe të regjistrohet si i tillë brenda 15 ditëve nga data e fillimit të kësaj veprimtarie dhe çdo person i tatueshëm identifikohet me anën e një numri identifikimi për TVSH-në. Personi i tatueshëm, i regjistruar në përputhje me dispozitat e kreut për rregjistrimin e personit të tatueshëm, detyrohet të kërkojë çregjistrimin jo më vonë se 15 ditë nga dita e fundit kur ai ka kryer furnizime të tatueshme, si pjesë të veprimtarisë së tij ekonomike.

Personi i tatueshëm, i cili i nënshtrohet regjimit të bizneseve të vogla, qarkullimi i të cilit gjatë 12 muajve të njëpasnjëshëm (ose më përpara) tejkalon kufirin minimal të regjistrimit për TVSH-në, është i detyruar të kërkojë të regjistrohet brenda 15 ditëve nga data e kalimit të kufirit. Gjithashtu personi i regjistruar për TVSH-në, ka të drejtë të kërkojë t'i nënshtrohet regjimit të bizneseve të vogla sipas specifikimeve të regjistrimit të tij për TVSH-në.

Faturimi

Faturat mund të jenë në dispozicion në letër ose në formë elektronike në rastet kur personi i tatueshëm i regjistruar mund të tregojë, me kërkesë të organeve tatimore, që sistemi i tij i

regjistrimeve është i kompjuterizuar dhe i aftë të prodhojë fatura tatimore me numër serial për çdo transaksion të tatueshëm dhe që ka një numër të konsiderueshëm klientësh konsumatorë, sipas procedurës së përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave, në bazë të nenit 104 të Ligjit Nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në RSH” i ndryshuar.

Neni 107 i ligjit të mësipërm përcakton se deklarata e TVSH-së në Shqipëri duhet të dorëzohet jo më vonë se 14 ditë pas përfundimit të periudhës tatimore që deklarohet, ku periudha tatimore është muaji kalendarik. Në bazë të pikës 1 të nenit 116, periudha, gjatë të cilës personi i tatueshëm duhet të sigurojë ruajtjen e faturave, që lidhen me furnizimet e mallrave apo të shërbimeve, të kryera në territorin e Shqipërisë, si edhe të atyre të marra nga ana e personave të tatueshëm apo jo të tatueshëm, të vendosur në Republikën e Shqipërisë është 5 vite të plota kalendarike, duke filluar nga viti që pason vitin kur lëshohet fatura.

Faturat luajnë një rol të madh, pasi ato janë të nevojshme si dëshmi e TVSH-së të paguar për mallrat ose shpenzimet në mënyrë që tatimpaguesit e regjistruar mund të kërkojnë një rimbursim (Agha & Haughton, 1996; Keen & Smith, 2006; Le, 2003)¹⁸.

Ndërsa (Yan, 2011:30), shprehet se metoda e kreditit të faturës duhet të jetë e detyrueshme pasi në shumë raste ndihmon autoritetet tatimore për të kontrolluar TVSH-në e paguar nga furnizuesi dhe tatimi i zbritur nga blerësi.

Nëpërmjet figurës që do të ilustruhet më poshtë, është e lehtë të kuptohet se pse personat e tatueshëm nxiten të kërkojnë medeomos faturën për mallrat ose shërbimet e blera. Pëveç penaliteteve ligjore mosmarrja e faturave krijon vështirësi dhe probleme në sektorin e

¹⁸ Marrë nga: Da Silva C.S.F., (2016), The determinants of value added tax revenues in Portugal. Tezë Masteri: Lisboa School of Economics & Management, 4.

financës duke orientuar firmën drejt mbajtjes së dy bilanceve, një për përdorim të brendshëm që është real e një për deklarim tatimor që është jo i saktë. Por, një administratë tatimore efikase, duke përdorur faturat dhe kryer krahasimet e blerjeve të kryera në njërën anë dhe shitjeve të deklaruar në anën tjetër, mund të shmangë evazionin fiskal të kryer nga subjektet.

Në qoftë se një mall i caktuar nuk ka hyrje në magazinë me faturë të rregullt tatimore, nuk mund të kryesh shitje për këtë mall. Efikasiteti i administratës tatimore në këtë drejtim luan një rol të rëndësishëm për zvogëlimin e evazionit fiskal.

Në Shqipëri evazoni fiskal është diskutuar së tepërmi kohët e fundit. Në vitin 2015 Administrata dhe hetimi tatimor kanë kryer kontrolle pothuajse në të gjitha bizneset duke nxitur paisjen e bizneseve me paisje fiskale, deklarimin e shitjeve reale duke kontrolluar lëshimin e kuponave dhe faturave tatimore. Në periudhën e kontrolleve tatimore pati një rritje të shitjeve të deklaruar dhe për pasojë edhe të ardhurave tatimore. Shume biznese kanë pasur penalitete dhe janë shoqëruar me gjoba për rastet e parregullsive të konstatuara nga administrata tatimore. Nga figura e mëposhtme shohim se deklarata e tatimit mbi vlerën e shtuar përfitohet nga të dhënat e deklaruar nga libri i shitjeve sipas totalit të kutizave në fund të shitjeve të përjashtuara, shitjeve pa TVSH, eksporteve të mallrave, furnizimeve me shkallë 0%, shitjeve të tatueshme (me shkallë 20%), shitjeve të tatueshme me shkallë 6%, shitjeve të tatueshme sipas regjimeve të agjentit të udhëtimit/ të marzhit të fitimit/të shitjeve në ankand (20%), autongarkesës së TVSH-së në shitje (reverse charge)(19 x 20%) dhe borxhit të keq; dhe nga të dhënat e librit të blerjeve sipas totalit të kutizave të blerjeve të përjashtuara, TVSH jo e zbritshme/pa TVSH, blerjeve të investimit brenda vendit pa TVSH, importeve të përjashtuara të investimeve pa TVSH, importeve të


mallrave të përjashtuara nga TVSH-ja, importeve të mallrave me shkallë tatimore 20%, importeve të investimit me TVSH 20%, blerjeve nga furnitorë vendas me shkallë 20%, blerjeve të investimeve vendase me TVSH 20%, blerjeve nga fermerët vendas (20%), autongarkesës së TVSH-së në blerje me të drejtë kreditimi (reverse charge), rregullimeve të TVSH-së së zbritshme dhe borxhit të keq.

Nga libri i shitjeve kemi atë që quhet totali i Tvsh-së së llogaritur dhe nga libri i blerjeve kalkulohet totali i Tvsh-së së zbritshme.

- Në qoftë se totali i TVSH-së së llogaritur është më i vogël se totali i TVSH-së së zbritshme, kemi tepricë të TVSH-së së zbritshme për muajin.
- Në qoftë se totali i TVSH-së së llogaritur është më i madh se totali i TVSH-së së zbritshme, atëherë për periudhën kemi TVSH të detyrueshme për t'u paguar.

Deklarata e TVSH-së tregohet sipas skemës së mëposhtme:

Figura 5- Deklarata e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar në Shqipëri



Burimi: Ilustrim nga autori

3.3.5 Historiku i Tvsh-së në Kosovë

Me Rregulloren Nr. 2000/20 UNMIK me datën 12 prill 2000, u shpall rregullorja “Mbi Administratën dhe Procedurat Tatimore” me qëllim institucionalizimin e administratës dhe proceduarve tatimore. Me datën 31 maj 2001, me Rregullore Nr. 2001/11 të UNMIK (United Nations Interim Administration Mission in Kosovo), u vendos Tatimi mbi vlerën e shtuar dhe u shfuqizuan Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2000/3 e datës 22 Janar 2000 “Mbi Tatimin në Shitje në Kosovë” dhe Rregulloren e UNMIK-ut Nr.2000/5 të datës 1 Shkurt 2000, “Mbi Vendosjen e Tatimit në Hotele, Ushqim dhe Pije në Kosovë”. Në bazë të nenit nr. 2 të kësaj rregulloreje: Nga 1 Korriku i vitit 2001 Tatimi mbi Vlerën e Shtuar ose TVSH, do të vilet në pajtueshmëri me dispozitat e përcaktuara në rregullore, mbi vlerën e tatueshme të importeve, Hyrjeve nga RFJ dhe furnizimeve të tatueshme. Në bazë të nenit 1.14 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/11, e datës 31 maj 2001, ‘Për Tatimin Mbi Vlerën E Shtuar’: “Hyrje nga RFJ” nënkupton furnizimin e hyrë në Kosovë nga një pjesë tjetër e Republikës Federale të Jugosllavisë.

Në bazë të nenit 2.2 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/11, e datës 31 maj 2001, ‘Për Tatimin Mbi Vlerën E Shtuar’: Tatimi mbi vlerën e shtuar do të vilet në masen prej 15% mbi vlerën e tatueshme të importeve, Hyrjeve nga RFJ dhe furnizimeve të tatueshme përveç për furnizimet e tatueshme me zero-përqind. Ndërsa në nenin 2.3 pohohet se Tatimi mbi vlerën e shtuar do të vilet në masën prej 0% mbi vlerën e tatueshme të furnizimeve të tatueshme me zero-përqind të pershkruara në nenin 10 e rregullores në fjalë. Sipas kësaj rregulloreje kufiri i rregjistrimit ka qenë 200,000 DM (marka gjermane) për vit kalendarik.

Neni 3.1 përcakton kohën në të cilën një person i tatueshëm duhet të kërkojë që të regjistrohet në Administratën Tatimore për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila është brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj rregullore.

Në nënet 8.1, 8.2 dhe 8.3 jepen sqarimet e mëposhtme:

- Vlera e tatueshme e furnizimit të tatueshëm në Kosovë do të jetë konsiderata e përgjithshme e pagueshme për atë furnizim.
- Vlera e tatueshme e një importi do të jetë vlera doganore e importit plus detyrimet doganore, akcizat apo tatimet dhe detyrimet e tjera të aplikueshme, pa përfshirë tatimin mbi vlerën e shtuar.
- Ndërsa vlera e tatueshme e një Hyrjeje nga RFJ do të jetë konsiderata e përgjithshme e pagueshme për atë furnizim.

Në bazë të nenit 23.2 një person i tatueshëm mund të kërkojë rimbursim nëse shuma e tatimit të paguar tejkalon 10,000 DM (marka gjermane). Në bazë të nenit 23.3: Për eksportet dhe Daljet drejt RFJ-se, një rimbursimin mund të kërkojë edhe nëse nuk është mbartur shuma e paguar teper e tatimit për se paku gjashtë muaj të njëpasnjëshëm, me kusht që aplikimet për rimbursim behen jo më shumë se një herë në tremuaj, ose kur tatimi i paguar teper tejkalon shumën prej 10,000 DM (marka gjermane) ato mund të behen edhe cdo muaj kalendarik.

Me rregulloren Nr. 2001/41 të UNMIK, të datës 31 dhjetor 2001 me qëllimin për të lehtësuar përcaktimet e rregullores me Nr. 2001/11 dhe përfundimin e konvertimit të markës gjermane (DM) në euro, janë shpallur ndryshimet e mëposhtme:

Në nenin 3.4, “200.000 DM” do të zëvendësohet me “100.000 euro”; (b) Në nenin 23.2(b), “10.000 DEM” do të zëvendësohet me “5000 euro”; dhe (c) Në nenet 23.3(c), “10.000

DEM” do të zëvendësohet me “7.500 euro”. Kjo rregullore ka hyrë në fuqi në datën 1 janar 2002.

Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar ndryshimin e normës së TVSH-së duke e ngritur nga 15% në 16% që nga 1 janari i vitit 2009, duke shënuar një rritje me 6.67% ose rritje me një pikë përqindje e shprehur ndryshe, (Ministria e Ekonomisë dhe Financave RK, 2008).

Ashtu sikurse në Shqipëri edhe në Kosovë, Tatimi mbi vlerën e shtuar është burimi kryesor i të hyrave tatimore. Në mars të vitit 2015, Qeveria e Kosovës e gjendur përballë një rritje të pritshme të deficitit buxhetor, si pasojë e rritjes së pagave në sektorin publik dhe shpenzimeve për autostradën Prishtinë- Shkup, detyrohet që të bëjë një varg ndryshimesh në tatime dhe akciza, (Instituti GAP, 2016). Sikurse ka ndodhur edhe në shumë shtete të tjera ndryshimi apo aprovimi i një ligji të ri për TVSH-në është konsideruar një manovër e sukseshme për një efekt potencial. Ndryshimin e ligjit të TVSH-së si një mjet për rritjen e të hyrave buxhetore e ka kryer edhe Shqipëria në vitin 1997, konkretisht nga 12.5% në 20%, normë e cila zbatohet edhe sot. Qeveria e Kosovës ka ngritur shkallën e TVSH-së nga 16% në 18% në shumicën e produkteve, ndërsa uli TVSH-në nga 16% në 8% kryesisht në produkte ushqimore, (Instituti GAP, 2016).

Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimin nr. 02/20, Vendimin 03/20 dhe 04/20 të datës 24 Mars 2015, miratoi një sërë ndryshimesh që kanë të bëjnë me politikat fiskale. Vendimi 02/20 është aprovuar Projektligji për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar. Me vendimin 03/20 është aprovuar Projektligji për Tatimin në të ardhurat e Korporatave. Me vendimin 04/20 është aprovuar Projektligji për Tatimin në të Ardhurat Personale.

Ligji i ri për tatimin mbi vlerën e shtuar ka hyrë në fuqi më 1 shtator 2015. Disa nga ndryshimet kryesore të këtij ligji mbi vlerën e shtuar, të botuar në Gazetën Zyrtare të Kosovës janë¹⁹:

- Shkalla standarde e TVSH-së është rritur nga 16% në 18%. Norma e Tvsh-së është rritur me 12.5%, ndërsa në Shqipëri është rritur me 60%.
- Qeveria e Kosovës ka aplikuar shkallë të reduktuar të TVSH-së prej 8% në disa produkte dhe shërbime. Disa nga këto produkte dhe shërbime përfshijnë: shërbimet publike (rrymë, ujë të pijshëm, mbledhje të mbeturinave, ngrohtore), drithërat, mielli, vajrat, qumështi, kripa për konsum njerëzor, librat shkollorë, pajisjet e teknologjisë së informacionit, barnat, pajisjet mjekësore, etj. Para hyrjes së ligjit në fuqi, TVSH në barna ishte 0%. Në qoftë se bëjmë krahasimin me Shqipërinë ka ndodhur e kundërta pothuajse në të njëjtën periudhë kohore. Në Shqipëri, në vitin 2014, barnat nga norma 10% e TVSH-së, u kthyen me normën 0% të TVSH-së.
- Pragu i regjistrimit dhe metoda e kalkulimit për regjistrim të bizneseve për TVSH ka ndryshuar. Para hyrjes në fuqi, bizneset të cilat kanë realizuar qarkullim më shumë se 50,000 euro brenda vitit kalendarik kanë qenë të detyruara të regjistrohen për certifikatë të TVSH-së. Me ligjin e ri, duhet të regjistrohen për TVSH të gjitha ato biznese të cilat brenda vitit kalendarik tejkalojnë 30,000 euro qarkullim duke ulur kështu pragun e regjistrimit me 40%.

¹⁹ Marrë nga: Instituti GAP, (2016). Efektet e ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar. http://www.institutigap.org/documents/13679_Ligji%20p%C3%ABr%20TVSH-%20final1.pdf, fq. 3-4.

- Me aprovim nga ATK, lirohen nga TVSH linjat e prodhimit dhe makineritë për përdorim në procesin e prodhimit, lënda e parë që shfrytëzohet për procesin e prodhimit, pajisjet e teknologjisë së informacionit. Gazetat, botimet periodike, pajisjet dhe materialet e importuara për nevojat e medieve të shkruara dhe elektronike lirohen automatikisht nga TVSH.
- Gazetat, botimet periodike, pajisjet dhe materialet e importuara për nevojat e medieve të shkruara dhe elektronike lirohen automatikisht nga TVSH.

3.3.6 Një vështrim mbi aplikimin e TVSH-së në Kosovë

Administrata Tatimore e Kosovës jep përcaktimet e mëposhtme për TVSH-në:

TVSH-ja është tatim mbi konsumin (qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve). Ai mbledhet nga personat që janë të regjistruar për këtë lloj tatimi nëpërmjet kryerjes së furnizimeve të ndryshme që i bëjnë konsumatorit më të parë duke përfshirë furnizimin e mallrave dhe shërbimeve. Çdo person i tillë në qarkullimin që kalon malli apo shërbimi nga burimi i furnizimit dhe deri te konsumatori i fundit vendoset një vlerë e shtuar e cila mbledhet nga shitësi për llogari të shtetit. Konsumatori i fundit është ai që kryen qarkullimin final me shumat e vlerave të shtuara furnizimit që ai ka blerë në çdo hap që ka kaluar furnizimi.

TVSH-ja është formë e tatimit me të cilën tatohet vlera të cilën shitësi e ka shtuar në çmimin e shitblerjes të prodhimit dhe të shërbimeve në secilën fazë të ciklit të qarkullimit.

Baza e TVSH-së është diferenca ndërmjet çmimit furnizues dhe çmimit të shitjes.

Pra, Tatimi mbi Vlerën e Shtuar - (TVSH) është tatim mbi konsumin, të cilin në mënyrë indirekte e paguan konsumatori përmes bizneseve, të cilat në fakt kanë rolin e agentëve ndërmjetësues.

TVSH-ja është një tatim që vetëdeklarohet nga subjektet. Pastaj është detyrë e organeve tatimore për të ndjekur nëpërmjet kontrolleve nëse deklarimi ka qenë i saktë.

Sipas Administratës Tatimore të Kosovës, për qëllime të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), person i tatueshëm është secili person i cili është, ose kërkohet që të regjistrohet për TVSH, dhe i cili në mënyrë të pavarur zhvillon një aktivitet ekonomik në mënyrë të rregullt apo jo të rregullt, pavarësisht nga qëllimi ose rezultati i atij aktiviteti ekonomik.

Çdo person që i përmbush të gjitha kushtet e përkufizimit mbi personin e tatueshëm, kërkohet që të regjistrohet për TVSH, nëse brenda vitit kalendarik tejkalon qarkullimin prej tridhjetëmijë euro (30.000€).

Aktualisht në Kosovë TVSH-ja aplikohet me dy norma: normën standarte në vlerën 18% dhe normën e reduktuar në vlerën 8% të vlerës së furnizimeve të importuara dhe furnizimeve të brendshme të tatueshme, me përjashtim të furnizimeve të përjashtuara dhe furnizimeve të trajtuara si eksporte. Ndërsa Shqipëria aplikon normën standarte 20% dhe normën e reduktuar 6% të vlerës së furnizimeve të importuara dhe furnizimeve të brendshme të tatueshme, me përjashtim të furnizimeve të përjashtuara dhe furnizimeve të trajtuara si eksporte.

3.4 Ambienti fiskal në Ballkan

Në nënçështjet e mëposhtme do të përshkruhen barra tatimore, normat tatimore në Shqipëri, Kosovë dhe Ballkan për vitin 2017, si edhe një krahasim i kostove tatimore në Ballkan.

3.4.1 Barra tatimore në Ballkan

Barra tatimore është shuma totale e tatimeve të paguara, si dhe detyrimeve doganore dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore, sipas bazës të të ardhurës të tatimit përkatës (tatimet mbi kapitalin, mbi punën dhe tatimet mbi konsumin) nga një grup i caktuar tatimpaguesish,

industrie, rajoni, shteti etj., të krahasueshme me çfarë paguajnë grupet, industritë, rajonet, shtetet, etj., (ALTAX, 2018:6). Ndryshimet e vogla në strukturën tatimore mund të kenë një ndikim thelbësor në barrën tatimore për familjet me të ardhura të ulëta (Go, Kearney, Robinson & Thierfelder, 2005:19).

Figura 6- Barra tatimore në Ballkan 2014-2017 (% e PBB-së)



Burimi: ALTAX 2018

Për vitin 2017 vendet të cilat kanë një vlerë të barrës tatimore në përqindje të PBB-së mbi 35% janë Greqia, Mali i Zi, Kroacia, Bosnjë-Hercegovina dhe Serbia. Këto 5 shtete kanë pasur për të gjithë periudhën 2014-2017 një vlerë të barrës tatimore mbi 35%, përveç Kroacisë dhe Serbisë të cilat në vitin 2015 kanë pasur një vlerë pak më të ulët se 35%, konkretisht 34.8% dhe 34.6%.

Për vitin 2017 Rumania, Bullgaria, Maqedonia, Shqipëria dhe Kosova kanë pasur një vlerë të barrës tatimore në përqindje të PBB-së ndërmjet vlerave 25%-28%. Për periudhën 2014-2017 për këto shtete barra tatimore është luhatur ndërmjet normave 23.9% dhe 28%. Për

Shqipërinë barra tatimore ka ardhur në rritje nga 23.9% në vitin 2014 në 25.9% në vitin 2017. Edhe për Kosovën barra tatimore ka qenë në rritje nga viti 2014 në vitin 2016. Në vitin 2017 ka pasur një ulje të barrës tatimore në Kosovë me 0.38%.

Një nivel i lartë i barrës tatimore është i pranishëm në vendet me nivel të lartë teknologjie, produktivitet të lartë të punës dhe një kulturë të zhvilluar për pagimin vullnetar të taksave, (ALTAX, 2018:34). Më tej në këtë artikull shpjegohet se në vendet e Ballkanit me nivel të ulët të zhvillimit ekonomik, ku të ardhurat për frymë janë ndër nivelet e ulta ose mesatare të nivelit europian të të ardhurave për frymë, ngadalësimi i rritjes së barrës tatimore ka efekt negativ në rritjen e PBB-së. Ulja e barrës tatimore do të rezultonte në uljen e PBB-së, pasi nxitja që japin taksat për ekonominë e vendeve ballkanike konsiderohet se kanë ende një efekt formatues në veprimet e administratës tatimore.

Sipas publikimit të (ALTAX, 2018) barrën tatimore sipas PBB-së Rajonale, më të lartë, në Shqipëri për vitin 2017 e ka qarku i Tiranës në vlerën 27.8%, i cili ka pësuar një rënie me 1.6% krahasuar me vitin 2016. Barrën tatimore më të ulët e ka qarku i Kukësit në vlerën 20.9%, i cili ka pësuar një rritje me 6.8% krahasuar me vitin 2016. Barrën tatimore sipas PBB-së Rajonale, më të lartë, në Kosovë për vitin 2017 e ka regjioni i Prishtinës në vlerën 28.3%, ndërsa barrën tatimore më të ulët e ka regjioni i Mitrovicës.

3.4.2 Normat tatimore në Shqipëri, Kosovë dhe Ballkan për vitin 2017

Baza kryesore e të ardhurave buxhetore në vendet e Ballkanit mbizotërohet nga tatimet mbi konsumin, ku përfshihen TVSH-ja, akciza dhe taksat doganore, (ALTAX, 2018:15).

Figura 7- Normat tatimore në Ballkan për vitin 2017

Nr.	SHTETI	TVSH	TATIM FITIMI	TATIM MBI TË ARDHURAT NGA PAGA	TATIM NË BURIM			SIGURIME SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE		
					DIVIDENT	INTERESA	PASURI	GJITHSEJ	PUNËDHËNËSI	PUNËMARRËSI
1	MAQEDONI	5; 18	10	10	10	10	10	27	0	27
2	KOSOVË	8; 18	10	10	0	10	10	10	5	5
3	KROACI	5; 13; 25	18	12; 40	12	15	15	37.2	17.2	20
4	MALI I ZI ¹	7; 21	9	9; 15	9	9	9	34.3	10.3	24
5	BOSNJË-HERCEGOVINË*	17	10	10	5	10	10	41.5	11	31
	BOSNJË-HERCEGOVINË**	17	10	10	10	10	10	23	0	23
6	BULLGARI ²	9; 20	10	10	0; 5	10	10	32.8	19.02	13.78
7	SHQIPËRI	6; 20	5; 15	13; 23	15	15	15	27.9	16.7	11.2
8	SERBI	10; 20	15	10; 25	20; 25	20; 25	20; 25	37.8	17.9	19.9
9	RUMANI ³	5; 9; 19	16	16	5	16	16	37.25	2.25	35
10	GREQI ⁴	6; 13; 24	29	45	15	15	20	41.06	25.06	16

Burimi: *PwC, KPMG, MeF*²⁰

Shënim: Ndryshimet e shkallëve tatimore, 2018

¹ Rritja e normës standarte të TVSH nga 19% në 21%. Ulje kontributit për punëmarrësin me 0.5%.

² Rritur kontributi social me 0.57% për punëdhënësin dhe 0.88% për punëmarrësin.

³ Ulur kontributi social me 20.5% për punëdhënësin dhe rritur me 18.5% për punëmarrësin.

⁴ Rritur kontributi social me 0.5% për punëdhënësin dhe 0.5% për punëmarrësin

* Federata e Bosnjë-Hercegovinës; ** Republika Srpska.

Sipas (ALTAX, 2018:19) për vitin 2017 rajoni i Ballkanit është karakterizuar në politika fiskale që janë fokusuar në stabilitet të normës së tatim fitimit, ulje të lehta të normës së kontributeve sociale, si dhe rritje të saj për TVSH-në në rastin e Malit të Zi (nga 19% në

²⁰ Marrë nga: ALTAX, (2018). Barra Tatimore Në Shqipëri, Kosovë dhe Ballkan, 2018, fq. 20.

21%). Politika fiskale e ndjekur ka synuar në stabilizimin dhe forcimin fiskal, si dhe në disa ndryshime të vogla që kanë patur për qëllim harmonizimin e politikave sociale, si dhe lehtësira për grupe të caktuara të aktiviteteve të ekonomisë kombëtare.

Siç ka ndodhur edhe në shumë vende, norma e TVSH-së dhe ndryshimet rreth saj janë kryer kryesisht me qëllimin e rritjes të ardhurave qeveritare.

Sipas (ALTAX 2018:19), norma standarte mesatare e TVSH-së në vitin 2017 për Ballkanin vijon të jetë 20%, njësoj sa ishte dhe për vitin 2016. Kosova, Bosnjë-Hercegovia, Maqedonia, Rumania zbatojnë norma tatimore standarte të TVSH-së nën mesataren e rajonit. Kroacia, Rumania dhe Greqia aplikojnë tre norma të Tvsh-së.

Përsa i përket ndryshimeve të normave të TVSH-së, në mënyrë të përmblodhur sipas (ALTAX, 2018:20) pohohet se: Kosova ka filluar të zbatojë një normë të reduktuar të TVSH-së, në fund të vitit 2015, si dhe ka rritur normën standarte me 2%, për qëllime të ruajtjes së stabilitetit fiskal të buxhetit. Mali i Zi dhe Serbia miratuan në 2016 normë të reduktuar të TVSH-së, respektivisht me 7% dhe 10%, Ndërkohë, Mali i Zi prej Janarit 2018 ka rritur normën standarte me 2% më shumë nga sa e kishte më përpara. Greqia miratoi në vitin 2016 rritje të normës standarte të TVSH me 1%, duke u renditur si vendi i dytë me normën standarte të TVSH më të lartë në Ballkan, pas Kroacisë e cila ka normën e TVSH-së në nivelin 25%. Shqipëria, Bullgaria dhe Serbia zbatojnë prej disa vitesh një normë standarte mesatare të TVSH-së në nivelin 20%.

Përsa i përket tatimit mbi fitimin, (ALTAX, 2018:20) pohon se bie në sy se Greqia, Kroacia, Shqipëria, Serbia, Rumania zbatojnë norma tatimore mbi mesataren e rajonit. Mali i Zi, Kosova, Maqedonia, Bosnjë-Hercegovina zbatojnë norma tatimore nën mesataren e rajonit. Normën më të lartë të tatimit mbi fitimin e mban Greqia me nivelin 29% mbi

fitimin tregtar. Normën më të ulët vijon ta mbajë Mali i Zi me nivelin e 9% të fitimit tregtar. Shqipëria ruan një normë tatimore që është sa mesatarja e rajonit. Ndërsa, Kosova mban një normë tatimore të ulët prej 10% të fitimit tregtar, që zbatohet në disa vende (Maqedoni, Bosnjë, Bullgari).

Në vitin 2017, në Shqipëri u fut një normë e reduktuar e tatimit mbi fitimin me 5% për personat juridikë, të cilët ushtrojnë aktivitetet për prodhimin apo zhvillimin e softëare-ve dhe siç shihet nga të dhënat e tabelës është e vetmja që aplikon një normë të reduktuar të tatimit mbi fitimin.

Tatimin progresiv për pagat (të ardhurat individuale) e zbatojnë Kroacia (dy shkallë tatimore), Mali i Zi (dy nivele tatimore), Shqipëria (dy nivele tatimore), Serbia (dy nivele tatimore). Maqedonia, Kosova, Bosnjë-Hercegovina dhe Bullgaria aplikojnë një shkallë tatimi mbi pagat në nivelin 10%, Rumania me 16% dhe Greqia paraqet nivelin më të lartë të këtij tatimi në vlerën 45%.

Përsa i përket tatimit në burim, Kosova ka tatimin mbi dividendin në masën 0%. Pas Kosovës rënditen Federata e Bosnjë Hecegovinës, Bullgaria dhe Rumania me 5% dhe normën më të lartë e ka Serbia e cila përdor taksë progressive 20% dhe 25%. Tatimin më të ulët mbi interesat dhe pasurinë e ka Mali i Zi në vlerën 9% dhe normën më të lartë e ka Serbia e cila përdor taksë progressive 20% dhe 25%. Kosova rënditet nën mesataren e normave tatimore për tatimin në burim në Ballkan me një taksë të sheshtë 10%, kurse dividendi nuk taksohet. Ndërsa Shqipëria rënditet mbi mesataren e normave tatimore për tatimin në burim në Ballkan me një taksë të sheshtë 15% për tatimet në burim.

Sipas (ALTAX, 2018:21) norma mesatare e kontributeve sociale për punëdhënsin dhe punëmarrësin në Ballkan për vitin 2018 është 31.8%. Kosova dhe Shqipëria rënditen poshtë

kësaj mesatareje, përkatësisht 10% dhe 27.9%, ndërsa normën më të lartë në Ballkan e ka Federata e Bosnjë Hercegovinës me 41.5% dhe poshtë saj me një diferencë të ulët renditet Greqia me vlerën 41.06%.

3.4.3 Kostot tatimore në Ballkan

ALTAX ka kryer një studim për kostot tatimore në Ballkan. Për kostot më të lira tatimore për vitin 2018 e para renditet *Maqedonia*. Taksa e shështë 10% ka funksionuar më së miri në këtë shtet.

Shqipëria renditet e dyta në Ballkan për kostot më të lira tatimore. Duke pasur një larmishmëri të politikës fiskale me noma të ulëta për të ardhurat individuale dhe të kapitalit, dhe jo vetëm por edhe me stimuj të fortë për ato që duan të investojnë në turizmin e luksit. Në vitin 2017 Shqipëria aplikoi një normë të reduktuar të tatimit të fitimit në vlerën 5% për industrinë e prodhimit të software-ve. Norma e tatimit mbi dividendin aktualisht është 15%, normë e cila është mbi mesataren e rajonit, por që gjenden edhe shumë shtetë të tjera të cilat aplikojnë një normë të lartë se 15% dhe si rrjedhojë do të ishte e favorshme norma e tatimit të dividendit në Shqipëri.

Rumania renditet e treta në rajon përsa i përket kostove më të lira tatimore. Ky është një shtet anëtar në BE dhe paraqet vlerën më të ulët të barrës tatimore.

Kosova renditet e katërta në rajon për kostot më të lira tatimore. Siç është përmendur edhe në çështjen më lart tatimi mbi dividendin në Kosovë është në vlerën 0% dhe ky përbën një avantazh për ata që duan të investojnë në Kosovë duke qenë se fitimi që do të shpërndahej nuk do të ketë ndalesa në burim për dividendin. Norma e kontributeve shoqërore dhe shëndetësore gjithsej nga punëdhënsi dhe punëmarrësi është vetëm 10%, e cila është norma më e ulët në Ballkan.

Në vendin e pestë dhe me rradhë rënditja e shteteve është e tillë: Bullgaria, Serbia, Bosnjë-Hercegovina, Mali i Zi dhe në vendin e fundit si shteti me koston më të lartë tatimore rënditet Greqia.

KAPITULLI IV: ANALIZA E TVSH-SË NË DIMENSIONE TË NDRYSHME

4.1 Transformimi i TVSH-së tek barnat dhe ndikimi tek raportet financiare

Tregu farmaceutik në Shqipëri është kthyer në objekt ndryshimesh tatimore vitet e fundit. Ndryshimet tatimore në sektorë të caktuar ekonomikë ndikojnë raportet financiare të firmave dhe ndoshta edhe në mbarëvajtjen financiare. Në studimet financiare gjenden punime të autorëve të cilët janë përpjekur për të analizuar ndikimet e transformimit të TVSH-së. Hulumtimet e kryera nga (Bubić, Mladineo & Šušak, 2016:163), i kanë çuar në përfundimin se ekziston një marrëdhënie e konsiderueshme midis ndryshimit të normës së TVSH-së dhe raporteve të likuiditetit të kompanive në Kroaci, ku një ndikim të rëndësishëm ka raporti i keshit. Në çështjet e mëposhtme do të trajtoj ndikimin e transformimit të TVSH-së tek raporti i fitimit marxhinal dhe tek raporti i keshit (pjesë e raporteve të likuiditetit), tek disa farmaci në Shqipëri.

4.1.1 Pamje e tregut farmaceutik në Shqipëri

Shqipëria numëron 1679 farmaci në të gjithë territorin e saj, ku thuajse gjysma janë në Tiranë, ose më saktë 43.4% të totalit (Scan, 2018).

Të dhënat e (Scan, 2018) tregojnë gjithashtu për një shpërndarje mjaft të pabarabartë të farmacive dhe farmacistëve në territorin e Republikës. Ndërkohë që në Tiranë ka një farmaci për 995 banorë, në Malësinë e Madhe ka një farmaci për çdo 12 333 banorë. Pra, Tirana ka 136 farmaci për çdo 100 mijë banorë, më shumë se çdo vend tjetër i Europës, shifër e cila tregon se në kryeqytet ky treg është i tejngopur.

Diana Toma në një intervistë për Monitor, ka rënditur problematikat e mëposhtme, me të cilat po përballen bizneset e farmaceutikës:

- Numri i madh i farmacive është problem dhe kjo në shumë raste bën që farmacistët t'i shohin pacientët si mjet fitimi.
- Numri i lartë i farmacistëve që dalin nga universitetet.
- Përfshirja brenda pronësisë në tregun e farmaceutikës të elementit jo farmaceutik.
- Komercializimi i recetave ka ulur marzhin e fitimit.
- Nuk ka rregullore për shërbimin e tregut farmaceutik.
- Ka vakume ligjore, si në ligjin e shërbimit farmaceutik ose ligje të tjera që shtrijnë efektin në farmaceutikë.
- Farmacistët kanë probleme me përfaqësimin.
- Së fundmi, shtrirja e importuesve të mëdhenj edhe në tregun e pakicës, po krijon monopole vertikale dhe kjo minon konkurrencën e drejtë në treg, (Toma, 2018).

(Hiadlovský, Rybovičová & Vinczeová, 2016:800) shprehen se në çdo ekonomi, sektori i biznesit është një forcë shtytëse e zhvillimit dhe rritjes. Farmacitë janë një biznes i cili aktualisht ka prespektivë për zhvillim, por një ndërhyrje e institucioneve përkatëse për një shpërndarje optimale do të ndihmonte në optimizimin e këtij tregu.

4.1.2 Ndryshimet ligjore për nivelin e TVSH-së së aplikuar për barnat

Me Ligjin nr. 10363, datë 16.12.2010 janë miratuar ndryshimet e më poshtme në Ligjin nr. 9728, datë 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”²¹:

²¹ Marrë nga: PBM, (2011). Tax Alert Shkurt 2011.
http://www.pbm.al/web/pub/tax_alert_shqip_feb_2011_38_1.pdf

- Furnizimi i ambalazheve dhe i materialeve, që përdoren për ambalazhim të barnave është furnizim i përjashtuar për efekt TVSH-je;
- Furnizimi i barnave dhe shërbimeve shëndetësore nga institucionet shëndetësore publike dhe private, është furnizim i tatueshëm. Niveli i TVSH-së së zbatuar për këto shërbime është 10%. Ky ligj ka hyrë në fuqi nga data 01.02.2011.

Aplikimi i normës së TVSH-së nga zero në 10% për barnat, ishte një nismë e qeverisë për diferencimin e TVSH-së për furnizimin e barnave dhe shërbimeve shëndetësore. Gjithashtu TVSH-ja e shërbimeve shëndetësore u ul nga 20% në 10%. Sipas relacionit që shoqëron këtë ligj, qëllimi ishte reduktimi i barrës fiskale të pacientëve në shërbimin shëndetësor.

Sipas udhëzimeve në fuqi të vitit 2010, ku u parashtrua ideja e projektligjit, grosistët në Shqipëri fitonin 12% për barnat e rimbursueshme nga ISKSH dhe 18% për të tjerat, farmacitë 29% për barnat e rimbursueshme dhe 33% për barnat e parimbursueshme, (Financieri, 2010). Sipas këtij udhezimi grosistët bëjnë shitjen e barnave në depot sekondare, të cilat i shpërndajnë në farmaci. Hyrja e medikamenteve bëhet vetëm me autorizim prodhuesi, që jepet nga Ministria e Shëndetësisë.

Por, sipas pikës 8.8.2 të Udhëzimit Nr.17 Datë 13.05.2008 Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar i Ndryshuar, për furnizimin e barnave dhe shërbimeve shëndetësore:

Që prej datës 1 prill 2014, furnizimi i barnave, shërbimeve shëndetësore nga institucionet shëndetësore, publike dhe private, është furnizim i përjashtuar nga TVSH-ja. Në kuptim të kësaj pike, me barna kuptohen barnat për konsum njerëzor dhe barnat që përdoren për kafshët. Ministria e Financave ka dhënë sqarimet se si do të tregtoheshin barnat duke filluar nga data e përcaktuar.

Sipas pikës 8.8.2.1 të udhëzimit të mësipërm, të gjitha barnat e importuara dhe prodhuara në vend, të pajisura me pullën e kontrollit me çmimin me TVSH 10%, me qëllim për t'u tregtuar (shitur) që rezultonin gjendje në subjekte farmaceutike deri më datë 31 mars 2014, do të aplikohet TVSH zero përqind në shitje, pavarësisht nga masa e TVSH që është e shënuar në pullë. (Ndryshuar me Udhëzimin nr. 6/2, datë 3.4.2014. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 44, datë 7 prill 2014).

Pjesa e barnave që tatohet me normën 10% të TVSH-së duhet të inventarizohet gjendja e stokut real dhe të dorëzohet me format elektronik deri më 20 prill (Shekulli, 2014). Në vazhdim të publikimit të mësipërm të (Shekulli, 2014) sqarohet se pjesa e TVSH-së së mbartur nga barnat që kanë qenë stok, do të shlyhet nga procesi i kreditimit dhe i debitimit të TVSH-së, sipas Ministrisë së Financave. Përveç këtij ndryshimi, pjesë e skemës ishin edhe 55 barna të reja për kurimin e tumoreve dhe kancerit, të cilat janë përfshirë për herë të parë në rimbursim. Gjithashtu janë përfshirë barna për sëmundjet e diabetit, kardiovaskulare. Për herë të parë janë përfshirë barna që përdoren për të kuruar varësinë nga alkooli. Barnat e zgjedhura janë bazuar në kërkesat e qendrave spitalore në të gjithë vendin.

4.1.3 Kriteret e përzgjedhjes së farmacive dhe modeli për studim

Ndikimi i sistemit tatimor në aktivitetet e biznesit të një kompanie është një komponent i rëndësishëm i politikës fiskale, (Bubić, Mladineo & Šušak, 2016:153).

Duke vëzhguar këto dinamika ndryshimesh, mendoj se do të ishte e përshtatshme një analizë që do të studjonte ndikimin e këtyre ndryshimeve ligjore tek raporti i fitimit marxhinal dhe raporti i keshit tek farmacitë në Shqipëri.

Raporti i fitimit marxhinal është raporti i të ardhurave neto kundrejt shitjeve. Ky raport tregon sa lekë (në rastin e Shqipërisë), fiton një firmë për çdo 100 lekë shitje.

Ndërsa raporti i keshit është raporti i shumës së parasë e ekuivalentët e saj me letrat me vlerë të tregtueshme kundrejt detyrimeve afatshkurtra. Ekzistojnë disa lloje raportesh të tjera të likuiditetit, siç është raporti korent, një prej raporteve më të përdorura, raporti i shpejtësisë (testi acid), raporti i kapitalit punues neto kundrejt mjeteve totale dhe raporti i matësit të interevalit, që është raporti i mjeteve korente kundrejt kostos operative mesatare ditore, por unë kam zgjedhur raportin e keshit, si një raport likuiditeti edhe më konservativ sepse konsideron vetëm paranë e gatshme dhe letrat me vlerë të tregtueshme. Likuiditeti është një nga fushat që reflekton performancën e kompanisë, (Hiadlovský, Rybovičová & Vinczeová, 2016:802). Gjithashtu autorët shtojnë se menaxhimi efikas i likuiditetit është një nga vendimet më të rëndësishme në lidhje me operacionet korente të çdo kompanie.


Kam zgjedhur këto raporte duke analizuar implikimet financiare që vijnë nga ndryshimet ligjore për barnat nga 0% TVSH në 10% TVSH në 2011, dhe pastaj për përjashtimet e barnave nga norma 10% e TVSH-së, duke u përjashtuar kështu edhe njëherë nga TVSH-ja në vitin 2014.

Analiza konsiston në përzgjedhjen e 25 farmacive të cilat operojnë në RSH. Përzgjedhja e tyre nuk është kryer në mënyrë rastësore, por kam vendosur disa kriterë për selektimin. Së pari firmat duhet të jenë krijuar minimalisht që nga viti 2009. Ky kriter është vendosur nisur nga fakti që firmat duhet të jenë konsoliduar në treg, për të shmangur mundësinë e selektimit të firmave të cilat nuk arrijnë të krijojnë qëndrueshmërinë ekonomike në treg dhe si rrjedhojë mbyllin veprimtarinë e tyre në një kohë të shkurtër. Së dyti, forma ligjore e farmacive të përzgjedhura duhet të jetë Sh.p.k. ose Sh.A., si

format më të përshtatshme për studim. Së treti, periudha e studimit do të përfshijë tetë vite, duke filluar nga viti 2009 deri në vitin 2016. Është e vështirë të zgjerohet më tepër periudha kohore duke qenë se farmacitë të cilat kanë depozituar pranë QKB-së bilancet e vitit 2007 dhe 2008 janë shumë të pakta. Gjithashtu është hasur vështirësi edhe në sigurimin e informacionit kontabël për vitin 2017, i cili ka pasur afat të dorëzohet deri më 31 korrik të vitit 2018, sipas shkronjës “a” të nenit 43/3 të ligjit 9723/2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.

Në vitin 2010, barnat janë të përjashtuara nga TVSH-ja. Nga 1 shkurti i vitit 2011, barnat trajtohen me normë 10% TVSH-je, ndërsa nga 1 prilli i vitit 2014 e në vazhdim, barnat janë përjashtuar përsëri nga TVSH-ja. Kriteret e përzgjedhjes së farmacive janë paraqitur skematikisht në figurën e mëposhtme:

Figura 8- Kriteret e përzgjedhjes së farmacive



Burimi: Ilustrim nga autori

Të dhënat e firmave të përzgjedhura për studim janë të ilustruara në tabelën e mëposhtme, ku jepen specifikimet për emrin, rrethin ku operon, Niptin, formën ligjore dhe vitin e krijimit:

Tabela 4- Të dhënat e Farmacive të përzgjedhura për analizë

Nr	Emri i Firmës	NIPTI	Rrethi	Forma ligjore	Viti i krijimit
1	Florifarma	K08002506W	Tiranë	Sh.p.k	1995
2	Cfo Pharma Kashar	K22305002U	Tiranë	Sh.p.k	2002
3	Rejsi Farma Shpk	J91419001U	Tiranë	Sh.p.k	1999
4	Fufarma	J61825037N	Tiranë	Sh.A.	1995
5	Sat Farm Shpk	K42212005J	Tiranë	Sh.p.k	2004
6	PHARMA ONE Sh.P.K.	K72228008B	Tiranë	Sh.p.k	2007
7	Gen - Alb Farma	K62220004U	Tiranë	Sh.p.k	2006
8	Megapharma"	J61814028F	Tiranë	Sh.p.k	1994
9	Albpharma Canada	K51806011R	Tiranë	Sh.p.k	2005
10	Anipharma	K23724401H	Tiranë	Sh.p.k	1999
11	Almegipharma	J81705002M	Tiranë	Sh.p.k	1998
12	A F A - Farma	K41714022W	Tiranë	Sh.p.k	2000
13	Aldosch - Farma	K31503045V	Tiranë	Sh.p.k	2003
14	Dispers Farma	K12511623V	Gjirokastër	Sh.p.k	2002
15	Farmaci "Ana 12"	K41525046C	Tiranë	Sh.p.k	2004
16	Onovo Pharma	K51408006C	Tiranë	Sh.p.k	2004
17	Zhani Farmaci	K14009620W	Korçë	Sh.p.k	2001
18	Profarma	J61827126O	Tiranë	Sh.A.	1995
19	Mati-Farma	J68403917O	Dibër	Sh.p.k	1995
20	Gerifarma	K17519702J	Shkodër	Sh.p.k	2001
21	Veco Pharma	K91908009A	Tiranë	Sh.p.k	2009
22	Genericspharma	K73417402A	Fier	Sh.p.k	2007
23	Bylis Pharma Shpk	K12929401M	Fier	Sh.p.k	2001
24	"Farma - Shqip" Shpk	J66702817I	Elbasan	Sh.p.k	1995
25	Farmaci Shkozeti	K31528666U	Durrës	Sh.p.k	2003

Burimi: Ilustrim nga autori

4.1.4 Analiza e raportit të fitimit marxhinal

Nisur edhe nga shpjegimet ligjore të dhëna më sipër vitet 2011 dhe 2014 do të konsiderohen si vitet ‘e para’ për analizë të efekteve tek raportet. Duke qenë se vetëm 1 muaj kemi pasur barnat pa TVSH, dhe 11 muaj të tjerë barnat janë trajtuar me normën 10% të TVSH-së, viti 2011 do të konsiderohet si një vit me barna me TVSH. Ndërsa për vitin 2014, meqënëse vetëm 3 muaj kemi pasur barnat me normën 10% TVSH, dhe 9 muaj të tjerë barnat kanë qenë të përjashtuara nga TVSH-ja, ky vit do të konsiderohet si një vit me barna të përjashtuara. Në tabelën e mëposhtme jepen llogaritjet e raportit të fitimit marxhinal të 25 farmacive të përzgjedhura për periudhën kohore 2009-2016:

Tabela 5- Raporti i fitimit marxhinal për periudhën 2009-2016

Nr.	Emri i Firmës	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
1	Florifarma	2.24%	2.10%	2.90%	2.53%	3.29%	0.28%	4.04%	7.92%
2	Cfo Pharma Kashar	1.32%	0.96%	3.88%	3.34%	4.21%	2.49%	8.24%	3.15%
3	Rejsi Farma Shpk	7.24%	9.28%	11.39%	10.50%	8.52%	5.46%	2.73%	3.63%
4	Fufarma	0.34%	1.32%	2.67%	3.36%	1.95%	1.65%	1.81%	2.72%
5	Sat Farm Shpk	3.30%	4.65%	15.30%	2.53%	0.45%	1.31%	1.58%	0.87%
6	Pharma One Sh.P.K.	2.35%	1.91%	2.33%	1.86%	1.91%	1.33%	0.80%	1.43%
7	Gen - Alb Farma	8.70%	6.05%	7.92%	5.81%	6.02%	11.14%	10.25%	18.73%
8	Megapharma"	2.53%	2.94%	3.63%	3.78%	2.19%	2.62%	2.39%	4.77%
9	Albpharma Canada	4.79%	6.10%	6.79%	2.56%	2.48%	3.35%	5.37%	10.14%
10	Anipharma	8.60%	9.27%	14.25%	5.07%	6.89%	4.94%	5.24%	4.01%
11	Almegipharma	12.29%	2.96%	12.02%	10.35%	9.13%	2.55%	2.61%	5.57%
12	A F A - Farma	-11.50%	0.51%	21.41%	10.46%	10.19%	9.27%	29.32%	24.35%
13	Aldosch - Farma	1.20%	12.21%	11.73%	13.11%	17.44%	8.79%	7.10%	6.97%
14	Dispers Farma	3.78%	3.19%	1.98%	1.89%	1.48%	1.10%	1.19%	0.15%
15	Farmacit "Ana 12"	7.54%	7.83%	5.90%	5.92%	6.98%	6.60%	5.52%	5.33%
16	Onovo Pharma	1.87%	2.58%	17.67%	14.33%	13.61%	5.75%	11.77%	27.96%
17	Zhani Farmaci	4.95%	3.57%	4.05%	-0.35%	12.15%	5.08%	3.36%	1.86%
18	Profarma	18.99%	15.85%	23.63%	17.82%	13.78%	18.32%	16.43%	15.73%
19	Mati-Farma	2.30%	4.22%	5.20%	3.63%	4.73%	2.88%	3.02%	2.97%

20	Gerifarma	7.38%	6.36%	7.64%	13.03%	13.03%	8.22%	7.37%	6.75%
21	Veco Pharma	-12.36%	7.85%	3.01%	2.40%	1.83%	2.68%	5.67%	18.44%
22	Genericspharma	2.87%	3.06%	3.25%	3.55%	3.16%	3.33%	2.22%	2.00%
23	Bylis Pharma Shpk	100.00%	10.63%	20.03%	17.75%	13.63%	9.41%	10.61%	7.31%
24	"Farma - Shqip" Shpk	12.10%	12.25%	10.63%	9.02%	8.67%	6.25%	4.25%	5.80%
25	Farmaci Shkozeti	5.24%	6.63%	7.28%	5.98%	6.34%	4.88%	4.25%	5.22%

Burimi: Llogaritje të autorit

Studimi i sjelljes së raportit të fitimit marxhinal të 25 farmacive është konsideruar i rëndësishëm për të parë ndikimin e transformimit të TVSH-së në tregun farmaceutik në Shqipëri. Më poshtë pasqyrohen efektet e këtyre ndryshimeve tatimore për disa nga farmacitë.

Firma Florifarma – Në vitin 2009, për çdo 100 lekë shitje, kjo farmaci fiton 2.24 lekë. Në vitin 2010 fitimi marxhinal u ul me 6.2%, ndërsa në vitin 2011 fitimi marxhinal u rrit me 37.9%, ndëkohë që në vitin 2012 ka pasur një rënie të fitimit marxhinal me 12.6%. Në vitin 2013 farmaci Florifarma ka fituar 3.29 lekë për çdo 100 lekë shitje. Ndërsa në vitin 2014, kur barnat janë përjashtuar nga TVSH-ja, fitimi marxhinal ka rënë me 91.3%. Pastaj deri në 2016 raporti ka qenë në rritje.

Farmaci CFO Pharma Kashar – Në vitin 2009, për çdo 100 lekë shitje ka fituar 1.32 lekë, fitim i cili u ul në vlerën 0.96 lekë në vitin 2010. Në vitin 2011, kur barnat janë përfshirë në normën 10% të TVSH-së, fitimi marxhinal për CFO Pharma Kashar është rritur me 305.5%. Në vijim fitimi marxhinal për këtë farmaci ka pësuar luhatje nga viti në vit. Në vitin 2014, fitimi marxhinal ka rënë me 40.8%. Në vitin 2015 kemi pasur një rritje me 230.7%, e pasuar me një rënie prej 61.8% në vitin 2016.

Farmaci Rejsi Farma Shpk – Në vitin 2009, për çdo 100 lekë shitje ka fituar 7.24 lekë. Në vitet 2010 e 2011 ka pasur rritje të fitimit marxhinal, konkretisht me 28.2% dhe 22.8%.

Ndërsa në vitin 2012 ka pasur rënie të fitimit marxhinal me 7.9%. Rënia ka vazhduar deri në vitin 2015, ku farmaci Rejsi Farma Shpk ka fituar 2.73 lekë për çdo 100 lekë shitje. Në vitin 2016, raporti i fitimit marxhinal është rritur me 32.7%.

Farmaci Fufarma – Në vitin 2009, për çdo 100 lekë shitje ka fituar 0.34 lekë. Nga viti 2010 deri në vitin 2012 raporti ka qenë në rritje dhe farmacia ka fituar 3.36 lekë për çdo 100 lekë shitje në vitin 2012. Në vitet 2013 dhe 2014 ka pasur rënie të raportit, konkretisht në vlerat 42% dhe 15.5%. Në vitet 2015 dhe 2016 ka pasur rritje të raportit.

Farmaci Sat Farm Shpk – Në vitin 2009, për çdo 100 lekë shitje ka fituar 4.65 lekë. Në vitin 2010 ka pasur rritje të raportit me 40.7%, ndërsa në vitin 2011 ka pasur rritje të raportit të fitimit marxhinal me 228.9%. Në vitet 2012 dhe 2013 ka pasur rënie të raportit të fitimit marxhinal dhe përkatësisht firma ka fituar 2.53 dhe 0.45 lekë për çdo 100 lekë shitje. Në vitin 2014, kur barnat janë përjashtuar nga TVSH-ja, firma ka pasur një rritje të raportit të fitimit marxhinal me 193.5%. Në vitin 2015 raporti është rritur me 20.7% dhe në vitin 2016 raporti ka pësuar rënie me 45.1%.

Farmaci Pharma One Shpk – Në vitin 2009, për çdo 100 lekë shitje ka fituar 2.35 lekë. Ky raport u ul me 18.7% në vitin 2010. Raporti i fitimit marxhinal u rrit me 22.1% në vitin 2011. Ndërsa në vitin 2012 farmacia ka pësuar përsëri një rënie të raportit me 20.5%. Në vitin 2013 fitimi marxhinal është rritur me 3%. Në vitet 2014 dhe 2015 raporti ka pësuar rënie. Ndërsa në vitin 2016, fitimi marxhinal është rritur me 78.4%.

Farmaci Gen - Alb Farma – Në vitin 2009, për çdo 100 lekë shitje ka fituar 8.7 lekë. Në vitin 2010, kjo vlerë u ul në 6.05 lekë, ndërsa në vitin 2011 raporti është rritur me 30.9%. Në vitet 2012 dhe 2015 kemi pasur rënie të raportit të fitimit marxhinal, përkatësisht në

vlerat 26.6% dhe 8%. Ndërsa në vitet 2013, 2014 dhe 2016 rritja ka qenë në vlerat respektive: 3.5%, 85.1 % dhe 82.8%.

Farmaci Megapharma – Në vitin 2009, për çdo 100 lekë shitje ka fituar 2.53 lekë. Në vitet 2010 dhe 2011 raporti i fitimit marxhinal është rritur përkatësisht me 16.2% dhe 23.6%. Në vitet 2012, 2014 dhe 2016 raporti i fitimit marxhinal është përkatësisht në vlerat 4%, 19.5% dhe 99.5%. Ndërsa në vitet 2013 dhe 2015 raporti ka pësuar rënie në vlerat respektivisht 41.9% dhe 8.7%.

Farmaci Albpharma Canada – Në vitin 2009, për çdo 100 lekë shitje ka fituar 4.79 lekë. Në vitin 2010 raporti është rritur me 27.2%, ndërsa në vitin 2011 raporti i fitimit marxhinal është rritur me 11.4%, ndërkohë që në vitin 2012 dhe 2013, ky raport është ulur përkatësisht me 62.3% dhe 3.2%. Nga viti 2014 nis përmirësimi i raportit të fitimit marxhinal, i cili fillon me një rritje 35% në këtë vit, 60.5% në vitin 2015 dhe 88.8% në vitin 2016.

Farmaci Anipharma - Në vitin 2009, për çdo 100 lekë shitje ka fituar 8.60 lekë. Në vitin 2010 ka pasur një rritje të vogël, duke arritur në vlerën 9.2%. Në vitin 2011 raporti i fitimit marxhinal është rritur me 53.8%. Në vitet në vazhdim raporti ka pasur alternime të ndryshimit të fitimit marxhinal. Në vitin 2014 raporti është ulur me 28.3%, ndërsa në vitin 2015 raporti është rritur me 6.1% dhe së fundmi në vitin 2016, raporti ka rënë me 23.5%.

Ndërsa një përmbledhje e ndryshimit në përqindje të raportit në krahasim me vitin e mëparshëm për të gjitha farmacitë e analizuara jepet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 6- Përmbledhje e ndryshimeve të raportit të fitimit marxhinal ndër vite

Nr.	Emri i Firmës	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
1	Florifarma	-6.2%	37.9%	-12.6%	29.9%	-91.3%	1319.2%	96.2%

2	Cfo Pharma Kashar	-27.8%	305.5%	-13.9%	25.9%	-40.8%	230.7%	-61.8%
3	Rejsi Farma Shpk	28.2%	22.8%	-7.9%	-18.9%	-35.9%	-49.9%	32.7%
4	Fufarma	291.9%	103.2%	25.7%	-42.0%	-15.5%	10.2%	50.2%
5	Sat Farm Shpk	40.7%	228.9%	-83.5%	-82.4%	193.5%	20.7%	-45.1%
6	Pharma One Sh.P.K.	-18.7%	22.1%	-20.5%	3.0%	-30.2%	-40.1%	78.4%
7	Gen - Alb Farma	-30.4%	30.9%	-26.6%	3.5%	85.1%	-8.0%	82.8%
8	Megapharma	16.2%	23.6%	4.0%	-41.9%	19.5%	-8.7%	99.5%
9	Albpharma Canada	27.2%	11.4%	-62.3%	-3.2%	35.0%	60.5%	88.8%
10	Anipharma	7.7%	53.8%	-64.4%	35.8%	-28.3%	6.1%	-23.5%
11	Almegipharma	-75.9%	306.0%	-13.9%	-11.8%	-72.1%	2.5%	113.5%
12	A F A - Farma	-104.5%	4280.8%	148.8%	-2.5%	-9.1%	216.4%	-16.9%
13	Aldosch - Farma	913.6%	-3.9%	11.7%	33.0%	-49.6%	-19.2%	-1.9%
14	Dispers Farma	-15.7%	-37.8%	-4.5%	-21.5%	-25.5%	7.4%	-87.2%
15	Farmaci "Ana 12"	4.0%	-24.7%	0.2%	17.9%	-5.4%	-16.5%	-3.3%
16	Onovo Pharma	37.8%	584.8%	-18.9%	-5.1%	-57.7%	104.8%	137.4%
17	Zhani Farmaci	-27.8%	13.4%	108.7%	3552.0%	-58.2%	-33.9%	-44.6%
18	Profarma	-16.5%	49.1%	-24.6%	-22.7%	33.0%	-10.3%	-4.3%
19	Mati-Farma	84.0%	23.1%	-30.2%	30.3%	-39.2%	4.8%	-1.7%
20	Gerifarma	-13.8%	20.1%	70.6%	0.0%	-36.9%	-10.4%	-8.4%
21	Veco Pharma	-163.5%	-61.7%	-20.3%	-23.6%	46.3%	111.6%	225.5%
22	Genericspharma	6.6%	6.1%	9.3%	-11.1%	5.6%	-33.4%	-10.1%
23	Bylis Pharma Shpk	-89.4%	88.4%	-11.3%	-23.2%	-30.9%	12.8%	-31.1%
24	"Farma - Shqip" Shpk	1.3%	-13.2%	-15.1%	-3.9%	-27.9%	-32.0%	36.3%
25	Farmaci Shkozeti	26.5%	9.8%	-17.9%	6.1%	-23.0%	-12.9%	22.9%

Burimi: Llogaritje të autorit

Përmbledhje

Duke përmbledhur rezultatet e 25-së farmacie të marra në studim, vihet re se në vitin

2011, kur një pjesë e barnave janë përfshirë me normën 10% të TVSH-së, fitimi marxhinal


është rritur në 76% të farmacive të analizuara (19 farmaci nga 25 gjithsej). Një fitim marxhinal i lartë është i preferueshëm sepse ky raport tregon sa lekë gjenerohen si fitim për çdo lekë shitje. Ndërsa për vitin 2014, kur barnat janë përjashtuar nga TVSH-ja, vetëm 28% e farmacive që janë marrë për analizë (7 farmaci nga 25 gjithsej), kanë pasur rritje të raportit të fitimit marxhinal. Ndërsa pjesa tjetër konkretisht 72% kanë pasur rënie të raportit të fitimit marxhinal, që do të thotë se ndryshimi tatimor në lidhje me TVSH-në ka ndikuar negativisht në fitueshmërinë e pjesës më të madhe të farmacive. Ndryshimet e raportit për këtë vit luhaten nga 0.28% në 18.32%.

Për vitet 2011 dhe 2014, farmacitë Sat Farm Shpk, Gen - Alb Farma, Megapharma, Albpharma Canada, Profarma dhe Genericspharma, ose e shprehur ndryshe 24% e farmacive të marra në studim kanë shfaqur të njëjtën sjellje, e shoqëruar me rritje të raportit të fitimit marxhinal, pavarësisht ndryshimeve tatimore.

Farmacitë A F A - Farma, Aldosch - Farma, Dispers Farma, Farmaci "Ana 12" dhe "Farma-Shqip" Shpk ose e shprehur ndryshe 20% e farmacive të marra në studim kanë shfaqur sjellje të njëjtë në vitet 2011 dhe 2014, por e reflektuar me rënien e raportit të fitimit marxhinal.

52% e farmacive të marra në studim kanë pasur rritje të raportit të fitimit marxhinal kur një pjesë e barnave janë përfshirë në normën 10% të TVSH-së dhe kanë pasur rënie të raportit të fitimit marxhinal kur barnat janë përjashtuar nga TVSH-ja. Ndërsa 4% e farmacive të marra në studim, kanë pësuar rënie të raportit të fitimit marxhinal kur një pjesë e barnave janë përfshirë në normën 10% të TVSH-së dhe kanë pësuar rritje të raportit të fitimit marxhinal kur barnat janë përjashtuar nga TVSH-ja. Në figurën e mëposhtme paraqitet analiza e raportit të fitimit marxhinal:

Figura 9- Analiza e raportit të fitimit marxhinal



Burimi: Llogaritje të autorit

Edhe nga figura e mësipërme vihet re se në pjesën më të madhe, në 52% të farmacive të analizuara, fitimi marxhinal është rritur kur barnat janë përfshirë në normën 10% të TVSH-së dhe fitimi marxhinal është ulur kur barnat janë përjashtuar nga TVSH-ja. Një peshë e vogël 4% e farmacive të studiuara kanë pasur rënie të raportit të fitimit marxhinal kur barnat janë përfshirë në normën 10% të TVSH-së dhe fitimi marxhinal është rritur kur barnat janë përjashtuar nga TVSH-ja.

4.1.5 Analiza e raportit të keshit

Menaxhimi financiar duhet të fokusohet kryesisht mbi atë se si një kompani krijon dhe mirëmban vlerën dhe për këtë arsye shqetësimet e tyre janë se si të ndërmerren vendimet më të mira në rrugën drejt përsosmërisë së proceseve të biznesit që çojnë kompanitë në rritjen e vlerës, (Hiadlovský, Rybovičová & Vinczeová, 2016:800).

Tabela 7- Raporti i keshit për periudhën 2009-2016

Nr.	Emri i Firmës	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
1	Florifarma	0.090	0.120	0.167	0.126	0.354	0.400	0.032	0.052
2	Cfo Pharma Kashar	0.091	0.111	0.123	0.157	0.254	0.150	0.468	0.016
3	Rejsi Farma Shpk	0.138	0.070	0.130	0.124	0.132	0.110	0.129	0.100
4	Fufarma	0.184	0.066	0.069	0.120	0.112	0.253	0.320	0.226
5	Sat Farm Shpk	26.625	0.030	0.027	0.036	0.059	0.097	0.320	0.594
6	Pharma One Sh.P.K.	0.017	0.010	0.041	0.040	0.088	0.096	0.040	0.077
7	Gen - Alb Farma	0.232	0.116	0.026	0.027	0.086	0.348	0.198	0.326
8	Megapharma"	0.134	0.027	0.016	0.030	0.011	0.207	0.196	0.073
9	Albpharma Canada	0.053	0.006	0.058	0.004	0.038	0.029	1.685	0.045
10	Anipharma	0.034	0.089	0.070	0.158	0.101	0.062	0.295	0.383
11	Almegipharma	0.132	0.010	0.018	0.014	0.443	0.578	4.957	0.774
12	A F A - Farma	0.030	0.002	0.004	0.018	0.006	0.962	0.420	2.601
13	Aldosch - Farma	0.195	0.019	0.042	0.156	0.080	-0.240	0.028	0.028
14	Dispers Farma	0.053	0.002	0.003	0.004	0.003	0.029	0.112	0.044
15	Farmaci "Ana 12"	0.753	0.101	0.000	0.428	0.344	2.585	0.014	0.055
16	Onovo Pharma	0.069	0.014	0.002	0.027	1.847	0.311	1.260	0.063
17	Zhani Farmaci	0.110	22.676	84.917	12.059	14.339	15.113	58.372	2.453
18	Profarma	0.617	0.022	0.017	0.048	0.036	0.004	0.001	0.014
19	Mati-Farma	0.355	0.625	0.504	0.223	1.430	2.851	0.679	1.991
20	Gerifarma	0.159	0.049	0.526	0.002	2.698	0.750	0.036	1.137
21	Veco Pharma	0.074	0.135	0.035	0.059	0.009	0.381	0.031	0.323
22	Genericspharma	0.123	0.136	0.107	0.044	0.046	0.037	0.030	0.035
23	Bylis Pharma Shpk	0.006	0.076	0.032	0.018	0.124	0.050	0.345	0.041
24	"Farma - Shqip" Shpk	- 10.022	-0.959	38.843	0.460	1.592	1.821	1.706	2.425
25	Farmaci Shkozeti	0.242	0.208	0.213	1.352	0.705	1.174	2.055	10.940

Burimi: Llogaritje të autorit

Më poshtë pasqyrohen efektet e këtyre ndryshimeve tatimore për disa nga farmacitë.

Farmaci Florifarma – Në vitin 2009, për çdo lekë të përgjegjësisë aktuale për detyrimet afatshkurtra farmacia ka vetëm 0.090 lekë të parave të gatshme dhe letrave me vlerë të tregtueshme për t'i paguar. Një raport keshi më i ulët se 1 tregon për mungesë likuiditeti të firmës, ndërsa një raport keshi më i lartë se 1, tregon likuiditet, por gjithashtu tregon edhe një përdorim jo eficient të parasë së gatshme me ekuivalentet e saj dhe të letrave me vlerë të tregtueshme. Në vitin 2010 raporti u rrit me 33.7%, ndërsa në vitin 2011, raporti i keshit u rrit me 39%, por përsëri vlera e tij është e ulët, vetëm 0.167 herë. Në vitin 2012 raporti i keshit ra me 24.6%, ndërsa në vitin 2013 vlera e raportit të keshit u rrit me 180.4%, në vlerën 0.354 herë. Në vitin 2014, kur barnat janë përjashtuar nga TVSH-ja, raporti i keshit u rrit me 13.1%. Ndërkohë që në vitin 2015 aftësia likuiduese e farmacisë, e matur nga raporti i keshit ka rënë me 92%. Në vitin 2016 është rritur raporti i keshit në krahasim me vitin 2015, por përsëri vlera është shumë e ulët, 0.052 herë. Aftësia likuiduese e farmacisë Florifarma është e ulët, megjithatë farmacia mund të përdorë pasuritë e tjera aktuale për të qenë në gjendje të zgjidhë detyrimet e saj aktuale.

Farmaci CFO Pharma Kashar - Në vitin 2009, për çdo lekë të përgjegjësisë aktuale për detyrimet afatshkurtra farmacia ka vetëm 0.091 lekë të parave të gatshme dhe letrave me vlerë të tregtueshme për t'i paguar. Nga viti 2010 deri në vitin 2013, raporti i keshit ka qenë gjithnjë e në rritje, duke arritur vlerën 0.254 në vitin 2013. Në vitin 2014, raporti i keshit ka qënë me 40.8%. Në vitin 2015, raporti është rritur me 211.6%, ndërsa në vitin 2016, raporti ka rënë me 96.5%, në vlerën 0.016 herë.

Farmaci Rejsi Farma Shpk - Në vitin 2009, për çdo lekë të përgjegjësisë aktuale për detyrimet afatshkurtra farmacia ka vetëm 0.138 lekë të parave të gatshme dhe letrave me vlerë të tregtueshme për t'i paguar. Nga viti 2010 e deri në vitin 2016, raporti i keshit ka

pasur luhatje, herë me rritje dhe herë me rënie. Në vitin 2016 paraqitet një vlerë tepër e ulët likuiditeti, në nivelin 0.10 herë.

Farmaci Fufarma - Në vitin 2009, për çdo lekë të përgjegjësisë aktuale për detyrimet afatshkurtra farmacia ka vetëm 0.184 lekë të parave të gatshme dhe letrave me vlerë të tregtueshme për t'i paguar. Në vitin 2010 raporti ka rënë me 64.2%. Për dy vitet në vazhdim, raporti i keshit ka qenë në rritje, me 5.2% në vitin 2011 dhe me 73.5% në vitin 2012. Në vitin 2013, raporti ka pasur një rënie me 7%, ndërkohë që në vitin 2014, kur barnat janë përjashtuar nga TVSH-ja, raporti i keshit është rritur me 126.6%. Rritja ka vazhduar edhe në vitin 2015 me 26.6%, ndërsa në vitin 2016, raporti i keshit i farmacisë Fufarma ka rënë me 29.5%.

Farmaci Sat Farm Shpk - Në vitin 2009, për çdo lekë të përgjegjësisë aktuale për detyrimet afatshkurtra farmacia ka vetëm 26.625 lekë të parave të gatshme dhe letrave me vlerë të tregtueshme për t'i paguar. Në vitin 2010 raporti ka rënë me 99.9%, gjithashtu edhe në vitin 2011, kur ka hyrë në fuqi norma 10% e TVSH-së për barnat, raporti i keshit ka rënë me 10.5%. Ndërsa nga viti 2012 e deri në vitin 2016, raporti i keshit ka pasur një trend rritës. Në vitin 2014, kur barnat janë përjashtuar nga TVSH-ja, raporti i keshit është rritur me 62.9%, në vitin 2015 raporti është rritur me 231.1%, ndërsa në vitin 2016 raporti i keshit është rritur me 85.4%, duke arritur në vlerën 0.594 herë, që tregon për një aftësi likuiduese në rritje.

Farmaci Pharma One Shpk - Në vitin 2009, për çdo lekë të përgjegjësisë aktuale për detyrimet afatshkurtra farmacia ka vetëm 0.017 lekë të parave të gatshme dhe letrave me vlerë të tregtueshme për t'i paguar. Në vitin 2010 raporti i keshit ka rënë me 41.5%. Në vitin 2011, raporti i keshit u rrit me 311.1%. Në vitin 2012, raporti ka pësuar rënie me

2.3%. Ndërkohë që në vitet 2013 dhe 2014, raporti është rritur përkatësisht me 122.2% dhe 9.1%. Në vitin 2015, raporti ka rënë me 58.1%, ndërsa në vitin 2016, raporti i keshit është rritur me 91.6%.

Farmaci Gen - Alb Farma - Në vitin 2009, për çdo lekë të përgjegjësisë aktuale për detyrimet afatshkurtra farmacia ka vetëm 0.232 lekë të parave të gatshme dhe letrave me vlerë të tregtueshme për t'i paguar. Në vitet 2010 dhe 2011, raporti i keshit ka pësuar rënie, konkretisht me 50.1% dhe 77.2%, ndërsa nga viti 2012 e deri në vitin 2014, raporti i keshit ka qenë gjithnjë e në rritje, duke arritur vlerën 0.348 herë në 2014-ën, me një rritje 305.8%. Në vitin 2015, aftësia likuiduese e matur nga raporti i keshit, ka rënë me 43.1%, ndërsa në vitin 2016 ka pasur një rritje në nivelin 64.4%.

Farmaci Megapharma - Në vitin 2009, për çdo lekë të përgjegjësisë aktuale për detyrimet afatshkurtra farmacia ka vetëm 0.134 lekë të parave të gatshme dhe letrave me vlerë të tregtueshme për t'i paguar. Në vitet 2010 dhe 2011, raporti i keshit ka rënë konkretisht me 79.6% dhe 41.4%. Ndërsa në vitin 2012 raporti është rritur me 84.5% dhe në vitin 2013 ka rënë me 62.4%. Në vitin 2014, raporti është rritur në vlerën 0.207 herë. Në vitet 2015 dhe 2016, raporti i keshit ka qenë në rënie, përkatësisht rënia ka qenë në nivelet 5.6% dhe 62.5%.

Farmaci Albpharma Canada - Në vitin 2009, për çdo lekë të përgjegjësisë aktuale për detyrimet afatshkurtra farmacia ka vetëm 0.053 lekë të parave të gatshme dhe letrave me vlerë të tregtueshme për t'i paguar. Në vitin 2010 raporti ka rënë me 88.7%, ndërsa në vitin 2011 raporti i keshit është rritur me 874.4%. Nga viti 2012 e deri në vitin 2016, ka pasur alternime me rritje dhe rënie të vlerës së raportit, duke shfaqur kështu një paqëndrueshmëri të aftësisë likuiduese të matur nga raporti i keshit. Theksoj që në vitin 2015, raporti i keshit

ishte në vlerën 1.685 herë, që do të thotë se paraja e gatshme me ekulivalentet e saj dhe letrat me vlerë të tregtueshme i tejkalojnë detyrimet afatshkurtra. Por gjithashtu është edhe një përdorim jo eficient i keshit për këtë vit. Në vitin 2016 raporti i keshit ra me 97.3%.

Farmaci Anipharma - Në vitin 2009, për çdo lekë të përgjegjesisë aktuale për detyrimet afatshkurtra farmacia ka vetëm 0.034 lekë të parave të gatshme dhe letrave me vlerë të tregtueshme për t'i paguar. Në vitin 2010 raporti i keshit është rritur me 161.4%, ndërsa në vitin 2011 raporti i keshit ka rënë me 21.8%. Në vitin 2012, raporti i keshit ka pasur përsëri rritje në vlerën 126.7%. Ndërsa në vitet 2013 dhe 2014, raporti i keshit ka pësuar rënie, përkatësisht në vlerat 36.4% dhe 383.4%. Ndërkohë që në vitet 2015 dhe 2016, raporti i keshit ka qenë në rritje.

Ndërsa një përmbledhje e ndryshimit në përqindje të raportit në krahasim me vitin e mëparshëm për të gjitha farmacitë e analizuar jepet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 8- Përmbledhje e ndryshimeve të raportit të keshit ndër vite

Nr.	Emri i Firmës	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
1	Florifarma	33.7%	39.0%	-24.6%	180.4%	13.1%	-92.0%	62.8%
2	Cfo Pharma Kashar	21.5%	10.3%	28.4%	61.0%	-40.8%	211.6%	-96.5%
3	Rejsi Farma Shpk	-49.8%	87.6%	-5.3%	7.2%	-16.7%	16.7%	-22.2%
4	Fufarma	-64.2%	5.2%	73.5%	-7.0%	126.6%	26.6%	-29.5%
5	Sat Farm Shpk	-99.9%	-10.5%	34.4%	65.4%	62.9%	231.1%	85.4%
6	Pharma One Sh.P.K.	-41.5%	311.1%	-2.3%	122.2%	9.1%	-58.1%	91.6%
7	Gen - Alb Farma	-50.1%	-77.2%	2.8%	216.0%	305.8%	-43.1%	64.4%
8	Megapharma"	-79.6%	-41.4%	84.5%	-62.4%	1766.5%	-5.6%	-62.5%
9	Albpharma Canada	-88.7%	874.4%	-92.7%	797.9%	-23.4%	5620.5%	-97.3%

10	Anipharma	161.4%	-21.8%	126.7%	-36.4%	-38.4%	374.6%	29.8%
11	Almegipharma	-92.8%	85.2%	-22.3%	3138.7%	30.6%	756.9%	-84.4%
12	A F A - Farma	-94.5%	121.7%	409.4%	-66.0%	15182.2%	-56.3%	519.0%
13	Aldosch - Farma	-90.4%	127.3%	266.6%	-48.8%	-400.6%	-111.7%	-0.8%
14	Dispers Farma	-96.5%	36.3%	39.5%	-14.4%	863.6%	287.9%	-61.1%
15	Farmaci "Ana 12"	-86.7%	-100.0%	-	-19.7%	651.4%	-99.5%	289.6%
16	Onovo Pharma	-79.2%	-88.5%	1512.4%	6855.8%	-83.2%	305.2%	-95.0%
17	Zhani Farmaci	20430.6%	274.5%	-85.8%	18.9%	5.4%	286.2%	-95.8%
18	Profarma	-96.4%	-23.8%	181.9%	-23.4%	-90.1%	-77.9%	1713.8%
19	Mati-Farma	75.9%	-19.4%	-55.7%	539.9%	99.4%	-76.2%	193.3%
20	Gerifarma	-69.4%	983.0%	-99.5%	113620.8%	-72.2%	-95.3%	3096.3%
21	Veco Pharma	82.5%	-74.2%	69.2%	-84.3%	4027.9%	-91.9%	951.4%
22	Genericspharma	11.0%	-21.3%	-58.8%	2.8%	-17.8%	-20.4%	17.7%
23	Bylis Pharma Shpk	1096.6%	-57.3%	-44.1%	581.9%	-59.8%	590.9%	-88.0%
24	"Farma - Shqip" Shpk	-90.4%	4148.3%	-98.8%	246.4%	14.4%	-6.3%	42.1%
25	Farmaci Shkozeti	-14.2%	2.3%	535.5%	-47.9%	66.5%	75.0%	432.4%

Burimi: Llogaritje të autorit

Përmbledhje


Duke analizuar sjelljen e 25-së farmacive mund të konkludoj se këto firma kanë shfaqur sjellje të ngjashme, por edhe sjellje specifike. Vlera më e ulët e raportit të keshit është - 10.022 herë, ndërkohë që vlera më e lartë e raportit të keshit është 84.917 herë. Në vitin 2011, kur një pjesë e barnave janë përfshirë në normën 10% të TVSH-së, 52% e farmacive të marra në studim (13 farmaci nga 25 gjithsej) kanë pësuar një rritje të raportit të keshit, ndërsa 48% e farmacive (12 farmaci nga 25 gjithsej) kanë shfaqur rënie të likuiditetit të matur nga raporti i keshit. Rritja e raportit të keshit tregon edhe rritje të likuiditetit dhe siç

dihet sa më likuid të jetë një biznes, aq më pak mundësi ka të përjetojë vështirësi në kryerjen e aktiviteteve të tij. Ndërsa në vitin 2014, kur barnat u përjashtuan nga TVSH-ja, 60% e farmacive të marra në studim (15 farmaci nga 25 gjithsej) kanë pësuar rritje të raportit.

Florifarma, Fufarma, Pharma One Sh.P.K., Almegipharma, A F A - Farma, Dispers Farma, Zhani Farmaci dhe Farmaci Shkozeti, ose 32% e farmacive të marra në studim, kanë shfaqur sjellje të njëjtë e reflektuar me rritjen e raportit të keshit në vitin 2011 dhe në vitin 2014. Farmacitë Anipharma, Onovo Pharma, Profarma, Genericspharma dhe Bylis Pharma Shpk, ose 20% e farmacive të marra në studim kanë shfaqur sjellje të njëjtë në vitet 2011 dhe 2014, por e reflektuar me rënien e raportit të keshit.

20% e farmacive të marra në studim kanë pasur rritje të raportit të keshit kur një pjesë e barnave janë përfshirë në normën 10% të TVSH-së dhe kanë pasur rënie të raportit të keshit kur barnat janë përjashtuar nga TVSH-ja. Ndërsa 28% e farmacive të marra në studim, kanë pësuar rënie të raportit të keshit kur një pjesë e barnave janë përfshirë në normën 10% të TVSH-së dhe kanë pësuar rritje të raportit të keshit kur barnat janë përjashtuar nga TVSH-ja. Në figurën e mëposhtme paraqitet analiza e raportit të keshit:

Figura 10- Analiza e raportit të keshit



Burimi: Llogaritje të autorit

Nga figura e mësipërme vihet re se 28% e farmacive të studjuara kanë pasur rënie të raportit të keshit kur barnat janë përfshirë në normën 10% të TVSH-së. Kjo do të thotë se për çdo lekë të përgjegjësisë aktuale për detyrimet afatshkurtra, këto farmaci kanë pasur më pak lekë të parave të gatshme dhe letrave me vlerë të tregtueshme për t'i paguar, që tregon për një mungesë likuiditeti. Nga ana tjetër po këto farmaci kanë pasur rritje të raportit të keshit kur barnat janë përjashtuar nga TVSH-ja. Ndërkohë që 20% e farmacive të analizuara kanë pasur rritje të raportit të keshit kur barnat janë përfshirë në normën 10% të TVSH-së dhe kanë pesuar rënie të raportit të keshit kur barnat janë përjashtuar nga TVSH-ja.

4.2 Pesha e të ardhurave të TVSH-së që mblidhen në doganë

Zakonisht të ardhurat nga TVSH-ja nga mallrat e importuara përbëjnë një përqindje të madhe e të ardhurave të TVSH-së (Ebrill, Keen, Bodin dhe Summers, 2001)²². Ebrill

²² Marrë nga: Legeida N. and Sologoub D. (2003) “*Modeling Value Added Tax (VAT) Revenues in a Transition Economy: Case of Ukraine*,” Working Paper No. 22, Institute For Economic Research And Policy Consulting, fq. 10.

(2001) zbuloi se mesatarisht 55% e të ardhurave të TVSH-së mblidhen në importe²³. Për të ilustruar peshën e akumulimit të Tvsh-së nga mallrat e importuara në tabelat e mëposhtme kam studjuar nga 12 periudha për rastin e Shqipërisë dhe Kosovës. Të dhënat paraqiten në tabelat e mëposhtme:

Tabela 9- Përqindja e të ardhurave të Tvsh-së nga Doganat për vitin 2017 për Shqipërinë (Vlerat janë në mln lekë)

Periudha	Të ardhurat e Tvsh-së nga Tatimet	Të ardhurat e Tvsh-së nga Doganat	Të ardhurat e Tvsh-së në total	Përqindja e TA nga Doganat
Janar 2017	4,370	5,775	10,145	56.9%
Shkurt 2017	2,781	7,310	10,091	72.4%
Mars 2017	2,082	8,984	11,066	81.2%
Prill 2017	2,476	8,140	10,616	76.7%
Maj 2017	3,011	8,816	11,827	74.5%
Qershor 2017	2,778	9,234	12,012	76.9%
Korrik 2017	3,169	9,358	12,527	74.7%
Gusht 2017	2,263	9,251	11,514	80.3%
Shtator 2017	3,394	8,729	12,123	72.0%
Tetor 2017	2,988	9,538	12,526	76.1%
Nëntor 2017	2,450	9,056	11,506	78.7%
Dhjetor 2017	3,192	10,395	13,587	76.5%

Burimi: Ministria e Financave RSH & llogaritje nga autori

Për vitin 2017 pesha e të ardhurave të Tvsh-së nga doganat varion nga 56.9% në muajin janar deri në vlerën 81.2% në muajin mars. Siç mund ta vëmë re vlera më e ulët i përket muajit janar (ekzaktësisht 56.9%). Ndërsa të hyrat më të mëdha të Tvsh-së nga doganat i kemi në muajin mars, e pastaj në muajin gusht. Për vitin 2017 në Shqipëri, përqindja e të ardhurave të TVSH-së të mbledhura në doganë është mesatarisht 74.95%. Pesha e

²³ Marrë nga: Da Silva C.S.F., (2016), The determinants of value added tax revenues in Portugal. Tezë Masteri: Lisboa School of Economics & Management, fq. 14.

akumulimit të Tvsh-së nga doganat zë një peshë të konsiderueshme nga 59.8% deri në 79.4% për vitin 2016.

Tabela 10- Përqindja e të ardhurave të Tvsh-së nga Doganat për vitin 2017 për Kosovën (Vlerat janë në mijë euro)

Periudha	Të ardhurat e Tvsh-së nga Tatimet	Të ardhurat e Tvsh-së nga Doganat	Të ardhurat e Tvsh-së në total	Përqindja e TA nga Doganat
Janar 2017	16,040	25,121	41,161	61.03%
Shkurt 2017	13,790	34,344	48,133	71.35%
Mars 2017	12,447	45,245	57,692	78.43%
Prill 2017	13,985	43,214	57,199	75.55%
Maj 2017	14,300	52,931	67,231	78.73%
Qershor 2017	13,916	47,834	61,750	77.46%
Korrik 2017	14,605	51,798	66,403	78.01%
Gusht 2017	18,653	57,485	76,138	75.50%
Shtator 2017	24,084	45,718	69,802	65.50%
Tetor 2017	15,686	51,779	67,464	76.75%
Nëntor 2017	20,517	47,779	68,296	69.96%
Dhjetor 2017	20,318	54,530	74,848	72.85%

Burimi: Ministria e Financave RK & llogaritje nga autori

Për vitin 2017 në Kosovë, përqindja e të ardhurave të TVSH-së të mbledhura në doganë është mesatarisht 73.77%. Sikurse edhe në rastin e Shqipërisë, në muajin janar kemi përqindjen më të ulët të të ardhurave të TVSH-së të mbledhura në doganë, konkretisht në vlerën 61.03%. ndërsa të hyrat më të mëdha të të ardhurave të TVSH-së nga doganat i kemi në muajin maj, në vlerën 78.73%.

4.3 Produktiviteti i TVSH-së në Shqipëri

CIS (Komonuelthi i Shteteve të Pavarura) është një organizatë rajonale e krijuar në dhjetor 1991 nga ish-Republikat Sovjetike. Në Deklaratën e miratuar, pjesëmarrësit e Komonuelthit shpallën ndërveprimin e tyre në bazë të barazisë sovrane. Aktualisht vendet anëtare të CIS janë: Azerbajxhani, Armenia, Bjellorusia, Kazakistani, Kirgistani, Moldavia, Rusia,

Taxhikistani, Turkmenistani, Uzbekistani dhe Ukraina. Në vitin 2008, Gjeorgjia u largua nga organizata, (Xprimm.com, 2018).

Në përgjithësi, efektiviteti fiskal i TVSH-së në vendet e CIS është më i ulët krahasuar me atë të vendeve të Evropës Qendrore (Dabrowski, Tomczynska, 2001)²⁴. Autorët theksojnë se ka pasur një ndryshim të konsiderueshëm ndërmjet shkallës së përgjithshme të TVSH-së dhe të ardhurave të TVSH-së në përqindje të PBB-së, e cila mund t'u atribuohet mangësive të mëposhtme në legjislacionin dhe administrimin e TVSH-së në vendet e CIS: përjashtime nga taksat, rimbursimi i TVSH-së, pagesat e TVSH-së, varësia e madhe e disa ekonomive në bujqësi, tregtia në shkallë të vogël, shërbimet në PBB që mund të ulin bazën efektive të mbledhjes së TVSH-së, aftësinë politike dhe administrative për të mbledhur taksat. Standardi ligjor dhe normat efektive të TVSH-së janë gjithashtu të ndryshme edhe në vendet e BE-së. Në vitin 1998 norma mesatare e BE-së për normën e TVSH-së ishte 19.4%, ndërsa norma efektive e TVSH-së ishte 10.5%, (Legeida & Sologoub, 2003:6). Sipas literaturës së financave publike, të ardhurat nga TVSH-ja do të varen nga baza tatimore, numri dhe niveli i normave tatimore, kapaciteti i administratës tatimore (cilësia dhe efikasiteti i administratës tatimore) dhe pajtueshmëria e taksapaguesve (Legeida & Sologoub, 2003:6).

Një nga raportet që mund të përdoren për të matur efikasitetin e TVSH-së është i ashtuquajtur "raporti i efikasitetit" ose "i produktivitetit" siç e quajnë disa autorë të tjerë. Ai është raporti i të ardhurave të TVSH-së ndaj PBB-së, i ndarë nga norma standarde e TVSH-së. Sa më i lartë ky raport, aq më i lartë është produktiviteti i sistemit të TVSH-së. Sa më i


²⁴ Marrë nga: Legeida N. and Sologoub D. (2003) "Modeling Value Added Tax (VAT) Revenues in a Transition Economy: Case of Ukraine," Eworking Paper No. 22, Institute For Economic Research And Policy Consulting, fq. 6.

ulët është raporti, më e përhapur është shkalla e përjashtimeve, evazioni fiskal ose performanca e dobët e administratës tatimore, (Tanzi & Davoodi, 2000:20). Formula për llogaritjen e produktivitetit jepet më poshtë:

$$\text{Produktiviteti i TVSH} - \text{së} = \frac{\text{TA nga TVSH} - \text{ja/PBB}}{\text{Norma standarte e TVSH} - \text{së}}$$

Në vitin 2008, viti i krizës financiare, produktiviteti i TVSH-së ka arritur vlerën më të lartë për periudhën kohore 2000-2016. Nga viti 2000 deri në vitin 2008 produktiviteti ka qenë në rritje, përveç vitit 2001 dhe 2003, ku rëniet kanë qenë përkatësisht me 4% dhe 1.1%. Viti 2001 shënon vitin me rënien më të madhe të treguesit të produktivitetit. Në vitin 2009 produktiviteti i TVSH-së u ul me 2.9% dhe deri në vitin 2013 ky tregues ka qenë në ulje duke dhënë një përrformancë më të dobët. Në vitin 2014 ka pasur një rritje të nivelit të produktivitetit me 6.9%. Në vitin 2015 kemi pasur një ulje të vogël, ndërsa në vitin 2016, raporti është përmirësuar. Ndërsa grafikisht trendi i produktivitetit të TVSH-së jepet në figurën e mëposhtme:

Figura 11- Produktiviteti i TVSH-së për Shqipërinë



Burimi: Ministria e Financave RSH (TA nga TVSH-ja), INSTAT (PBB) & llogaritje të

autorit


4.4 Efikasiteti i TVSH-së në Shqipëri

Një raport tjetër për të matur efikasitetin e TVSH-së, është e bazuar në konsumin. Në vend të PBB-së, vendoset konsumi final dhe përfitohet “Raporti i efikasitetit C”, i përdorur nga FMN-ja. Formula e këtij raporti është:

$$\text{Efikasiteti i TVSH} - \text{së} = \frac{TA \text{ nga TVSH} - ja / \text{Konsumi}}{\text{Norma standarte e TVSH} - \text{së}}$$

Ndërkohë që produktiviteti i TVSH-së, i matur për periudhën kohore 2000-2016, luhatej brenda normave 36.5% dhe 49.6%, efikasiteti i TVSH-së referuar së njëjtës periudhë kohore, luhatet në vlerat 46.1% dhe 60%. Sikurse raporti i produktivitetit, edhe raporti i efikasitetit vlerën më të lartë e ka arritur në vitin 2008. Nga viti 2000 deri në vitin 2008 performanca e efikasitetit është paraqitur mirë, sepse vetëm në vitin 2003 ka pasur një rënie me 1.5%, ndërsa vitet e tjera treguesi ka qenë në rritje përgjithësisht dhe ndryshim pozitiv. Nga viti 2009 deri në vitin 2013, sikurse pritej, treguesi ka qenë në rënie. Nga viti 2014 deri në vitin 2016 treguesi ka pasur rritje dhe rënie. Nga raportet vihet re se dy treguesit e studjuar kanë një ngjashmëri ndërmjet tyre, por tek raporti i efikasitetit të ardhurat nga TVSH-ja përafrohen më shumë me konsumin, sesa përafrohen të ardhurat e TVSH-së me PBB-në. Në grafikun e mëposhtëm ilustron trendin e ecurisë së efikasitetit të TVSH-së, referuar të dhënave për Shqipërinë, për serinë kohore 2000-2016:

Figura 12- Efikasiteti i TVSH-së për Shqipërinë



Burimi: Ministria e Financave RSH (TA nga TVSH-ja), INSTAT (Konsumi) & llogaritje të autorit

4.5 Sjellja e bizneseve sipas pragut të regjistrimit të TVSH-së në Kosovë

Firmat mund të prirën të shfaqin sjellje të ndryshme në rastet e ndryshimeve të pragut të regjistrimit të TVSH-së.

Në tabelën e mëposhtme kam paraqitur të dhënat në lidhje me numrin e bizneseve nën dhe mbi pragun e regjistrimit të TVSH-së për Republikën e Kosovës, nga viti 2013 deri në vitin 2018. Ndryshimet që janë bërë për pragun e TVSH-së janë dhënë të specifikuara më poshtë.

Tabela 11- Numri i bizneseve nën/mbi pragun e TVSH-së

Viti	Numri i bizneseve nën pragun 30000€ dhe 50000€	Numri i bizneseve mbi pragun 30000€ dhe 50000€	Totali
2013*	85,025	6,723	91,748
2014	86,406	7,265	93,671
2015**	87,364	9,516	96,880
2016	89,231	10,622	99,853
2017	91,494	11,435	102,929

2018	92,694	11,439	104,133
-------------	--------	--------	---------

* Për vitet 2013 dhe 2014 qarkullimi deri tek pragu i TVSH-së në vlerën deri në 49 999€;

** Ndërsa për vitet 2015-2018 qarkullimi deri tek pragu i TVSH-së në vlerën deri në 29 999€.

Burimi: Administrata Tatimore e Kosovës, 2018²⁵

Për vitet 2013 dhe 2014 kur qarkullimi deri tek pragu i TVSH-së ishte deri në 49 999€, numri i bizneseve poshtë nivelit të pragut ishte rreth vlerës 92%. Në vitin 2015 kur qarkullimi deri tek pragu i TVSH-së u ndryshua në vlerën deri në 29 999€, numri i bizneseve mbi nivelin e pragut u rrit me 26.65%. Ndërsa numri i bizneseve nën pragun e regjistrimit të TVSH-së ra me 2.24%. Nga viti 2015 deri në vitin 2018, muajin e fundit që janë marrë të dhënat, numri i bizneseve mbi pragun e regjistrimit të TVSH-së ka qenë në rritje duke mbajtur një përqindje prej 11% afërsisht ndaj totalit të bizneseve në Kosovë.

²⁵ Kthyer përgjigje me email.

KAPITULLI V: ANALIZA E RIMBURSIMIT TË TVSH-SË, KRAHASIM SHQIPËRI-KOSOVË

5.1 Kuadri ligjor për rimbursimin në Shqipëri

Sipas nenit 77 të ligjit 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, një person i tatueshëm kërkon rimbursim të tepricës së kreditimit tatimor të TVSH-së nëse plotëson disa kritere.

- Kriteri i parë është që personi i tatueshëm duhet të ketë mbartur tepricën e TVSH-së së zbritshme për 3 muaj radhazi sipas specifikimeve ligjore konform këtij ligji.
- Kriteri i dytë është që TVSH-ja e kërkuar për t’u rimbursuar tejkalon shumën prej 400 000 (katërqind mijë) lekësh.

Ligji i mësipërm specifikon më tej: Për rastet kur në marrëveshjet financiare të ratifikuara nga Kuvendi ose në marrëveshjet e granteve të miratuara nga Këshilli i Ministrave parashikohet mospërdorimi i burimeve financiare të huaja për të paguar taksa e tatime, duke përfshirë ose jo tatimin mbi vlerën e shtuar, tatimi mbi vlerën e shtuar i paguar u rimbursohet financuesve të huaj nga sistemi i thesarit, brenda 30 ditëve, sipas rregullave të caktuara nga Ministri i Financave. Ndërsa tatimi mbi vlerën e shtuar për importimin e materialeve ushtarake për Forcat e Armatosura, të dhuruara nga vendet anëtare të Aleancës së NATO-s apo partnerët, paguhet si kosto lokale nga Ministria e Mbrojtjes.

Përsa i përket eksportuesve, ata kanë të drejtë të kërkojnë rimbursim kur teprica e tyre tejkalon shumën 400 000 (katërqind mijë) lekë, sipas pikës 4 të nenit 77. Kategoria e eksportuesve përcaktohet nga Këshilli i Ministrave.

Periudha gjatë së cilës, drejtoria rajonale e tatimeve verifikon situatën tatimore të personit tatimpagues që kërkon rimbursimin është brenda 30 ditëve nga nga data e paraqitjes së

kërkesës së tatimpaguesve eksportues dhe brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së tatimpaguesit. Gjithashtu drejtoria ushtron kontroll bazuar në analizën e riskut dhe miraton tepricën kreditore si të rimbursueshme. Në qoftë se kërkesa miratohet, pagesa kryhet brenda 5 ditëve nga miratimi, nëpërmjet sistemit të thesarit.

Në vendet e zhvilluara rimbursimet paguhen në përgjithësi brenda katër javësh nga marrja e një kërkesë për rimbursim, (Harrison & Krellove, 2005:5). Ndërsa për vendet në zhvillim dhe në tranzicion, autorët pohojnë se situata është e ndryshme, ku koha shkon në disa muaj dhe ndonjëherë më shumë se një vit, për të përpunuar pretendimet e rimbursimit.

Në rubrikën e rimbursimit, në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të tatimeve të RSH, cilësohet se tatimpaguesit eksportues ose personat e tatueshëm që riekportojnë mallrat joshqiptare nën regjimin e përpunimit aktiv në Republikën e Shqipërisë, rimbursohen automatikisht brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim të TVSH-së, si persona me risk zero në qoftë se plotësojnë këto kushte:

- Vlera e eksporteve të kryera në periudhën ose periudhat tatimore, për të cilën ose për të cilat kërkohet rimbursim, është më shumë se 70% e vlerës së përgjithshme të shitjeve, përfshirë eksportet;
- Kanë aktivitet eksportues mbi 1 vit;
- Paraqesin si dokument prove të kryerjes së eksportit deklaratën doganore të eksportit, lëshuar sipas legjislacionit doganor në Republikën e Shqipërisë.
- Nuk kanë detyrime të papaguara të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Neni 33 i Udhëzimit Nr. 6, Datë 30.01.2015, “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” përcakton rregulla të përgjithshme për rimbursimin e shpenzimeve që nuk përfshihen në vlerën e tatueshme.

Për qëllime të ushtrimit të së drejtës për rimbursim të TVSH-së për qëllime të nenit 49 për “Procedurat e rimbursimit për mallrat në bagazhin personal të udhëtarit”, konsiderohen si eksporte mallrat e eksportuara në bagazhin personal të udhëtarit, vlera totale e të cilave përfshirë TVSH-në nuk është më e vogël se 120 000 (njëqind e njëzet mijë) lekë. Sipas pikës 3, të nenit 49 të Udhëzimit Nr. 6, Datë 30.01.2015, “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”: Një person konsiderohet udhëtar jo i vendosur brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, nëse vërtetohet se banesa e përhershme apo rezidenca e tij e zakonshme nuk ndodhet brenda këtij territori.

Në bazë të Nenit 49, Udhëzimi Nr. 6, Datë 30.01.2015, “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, Autoriteti tatimor nëpërmjet Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve brenda 30 ditëve nga data e marrjes së aplikimit verifikon aplikimin për rimbursim nëse janë plotësuar të gjitha kushtet, procedurat dhe dokumentacioni i kërkuar sipas këtij neni dhe nëse po, urdhëron rimbursimin e shumës së TVSH-së në llogarinë bankare të udhëtarit të shënuar në formularin e dërguar. Neni 63 i udhëzimit të mësipërm trajton specifikimet për rimbursimin e marrëveshjeve financiare.

5.2 Kuadri ligjor për rimbursimin në Kosovë

Sipas nenit 40 të ligjit Nr. 05/L -037 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar” për Republikën e Kosovës, personi i tatueshëm mund të kërkojë rimbursimin e TVSH-së nëse për tre muaj radhazi është në kreditim dhe në fund të muajit të tretë shuma e kreditimit të TVSH-së kalon vlerën prej tremijë euro (3000 €), si dhe nëse janë dorëzuar të gjitha deklaratat e

TVSH-së dhe tatimeve tjera për të gjitha periudhat tatimore të kaluara. Eksportuesit mund të kërkojnë rimbursimin e TVSh-së pas secilës periudhë tatimore, me kusht që të plotësohen disa kushte specifike. Së pari shuma e kreditit duhet të tejkalojë shumën tremijë euro (3000€) në fund të periudhës tatimore. Së dyti personi i tatueshëm duhet të ketë të përmbushur të gjitha dispozitat e aplikueshme doganore dhe të TVSH-së dhe së fundmi sikur për personat e tjerë tatimpagues, eksportuesit duhet të kenë dorëzuar të gjitha deklaratat e TVSh-së dhe deklaratat e tjera tatimore për të gjitha periudhat e kaluara.

Nga 01.01.2017, në Kosovë është mundësuar edhe rimbursimi i TVSh-së për mallrat në bagazhin personal të udhëtarëve, me kusht që vlera totale e furnizimit përfshirë TVSh-në është më e madhe se 175€ (njëqind e shtatëdhjetë e pesë) euro, (Deloitte, 2015). Më tej sqarohet se këto mallra duhet të transferohen jashtë Kosovës jo më vonë se 90 ditë kalendarike pas datës së shënuar në faturën origjinale të blerjes së mallit. Udhëtarit të tillë i kërkohet të dëshmojë se banesa e përhershme apo rezidenca e tij e zakonshme ndodhet jashtë Kosovës.

5.3 Rimbursimi i TVSH-së dhe mundësitë për mashtrime e evasion fiskal

(Keen & Smith, 2007:7) pohojnë se në qendër të TVSH-së është mekanizmi i rimbursimit. Personat e tatueshëm për plotësimin e aktivitetit të tyre ekonomik realizojnë blerje dhe furnizime të ndryshme, disa prej të cilave mund të jenë edhe më TVSH. Përveç librit të blerjeve pjesë e deklarimeve të detyrueshme për një biznes me xhiro mbi dy milion lekë (sipas ndryshimeve të vitit 2018 për Shqipërinë), është edhe libri i shitjeve. Në qoftë se totali i TVSH-së së llogaritur në shitje është më i vogël se totali i TVSH-së së zbritshme (për blerjet), kemi tepriçë të TVSH-së së zbritshme për muajin. Kjo do të thotë se përveç faktit që biznesi për periudhën në fjalë (e cila është mujore), nuk ka detyrim për të paguar

TVSH-në shtetit, biznesi gjithashtu akumulon TVSH në llogaritë e përgjithshme kontabël, e cila mund t'i shërbejë në periudha të mëvonshme, kur totali i TVSH-së së llogaritur në shitje do të jetë më i madh se totali i TVSH-së së zbritshme sipas librit të blerjeve. Duke pasur parasysh mekanizmin e funksionimit të kësaj skeme, ekziston mundësia e mashtrimeve nga bizneset, duke krijuar fatura “të rreme”, të cilat nuk janë reale, për qëllim të përfitimit të diferencës së TVSH-së. Kjo është përgjegjësi e Administratës Tatimore, e cila nëse kryen me efektivitet punën e saj, mundet edhe të parandalojë këto raste. Në qoftë se kryhen kontrolle të vazhdueshme për gjendjen e inventarit dhe lëvizjet e tij nga blerjet dhe pastaj tek shitjet mund të arrihen rezultate të suksesshme dhe efektive. Por cilësia e këtyre kontrolleve varet nga shumë faktorë, duke filluar nga numri i punonjësve të administratës tatimore, faktorë të brendshëm e të jashtëm etj.

(Tait, 1988:307),²⁶ raporton se 44 për qind e të gjitha mashtrimeve të TVSH-së në Hollandë vjen nga kërkesat e rreme për TVSH-në e paguar në periudhat e mëparshme duke paraqitur fatura të fallsifikuara për blerjet joekzistente ose të ekzagjeruara.

5.3.1 TVSH-ja dhe mundësitë për mashtrime e evasion fiskal

TVSH-ja krijon mundësinë e shmangies së këtij detyrimi në forma të ndryshme. Një mënyrë që përdoret është raportimi më i ulët i shitjeve, duke realizuar shitje pa fatura të rregullta tatimore e duke manovruar me llogaritjet kontabël sipas përfitimeve të përbashkëta ndërmjet klientëve dhe furnitorëve. Klientëve mund t'u ofrohet zbritje çmimit për njësi e favore të tjera në sajë të marrëveshjeve fitimprurëse. Mallrat dhe shërbimet përdoren jo vetëm nga personat juridikë, por dhe nga individët e thjeshtë. Për këto të fundit

²⁶ Marrë nga: *Keen M. & Smith S. (2007). VAT Fraud and Evasion: What Do We Know, and What Can be Done? Working Paper 07/31, International Monetary Fund, Washington, DC, 9.*

akumulimi i TVSH-së nuk ju shërben për asgjë, kështu që këtyre mund të mos ju interesojë shumë marrja e një fature të rregullt tatimore. Për të shmangur këtë, ligji ka ngarkuar me përgjegjësi jo vetëm shitësin, por edhe blerësin po ashtu. Në çdo subjekt tregtar përveç specifikimeve të tjera sipas llojit të biznesit, është e detyrueshme që në ambientet e tij të jetë certifikata e regjistrimit të personit të tatueshëm dhe të jetë e vendosur, në një vend të dukshëm për klientin një letër ku shkruhet dhe inkurajohet të tërheqë kuponin tatimor. Ky detyrim vjen në bazë të Ligjit 99/2015 "Për Procedurat Tatimore", i botuar në Fletoren Zyrtare nr. 187, datë 28 Tetor 2015, dhe që ka hyrë në fuqi më 12 Nëntor 2015. Çdo blerësi, person fizik, juridik ose individ, i lind e drejta të mos kryejë transaksionin për vlerën e mallit ose shërbimit të ofruar, nëse shitësi nuk lëshon faturën tatimore ose kuponin tatimor, në përputhje me ligjin. Është përgjegjësi e klientit të tërheqë kuponin tatimor dhe ai gjohet me një vlerë monetare në qoftë se nuk merr kuponin tatimor për shërbimet ose mallrat e furnizuara. Në fund të vitit 2015 është organizuar në Shqipëri një nismë për të ndërgjegjësuar qytetarët që të marrin kuponin tatimor nëpërmjet lotarisë promovionale të kuponit tatimor. Ministria e Financave ka dhënë 511 shpërblime për konsumatorët që kanë ruajtur kuponat tatimor të lëshuar gjatë periudhës 15 Nëntor - 31 Dhjetor 2015, (Ora News, 2015). Për t'u bërë pjesëmarrës në lotarinë e kuponit tatimor konsumatorët duhet të mbledhnin jo më pak se 50 kupona tatimorë, me vlerë totale të të gjithë kuponave jo më të vogël se 5,000 lekë. 511 fituesit kanë marrë një vlerë totale së bashku prej 80 milion lekësh të vjetra, (Ora News, 2015).

Një tendencë tjetër e personave të tatueshëm është prirja e tyre për të mos kapërcyer pragun e regjistrimit të TVSH-së për të shmangur pagesën e tatimit. Këtë e realizojnë nëpërmjet raportimit më të ulët të shitjeve. Të ardhurat e humbura duke vendosur një prag të lartë

mund të jenë të vogla krahasuar me kursimin e shpenzimeve të administratës tatimore ndaj tatimpaguesit (Keen & Smith, 2007:11). Ky pohim ndiqet nga ideja se në qoftë se vendoset një prag i ulët, në tatimin mbi vlerën e shtuar do të përfshihen më shumë biznese dhe do të duhen më shumë kapacitete nga administrata tatimore për kryerjen e kontrolleve dhe mbikëqyerjes financiare.

Gjithashtu (Harrison & Krellove, 2005:5) pohojnë se përhapja e kërkesave mashtruese shpesh përmendet nga zyrtarët e taksave si një arsye kryesore duke vonuar pagesën e rimbursimeve.

5.4 Ndikimi i hapjes ekonomike dhe PBB-së reale në rimbursimin e TVSH-së

(Baunsgaard & Keen, 2005:14) arritën në përfundimin se për vendet me të ardhura të mesme, rimëkëmbja e të ardhurave pas liberalizimit të tregtisë ka qenë rreth 50 cent për çdo dollar të të ardhurave nga taksat tregtare të humbura dhe rikuperimi i të ardhurave ka qenë shumë i dobët në vendet me të ardhura të ulëta.

Në një ekonomi të hapur, vendet lidhen me njëra-tjetrën nëpërmjet importeve dhe eksporteve. Shkalla e hapjes së ekonomisë ndaj ekonomive të tjera është :

$$\text{Shkalla e hapjes së një ekonomie (O)} = \frac{\text{Eksporte} + \text{Importe}}{\text{GDP}}$$

- ✚ Sa më i madh të jetë ky raport, aq më e hapur është ekonomia e një vendi;
- ✚ Vendet me një ekonomi liberale, kanë ekonomi më të hapur;
- ✚ Sa më e madhe të jetë ekonomia e një vendi, aq më e vogël është (O), sepse tregu është i vetëmjaftueshëm.

Rimbursimet pritet të jenë më të larta në ekonomitë me rritje të shpejtë dhe në ekonomitë më të hapura (Legeida & Sologoub, 2003:4). Megjithëse procedurat e rimbursimit të

TVSH-së janë përcaktuar në dispozitat përkatëse ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e TVSH-së dhe zbatimi i këtyre procedurave është detyrim ligjor i organeve tatimore, shpesh këto procedura kthehen në objekt diskutimesh. Bizneset pretendojnë në vijimësi se ka vonesa në përfitim të shumave, ndërsa tatimet në shumë raste kanë gjetur skema abuzimi me miliona euro gjatë procesit të rimbursimit, (Acp.al, 2018). Nisur nga kontradiktat e pretendimeve dhe fakteve reale është konsideruar interesante analiza e rimbursimit të TVSH-së, në kërkim të faktorëve që ndikojnë në nivelin e rimbursimeve në dimension krahasues ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës me ndërtimin e modelit të regresionit të shumës me dy variabla të pavarur. Gjithashtu një arsye tjetër pse është kryer kjo analizë, është se grupet kryesore që përfitojnë nga rimbursimi i TVSH-së janë eksportuesit dhe investitorët, të cilat janë dy grupe potenciale për zhvillimin e një vendi, vlerësuar edhe nga studjuesit e ndryshëm. Gjetjet e kësaj analize mund të jenë objekt hulumtimi për studime më të thelluara në varësi të rezultateve të dy variablave të pavarur tek rimbursimi i TVSH-së në dy shtetet e zgjedhura.

Për të analizuar efektet që kanë treguesi i rritjes ekonomike, i matur nga PBB-ja reale dhe të treguesit të hapjes ekonomike në rimbursimet, në çështjet më poshtë do të ndërtoj modelin e regresionit të shumës. Analiza do të bazohet në dy modele. Modeli i parë do të trajtohet për Shqipërinë me të dhënat ekonomike referuar këtij vendi. Modeli i dytë do të trajtohet për Kosovën me të dhënat përkatëse. Duke qenë se janë marrë në konsideratë dy shtete të ndryshme mund të nxirren edhe konkluzione mbi trendet ekonomike të këtyre dy vendeve. Si do të jetë ndikimi i variablave të pavarur mbi rimbursimin dhe a vërtetohet pohimi i mësipërm për RSH dhe RK vërtetohet në vijim të punimit. Periudha kohore e marrë në shqyrtim për analizë është 2007-2017.

5.4.1 Shkalla e hapjes së ekonomisë për Shqipërinë

Shqipëria aplikon një regjim liberal tregu. Tregtia e jashtme është liberalizuar që në vitin 1990 dhe ndjek standartet e vendosura nga Bashkimi Evropian dhe Organizata Botërore e Tregtisë. Shqipëria është anëtare e OBT-së që prej datës 08 shtator 2000 dhe aplikon regjimin e OBT-së mbi procedurën e liçencimit të importit, (Koha.net, 2018). Gjithashtu (Koha.net, 2018) në këtë publikim shkruan se si rezultat i liberalizimit të tregut dhe procesit të vazhdueshëm të përafrimit të kuadrit rregullator doganor me standartet e sistemit të BE, importi dhe eksporti i mallrave, si rregull i përgjithshëm, nuk varen nga ndonjë autorizim i veçantë. Për më tepër, marrëveshjet bilaterale ose multilaterale mund të vendosin kuota ose kërkesa kontrollesh. Gjithashtu, nevoja për pajisje me liçencë ekziston në rastin e disa mallrave specifike me qarkullim të kufizuar brenda vendit siç janë mallrat ushtarake dhe strategjike, materialet radioaktive, ilaçet etj. Shkalla e hapjes së ekonomisë për Shqipërinë, për periudhën kohore 2007-2017 jepet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 12- Shkalla e hapjes së ekonomisë për Shqipërinë (Vlerat janë në mln lekë)

Viti	Eksportet	Importet	PBB	Shka. Hap. Ekon. (O) %
2007	97,171	376,194	965528	49.0%
2008	112,572	439,894	1080676	51.1%
2009	104,515	428,839	1143936	46.6%
2010	161,548	477,768	1239645	51.6%
2011	196,897	544,004	1300624	57.0%
2012	213,029	528,491	1332811	55.6%
2013	246,397	517,378	1350053	56.6%
2014	255,759	552,281	1395305	57.9%
2015	243,183	544,616	1434307	54.9%
2016	243,498	579,248	1472948	55.9%
2017	272,988	626,178	1551235	58.0%

Burimi : INSTAT (Eksportet, Importe, PBB) & Llogaritje të autorit

Nga të dhënat më sipër shohim se shkalla e hapjes së ekonomisë është më e lartë në vitin 2017, ndërkohë që në vitin 2015 kemi një rënie me 5.18%. Vlera më e ulët është në vitin 2009, konkretisht 46.6%, kjo shihet edhe nga tabela, nga vlerat e ulëta të importeve dhe eksporteve, në krahasim me vitet e tjera. Siç e shohim shkalla e hapjes së ekonomisë përgjithësisht është në rritje, ndonjëherë edhe me luhatje poshtë ose lart, sepse tregu ynë nuk është i mjaftueshëm për të mbuluar të gjitha fushat e mallrave dhe shërbimeve.

5.4.2 Shkalla e hapjes së ekonomisë për Kosovën

Në qershor të vitit 2013, Këshilli i Bashkimit Evropian autorizoi Komisionin Evropian që të nisë negociatat për Marrëveshje të Stabilizim Asocimit (MSA) mes Kosovës dhe BE-së, (Gashi & Pugh, 2015:15). Autorët gjithashtu pohojnë se MSA-ja është një kombinim i dispozitave të cilat pikësëpari sigurojnë liberalizimin e tregtisë në mallra dhe shërbime, ndërsa së dyti kërkon reforma institucionale të nevojshme në mënyrë që Kosova të takohet me rregullat dhe standardet institucionale të BE-së. Më 27 tetor 2015 , në Straburg nënshkruhet Marrëveshja e Stabilizim Asoocimit në mes Kosovës dhe BE-së, (Palokaj & Tuhina, 2016:8). Në vazhdim autorët pohojnë se për herë të parë aplikohet parimi “EU only” ku marrëveshjen e nënshkruajnë përfaqësuesit e institucioneve europiane në vend të përfaqësuesve të secilit shtet anëtar. Me 1 prill të vitit 2016 hyn në fuqi Marrëveshja e Stabilizim Asocimit në mes të Kosovës dhe Bashkimit Evropian, (Palokaj & Tuhina, 2016:5).

Shkalla e hapjes së ekonomisë për Kosovën, për periudhën kohore 2007-2017 jepet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 13- Shkalla e hapjes së ekonomisë për Kosovën (Vlerat janë në Euro)

Viti	Eksporte	Importe	PBB	Shka. Hap. Ekon. (O) %
2007	147,000,000	1,576,000,000	3,393,700,000	50.8%
2008	196,000,000	1,930,000,000	3,882,762,000	54.8%
2009	165,000,000	1,936,000,000	4,069,622,000	51.6%
2010	296,000,000	2,158,000,000	4,401,964,000	55.7%
2011	319,000,000	2,492,000,000	4,814,535,000	58.4%
2012	276,000,000	2,508,000,000	5,058,763,000	55.0%
2013	294,000,000	2,449,000,000	5,326,617,000	51.5%
2014	325,000,000	2,538,000,000	5,567,494,000	51.4%
2015	325,000,000	2,635,000,000	5,807,009,000	51.0%
2016	309,627,000	2,789,486,000	6,070,113,000	51.1%
2017	378,012,000	3,047,205,000	7,000,000,000	48.9%

Burimi : Agjensia e Statistikave të Kosovës & Llogaritje të autorit


Nga të dhënat vëmë re se shkalla më e lartë e hapjes ekonomike është në vitin 2011, ekzaktësisht me 58.4%. Vlera më e ulët është në vitin 2017, ku treguesi i hapjes ekonomike për Kosovën merr vlerën 48.9%. Rritjen më të lartë ky tregues e ka pasur në vitin 2010, me 8% dhe uljen më të madhe e ka pasur në vitin 2013 me 6.4%. Nga viti 2013 deri në vitin 2016, treguesi i hapjes ekonomike luhet rreth vlerës 51%.

5.4.3 Ecuria e PBB-së reale në Shqipëri

Produkti i brendshëm Bruto është një ndër indikatorët e llogarive kombëtare. Ai përfaqëson vlerën totale në para të të gjithë të mirave dhe shërbimeve të prodhuara gjatë një periudhe specifike nga njësitë prodhuese rezidente. Për të matur rritjen ekonomike analizohet PBB-ja e një ekonomie. Për shkak të efektit të treguesit makroekonomik të inflacionit shumë analistë të fushës e masin rritjen ekonomike nëpërmjet ndryshimit vjetor të PBB-së reale dhe ndryshimit në përqindje të PBB për frymë. Rritja e PBB reale tregon se sa shpejt po zgjerohet ekonomia.

Nga viti 2005 në vitin 2008 rritja reale e PBB-së ka qenë me trend rritës. Në vitin 2008 ka shënuar edhe rritjen më të lartë në 7.5% për periudhën e marrë në studim. Në vitin 2009 e ndikuar edhe nga kriza financiare PBB-ja reale ka rënë me 56%. Në vitin 2010 kemi një rimbëkëmbje ekonomike e shprehur edhe në rritjen e PBB-së reale me 24.24%. Nga viti 2011 në vitin 2013 kemi rënie të vazhdueshme të PBB-së reale. Në vitin 2014 rritja reale e PBB-së u rrit nga 0.7% në 2.1% dhe deri në vitin 2017 ka pasur përgjithësisht rritje. Sipas aktiviteteve ekonomike, peshën më të madhe në ekonomi për vitin 2016 vazhdojnë ta zënë Shërbimet me 46.7%, me një rritje vjetore në terma realë me 4.43%. Industria dhe Ndërtimi përbëjnë 21.1% të PBB-së, të cilat janë rritur në terma realë përkatësisht: Industria me 1.34% dhe Ndërtimi me 3.1%. Bujqësia, gjuetia, pyjet dhe peshkimi përbëjnë 19.9% të PBB-së dhe me një rritje me 1.67% në terma realë, (AIDA, 2018). Në figurën e mëposhtme jepet ecuria e rritjes reale të PBB-së:

Figura 13- Ecuria e rritjes reale të Pbb-së në Shqipëri



Burimi: Ministria e Financave RSH (Treguesit makroekonomik) & përshtatje nga autori

5.4.4 Ecuria e PBB-së reale në Kosovë

Mjedisi tregtar në Republikën e Kosovës është duke u shëndërruar ndër më konkurruesit në rajon. Përparësitë e krijuara sikurse janë sistemi tatimor, burimet e bollshme natyrore, regjistrimi i shpejtë dhe efikas i bizneseve, ligjet transparente mbi investimet e huaja, publikimet dhe trajnimet e shumta si dhe shumë avantazhe të tjera e bëjnë Kosovën një mjedis tërheqës dhe të favorshëm për investitorët e huaj.


Republika e Kosovës shquhet si vendi me mundësi të mëdha për investime në Ballkan, pra një arsye e fortë tërheqëse për investitorët ndërkombëtarë si një vend primar për investimet e tyre. Për më tepër sipas publikimit të (ALTAX, 2018), Kosova rënditet e katërta në rajon për kostot më të lira tatimore. Të gjitha këto avantazhe janë premisa për një rritje të PBB-së reale në Kosovë.

Sipas publikimit, rritja reale e PBB-së sipas aktiviteteve ekonomike në aktivitetet financiare dhe të sigurimit është 30.4%, në industrinë përpunuese është 7.4%, në transportin dhe magazinimin është 6.8%, në tregtinë me shumicë dhe pakicë është 5.7%, në afarizmin me pasuritë e patundshme është 4.2%, në industrinë nxjerrëse është 4%, në hotelet dhe restorantet është 3.9%, në bujqësinë, gjuetinë dhe pylltarinë është 3.4% dhe në ndërtimtarinë rritja ka qenë 2.6%, (Telegrafi.com, 2018). Më tej shkruhet se rënie reale kishte në të dhënat e furnizimit me energji elektrike, ujë dhe trajtim të mbeturinave me 22%. Ndërsa, me vlerësimin e tremujorit të katërt, sipas metodologjisë, Agjensia e Statistikave të Kosovës ka dhënë vlerësimin për vitin 2017, i cili mbështetur në shumën e tremujorëve, ka pasur një rritje prej 3.74 për qind, krahasuar me vitin 2016.

Duke krahasuar serinë kohore 2007-2008, ajo që vihet re, sikurse edhe në rastin e Shqipërisë, është viti 2009. Në këtë vit Shqipëria e ndikuar nga kriza financiare, pati një

rënie të PBB-së reale me 56%, ndërsa në Kosovë rënia e PBB-së reale ishte 47.8%. Ndonëse rënia ishte më e ulët se sa Shqipëria, Kosova edhe në vitin 2010 pati rënie të PBB-së reale me 8.3%, ndërsa Shqipëria e tejkaloi krizën më mirë këtë vit, duke shënuar një rritje të PBB-së reale me 24.24%. Ndërkohë që PBB-ja e Kosovës pati luhatje, me ulje dhe ngritje të rritjes reale, Shqipëria për tre vite radhazi pati rënie të këtij treguesi deri në vitin 2013. Në vitin 2014 Kosova ka pasur një rënie të theksuar të PBB-së reale, ndërsa Shqipëria në këtë vit e rifilloi stabilizimin. Në vitet 2015 deri në vitin 2017 vlera e këtij treguesi është luhatur ndërmjet nivelit 3.7% dhe 4.1%. Në figurën e mëposhtme jepet grafikisht ecuria e rritjes reale të PBB-së në Kosovë për serinë kohore 2007-2017:

Figura 14- Ecuria e rritjes reale të PBB-së në Kosovë




Burimi: Banka Qëndrore e Kosovës & përshtatje nga autori

5.4.5 Ecuria e rimbursimeve në Shqipëri

Rimbursimi i TVSH-së për periudhën kohore 2007 deri në vitin 2010 ka pasur vetëm rritje, ku rritja më e madhe shënohet në vitin 2010, konkretisht me 167.6%. Sipas publikimeve të

Ministrisë së Financave të RSH-së, prej totalit të rimbursimit të TVSH-së për vitin 2010, 2101 milionë lekë u rimbursuan me kompensim nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, ndërsa pjesa tjetër nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Në vitet 2012 dhe 2013 kemi pasur rritje të rimbursimeve. Në vitin 2013 u krye edhe rimbursimi për Kurum Internacional në vlerën 3473 milion lekë, detyrim i cili ishte i prapambetur dhe është kryer nga të hyrat e privatizimit të Hec-eve. Në vitet 2014 dhe 2015 kemi pasur rënie të vlerës së rimbursimeve të TVSH-së, ndërsa në vitet 2016 dhe 2017 vlera e rimbursimeve ka qenë në rritje. Në figurën e mëposhtme tregohet grafikisht ecuria e rimbursimit të TVSH-së në Shqipëri për serinë kohore 2007-2017:

Figura 15- Rimbursimi i TVSH-së në Shqipëri (Vlerat janë në milionë lekë)




Burimi: Ministria e Financave RSH & Përshtatje nga autori

5.4.6 Ecuria e rimbursimeve në Kosovë

Për serinë kohore 2007-2017, vlerat e rimbursimit të TVSH-së në Kosovë kanë pësuar luhatje të ndryshme. Në vitin 2008 ka pasur një rritje të ndjeshme të rritjes së vlerës totale

të rimbursimeve, e pasuar me një rënie të vogël në vitin 2009, konkretisht me 8.5%. Në vitet 2010 dhe 2011 vlera e rimbursimit të TVSH-së ka qenë në rritje. Në vitin 2011 rritja ka qenë 31.3%, ndërsa në vitin 2012 ka pasur një rënie me 2.2%, që ndiqet me një rritje prej 19.5% në vitin 2013. Nga viti 2014 deri në vitin 2016, vlera totale e rimbursimit të TVSH-së ka qenë në zbritje. Në vitin 2017 ka pasur një rritje të rimbursimeve me 78.6%. Sipas publikimit të Administratës Tatimore të Kosovës referuar këtij viti, për rimbursime dhe kthime në total janë aprovuar 680,090 kërkesa, ku prej tyre 646 janë për biznese dhe persona fizik, ndërsa pjesa tjetër prej 679,444 është për rimbursimin e kuponëve fiskal, ku vlera totale e rimbursimeve të aprovuara është 52.4 milion euro, prej tyre në xhirollogari janë transferuar për të gjitha llojet e tatimeve mjete në vlerë prej 46.7 milion euro, ndërsa për mbulimin e obligimeve ATK/KP janë transferuar mjete në vlerë prej 5.6 milion euro. Pjesën më të madhe e përfaqëson rimbursimi i TVSH-së në vlerën totale rreth 31.2 milion euro. Ecuria e rimbursimeve të TVSH-së për periudhën kohore 2007-2017 paraqitet në figurën e mëposhtme.

Figura 16- Rimbursimi i TVSH-së në Kosovë (Vlerat janë në Euro)



Burimi: Administrata Tatimore e Kosovës & Përshtatje nga autori

5.5 Analiza e modelit të regresionit të shumës

Në këtë çështje do të përdoret analiza e regresionit të shumës për të studjuar ndikimin e variablave të pavarur tek variabli i varur në bazë të literaturës.

5.5.1 Modeli i rimbursimit për Shqipërinë

Ky model i referohet të dhënave për Shqipërinë për serinë kohore 2007-2017.

Ndërsa si variabla të pavarur nga komponentët ekonomik kam zgjedhur:

Variabël i varur: Rimbursimi i TVSH-së

Variabël i pavarur: Hapja ekonomike

Variabël i pavarur: PBB-ja reale

Nga ky model do të studiojmë hipotezat e mëposhtme:

Hipoteza zero (H_0): Asnjë nga komponentët ekonomik nuk ndikon në rimbursimin e TVSH-së.

Hipoteza alternative (H_a): Të paktën njëri nga komponentët ekonomik ka ndikim në rimbursimin e TVSH-së.

Nënhipotezat e këtij studimi mbështeten në lidhjen që ekziston ndërmjet rimbursimit të TVSH-së dhe variablave të pavarur si më poshtë:

$H_{0,1}$: Hapja ekonomike nuk ka ndikim në rimbursimin e TVSH-së.

$H_{a,1}$: Hapja ekonomike ka ndikim në rimbursimin e TVSH-së.

$H_{0,2}$: PBB-ja reale nuk ka ndikim në rimbursimin e TVSH-së.

$H_{a,2}$: PBB-ja reale ka ndikim në rimbursimin e TVSH-së.

Hipoteza 1: Lidhja ndërmjet hapjes ekonomike dhe rimbursimit të TVSH-së pritet të jetë një lidhje e drejtë. Rimbursimet pritet të jenë më të larta në ekonomitë me rritje të shpejtë dhe në ekonomitë më të hapura (Legeida & Sologoub, 2003:4).

Hipoteza 2: Lidhja ndërmjet PBB-së reale dhe rimbursimit të TVSH-së pritet të jetë një lidhje pozitive. Identifikimi i lidhjes jepet nga pohimi i autorëve të mësipërm.

5.5.1.1 Modeli 1 - Analiza OLS me nivel rëndësie 5%

Tabela 14- Modeli 1, Analiza OLS, Vëzhgimet 2007-2017 (T=11)
Variabël i varur: Rimbursimet e TVSH-së (Rasti i Shqipërisë)

	<i>Coefficient</i>	<i>Std. Error</i>	<i>t-ratio</i>	<i>p-value</i>	
const	-29895	13346.2	-2.2400	0.05543	*
Hapja e ekonomisë	70651.7	22791.3	3.0999	0.01467	**
PBB Reale	-30761	45399.1	-0.6776	0.51716	

Mean dependent var	7321.055	S.D. dependent var	3668.156
Sum squared resid	39780199	S.E. of regression	2229.916
R-squared	0.704354	Adjusted R-squared	0.630443
F(2, 8)	9.529712	P-value(F)	0.007640
Log-likelihood	-98.66374	Akaike criterion	203.3275
Schwarz criterion	204.5212	Hannan-Quinn	202.5750
rho	0.003198	Durbin-Watson	1.580011

* tregues të rëndësishëm në nivel rëndësie 10%

** tregues të rëndësishëm në nivel rëndësie 5%

*** tregues të rëndësishëm në nivel rëndësie 1%.

Burimi: Llogaritje të autorit

Siç e shohim nga analiza OLS, për modelin me 11 vëzhgime gjithsej, kemi një $R^2 = 70.43\%$, ose e thënë ndryshe 70.43% e variacionit të rimbursimit të TVSH-së, shpjegohet me variablat e hapjes ekonomike dhe PBB-së reale. Variabli ‘Hapja e ekonomisë’ është statistikisht domëthënës në nivelin e rëndësisë 5%. Ndërsa variabli ‘PBB reale’ ka një vlerë ‘p’ të lartë dhe nuk ka rezultuar domëthënës për modelin.

Për vlera të p-së (niveli i vrojtuar i rëndësisë) më të mëdha se 0.05 ndikimi i variablit të pavarur mbi variablin e varur është i parëndësishëm në kushtet kur variablat e tjerë mbeten të pandryshuar në ekuacion dhe për vlera të p-së më të vogla se 0.05 hipoteza

zero mbi mungesën e lidhjes do të refuzohet, pra lidhja midis variablave është e rëndësishme. Analizojmë me rradhë të gjitha hipotezat e studimit sipas vlerës së p-së:

H_{0,1}: Hapja ekonomike nuk ka ndikim në rimbursimin e TVSH-së.

H_{a,1}: Hapja ekonomike ka ndikim në rimbursimin e TVSH-së.

Vlera e ‘p’ e variablit ‘Hapja ekonomike’ është 0.01467, që do të thotë më e vogël se 0.05 dhe për rrjedhojë bie hipoteza zero e vërtetohet hipoteza alternative, d.m.th. hapja ekonomike ka ndikim në rimbursimin e TVSH-së dhe ky variabël duhet të qëndrojë në model.

H_{0,2}: PBB-ja reale nuk ka ndikim në rimbursimin e TVSH-së.

H_{a,2}: PBB-ja reale ka ndikim në rimbursimin e TVSH-së.

Nga model i mësipërm vëmë re një lidhje negative ndërmjet PBB reale dhe rimbursimit të TVSH-së. Kjo është në kundërshtim me pohimin e (Legeida & Sologoub, 2003), të cilët argumentojnë se rimbursimet janë më të larta në ekonomitë me rritje më të madhe ekonomike.

Vlera e ‘p’ e variablit PBB reale është 0.51716, që do të thotë më e madhe se 0.05 dhe për rrjedhojë vërtetohet hipoteza zero, që do të thotë sipas këtij modeli ndryshimi i PBB reale nuk ka ndikim në rimbursimin e TVSH-së. Nga ky përfundim ky variabël duhet të largohet nga modeli.

Tabela 15- Përmbledhje e rezultateve për Grupin e parë të hipotezave, rasti i Shqipërisë

Nr.	Përshkrimi i hipotezës	Rezultati
1	Hapja ekonomike ka ndikim në rimbursimin e TVSH-së në Shqipëri.	Pranohet
2	PBB-ja reale ka ndikim në rimbursimin e TVSH-së në Shqipëri.	Refuzohet

Burimi: Llogaritje të autorit

5.5.1.2 Modeli 1 i përmirësuar - Analizë OLS me nivel rëndësie 5%

Kryejmë edhe njëherë analizën për modelin e përmirësuar duke larguar variablin ‘PBB reale’ dhe konkretisht përfitohet modeli i mëposhtëm:

**Tabela 16- Modeli 1 i përmirësuar, Analiza OLS, Vëzhgimet 2007-2017 (T=11)
Variabël i varur: Rimbursimi i TVSH-së (Rasti i Shqipërisë)**

	<i>Coefficient</i>	<i>Std. Error</i>	<i>t-ratio</i>	<i>p-value</i>	
const	-35857.4	9728.03	-3.6860	0.00503	***
Hapja ekonomike	79691.8	17914.1	4.4486	0.00160	***

Mean dependent var	7321.055	S.D. dependent var	3668.156
Sum squared resid	42063082	S.E. of regression	2161.869
R-squared	0.687388	Adjusted R-squared	0.652653
F(1, 9)	19.78969	P-value(F)	0.001604
Log-likelihood	-98.97065	Akaike criterion	201.9413
Schwarz criterion	202.7371	Hannan-Quinn	201.4397
rho	-0.071508	Durbin-Watson	1.773991

* tregues të rëndësishëm në nivel rëndësie 10%

** tregues të rëndësishëm në nivel rëndësie 5%

*** tregues të rëndësishëm në nivel rëndësie 1%.

Burimi: Llogaritje të autorit

Siç e shohim nga analiza OLS, për modelin e përmirësuar me 11 vëzhgime gjithsej, kemi një $R^2 = 68.74\%$, ose e thënë ndryshe 68.74% e variacionit të rimbursimit të TVSH-së shpjegohet nga hapja ekonomike. Variabli ‘Hapja ekonomike’ me modelin e përmirësuar ka rezultuar domethënë në nivelin e rëndësisë 1%. Modeli që përfitohet merr formën siç më poshtë:

$$\text{Rimbursimi i TVSH-së} = 35\,857.4 + 79\,691.8 \text{ Hapja ekonomike}$$

Interpretimi i koeficientave të regresionit:

- Konstantja 35 857.4 konsiderohet si intercepti, e cila tregon mesatarisht rimbursimin e TVSH-së, kur hapja ekonomike merr vlerën 0.

- Koeficienti 79 691.8 pranë variablit ‘Hapja ekonomike’, tregon për një lidhje pozitive ndërmjet hapjes ekonomike dhe rimbursimit të TVSH-së. Pra një rritje prej 1 njësi e hapjes ekonomike sjell një rritje prej 79 691.8 njësi të rimbursimit të TVSH-së. Kjo është në përputhje me pohimin e (Legeida & Sologoub, 2003), të cilët argumentojnë se rimbursimet janë më të larta në ekonomitë më të hapura.

5.5.1.3 Kontrolli individual për koeficientët e regresionit

Për të kryer kontrollin individual të koeficientave të regresionit ndjekim procedurën 5-hapëshe:

1. Hedhja e hipotezës

$H_0: b_1=0$ (Modeli është jo i rëndësishëm)

$H_a: b_1 \neq 0$ (Modeli është i rëndësishëm)

2. Marrim një nivel rëndësie $\alpha=0.05$ (5%).

3. Përcaktimi i statistikes së kontrollit

$t=b-B/sb$ (Shperndarja e Studentit, e cila përdoret për rastet kur madhësia e zgjedhjes është më e vogël se 30)

4. Rregulli për marrjen e vendimit

Kontroll i dyanshëm

$\alpha=0.05$ (5%). $\rightarrow$ Apendixi F $\rightarrow$ Vlera kritike $t_k=2.262$

$df=n-(k+1)=11-(1+1)=9$


ku: α -niveli i rëndësisë

df-shkallët e lirisë

n-madhesia e zgjedhjes (numri i periudhave të marra në studim)

k-numri i variablave të pavarur

Figura 17- Rregulli për marrjen e vendimit, modeli i rimbursimit për Shqipërinë



Burimi: Ilustrim nga autori

5. Marrja e vendimit

Nga analiza e regresionit kemi vlerat: $t_1 = 4.45$

$t_1 = 4.45$ bie në zonën ku H_0 hidhet poshtë, prandaj variabli i hapjes ekonomike nuk largohet nga modeli i regresionit, sepse kontribon në shpjegimin e variacionit të rimbursimit të TVSH-së.

*Nga kjo arrijmë në përfundimin që **modeli është i rëndësishëm me nivel besueshmërie 95%.***

5.5.2 Modeli i rimbursimit për Kosovën

Ky model i referohet të dhënave për Kosovën për serinë kohore 2007-2017.

Variabël i varur: Rimbursimi i TVSH-së

Ndërsa si variabla të pavarur nga komponentët ekonomik kam zgjedhur:

Variabël i pavarur: Hapja ekonomike

Variabël i pavarur: PBB-ja reale

Nga ky model do të studiojmë hipotezat e mëposhtme:

Hipoteza zero (H_0): Asnjë nga komponentët ekonomik nuk ndikon në rimbursimin e TVSH-së.

Hipoteza alternative (H_a): Të paktën njëri nga komponentët ekonomik ka ndikim në rimbursimin e TVSH-së.

Nënhipotezat e këtij studimi mbështetën në lidhjen që ekziston ndërmjet rimbursimit të TVSH-së dhe variablave të pavarur si më poshtë:

$H_{0,1}$: Hapja ekonomike nuk ka ndikim në rimbursimin e TVSH-së.

$H_{a,1}$: Hapja ekonomike ka ndikim në rimbursimin e TVSH-së.

$H_{0,2}$: PBB-ja reale nuk ka ndikim në rimbursimin e TVSH-së.

$H_{a,2}$: PBB-ja reale ka ndikim në rimbursimin e TVSH-së.

Sikurse edhe në modelin e Shqipërisë literatura referuese mbetet e njëjta, më poshtë jepen pritshmëritë për lidhjet:

Hipoteza 1: Lidhja ndërmjet hapjes ekonomike dhe rimbursimit të TVSH-së pritet të jetë një lidhje e drejtë. Rimbursimet pritet të jenë më të larta në ekonomitë me rritje të shpejtë dhe në ekonomitë më të hapura (Legeida & Sologoub, 2003:4).

Hipoteza 2: Lidhja ndërmjet PBB-së reale dhe rimbursimit të TVSH-së pritet të jetë një lidhje pozitive. Identifikimi i lidhjes jepet nga pohimi i autorëve të mësipërm.

5.5.2.1 Modeli 2 - Analiza OLS me nivel rëndësie 5%

Tabela 17- Modeli 2, Analiza OLS, Vëzhgimet 2007-2017 (T=11)
Variabël i varur: Rimbursimet e TVSH-së (Rasti i Kosovës)

	<i>Coefficient</i>	<i>Std. Error</i>	<i>t-ratio</i>	<i>p-value</i>	
const	22.0363	35.9769	0.6125	0.55720	
Hapja ekonomike	24.6269	68.4192	0.3599	0.72821	
PBB Reale	-299.804	123.577	-2.4260	0.04146	**

Mean dependent var	23.08818	S.D. dependent var	7.139434
Sum squared resid	293.3708	S.E. of regression	6.055687
R-squared	0.424442	Adjusted R-squared	0.280552
F(2, 8)	2.949775	P-value(F)	0.109738
Log-likelihood	-33.66780	Akaike criterion	73.33561
Schwarz criterion	74.52929	Hannan-Quinn	72.58316
rho	-0.476963	Durbin-Watson	2.322838

* tregues të rëndësishëm në nivel rëndësie 10%

** tregues të rëndësishëm në nivel rëndësie 5%

*** tregues të rëndësishëm në nivel rëndësie 1%.

Burimi: Llogaritje të autorit

Siç e shohim nga analiza OLS, për modelin me 11 vëzhgime gjithsej, kemi një $R^2 = 42.44\%$, ose e thënë ndryshe 42.44% e variacionit të rimbursimit të TVSH-së, shpjegohet me variablat e hapjes ekonomike dhe PBB-së reale. Kjo vlerë është shumë më e ulët krahasuar me rastin e Shqipërisë. Variabli ‘Hapja e ekonomisë’ ka një vlerë ‘p’ të lartë dhe nuk ka rezultuar domethënëse për modelin për rastin e Kosovës. Ky përfundim është i ndryshëm nga rasti i Shqipërisë, në të cilën hapja ekonomike ka rezultuar statistikisht domethënëse në nivelin e rëndësisë 5% në modelin e parë dhe statistikisht domethënëse në nivelin e rëndësisë 1% në modelin e përmirësuar.

Ndërsa variabli ‘PBB reale’ është statistikisht domethënëse në nivelin e rëndësisë 5%. Edhe për këtë variabël kemi marrë një përfundim krejtësisht të ndryshëm për rastin e Shqipërisë, ky rezultoi se PBB-ja reale nuk ka ndikim në vlerat e rimbursimit të TVSH-së.

Për vlera të p-së (niveli i vërtetuar i rëndësisë) më të mëdha se 0.05 ndikimi i variablit të pavarur mbi variablin e varur është i parëndësishëm në kushtet kur variablat e tjerë mbeten të pandryshuar në ekuacion dhe për vlera të p-së më të vogla se 0.05 hipoteza zero mbi mungesën e lidhjes do të refuzohet, pra lidhja midis variablave është e rëndësishme. Analizojmë me rradhë të gjitha hipotezat e studimit sipas vlerës së p-së:

H_{0,1}: Hapja ekonomike nuk ka ndikim në rimbursimin e TVSH-së.

H_{a,1}: Hapja ekonomike ka ndikim në rimbursimin e TVSH-së.

Nga model i mësipërm vëmë re një lidhje pozitive ndërmjet hapjes ekonomike dhe rimbursimit të TVSH-së. Vlera e 'p' e variablit 'Hapja ekonomike' është 0.72821, që do të thotë më e madhe se 0.05 dhe për rrjedhojë vërtetohet hipoteza zero, që do të thotë sipas këtij modeli ndryshimi i vlerës së hapjes ekonomike nuk ka ndikim në rimbursimin e TVSH-së. Nga ky përfundim ky variabël duhet të largohet nga modeli. Lidhja pozitive ndërmjet hapjes ekonomike dhe rimbursimit të TVSH-së është në përputhje me pohimin e (Legeida & Sologoub, 2003), të cilët argumentojnë se rimbursimet janë më të larta në ekonominë më të hapura, por ky variabël nuk ka rezultuar domethënës për rastin e Kosovës.

H_{0,2}: PBB-ja reale nuk ka ndikim në rimbursimin e TVSH-së.

H_{a,2}: PBB-ja reale ka ndikim në rimbursimin e TVSH-së.

Vlera e 'p' e variablit 'PBB reale' është 0.04146, që do të thotë më e vogël se 0.05 dhe për rrjedhojë bie hipoteza zero e vërtetohet hipoteza alternative, d.m.th. PBB-ja reale ka ndikim në rimbursimin e TVSH-së dhe ky variabël duhet të qëndrojë në model.

Tabela 18- Përmbledhje e rezultateve për Grupin e parë të hipotezave, Rasti i Kosovës

Nr.	Përshkrimi i hipotezës	Rezultati
1	Hapja ekonomike ka ndikim në rimbursimin e TVSH-së në Kosovë	Refuzohet
2	PBB-ja reale ka ndikim në rimbursimin e TVSH-së në Kosovë	Pranohet

Burimi: Llogaritje të autorit

5.5.2.2 Modeli 2 i përmirësuar - Analizë OLS me nivel rëndësie 5%

Kryejmë edhe njëherë analizën për modelin e përmirësuar duke larguar variablin 'Hapja ekonomike' dhe konkretisht përfitohet modeli i mëposhtëm:

**Tabela 19- Modeli 2 i përmirësuar, Analiza OLS, Vëzhgimet 2007-2017 (T=11)
Variabël e varur: Rimbursimi i TVSH-së (Rasti i Kosovës)**

	<i>Coefficient</i>	<i>Std. Error</i>	<i>t-ratio</i>	<i>p-value</i>	
const	34.8485	4.96617	7.0172	0.00006	***
PBB_Reale	-295.351	116.859	-2.5274	0.03237	**

Mean dependent var	23.08818	S.D. dependent var	7.139434
Sum squared resid	298.1218	S.E. of regression	5.755402
R-squared	0.415121	Adjusted R-squared	0.350134
F(1, 9)	6.387791	P-value(F)	0.032373
Log-likelihood	-33.75616	Akaike criterion	71.51232
Schwarz criterion	72.30811	Hannan-Quinn	71.01069
rho	-0.472064	Durbin-Watson	2.389458

* tregues të rëndësishëm në nivel rëndësie 10%

** tregues të rëndësishëm në nivel rëndësie 5%

*** tregues të rëndësishëm në nivel rëndësie 1%.

Burimi: Llogaritje të autorit

Siç e shohim nga analiza OLS, për modelin e përmirësuar me 11 vëzhgime gjithsej, kemi një $R^2 = 41.51\%$, ose e thënë ndryshe 41.51% e variacionit të rimbursimit të TVSH-së shpjegohet nga PBB-ja reale. Variabli ‘PBB reale’ sikurse edhe tek modeli i mëparshëm ka rezultuar domethënë në nivelin e rëndësisë 5%. Modeli që përfitohet merr formën siç më poshtë:

$$\text{Rimbursimi i TVSH-së} = 34.85 - 295.3 \text{ PBB reale}$$

Interpretimi i koeficientave të regresionit:

- Konstantja 34.85 konsiderohet si intercepti, e cila tregon mesatarisht rimbursimin e TVSH-së, kur PBB reale merr vlerën 0.
- Koeficienti -295.3 pranë variablilit ‘PBB reale’, tregon për një lidhje negative ndërmjet PBB-së reale dhe rimbursimit të TVSH-së. Pra një rritje prej 1 njësi e PBB-së reale sjell një rënie prej 295.3 njësi të rimbursimit të TVSH-së. Kjo është në

kundërshtim me pohimin e (Legeida & Sologoub, 2003:4), të cilët argumentojnë se rimbursimet janë më të larta në ekonomitë me rritje më të lartë ekonomike.

5.5.2.3 Kontrolli individual për koeficientët e regresionit

Për të kryer kontrollin individual të koeficientave të regresionit ndjekim procedurën 5-hapëshe:

1. Hedhja e hipotezës

$H_0: b_1=0$ (Modeli është jo i rëndësishëm)

$H_a: b_1 \neq 0$ (Modeli është i rëndësishëm)

2. Marrim një nivel rëndësie $\alpha= 0.05$ (5%).

3. Përcaktimi i statistikes së kontrollit

$t=b-B/sb$ (Shperndarja e Studentit, e cila përdoret për rastet kur madhësia e zgjedhjes është më e vogël se 30)

4. Rregulli për marrjen e vendimit

Kontroll i dyanshëm

$\alpha= 0.05$ (5%). $\rightarrow$ Apendixi F $\rightarrow$ Vlera kritike $t_k= 2.262$

$df= n - (k+1)=11 - (1+1)=9$


ku: α -niveli i rëndësisë

df-shkallët e lirisë

n-madhesia e zgjedhjes (numri i periudhave të marra në studim)

k-numri i variablave të pavarur

Figura 18 - Rregulli për marrjen e vendimit, modeli i rimbursimit për Kosovën



Burimi: Ilustrim nga autori

5. Marrja e vendimit

Nga analiza e regresionit kemi vlerat: $t_1 = -2.53$

$t_1 = -2.53$ bie në zonën ku H_0 hidhet poshtë, prandaj variabli i PBB-së reale nuk largohet nga modeli i regresionit, sepse kontribon në shpjegimin e variacionit të rimbursimit të TVSH-së.

Nga kjo arrijmë në përfundimin që **modeli është i rëndësishëm me nivel besueshmërie 95%.**

KAPITULLI VI: ANALIZË E NDIKIMIT TË FAKTORËVE TË NDRYSHËM TEK TË ARDHURAT E TVSH-SË, RAST ILUSTRUES SHQIPËRIA

6.1 Ecuria e variablave të zgjedhur


Një literaturë e gjërë është shfletuar për t'i dhënë përgjigje pyetjes kërkimore të ngritur në fillim të punimit, në kërkim të faktorëve që ndikojnë në nivelin e të ardhurave të TVSH-së në Shqipëri. Ndërkohë para se të analizojmë gjetjet nga hipotezat e ngritura për rastin e Shqipërisë, jepet një përshkrim i variablave që do të përdoren dhe gjithashtu paraqitet edhe ecuria e tyre ndër vite.

Ecuria e importeve, eksporteve dhe volumit tregtar

Në figurën e mëposhtme paraqitet ecuria e importeve, eksporteve dhe volumit tregtar (shuma e importeve dhe e eksporteve) për serinë kohore 2005-2017 për Republikën e Shqipërisë. Nga viti 2005 deri në vitin 2008 ecuria e importeve ka një trend rritës. Nga viti 2006 në vitin 2007 ka pasur një rritje të importeve me 26% afërsisht. Në vitin 2009 kemi një rënie me 2.5% të importeve që pasohet me një rritje në 11.4% në vitin 2010. Nga 2011 deri në 2013 importet në vlerë janë në rënie deri në vlerën 517 miliardë në 2013. Në vitin 2014 e prapa vlera e importeve përgjithësisht është në rritje. Përsa i përket eksporteve ato kanë njohur rritje nga 2005 deri në vitin 2008, por sikurse importet vlera e tyre në 2009 ka pësuar rënie me 7%. Viti 2010 shënon rritjen me 54% të eksporteve. Kjo ka ardhur si pasojë e rimëkëmbjes së ekonomisë pas krizës financiare të viti 2009. Nga viti 2010 e prapa eksportet kanë pasur një trend rritës, përveç vitit 2015 dhe 2016. Përqindja e mbulimit të eksporteve nga viti 2005 deri në vitin 2008 është luhatur rreth vlerave 25.1% në 25.9%. Në

vitin 2009, që njihet si viti i krizës financiare përqindja e mbulimit u ul në 24.4%. Nga viti 2010 deri në vitin 2013 përqindja e rritjes së eksporteve ka qenë më e lartë se përqindja e rritjes së importeve, ndërsa në vitin 2014 kemi një ulje të përqindjes së mbulimit që vijon deri në vitin 2016, për të vijuar me një rritje me 3.8% në vitin 2017. Volumi tregtar ka qenë në rritje të vazhdueshme. Rëni e këtij treguesi kanë qenë në vitet 2009 dhe në vitin 2015. Në disa vite të dekadës së fundit, Mali i Zi, Maqedonia, Shqipëria importet dhe eksportet në raport me PBB-në kanë qenë të paqëndrueshme, jo vetëm gjatë krizës financiare globale (2008-2009), por edhe në vitet pas saj. Krahasimi mes importeve dhe eksporteve në Ballkanin Perëndimor tregon një deficit të madh tregtar, të cilat janë kompensuar në ekonomi nga efektet e remitancave dhe faktorët pozitivë të balancës së të ardhurave (AL-TAX, 2018).

Figura 19- Ecuria e importeve, eksporteve dhe volumit tregtar (në miliardë)




Burimi: INSTAT, përshtatur nga autori

Në figurën e mësipërme ilustron grafikisht ecuria e importeve, eksporteve dhe volumit tregtar.

Indeksi i hapjes tregtare

Indeksi i hapjes tregtare është trajtuar më gjërësisht në çështjen nr. 5.4.1. Për vendet në zhvillim ky tregues është shumë i rëndësishëm sepse tregon se sa shpejt i përshtaten ideve të reja inovative. Një tregues i lartë është gjithashtu i rëndësishëm për rritje ekonomike. Në figurën e mëposhtme ilustron grafikisht ecuria e indeksit të hapjes tregtare:

Figura 20- Hapja ekonomike



Burimi: INSTAT & llogaritje nga autori

Ecuria e PBB-së për frymë


Një nga treguesit e pasurisë së individëve të një vendi është Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) për frymë, i cili matet si raporti i PBB-së me numrin e popullsisë totale të atij vendi.

PBB për Frymë tregon se sa është aftësia e popullsisë të blejë të mira dhe shërbime në atë vend. Disa studime rajonale tregojnë se Ballkanit në përgjithësi i duhet edhe të paktën 50 vite që të arrijnë nivelin ekonomik të vendeve anëtare të BE, por specifikisht Shqipërisë i duhen më shumë vite, (Monitor, 2017).

Në vitin 2017, të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor përveç Kosovës sipas metodës Atlas të Bankës Botërore, u klasifikuan si vende me të ardhura të nivelit të sipërm të grupit me të ardhura të mesme, (ALTAX, 2018:12). Më tej, ALTAX pohon se kategoria e vendeve me të ardhura të nivelit të sipërm përfshin vendet me të ardhura kombëtare bruto (AKB) për frymë ndërmjet 3,956\$ dhe 12,235\$.

Ecuria e rritjes së PBB-së për frymë ka njohur luhatje të shumta. Në vitet 2005-2009 përqindjen e rritjes më të ulët e ka pasur në 2009, përkatësisht me 4.8%. Në vitin 2010 kemi një rritje të PBB-së për frymë, ndërkohë që në vitin 2012 kemi një rënie drastike nga 7.1% në 3.7%. Në vijim deri në vitin 2016 kjo ka qenë vlera më e lartë e rritjes së treguesit të PBB-së për frymë. Në figurën e mëposhtme ilustruhet grafikisht:

Figura 21- Ecuria e rritjes së PBB-së për frymë



Burimi: Ministria e Financave RSH (Treguesit makroekonomik) & përshtatje nga autori

Ecuria e normës së papunësisë


Shkalla e papunësisë është raporti midis numrit të të papunëve të regjistruar dhe numrit të popullsisë aktive (forcës së punës). Forca e punës përbën pjesën e popullatës e cila është në

moshë pune (në Shqipëri nga mosha 16 deri në moshën e pensionit), dhe është në kërkim të vazhdueshëm për punë. Papunësia e të rinjve kufizon mundësitë për rritjen e standardeve të jetesës dhe rritjen ekonomike në periudhë afatmesme, vlerëson Banka Botërore në një analizë të posaçme për punësimin e të rinjve në rajon, (Monitor, 2016). Rezultatet e dobëta të tregut të punës në 6 vendet e Europës Juglindore Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, dhe Serbia do të kenë pasoja negative, jo vetëm për të rinjtë në rajon, por për rritjen ekonomike, varfërinë dhe përfshirjen sociale në të gjitha nivelet e shoqërisë, vlerëson BB, (Nacional Albania, 2016). Arsyet e papunësisë janë nga më të ndryshmet, por vlen të theksohet se në Shqipëri ndikojnë edhe fakti i punësimit informal, pjesa e popullsisë në emigracion dhe vështirësitë për t'u përfshirë fillimisht në tregun e punës.

Sipas (ALTAX, 2018), Shqipëria ka qenë vendi me performancën më të mirë përse lidhet me indeksin e punësimit, me një normë mesatare papunësie të barabartë me rreth 15 përqind të fuqisë punëtore. Në Shqipëri, shkalla e papunësisë e forcës për punë me arsim bazë është sistematikisht më e ulët se sa shkalla e papunësisë për forcat e punës me arsim të mesëm dhe të lartë.

Norma e papunësisë në Shqipëri nga viti 2005 në vitin 2012 është luhatur rreth vlerave 13% deri në 14%. Në vitin 2013 kemi pasur një rritje nga 13% në 15.6%. Ndërkohë që në vitin 2014 norma është rritur në 17.3%, duke qëndruar në këtë normë edhe për vitin 2015, në vitin 2016 norma e papunësisë ka rënë me 12.1%. Në figurën e mëposhtme paraqitet ecuria e normës së papunësisë në Shqipëri për serinë kohore 2005– 2016:

Figura 22- Ecuria e normës së papunësisë



Burimi: Ministria e Financave RSH (Treguesit makroekonomik) & përshtatje nga autori


Ecuria e konsumit të familjeve

Konsumi i familjeve për serinë kohore 2005- 2016 ka pasur një trend rritës. Në vitin 2007 ka pasur një rritje me 16.58%. Në vitin 2009 sikurse e pamë tek treguesit e tjerë përgjithësisht kishte rënie, përsa i përket konsumit të familjeve nuk kemi rënie, por një rritje më të ulët krahasuar me vitet e tjera paraardhëse, konkretisht 2.9%. Për serinë kohore në studim rritjet më të ulëta ky tregues i ka pasur në vitet 2012 dhe 2015, respektivisht 2.04% dhe 2.40%. Në Anketën e Buxhetit të Familjes të kryer nga (Instat, 2016), konkludohet se shpenzimet mesatare për konsum të Njësisë Ekonomike Familjare (NjEF) tregojnë se në vitin 2016, ka pasur një rritje më të madhe të shpenzimeve të 10 përqindëshit të NjEF me shpenzimet më të larta (14,6%) në krahasim me rritjen e shpenzimeve mesatare për konsum të 90 përqindëshit tjetër (0,6 %) në krahasim me 2015. Si rrjedhim, raporti i decileve në 2016, për këtë tregues, paraqet një rritje të pabarazisë nga 2.2 në 2.5, krahasuar me 2015.²⁷

Në figurën e mëposhtme jepet ecuria e konsumit të familjeve:

²⁷ Decilja përcaktohet si një nga dhjetë grupet e barabarta në të cilat janë ndarë vlerat statistikore të renditura të një variabli, në këtë rast shpenzimet e konsumit.

Figura 23- Ecuria e konsumit të familjeve (në milionë)



Burimi: INSTAT & llogaritje nga autori

Ecuria e rritjes reale të Pbb-së

Ecuria e rritjes reale të PBB-së është trajtuar gjërësisht në çështjen nr. 5.4.3 ngaqë është marrë si variabël i pavarur në modelin e mësipërm.

Ecuria e normës së inflacionit

Inflacioni është një tregues i ndryshimit të nivelit të përgjithshëm të çmimeve në një ekonomi. Inflacioni matet si ndryshimi i Indeksit të çmimeve të konsumit (IÇK), i cili mat ndryshimin e çmimit të një shporte artikujsh që përfaqëson ato mallra që konsumohen zakonisht nga një familje. Në rastin e Shqipërisë, historiku i normave të inflacionit ndahet në tre nënperiudha:

- Para vitit 1991, ku norma e inflacionit ishte 0, për shkak të ekonomisë së centralizuar;


- 1991 – 1998, me norma shumë të larta dhe në disa vite me hiperinflacion (Hiperinflacion përkufizohet si një inflacion i akumuluar për një periudhë 3-vjeçare mbi 100%.);
- Pas vitit 1999, me një inflacion në nivele të ulta, nën kontroll, (Open Data Albania, 2011).

Shqipëria ndjek politika monetare stimuluese që synojnë në mbajtjen në nivele të ulëta të normave të interesit dhe favorizojnë rritjen e kreditimit të ekonomisë. Sipas Bankës së Shqipërisë stimuli monetar do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2018.

Për periudhën 2005- 2008 vlerën më të lartë e shënoi në vitin 2008 në vlerën 3.4%. Në vitin 2009 norma e inflacionit ka rënë me 35.29%. Ndërkohë në vitin 2010 norma e inflacionit u rrit me 59.09%. Në periudhën 2012- 2017 norma e inflacionit ka qenë në nivelët 2% e poshtë, i cili është brenda objektivit të politikës monetare prej 1 - 3 %.

Sipas ALTAX 2018 niveli i inflacionit ka pasur një ecuri sipas trageteve të parashikuara nga Bankat Qendrore vetëm në Shqipëri dhe Serbi. Shqipëria gjatë gjithë këtyre viteve ka rregjistruar inflacionin më të ulët dhe më të qëndrueshëm në rajon. Kosova, Mali i Zi dhe Bosnjë-Hercegovina përjetuan paqëndrueshmëri të konsiderueshme të presionit inflacionist. Në një nivel më të vogël, ky presion ishte i pranishëm edhe në Maqedoni. Kjo do të thotë që ekonomitë e vogla të hapura ndaj tregut global, të cilat kanë hequr dorë nga sovraniteti i tyre monetar, përjetojnë më shumë inflacion të paqëndrueshëm për shkak të karakterit të tij ekzogjen, të nxitur nga tronditjet reale dhe financiare ndaj tregjeve të jashtme dhe ndryshimeve në kurset e këmbimit midis monedhave kryesore. Sidoqoftë, është e drejtë të thuhet që nga 2014-2017, të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor janë në gjendje të konvergojnë në nivele më të larta të inflacionit.

Figura 24- Ecuria e normës së inflacionit




Burimi: Ministria e Financave RSH (Treguesit makroekonomik) & përshtatje nga autori

Ecuria e Shpenzimeve qeveritare

Shpenzimet qeveritare nga viti 2005 deri në vitin 2009 kanë qenë në rritje. Në vitin 2009 kanë pasur një rritje të ulët 8.07% krahasuar me vitet paraardhëse ku rritja ka qenë në nivelet 10.38% - 23.04%. Në vitin 2010 ka pasur rënie të shpenzimeve me 4.5%. Nga viti 2011 deri në vitin 2014 shpenzimet kanë qenë përgjithësisht në rritje. Në vitet 2015 dhe 2016 rënia në shpenzimet qeveritare ka qenë relativisht e ulët, respektivisht 0.33% dhe 0.85%, vlera të cilat ndiqen nga një rritje 6.39% në vitin 2017.

Figura 25- Ecuria e Shpenzimeve qeveritare (në miliardë)



Burimi: Ministria e Financave RSH, përshtatje nga autori

6.2 Modelet ekonometrike

Përdorimi i teknikës statistikore siç është modeli i regresionit shumë, shërben për të modeluar lidhjen që ekziston në mes dy ose më shumë variabla shpjegues, të konsideruar si variabla të pavarur, dhe një variabli të varur. Çdo vlerë e variablit të pavarur x , është e lidhur me një vlerë të variablit të varur y . Formalisht, modeli i regresionit linear të shumëfishtë, duke pasur parasysh n vëzhgime, është:

$$Y_i = \beta_0 + \beta_1 X_{i1} + \beta_2 X_{i2} + \dots + \beta_p X_{ip} + \text{për } i=1,2,\dots,n.$$

6.2.1 Modeli 1: TA nga TVSH-ja & Tregtia nderkombëtare

Ky model i referohet të dhënave për Shqipërinë për serinë kohore 2005-2017.

Variabël i varur: Të ardhurat nga Tvsh-ja

Ndërsa si variabla të pavarur nga komponentët e tregtisë ndërkombëtare kam zgjedhur:

Variabël i pavarur: Hapja ekonomike

Variabël i pavarur: Rritja e importeve në përqindje

Variabël i pavarur: Rritja e eksporteve në përqindje

Variabël i pavarur: Volumi tregtar

Nga ky model do të studiojmë hipotezat e mëposhtme:

Hipoteza zero (H_0): Asnjë nga komponentët e tregtisë ndërkombëtare nuk ndikon në të ardhurat e Tvsh-së.

Hipoteza alternative (H_a): Të paktën njëri nga komponentët e tregtisë ndërkombëtare ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

Nënhipotezat e këtij studimi mbështeten në lidhjen që ekziston ndërmjet të ardhurave të Tvsh-së dhe variablave të pavarur si më poshtë:

$H_{0,1}$: Hapja ekonomike nuk ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

$H_{a,1}$: Hapja ekonomike ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

$H_{0,2}$: Rritja e importeve nuk ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

$H_{a,2}$: Rritja e importeve ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

$H_{0,3}$: Rritja e eksporteve nuk ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

$H_{a,3}$: Rritja e eksporteve ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

$H_{0,4}$: Volumi tregtar nuk ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

$H_{a,4}$: Volumi tregtar ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

6.2.1.1 Hedhja e hipotezave dhe lidhjet teorike

Hipoteza I: Lidhja ndërmjet hapjes ekonomike dhe të ardhurave të Tvsh-së pritet të jetë një lidhje e drejtë. Godin & Hindriks (2015) theksojnë se hapja e tregtisë, matur si shuma e eksporteve dhe importeve e pjesëtuar me PBB-në ka një ndikim pozitiv në mbledhjen e taksave dhe tatimeve për mallra dhe shërbime²⁸. Ata argumentojnë se pritet që është më e

²⁸ Marrë nga: Da Silva C.S.F., (2016), The determinants of value added tax revenues in Portugal. Tezë Masteri: Lisboa School of Economics & Management, fq. 14.

lehtë për tatimin e artikujve kur arrijnë në kufi, duke marrë parasysh edhe pjesën doganore. Gjithashtu (Azaria & Robinson, 2005:73) kanë arritur në rezultatin se hapja e tregtisë ka një ndikim pozitiv në të ardhurat totale tatimore.

Hipoteza 2: Lidhja ndërmjet importeve dhe të ardhurave të Tvsh-së pritet të jetë një lidhje e drejtë. Ebrill (2001) arriti në konkluzionin se mesatarisht 55% e të ardhurave të TVSH-së mbliidhen në importe²⁹. (Bikas & Andruskaite, 2013:48) gjetën një marrëdhënie pozitive midis importeve dhe të ardhurave nga Tvsh-ja.

Hipoteza 3: Lidhja ndërmjet eksporteve dhe të ardhurave nga Tvsh-ja pritet të jetë e zhdrejtë. (Bikas & Andruskaite, 2013:45) gjetën një marrëdhënie negative mes eksporteve dhe të ardhurat nga Tvsh-ja.

Hipoteza 4: Lidhja ndërmjet volumit tregtar dhe të ardhurave nga Tvsh-ja pritet të jetë një lidhje e drejtë. (Wawire, 2011:32-33) pohon se ekzistojnë marrëdhënie pozitive midis tregtisë ndërkombëtare dhe të ardhurave të Tvsh-së, gjithashtu të ardhurat e Tvsh-së mund të rriten përmes zgjerimit të tregtisë ndërkombëtare.

Tabela 20- Statistikat përshkruese të të dhënave (të dhënat në miliardë)

Variabli	Mean	Minimum	Maksimum	C.V.
Ta nga TVSH-ja	109.769	65	140	0.19953
Hapja Ekonomike	0.52308	0.41	0.58	0.11021
Importe	475	262	626	0.23004
Eksporte	176.231	66	273	0.4298
Volumi Tregtar	65.1308	32.8009	89.9166	0.27974

Burimi: Llogaritje të autorit

²⁹ Marrë nga: Da Silva C.S.F., (2016), The determinants of value added tax revenues in Portugal. Tezë Masteri: Lisboa School of Economics & Management, fq. 14.

6.2.1.2 Analiza OLS me nivel rëndësie 10%

Tabela 21- Modeli 1, Analiza OLS, Vëzhgimet 2005-2017 (T=13)
Variabël i varur: TA nga Tvsh-ja

	<i>Coefficient</i>	<i>Std. Error</i>	<i>t-ratio</i>	<i>p-value</i>	
Const	49.4462	14.1037	3.5059	0.00801	***
Hapja_Ekonomike	-130.652	43.9027	-2.9759	0.01771	**
Importe	3.90238	1.64023	2.3792	0.04460	**
Eksporte	3.59591	1.67114	2.1518	0.06360	*
Volumi_Tregtar	-36.2144	16.5447	-2.1889	0.06003	*

Mean dependent var	109.7692	S.D. dependent var	21.90188
Sum squared resid	41.24356	S.E. of regression	2.270560
R-squared	0.992835	Adjusted R-squared	0.989253
F(4, 8)	277.1373	P-value(F)	1.31e-08
Log-likelihood	-25.95075	Akaike criterion	61.90149
Schwarz criterion	64.72624	Hannan-Quinn	61.32088
Rho	0.153785	Durbin-Watson	1.442250

* tregues të rëndësishëm në nivel rëndësie 10%

** tregues të rëndësishëm në nivel rëndësie 5%

*** tregues të rëndësishëm në nivel rëndësie 1%.

Burimi: Llogaritje të autorit

Siç e shohim nga analiza OLS, për modelin me 13 vëzhgime gjithsej, kemi një $R^2 = 99.28\%$, ose e thënë ndryshe 99.28% e variacionit të të ardhurave të Tvsh-së, shpjegohet me variablat e zgjedhur më lart. Variablat hapja ekonomike dhe importet janë statistikisht domëthënës në nivelin e rëndësisë 5% . Ndërsa dy variablat e tjerë: eksportet dhe volumi tregtar kanë rezultuar statistikisht domëthënës në nivelin 10% të rëndësisë. Modeli që përfitohet nga analiza e mësipërme merr formën siç më poshtë:

$$\text{TA nga Tvsh-ja} = 49.45 - 130.65 \text{ H. E.} + 3.90 \text{ Imp} + 3.59 \text{ Eks} - 36.21 \text{ V.T.}$$

Konstantja 49.45 konsiderohet si intercepti, e cila tregon mesatarisht të ardhurat e Tvsh-së, kur variablat e tjerë marrin vlerën 0.

Për vlera të p-së (niveli i vrojtuar i rëndësisë) më të mëdha se 0.1 ndikimi i variablit të pavarur mbi variablin e varur është i parëndësishëm në kushtet kur variablat e tjerë mbeten të pandryshuar në ekuacion dhe për vlera të p-së më të vogla se 0.1 hipoteza zero mbi mungesën e lidhjes do të refuzohet, pra lidhja midis variablave është e rëndësishme. Analizojmë me rradhë të gjitha hipotezat e studimit sipas vlerës së p-së:

H_{0,1}: Hapja ekonomike nuk ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

H_{a,1}: Hapja ekonomike ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

Koeficienti -130.65 pranë variablit 'Hapja ekonomike', tregon për një lidhje negative ndërmjet hapjes ekonomike dhe të ardhurave nga Tvsh-ja. Pra një rritje prej 1 njësi e hapjes ekonomike sjell një rënie prej 130.65 njësi të të ardhurave nga Tvsh-ja. Ky përfundim është në kundërshtim me rezultatet e (Godin & Hindriks, 2015), të cilët theksojnë se hapja e tregtisë ka një ndikim pozitiv në mbledhjen e taksave dhe tatimeve për mallra dhe shërbime. Gjithashtu lidhja negative që ka rezultuar është në kundërshtim edhe me rezultatet e (Azaria & Robinson, 2005), të cilët kanë arritur në rezultatin se hapja e tregtisë ka një ndikim pozitiv në të ardhurat totale tatimore.

Vlera e 'p' e variablit hapja ekonomike është 0.01771, që do të thotë më e vogël se 0.1 dhe për rrjedhojë bie hipoteza zero e vërtetohet hipoteza alternative, d.m.th. hapja ekonomike ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

H_{0,2}: Rritja e importeve nuk ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

H_{a,2}: Rritja e importeve ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

Koeficienti 3.90 pranë variablit 'Importe', tregon për një lidhje pozitive ndërmjet rritjes së importeve dhe të ardhurave nga Tvsh-ja. Pra një rritje prej 1 njësi e importeve sjell një rritje prej 3.90 njësi të të ardhurave nga Tvsh-ja. Ky përfundim është në përputhje me rezultatet e

(Bikas & Andruskaite, 2013), të cilët gjetën një marrëdhënie pozitive midis importeve dhe të ardhurave nga Tvsh-ja.

Vlera e 'p' e variablit 'Importe' është 0.04460, që do të thotë më e vogël se 0.1 dhe për rrjedhojë bie hipoteza zero e vërtetohet hipoteza alternative, d.m.th. rritja e importeve ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

H_{0,3}: Rritja e eksporteve nuk ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

H_{a,3}: Rritja e eksporteve ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

Koeficienti 3.59 pranë variablit 'Eksporte', tregon për një lidhje pozitive ndërmjet rritjes së eksportve dhe të ardhurave nga Tvsh-ja. Pra një rritje prej 1 njësi e eksporteve sjell një rritje prej 3.59 njësi të të ardhurave nga Tvsh-ja. Ky përfundim është në kundërshtim me rezultatet e (Bikas & Andruskaite, 2013), të cilët gjetën një marrëdhënie negative mes eksporteve dhe të ardhurat nga Tvsh-ja.

Vlera e 'p' e variablit 'Eksporte' është 0.06360, që do të thotë më e vogël se 0.1 dhe për rrjedhojë bie hipoteza zero e vërtetohet hipoteza alternative, d.m.th. rritja e eksporteve ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

H_{0,4}: Volumi tregtar nuk ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

H_{a,4}: Volumi tregtar ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

Koeficienti -36.21 pranë variablit 'Volumi tregtar', tregon për një lidhje negative ndërmjet volumit tregtar dhe të ardhurave nga Tvsh-ja. Pra një rritje prej 1 njësi e volumit tregtar sjell një rënie prej 36.21 njësi të të ardhurave nga Tvsh-ja. Ky përfundim është në kundërshtim me rezultatet e (Wawire, 2011), i cili pohon se ekzistojnë marrëdhënie pozitive midis tregtisë ndërkombëtare dhe të ardhurave të Tvsh-së.

Vlera e 'p' e variablit 'Volumi tregtar' 0.06003, që do të thotë më e vogël se 0.1 dhe për rrjedhojë bie hipoteza zero e vërtetohet hipoteza alternative, d.m.th. rritja e volumit tregtar ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

Tabela 22- Përmbledhje e rezultateve për Grupin e dytë të hipotezave, Modeli i parë, rasti i Shqipërisë

Nr.	Përshkrimi i hipotezës	Rezultati
1	Hapja ekonomike ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.	Pranohet
2	Rritja e importeve ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.	Pranohet
3	Rritja e eksporteve ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.	Pranohet
4	Volumi tregtar ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.	Pranohet

Burimi: Llogaritje të autorit

6.2.1.3 Kontrolli individual për koeficientët e regresionit

Për të kryer kontrollin individual të koeficientave të regresionit ndjekim procedurën 5-hapëshe:

1. Hedhja e hipotezës

$H_0: b_1=0, b_2=0, b_3=0, b_4=0$ (Modeli është jo i rëndësishëm)

$H_a: b_1 \neq 0, b_2 \neq 0, b_3 \neq 0, b_4 \neq 0$ (Modeli është i rëndësishëm)

2. Marrim një nivel rëndësie $\alpha=0.1$ (10%).

3. Përcaktimi i statistikes së kontrollit

$t=b-B/sb$ (Shperndarja e Studentit, e cila përdoret për rastet kur madhësia e zgjedhjes është më e vogël se 30)

4. Rregulli për marrjen e vendimit

Kontroll i dyanshëm

$\alpha=0.1$ (10%). $\rightarrow$ Apendixi F $\rightarrow$ Vlera kritike $t_k=1.860$

$df=n-(k+1)=13-(4+1)=8$


ku: α -niveli i rendësisë

df-shkallët e lirisë

n-madhesia e zgjedhjes (numri i periudhave të marra në studim)

k-numri i variablave të pavarur

Figura 26- Rregulli për marrjen e vendimit, Modeli i pare i të ardhurave nga TVSH-ja, rasti i Shqipërisë



Burimi: Ilustrim nga autori

5. Marrja e vendimit

Nga analiza e regresionit kemi vlerat: $t_1 = -2.97$

$$t_2 = 2.37$$

$$t_3 = 2.15$$

$$t_4 = 2.18$$

$t_1 = -2.97$ bie në zonën ku H_0 hidhet poshtë, prandaj ky variabël nuk largohet nga modeli i regresionit, sepse kontribon në shpjegimin e variablit të varur.

$t_2 = 2.37$ bie në zonën ku H_0 hidhet poshtë, prandaj ky variabël nuk largohet nga modeli i regresionit, sepse kontribon në shpjegimin e variablit të varur.

$t_3 = 2.15$ bie në zonën ku H_0 hidhet poshtë, prandaj ky variabël nuk largohet nga modeli i regresionit, sepse kontribon në shpjegimin e variablit të varur.

$t_4 = 2.18$ bie në zonën ku H_0 hidhet poshtë, prandaj ky variabël nuk largohet nga modeli i regresionit, sepse kontribon në shpjegimin e variablit të varur.

Asnjë nga variablat e pavarur nuk largohet nga modeli dhe nga kjo arrijmë në përfundimin që modeli është i rëndësishëm.

6.2.1.4 Kontrolli global për koeficientin e determinacionit (R^2)

Për të kryer kontrollin global për koeficientin e determinacionit (R^2) ndjekim procedurën 5-hapëshe:

1. Hedhja e hipotezës

$$H_0: R^2=0$$

$$H_a: R^2 \neq 0$$

2. Marrim një nivel rëndësie $\alpha = 0.1$ (10%).
3. Përcaktimi i statistikes së kontrollit

$$F = \frac{R^2/k}{1 - R^2/n - (k+1)}$$


4. Rregulli për marrjen e vendimit

$$\alpha = 0.1 \text{ (10\%).}$$

$$df_n = k = 4 \quad \rightarrow \text{Apendixi G} \rightarrow \text{Vlera kritike } t_k = 2.81$$

$$df_e = n - (k+1) = 13 - (4+1) = 8$$

Figura 27- Rregulli për marrjen e vendimit për kontrollin global të koeficientit të determinacionit (R^2), Modeli i parë i të ardhurave nga TVSH-ja, rasti i Shqipërisë



Burimi: Ilustrim nga autori

Nëse $F_{\text{llogaritur}} > 2.81$ H_0 hidhet poshtë, në të kundërt jo.

Tabela 23- Llogaritja e statistikës së kontrollit F

Burimi	df	SS	MS	F
Regresioni	4	$R^2=0.992835$	$R^2/k=0.24821$	$F=0.24821/0.0009$ $F=277.135$
Gabimet	8	$1-R^2=0.00716$	$1-R^2/n-(k+1)$ 0.0009	=
Totali	12	1		

Burimi: Llogaritje të autorit

Meqenëse F e llogaritur është më e madhe se vlera kritike $277.135 > 2.81$, hipoteza zero $R^2=0$, bie poshtë.

Rreth 99% e variacionit të variablit të varur arrihet të shpjegohet nga variacioni i variablave të pavarur, ndërsa pjesa tjetër mbetet e pashpjegueshme.

6.2.1.5 Modeli 1 i përmirësuar, analizë OLS me nivel rëndësie 5%

Në modelin 1 të paraqitur më lart, nga analiza e regresionit, vihet re se dy variablat e pavarur ‘Eksportet’ dhe ‘Volumi Tregtar’ janë statistikisht domëthënës në nivelin e rëndësisë 10%. Por nëse për studimin do të ishte zgjedhur një nivel rëndësie 5% e nivel

besueshmërie 95% këto dy variabla do të ishin larguar nga modeli. Nga kjo marrim iniciativën të analizojmë më tej ç'ndodh me modelin tonë nëse i largojmë këto dy variabla. Theksojmë që variablat e mësipërm janë të rëndësishëm për modelin e zgjedhur dhe kontribuojnë në shpjegimin e variablit të varur, por kjo analizë do të zhvillohet thjesht për të parë efektet e modelit të përmirësuar. Konkretisht më poshtë jepet analiza me metodën OLS, e llogaritur në Gretl:

Tabela 24- Modeli 1 i përmirësuar, Analiza OLS, Vëzhgimet 2005-2017 (T=13)
Variabël i varur: TA nga Tvsh-ja

	<i>Coefficient</i>	<i>Std. Error</i>	<i>t-ratio</i>	<i>p-value</i>	
const	68.7603	15.87	4.3327	0.00148	***
Hapja Ekonomike	-185.68	54.3697	-3.4151	0.00660	***
Importe	0.290808	0.0286834	10.1385	<0.00001	***

Mean dependent var	109.7692	S.D. dependent var	21.90188
Sum squared resid	94.32007	S.E. of regression	3.071157
R-squared	0.983614	Adjusted R-squared	0.980337
F(2, 10)	300.1476	P-value(F)	1.18e-09
Log-likelihood	-31.32754	Akaike criterion	68.65508
Schwarz criterion	70.34993	Hannan-Quinn	68.30671
rho	0.490213	Durbin-Watson	0.862589

* tregues të rëndësishëm në nivel rëndësie 10%
 ** tregues të rëndësishëm në nivel rëndësie 5%
 *** tregues të rëndësishëm në nivel rëndësie 1%.

Burimi: Llogaritje të autorit

Nga analiza e mësipërme vihet re që modeli është përmirësuar. Variablat hapja ekonomike dhe importet tani janë statistikisht domethënëse në nivelin e rëndësisë 1%. Ndërmjet variablit të pavarur 'Hapja ekonomike' dhe variablit të varur 'Të ardhurat nga Tvsh-ja' kemi përsëri një lidhje të zhdrejtë, ndërsa ndërmjet variablit të pavarur 'Importe' dhe variablit të varur 'Të ardhurat nga Tvsh-ja' ekziston një lidhje e drejtë.

6.2.1.6 Kontrolli individual për koeficientët e regresionit

Për të kryer kontrollin individual të koeficientave të regresionit ndjekim procedurën

5- hapëshe:

1. Hedhja e hipotezës

$H_0: b_1=0, b_2=0$ (Modeli është jo i rëndësishëm)

$H_a: b_1 \neq 0, b_2 \neq 0$ (Modeli është i rëndësishëm)

2. Marrim një nivel rëndësie $\alpha= 0.01$ (1%).

3. Përcaktimi i statistikes së kontrollit

$t=b-B/sb$ (Shperndarja e Studentit, e cila përdoret për rastet kur madhësia e zgjedhjes është më e vogël se 30)

4. Rregulli për marrjen e vendimit

Kontroll i dyanshëm

$\alpha= 0.01$ (1%). $\rightarrow$ Apendixi F $\rightarrow$ Vlera kritike $t_k= 3.169$

$df= n - (k+1)=13 - (2+1)=10$


ku: α -niveli i rëndësisë

df -shkallet e lirisë

n -madhësia e zgjedhjes (numri i periudhave të marra në studim)

k -numri i variablave të pavarur

Figura 28- Rregulli për marrjen e vendimit, Modeli i parë i të ardhurave nga TVSH-ja, i përmirësuar, rasti i Shqipërisë



Burimi: Ilustrim nga autori

5. Marrja e vendimit

Nga analiza e regresionit kemi vlerat: $t_1 = -3.42$

$$t_2 = 10.14$$

$t_1 = -3.42$ bie në zonën ku H_0 hidhet poshtë, prandaj ky variabël nuk largohet nga modeli i regresionit, sepse kontribon në shpjegimin e variablit të varur.

$t_2 = 10.14$ bie në zonën ku H_0 hidhet poshtë, prandaj ky variabël nuk largohet nga modeli i regresionit, sepse kontribon në shpjegimin e variablit të varur.

*Asnjë nga variablat e pavarur nuk largohet nga modeli dhe nga kjo arrijmë në përfundimin që **modeli është i rëndësishëm me nivel besueshmërie 99%.***

6.2.1.7 Kontrolli global për koeficientin e determinacionit (R^2)

Për të kryer kontrollin global për koeficientin e determinacionit (R^2) ndjekim procedurën 5- hapëshe:

1. Hedhja e hipotezës

$$H_0: R^2 = 0$$

$$H_a: R^2 \neq 0$$

2. Marrim një nivel rëndësie $\alpha = 0.1$ (10%).
3. Përcaktimi i statistikës së kontrollit

$$F = \frac{R^2/k}{1 - R^2/n - (k+1)}$$


4. Rregulli për marrjen e vendimit

$$\alpha = 0.01 \text{ (1\%)}$$

$$df_n = k = 2 \quad \rightarrow \text{Apendixi G} \rightarrow \text{Vlera kritike } t_k = 7.56$$

$$df_e = n - (k+1) = 13 - (2+1) = 10$$

Figura 29- Rregulli për marrjen e vendimit për kontrollin global të koeficientit të determinacionit (R^2), Modeli i parë i të ardhurave nga TVSH-ja, i përmirësuar, rasti i Shqipërisë



Burimi: Ilustrim nga autori

Nëse $F_{\text{llogaritur}} > 7.56$ H_0 hidhet poshtë, në të kundërt jo.

5. Marrja e vendimit

Tabela 25- Llogaritja e statistikës së kontrollit F

Burimi	df	SS	MS	F
Regresioni	2	$R^2 = 0.983614$	$R^2/k = 0.49181$	$F = 0.49181/0.00164$

F=300.139			
Gabimet	10	$1-R^2=0.01639$	$1-R^2/n-(k+1)$ $= 0.00164$
Totali	12	1	

Burimi: Llogaritje të autorit

Meqënëse F e llogaritur është më e madhe se vlera kritike $300.139 > 7.56$, hipoteza zero $R^2=0$, bie poshtë.

Rreth 98% e variacionit të variablilit të varur arrihet të shpjegohet nga variacioni i variablave të pavarur, ndërsa pjesa tjetër mbetet e pashpjegueshme.

6.2.1.8 Autokorreleacioni

Në rast se ekziston lidhje midis termave të gabimit të serive të ndryshme atëherë paraqitet problemi i lidhje serike ose i quajtur si autokorrelacion. Nëse në një model kemi prani të autokorrelacionit disa nga pasojat janë që vlerësimet mbeten lineare dhe të pazhvendosura, gjithashtu nuk janë efikente, që do të thotë nuk kanë variancë minimale.

Për të studiuar autokorrelacionin, pra për të zbuluar nëse ekziston një lidhje ose varësi midis termave të gabimit atëherë në procedojme me Testin ‘*Durbin-Watson*’, d.

1. Hedhja e hipotezes

H_0 : Joautokorrelacion

H_a : Autokorrelacion

2. Niveli i rëndësisë

$\alpha=0.01$ (1%)

3. Përcaktimi i Statistikës së kontrollit

$$d = \frac{\sum (e_t - e_{t-1})^2}{\sum e_t^2}$$

4. Rregulli për marrjen e vendimit

Në bazë të tabelës D-5B për $n=13$, $k'=2$, dhe $\alpha=1\%$ vlerat kritike të gjetura janë $d_L=0.616$ dhe $d_U=1.261$.

Nga llogaritjet në programin Gretl vlera $d=0.8626$, ndërsa rregullat për marjen e vendimit paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela 26- Marrja e vendimit për testin Durbin Watson për vlerën 'd'

Hipoteza bazë	Vendimi	Nëse
Joautokorrelacion pozitiv	Bie	$0 < d < d_L$
Joautokorrelacion pozitiv	Nuk mund të merret ndonjë vendim	$d_L < d < d_U$
Joautokorrelacion negativ	Bie	$4 - d_L < d < 4$
Joautokorrelacion negativ	Nuk mund të merret ndonjë vendim	$4 - d_U < d < 4 - d_L$
Joautokorrelacion pozitiv ose negativ	Pranohet	$d_U < d < 4 - d_U$

Burimi: Gujarati (2004)

5. Marrja e vendimit

Meqënëse vlera e përlllogaritur nga modeli i regresionit është $d = 0.8626$ (zona midis d_L dhe d_U nuk mund të merret ndonjë vendim për të treguar nëse në këtë model ka prani të autokorrelacionit.

6.2.2 Modeli 2: TA nga TVSH-ja & Papunësia, konsumi, rritja e PBB-së për frymë

Ky model i referohet të dhënave për Shqipërinë për serinë kohore 2005-2016.

Variabël i varur: Të ardhurat nga Tvsh-ja

Ndërsa si variabla të pavarur nga komponentët e tregut të punës dhe konsumit kam zgjedhur:

Variabël i pavarur: Papunësia

Variabël i pavarur: Konsumi i familjeve

Variabël i pavarur: Rritja e PBB-së për frymë

Nga ky model do të studiojmë hipotezat e mëposhtme:

Hipoteza zero (H_0): Asnjë nga komponentët e tregut të punës dhe konsumit nuk ndikon në të ardhurat e Tvsh-së.

Hipoteza alternative (H_a): Të paktën njëri nga komponentët e tregut të punës dhe konsumit ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

Nënhipotezat e këtij studimi mbështetën në lidhjen që ekziston ndërmjet të ardhurave të Tvsh-së dhe variablave të pavarur si më poshtë:

$H_{0,1}$: Papunësia nuk ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

$H_{a,1}$: Papunësia ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

$H_{0,2}$: Konsumi i familjeve nuk ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

$H_{a,2}$: Konsumi i familjeve ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

$H_{0,3}$: Rritja e PBB-së për frymë nuk ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

$H_{a,3}$: Rritja e PBB-së për frymë ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

6.2.2.1 Hedhja e hipotezave dhe lidhjet teorike

Hipoteza 1: Lidhja ndërmjet papunësisë dhe të ardhurave nga Tvsh-ja pritet të jetë një lidhje e zhdrejtë. (Bikas & Rashkauskas, 2011:32) konstatojnë se në rastet kur rritet papunësia, të ardhurat nga Tvsh-ja zvogëlohen ndjeshëm, që do të thotë se kemi ekzistencën e një marrëdhënie negative. Kjo lidhet me idenë që individët blejnë mallra dhe shërbime me të ardhurat nga paga, e për pasojë papunësia zvogëlon fuqinë blerëse të individëve, duke çuar në një reduktimi të konsumit dhe së fundmi, në uljen e të ardhurave të TVSH-së. Një prespektivë tjetër mbi lidhjen e papunësisë dhe të ardhurave të Tvsh-së është dhënë përsëri nga autorët (Bikas & Andruskaite, 2013:47), të cilët sugjerojnë se papunësia nuk ka efekt të drejtpërdrejtë mbi të ardhurat e TVSH-së, por që në mënyrë

indirekte ndikon negativisht në të ardhurat e Tvsh-së nëpërmjet efektit të saj të drejtpërdrejtë negativ mbi të ardhurat në dispozicion të familjeve dhe konsumit të tyre. Nga llogaritjet e këtyre autorëve, koeficienti i korrelacionit ndërmjet të ardhurave të TVSH-së dhe papunësisë ka rezultuar -0.20, që do të thotë se ndërmjet këtyre variablave ekziston një lidhje e dobët. Nga ana tjetër (Njogu, 2015:27) arriti në përfundimin se ekzistojnë marrëdhënie pozitive të rëndësishme ndërmjet shkallës së papunësisë dhe normave të TVSH-së.

Hipoteza 2: Lidhja ndërmjet konsumit të familjeve dhe të ardhurave nga Tvsh-ja pritet të jetë lidhje e drejtë. (Bikas & Rashkauskas, 2011:36) në studimet e tyre tregojnë një marrëdhënie pozitive mes konsumit të familjeve dhe të ardhurave nga TVSH-ja.

Hipoteza 3: Përsa i përket lidhjes së PBB-së për frymë dhe të ardhurave të Tvsh-së autorë të ndryshëm kanë arritur në rezultate të ndryshme. (Bikas & Andruskaite, 2013:48) arritën në konkluzionin se PBB për frymë është pozitivisht e lidhur me të ardhurat e TVSH-së. Ndërsa rezultatet e (Azaria & Robinson, 2005) tregojnë se kur PPB-ja për frymë rritet, të ardhurat tatimore priren të ulen³⁰.

Tabela 27- Statistikat përshkruese të të dhënave (Vlerat janë në milionë)

Variabli	Mean	Minimum	Maximum	C.V.
Ta nga Tvsh	107191.	64533.6	131390.	0.194755
Papunesia	0.144167	0.127000	0.173000	0.110542
Konsumi i famil	951456.	615108.	1.18681e+006	0.192705
Gdp per fryme	0.0600833	0.0260000	0.107000	0.468469

Burimi: Llogaritje të autorit

³⁰ Marrë nga: Da Silva C.S.F., (2016), The determinants of value added tax revenues in Portugal. Tezë Masteri: Lisboa School of Economics & Management, fq. 14.

6.2.2.2 Analiza OLS me nivel rëndësie 10%

Tabela 28- Modeli 2, Analiza OLS, Vëzhgimet 2005-2016 (T=12)
Variabël i varur: TA nga Tvsh-ja

	<i>Coefficient</i> <i>t</i>	<i>Std. Error</i>	<i>t-ratio</i>	<i>p-value</i>	
const	14040.5	27276.7	0.5147	0.62065	
Papunësia	-231060	101140	-2.2846	0.05170	*
Konsumi i famil.	0.129274	0.0158767	8.1424	0.00004	***
PBB Për Frymë	57640.1	110394	0.5221	0.61572	

Mean dependent var	107190.9	S.D. dependent var	20875.93
Sum squared resid	1.43e+08	S.E. of regression	4227.937
R-squared	0.970169	Adjusted R-squared	0.958983
F(3, 8)	86.72689	P-value(F)	1.93e-06
Log-likelihood	-114.7881	Akaike criterion	237.5762
Schwarz criterion	239.5158	Hannan-Quinn	236.8581
rho	0.201054	Durbin-Watson	1.534198

* tregues të rëndësishëm në nivel rëndësie 10%

** tregues të rëndësishëm në nivel rëndësie 5%

*** tregues të rëndësishëm në nivel rëndësie 1%.

Burimi: Llogaritje të autorit

Siç e shohim nga analiza OLS, për modelin me 12 vëzhgime gjithsej, kemi një $R^2 = 97.02\%$, ose e thënë ndryshe 97.02% e variacionit të të arrdhurave të Tvsh-së, shpjegohet me variablat e zgjedhur më lart. Variabli ‘Papunësia’ është statistikisht domëthënës në nivelin e rëndësisë 10%. Ndërsa variabli ‘Konsumi i familjes’ ka rezultuar domëthënës në nivelin 1%. Variabli i pavarur ‘PBB për frymë’ ka një vlerë ‘p’ të lartë dhe nuk ka rezultuar domëthënës për modelin.

Për vlera të p-së (niveli i vrojtuar i rëndësisë) më të mëdha se 0.1 ndikimi i variablit të pavarur mbi variablin e varur është i parëndësishëm në kushtet kur variablat e tjerë mbeten të pandryshuar në ekuacion dhe për vlera të p-së më të vogla se 0.1 hipoteza zero mbi mungesën e lidhjes do të refuzohet, pra lidhja midis variablave është e rëndësishme. Analizojmë me rradhë të gjitha hipotezat e studimit sipas vlerës së p-së:

H_{0,1}: Papunësia nuk ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

H_{a,1}: Papunësia ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

Vlera e 'p' e variablit 'Papunësia' është 0.05170, që do të thotë më e vogël se 0.1 dhe për rrjedhojë bie hipoteza zero e vërtetohet hipoteza alternative, d.m.th. inflacioni ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së dhe ky variabël duhet të qëndrojë në model.

H_{0,2}: Konsumi i familjeve nuk ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

H_{a,2}: Konsumi i familjeve ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

Vlera e 'p' e variablit 'Konsumi i familjeve' është 0.00004, që do të thotë më e vogël se 0.1 dhe për rrjedhojë bie hipoteza zero e vërtetohet hipoteza alternative, d.m.th. konsumi i familjeve ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së dhe ky variabël duhet të qëndrojë në model.

H_{0,3}: Rritja e PBB-së për frymë nuk ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

H_{a,3}: Rritja e PBB-së për frymë ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

Nga model i mësipërm vëmë re një lidhje pozitive ndërmjet PBB për frymë dhe të ardhurave nga Tvsh-ja. Lidhja pozitive që ka rezultuar nga modeli është në përputhje me rezultatet e (Bikas & Andruskaite, 2013), të cilët arritën në konkluzionin se PBB-ja për frymë është pozitivisht e lidhur me të ardhurat e TVSH-së. Por rezultati i punimit tim është në kundërshtim me rezultatet e (Azaria & Robinson, 2005), të cilët tregojnë se kur PPB-ja për frymë rritet, të ardhurat tatimore priren të ulen.

Vlera e 'p' e variablit PBB për frymë është 0.61572, që do të thotë më e madhe se 0.1 dhe për rrjedhojë vërtetohet hipoteza zero, që do të thotë sipas këtij modeli ndryshimi i PBB për frymë nuk ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së. Nga ky përfundim ky variabël duhet të largohet nga modeli.

Tabela 29- Përmbledhje e rezultateve për Grupin e dytë të hipotezave, Modeli i dytë, rasti i Shqipërisë

Nr.	Përshkrimi i hipotezës	Rezultati
1	Papunësia ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.	Pranohet
2	Konsumi i familjeve ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.	Pranohet
3	Rritja e PBB-së për frymë ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.	Refuzohet

Burimi: Llogaritje të autorit

6.2.2.3 Modeli 2 i përmirësuar - Analizë OLS me nivel rëndësie 5%

Kryejmë edhe njëherë analizën për modelin e përmirësuar duke larguar variablin ‘PBB për frymë’ dhe konkretisht përfitohet modeli i mëposhtëm:

**Tabela 30- Modeli 2 i përmirësuar, Analiza OLS, Vëzhgimet 2005-2016 (T=12)
Variabël i varur: TA nga Tvsh-ja**

	Coefficient	Std. Error	t-ratio	p-value	
const	26928.4	11129.5	2.4195	0.03864	**
Papunësia	-249646	90763.6	-2.7505	0.02246	**
Konsumi i famil	0.122184	0.00788899	15.4880	<0.00001	***

Mean dependent var	107190.9	S.D. dependent var	20875.93
Sum squared resid	1.48e+08	S.E. of regression	4053.487
R-squared	0.969153	Adjusted R-squared	0.962298
F(2, 9)	141.3804	P-value(F)	1.59e-07
Log-likelihood	-114.9892	Akaike criterion	235.9783
Schwarz criterion	237.4330	Hannan-Quinn	235.4397
rho	0.243158	Durbin-Watson	1.466984

* tregues të rëndësishëm në nivel rëndësie 10%

** tregues të rëndësishëm në nivel rëndësie 5%

*** tregues të rëndësishëm në nivel rëndësie 1%.

Burimi: Llogaritje të autorit

Siç e shohim nga analiza OLS, për modelin e përmirësuar me 12 vëzhgime gjithsej, kemi një $R^2 = 97.92\%$, ose e thënë ndryshe 96.92% e variacionit të të ardhurave të Tvsh-së, shpjegohet me variablat e zgjedhur më lart. Variabli ‘Papunësia’ është statistikisht domëthënës në nivelin e rëndësisë 5%. Ndërsa variabli ‘Konsumi i familjeve’ ka rezultuar domëthënës në nivelin 1% sikurse edhe tek modeli i mësipërm. Modeli që përfitohet merr formën siç më poshtë:

$$TA \text{ nga Tvsh-ja} = 26928.4 - 249646 \text{ Papunësia} + 0.12 \text{ Konsumi i familjeve}$$

Interpretimi i koeficientave të regresionit:

- Konstantja 26928.4 konsiderohet si intercepti, e cila tregon mesatarisht të ardhurat e Tvsh-së, kur variablat e tjerë marrin vlerën 0.
- Koeficienti -249646 pranë variablit 'Papunësia', tregon për një lidhje negative ndërmjet papunësisë dhe të ardhurave nga Tvsh-ja. Pra një rritje prej 1 njësi e papunësisë sjell një rënie prej 249646 njësi të të ardhurave nga Tvsh-ja. Ky përfundim është në përputhje me rezultatet e (Bikas & Rashkauskas, 2011), të cilët konstatojnë se në rastet kur rritet papunësia, të ardhurat nga Tvsh-ja do të ulen.
- Koeficienti 0.12 pranë variablit 'Konsumi i familjeve', tregon për një lidhje pozitive ndërmjet konsumit të familjeve dhe të ardhurave nga Tvsh-ja. Pra një rritje prej 1 njësi e konsumit të familjeve sjell një rritje prej 0.12 njësi të të ardhurave nga Tvsh-ja. Ky rezultat është në përputhje me rezultatet e (Bikas & Rashkauskas, 2011), të cilët, në studimet e tyre gjetën një marrëdhënie pozitive mes konsumit të familjeve dhe të ardhurave nga TVSH-ja.

6.2.2.4 Kontrolli individual për koeficientët e regresionit

Për të kryer kontrollin individual të koeficientave të regresionit ndjekim procedurën 5-hapëshe:

1. Hedhja e hipotezës
 - $H_0: b_1=0, b_2=0$ (Modeli është jo i rëndësishëm)
 - $H_a: b_1 \neq 0, b_2 \neq 0$ (Modeli është i rëndësishëm)
2. Marrim një nivel rëndësie $\alpha = 0.05$ (5%).

3. Përcaktimi i statistikës së kontrollit

$t = b - B/sb$ (Shpërndarja e Studentit, e cila përdoret për rastet kur madhësia e zgjedhjes është më e vogël se 30)

4. Rregulli për marrjen e vendimit

Kontroll i dyanshëm

$\alpha = 0.05$ (5%). $\rightarrow$ Apendixi F $\rightarrow$ Vlera kritike $t_k = 2.262$

$df = n - (k+1) = 12 - (2+1) = 9$


ku: α -niveli i rendësisë

df-shkallët e lirisë

n-madhesia e zgjedhjes (numri i periudhave të marra në studim)

k-numri i variablave të pavarur

Figura 30- Rregulli për marrjen e vendimit, modeli i dytë i të ardhurave nga TVSH-ja, rasti i Shqipërisë



Burimi: Ilustrim nga autori

5. Marrja e vendimit

Nga analiza e regresionit kemi vlerat: $t_1 = -2.75$

$t_2 = 15.49$

$t_1 = -2.75$ bie në zonën ku H_0 hidhet poshtë, prandaj ky variabël nuk largohet nga modeli i regresionit, sepse kontribon në shpjegimin e variablit të varur.

$t_2 = 15.49$ bie në zonën ku H_0 hidhet poshtë, prandaj ky variabël nuk largohet nga modeli i regresionit, sepse kontribon në shpjegimin e variablit të varur.

*Asnjë nga variablat e pavarur nuk largohet nga modeli dhe nga kjo arrijmë në përfundimin që **modeli është i rëndësishëm me nivel besueshmërie 95%.***

6.2.2.5 Kontrolli global për koeficientin e determinacionit (R^2)

Për të kryer kontrollin global për koeficientin e determinacionit (R^2) ndjekim procedurën 5-hapëshe:

1. Hedhja e hipotezës
 $H_0: R^2=0$
 $H_a: R^2 \neq 0$
2. Marrim një nivel rëndësie $\alpha = 0.05$ (5%).
3. Përcaktimi i statistikes së kontrollit

$$F = \frac{R^2/k}{1 - R^2/n - (k+1)}$$


4. Rregulli për marrjen e vendimit

$\alpha = 0.05$ (5%).

$df_n = k = 2 \quad \rightarrow$ Apendixi G $\rightarrow$ Vlera kritike $t_k = 4.26$

$df_e = n - (k+1) = 12 - (2+1) = 9$

Figura 31- Rregulli për marrjen e vendimit për kontrollin global të koeficientit të determinacionit (R^2), modeli i dytë i të ardhurave nga TVSH-ja, rasti i Shqipërisë



Burimi: Ilustrim nga autori

Nëse $F_{\text{llogaritur}} > 4.26$ H_0 hidhet poshtë, në të kundërt jo.

5. Marrja e vendimit

Tabela 31- Llogaritja e statistikës së kontrollit F

Burimi	df	SS	MS	F
Regresioni	2	$R^2=0.969153$	$R^2/k=0.48458$	$F= 0.48458/0.00343$ $F=141.381$
Gabimet	9	$1-R^2=0.03085$	$1-R^2/n-(k+1)$ $= 0.00343$	
Totali	11	1		

Burimi: Llogaritje të autorit

Meqënëse F e llogaritur është më e madhe se vlera kritike $141.381 > 4.26$, hipoteza zero $R^2=0$, bie poshtë.

Rreth 97% e variacionit të variablit të varur arrihet të shpjegohet nga variacioni i variablave të pavarur, ndërsa pjesa tjetër mbetet e pashpjegueshme.

6.2.2.6 Autokorrelacioni

Për të studiuar autokorrelacionin, pra për të zbuluar nëse ekziston një lidhje ose varësi midis termave të gabimit atëherë në procedojme me Testin ‘Durbin-Watson’, d.

1. Hedhja e hipotezes

H_0 : Joautokorrelacion

H_a : Autokorrelacion

2. Niveli i rëndësisë

$\alpha=0.05$ (5%)

3. Përcaktimi i Statistikës së kontrollit

$$d = \sum (e_t - e_{t-1})^2 / \sum e_t^2$$

4. Rregulli për marrjen e vendimit

Në bazë të tabelës D-5A për $n=12$, $k'=2$, dhe $\alpha=5\%$ vlerat kritike të gjetura janë $d_L=0.812$ dhe $d_U=1.579$

Nga llogaritjet në programin Gretl vlera $d=1.467$, ndërsa rregullat për marrjen e vendimit paraqiten në tabelën nr. 24 e paraqitur gjatë punimit.

5. Marrja e vendimit

Meqënëse vlera e përlogaritur nga modeli i regresionit është $d=1.467$ (zona midis d_L dhe d_U nuk mund të merret ndonjë vendim për të treguar nëse në këtë model ka prani të autokorrelacionit.

6.2.3 Modeli 3: TA nga TVSH-ja & PBB reale, inflacioni, shpenzimet qeveritare

Ky model i referohet të dhënave për Shqipërinë për serinë kohore 2005-2017.

Variabël i varur: Të ardhurat nga Tvsh-ja

Ndërsa si variabla të pavarur nga komponentët makroekonomik kam zgjedhur:

Variabël i pavarur: PBB reale

Variabël i pavarur: Inflacioni

Variabël i pavarur: Shpenzimet qeveritare

Nga ky model do të studiojmë hipotezat e mëposhtme:

Hipoteza zero (H_0): Asnjë nga komponentët makroekonomikë nuk ndikon në të ardhurat e Tvsh-së.

Hipoteza alternative (H_a): Të paktën njëri nga komponentët makroekonomikë ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

Nënhipotezat e këtij studimi mbështetën në lidhjen që ekziston ndërmjet të ardhurave të Tvsh-së dhe variablave të pavarur si më poshtë:

$H_{0,1}$: PBB reale nuk ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

$H_{a,1}$: PBB reale ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

$H_{0,2}$: Inflacioni nuk ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

$H_{a,2}$: Inflacioni ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

$H_{0,3}$: Shpenzimet qeveritare nuk kanë ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

$H_{a,3}$: Shpenzimet qeveritare kanë ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

6.2.3.1 Hedhja e hipotezave dhe lidhjet teorike

Hipoteza 1: Lidhja ndërmjet PBB-së dhe të ardhurave të Tvsh-së pritet të jetë lidhje pozitive. (Bikas & Andruskaite, 2013:48) dhe (Wawire, 2011:31) gjetën një marrëdhënie pozitive midis PBB-së dhe të hyrave Tvsh-së.

Hipoteza 2: Lidhja ndërmjet Inflacionit dhe të ardhurave të Tvsh-së pritet të jetë lidhje pozitive. Inflacioni është pozitivisht i lidhur me të ardhurat e TVSH-së dhe me normën e TVSH-së. Inflacioni më i lartë çon në të ardhura më të larta të TVSH-së dhe një normë më të lartë të TVSH-së, që do të thotë se normat e TVSH-së përshtaten përballë inflacionit, në

mënyrë që qeveria të mund të arrijë të ardhurat e nevojshme për të përmbushur shpenzimet e tyre të parashikuara (Pagán, 2001)³¹.

Hipoteza 3: Lidhja ndërmjet shpenzimeve qeveritare dhe të ardhurave të Tvsh-së pritët të jetë lidhje pozitive. Zakonisht argumentohet se të ardhurat e TVSH-së çojnë në një rritje në shpenzimet qeveritare, Pagán (2001) konstatoi se kjo nuk është e vërtetë³². Në fakt, rezultatet e tij tregojnë marrëdhënien e kundërt, që do të thotë rritjet në shpenzimet qeveritare çojnë në të ardhura më të larta të TVSH-së, e cila ndodh për shkak të stimulit ekonomik të shkaktuar nga shpenzimet qeveritare. Gjithashtu edhe (Nartey, 2011:42) arriti në konkluzionin se koeficienti i shpenzimeve qeveritare është pozitiv dhe i rëndësishëm, duke nënkuptuar që shpenzimet e qeverisë në mënyrë të konsiderueshme përcaktojnë të ardhurat e TVSH-së në periudhë afatgjatë.

Tabela 32-Statistikat përshkruese të të dhënave (Vlerat janë në miliardë)

Variabli	Mean	Minimum	Maximum	Std. Dev.
Ta_Nga_Tvsh-ja	109.769	65.0000	140.000	21.9019
PBB_Reale	0.0376615	0.00700000	0.0750000	0.0190199
Inflacioni	0.0238462	0.0130000	0.0350000	0.00730121
Shp_Qeveritare	368.381	232.339	461.410	71.4371

Burimi: Llogaritje të autorit

6.2.3.2 Analiza OLS me nivel rëndësie 10%

Tabela 33-Modeli 3, Analiza OLS, Vëzhgimet 2005-2017 (T=13)
Variabël i varur: TA nga Tvsh-ja

	<i>Coefficient</i>	<i>Std. Error</i>	<i>t-ratio</i>	<i>p-value</i>	
Const	-20.457	10.7522	-1.9026	0.08952	*
PBB_Reale	12.8546	82.5144	0.1558	0.87964	
Inflacioni	459.023	191.97	2.3911	0.04048	**
Shp_Qeveritare	0.322482	0.0207667	15.5288	<0.00001	***

³¹ Marrë nga: Da Silva C.S.F., (2016), The determinants of value added tax revenues in Portugal. Tezë Masteri: Lisboa School of Economics & Management, fq. 15.

³² Marrë nga: Da Silva C.S.F., (2016), The determinants of value added tax revenues in Portugal. Tezë Masteri: Lisboa School of Economics & Management, fq. 16.

Mean dependent var	109.7692	S.D. dependent var	21.90188
Sum squared resid	146.8851	S.E. of regression	4.039872
R-squared	0.974483	Adjusted R-squared	0.965977
F(3, 9)	114.5675	P-value(F)	1.73e-07
Log-likelihood	-34.20676	Akaike criterion	76.41352
Schwarz criterion	78.67332	Hannan-Quinn	75.94903
rho	0.076825	Durbin-Watson	1.813823

* tregues të rëndësishëm në nivel rëndësie 10%

** tregues të rëndësishëm në nivel rëndësie 5%

*** tregues të rëndësishëm në nivel rëndësie 1%.

Burimi: Llogaritje të autorit

Siç e shohim nga analiza OLS, për modelin me 13 vëzhgime gjithsej, kemi një $R^2 = 97.45\%$, ose e thënë ndryshe 97.45% e variacionit të të ardhurave të Tvsh-së, shpjegohet me variablat e zgjedhur më lart. Variabli i pavarur ‘PBB reale’ ka një vlerë ‘p’ të lartë dhe nuk ka rezultuar domëthënës për modelin. Variabli ‘Inflacioni’ është statistikisht domëthënës në nivelin e rëndësisë 5%. Ndërsa variabli ‘Shpenzimet qeveritare’ ka rezultuar domëthënës në nivelin e rëndësisë 1%.

Për vlera të p-së (niveli i vrojtuar i rëndësisë) më të mëdha se 0.1 ndikimi i variablit të pavarur mbi variablin e varur është i parëndësishëm në kushtet kur variablat e tjerë mbeten të pandryshuar në ekuacion dhe për vlera të p-së më të vogla se 0.1 hipoteza zero mbi mungesën e lidhjes do të refuzohet, pra lidhja midis variablave është e rëndësishme. Analizojmë me rradhë të gjitha hipotezat e studimit sipas vlerës së p-së:

$H_{0,1}$: PBB reale nuk ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

$H_{a,1}$: PBB reale ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

Nga model i mësipërm vëmë re një lidhje pozitive ndërmjet PBB reale dhe të ardhurave nga Tvsh-ja. Ky përfundim është në përputhje me rezultatet e (Bikas & Andruskaite, 2013) dhe

(Wawire, 2011), të cilët gjetën një marrëdhënie pozitive midis PBB-së dhe të hyrave të Tvsh-së.

Vlera e ‘p’ e variablit PBB reale është 0.87964, që do të thotë më e madhe se 0.1 dhe për rrjedhojë vërtetohet hipoteza zero, që do të thotë sipas këtij modeli ndryshimi i PBB reale nuk ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së. Nga ky përfundim ky variabël duhet të largohet nga modeli.

H_{0,2}: Inflacioni nuk ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

H_{a,2}: Inflacioni ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

Vlera e ‘p’ e variablit ‘Inflacioni’ është 0.04048, që do të thotë më e vogël se 0.1 dhe për rrjedhojë bie hipoteza zero e vërtetohet hipoteza alternative, d.m.th. inflacioni ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së dhe ky variabël duhet të qëndrojë në model.

H_{0,3}: Shpenzimet qeveritare nuk kanë ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

H_{a,3}: Shpenzimet qeveritare kanë ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.

Vlera e ‘p’ e variablit ‘Shpenzimet qeveritare’ është <0.00001, që do të thotë edhe më e vogël se 0.1 dhe për rrjedhojë bie hipoteza zero e vërtetohet hipoteza alternative, d.m.th. shpenzimet qeveritare kanë ndikim në të ardhurat e Tvsh-së dhe ky variabël duhet të qëndrojë në model.

Tabela 34- Përmbledhje e rezultateve për Grupin e dytë të hipotezave, Modeli i tretë, rasti i Shqipërisë

Nr.	Përshkrimi i hipotezës	Rezultati
1	PBB reale ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.	Refuzohet
2	Inflacioni ka ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.	Pranohet
3	Shpenzimet qeveritare kanë ndikim në të ardhurat e Tvsh-së.	Pranohet

Burimi: Llogaritje të autorit

6.2.3.3 Modeli 3 i përmirësuar - Analizë OLS me nivel rëndësie 5%

Kryejmë edhe njëherë analizën për modelin e përmirësuar duke larguar variablin ‘PBB reale’ dhe konkretisht përfitohet modeli i mëposhtëm:

Tabela 35-Modeli 3 i përmirësuar, Analiza OLS, Vëzhgimet 2005-2017 (T=13)
Variabël i varur: TA nga Tvsh-ja

	<i>Coefficient</i>	<i>Std. Error</i>	<i>t-ratio</i>	<i>p-value</i>	
Const	-19.6657	9.00256	-2.1845	0.05384	*
Inflacioni	470.095	169.405	2.7750	0.01962	**
Shp. Qeveritare	0.320931	0.017314	18.5359	<0.00001	***

Mean dependent var	109.7692	S.D. dependent var	21.90188
Sum squared resid	147.2812	S.E. of regression	3.837723
R-squared	0.974414	Adjusted R-squared	0.969297
F(2, 10)	190.4189	P-value(F)	1.10e-08
Log-likelihood	-34.22426	Akaike criterion	74.44853
Schwarz criterion	76.14338	Hannan-Quinn	74.10016
rho	0.071045	Durbin-Watson	1.820674

* tregues të rëndësishëm në nivel rëndësie 10%

** tregues të rëndësishëm në nivel rëndësie 5%

*** tregues të rëndësishëm në nivel rëndësie 1%.

Burimi: Llogaritje të autorit

Siç e shohim nga analiza OLS, për modelin e përmirësuar me 13 vëzhgime gjithsej, kemi një $R^2 = 97.44\%$, ose e thënë ndryshe 97.44% e variacionit të të ardhurave të Tvsh-së, shpjegohet me variablat e zgjedhur më lart. Variabli ‘Inflacioni’ është statistikisht domethënës në nivelin e rëndësisë 5%, ndërsa variabli ‘Shpenzimet qeveritare’ ka rezultuar domethënës në nivelin 1%, të dy sikurse edhe tek modeli i mësipërm. Modeli që përfitohet merr formën siç më poshtë:

$$\text{TA nga Tvsh-ja} = -19.67 + 470.09 \text{ Inflacioni} + 0.32 \text{ Shp. Qeveritare}$$

Interpretimi i koeficientave të regresionit:

- Konstantja -19.67 konsiderohet si intercepti, e cila tregon mesatarisht të ardhurat e Tvsh-së, kur variablat e tjerë marrin vlerën 0.

- Koeficienti 470.09 pranë variablit ‘Inflacioni’, tregon për një lidhje pozitive ndërmjet inflacionit dhe të ardhurave nga Tvsh-ja. Pra një rritje prej 1 njësi e inflacionit sjell një rritje prej 470.09 njësi të të ardhurave nga Tvsh-ja. Ky përfundim është në përputhje me rezultatet e (Pagán, 2001), i cili pohon se ekziston një lidhje pozitive ndërmjet inflacionit dhe të ardhurave të TVSH-së.
- Koeficienti 0.32 pranë variablit ‘Shpenzime Qeveritare’, tregon për një lidhje pozitive ndërmjet shpenzimeve qeveritare dhe të ardhurave nga Tvsh-ja. Pra një rritje prej 1 njësi e shpenzimeve qeveritare sjell një rritje prej 0.32 njësi të të ardhurave nga Tvsh-ja. Ky përfundim është në përputhje me rezultatet e Pagán (2001) që tregojnë se rritjet në shpenzimet qeveritare çojnë në të ardhura më të larta të TVSH-së, e cila ndodh për shkak të stimulit ekonomik të shkaktuar nga shpenzimet qeveritare. Përfundimi i arritur përputhet gjithashtu edhe me rezultatet e (Nartey, 2011:42), i cili arriti në konkluzionin se koeficienti i shpenzimeve qeveritare është pozitiv dhe i rëndësishëm.

6.2.3.4 Kontrolli individual për koeficientët e regresionit

Për të kryer kontrollin individual të koeficientave të regresionit ndjekim procedurën

5- hapëshe:

1. Hedhja e hipotezës

$H_0: b_1=0, b_2=0$ (Modeli është jo i rëndësishëm)

$H_a: b_1 \neq 0, b_2 \neq 0$ (Modeli është i rëndësishëm)

2. Marrim një nivel rëndësie $\alpha= 0.05$ (5%).

3. Përcaktimi i statistikes së kontrollit

$t=b-B/sb$ (Shperndarja e Studentit, e cila përdoret për rastet kur madhësia e zgjedhjes është më e vogël se 30)

4. Rregulli për marrjen e vendimit

Kontroll i dyanshëm

$\alpha = 0.05$ (5%). $\rightarrow$ Apendixi F $\rightarrow$ Vlera kritike $t_k = 2.228$

$df = n - (k+1) = 13 - (2+1) = 10$


ku: α -niveli i rendësisë

df-shkallët e lirisë

n-madhesia e zgjedhjes (numri i periudhave të marra në studim)

k-numri i variablave të pavarur

Figura 32- Rregulli për marrjen e vendimit, modeli i tretë i të ardhurave nga TVSH-ja, rasti i Shqipërisë



Burimi: Ilustrim nga autori

5. Marrja e vendimit

Nga analiza e regresionit kemi vlerat: $t_1 = 2.77$

$t_2 = 18.54$

$t_1 = 2.77$ bie në zonën ku H_0 hidhet poshtë, prandaj ky variabël nuk largohet nga modeli i regresionit, sepse kontribon në shpjegimin e variablit të varur.

$t_2 = 18.54$ bie në zonën ku H_0 hidhet poshtë, prandaj ky variabël nuk largohet nga modeli i regresionit, sepse kontribon në shpjegimin e variablit të varur.

*Asnjë nga variablat e pavarur nuk largohet nga modeli dhe nga kjo arrijmë në përfundimin që **modeli është i rëndësishëm me nivel besueshmërie 95%.***

6.2.3.5 Kontrolli global për koeficientin e determinacionit (R^2)

Për të kryer kontrollin global për koeficientin e determinacionit (R^2) ndjekim procedurën 5- hapëshe:

1. Hedhja e hipotezës

$$H_0: R^2 = 0$$

$$H_a: R^2 \neq 0$$

2. Marrim një nivel rëndësie $\alpha = 0.05$ (5%).
3. Përcaktimi i statistikes së kontrollit

$$F = \frac{R^2/k}{1 - R^2/n - (k+1)}$$


4. Rregulli për marrjen e vendimit

$$\alpha = 0.05 \text{ (5\%).}$$

$$df_n = k = 2 \quad \rightarrow \text{Apendixi G} \rightarrow \text{Vlera kritike } t_k = 4.10$$

$$df_e = n - (k+1) = 13 - (2+1) = 10$$

Figura 33- Rregulli për marrjen e vendimit për kontrollin global të koeficientit të determinacionit (R^2), modeli i tretë i të ardhurave nga TVSH-ja, rasti i Shqipërisë



Burimi: Ilustrim nga autori

Nëse $F_{\text{llogaritur}} > 4.10$ H_0 hidhet poshtë, në të kundërt jo.

5. Marrja e vendimit

Tabela 36- Llogaritja e statistikës së kontrollit F

Burimi	df	SS	MS	F
Regresioni	2	$R^2=0.974414$	$R^2/k=0.48721$	$F= 0.48721/0.00256$ $F=190.419$
Gabimet	10	$1-R^2=0.02559$	$1-R^2/n-(k+1)$ $= 0.00256$	
Totali	12	1		

Burimi: Llogaritje të autorit

Meqënëse F e llogaritur është më e madhe se vlera kritike $190.419 > 4.10$, hipoteza zero $R^2=0$, bie poshtë.

Rreth 97% e variacionit të variablit të varur arrihet të shpjegohet nga variacioni i variablave të pavarur, ndërsa pjesa tjetër mbetet e pashpjegueshme.

6.2.3.6 Autokorrelacioni

Për të studiuar autokorrelacionin, pra për të zbuluar nëse ekziston një lidhje ose varësi midis termave të gabimit atëherë në procedojme me Testin ‘Durbin-Watson’, d.

1. Hedhja e hipotezës

H_0 : Joautokorrelacion

H_a : Autokorrelacion

2. Niveli i rëndësisë

$\alpha=0.05$ (5%)

3. Përcaktimi i Statistikës së kontrollit

$$d = \sum (e_t - \bar{e})^2 / \sum e_t^2$$

4. Rregulli për marrjen e vendimit

Në bazë të tabelës D-5A për $n=13$, $k'=2$, dhe $\alpha=5\%$ vlerat kritike të gjetura janë $d_L=0.861$ dhe $d_U=1.562$

Nga llogaritjet në programin Gretl vlera $d=1.8206$, ndërsa rregullat për marrjen e vendimit paraqiten në tabelën nr. 24 e paraqitur gjatë punimit.

5. Marrja e vendimit

Meqënëse vlera e përlogaritur nga modeli i regresionit është $d=1.8206$ (zona midis d_L dhe d_U) prandaj pranohet hipoteza zero, dmth në këtë model nuk kemi prani të autokorrelacionit dhe ky është një tregues i mirë.

6.2.4 Modeli 4: Ndikimi i nivelit të korrupsionit tek të ardhurat e TVSH-së

Niveli i korrupsionit në një vend krijon efekte negative në ekonominë dhe të ardhurat. Të ardhura më të ulëta krijojnë një dinamikë projeksionesh për mënyrën se si do të shpërndahen këto të hyra, të cilat janë më të ulëta, por nga ana tjetër nevoja për investime publike të shumëllojshme është gjithnjë e në rritje. Korrupsioni zhvillon ekonominë informale dhe mund të krijojë dëme ekonomike të cilat pengojnë rritjen ekonomike.


Një burim i rëndësishëm i të ardhurave për një vend janë të ardhurat që vijnë nga TVSH-ja. (Sarmiento, 2016:95) pohon se një nivel më i ulët i korrupsionit dhe një sistem më i mirë ligjor dhe gjyqësor tentojnë të ndikojnë pozitivisht në të ardhurat e TVSH-së.

Për vendet në tranzicion dhe të zhvilluara argumentohet se stabiliteti politik, zvogëlimi i dhunës dhe korrupsionit mund të rrisë të ardhurat e TVSH-së (Oordt 2016:28).

Në këtë çështje synoj të ilustroj se si niveli i perceptuar i korrupsionit për Shqipërinë ndikon tek të ardhurat e TVSH-së në Shqipëri, nëpërmjet përdorimit të regresionit të thjeshtë. Të dhënat e të ardhurave të TVSH-së janë marrë nga Ministria e Financave të RSH-së. Ndërsa të dhënat e indeksit të perceptuar të korrupsionit në Shqipëri (Corruption Perception Index) janë marrë nga Transparency International (the global coalition against corruption).

Pikëzimi i nivelit të korrupsionit është nga 0 deri në 100 pikë. Sa më afër 0 të jetë vlera e korrupsionit e një shteti, aq më i korruptuar është ai vend. E kundërta, sa më afër vlerës 100, aq më i ulët është niveli i korrupsionit për atë vend. Periudha kohore e marrë në studim për këtë çështje është 2002-2017. Në figurën e mëposhtme paraqitet Indeksi i perceptuar i korrupsionit në Shqipëri për periudhën kohore në fjalë:

Figura 34- Indeksi i përceptuar i korrupsionit në Shqipëri



Burimi: Transparency International (2018)

Siç shihet nga figura nga viti 2002 deri në vitin 2006, vlera e korrupsionit luhetet në vlerat 24-26 pikë, që do të thotë që niveli i korrupsionit paraqitet i lartë në Shqipëri. Ndërsa në vitet e tjera vlera ka qenë përgjithësisht në rritje, duke arritur në vlerën 39 pikë në vitin 2016.

6.2.4.1 Modeli i regresionit

Ky model i referohet të dhënave për Shqipërinë për serinë kohore 2002-2017.

Variabël i varur: Të ardhurat nga TVSH-ja

Variabël i pavarur: Indeksi i përceptuar i korrupsionit

Nga ky model do të studjoj hipotezat e mëposhtme:

Hipoteza zero (H_0): Indeksi i përceptuar i korrupsionit nuk ndikon në të ardhurat e TVSH-së.

Hipoteza alternative (H_a): Indeksi i përceptuar i korrupsionit ka ndikim tek të ardhurat e TVSH-së.

Nga ky model presim që një nivel i lartë i përceptuar i korrupsionit (në rastin tonë sa më afër zeros), ul të ardhurat tatimore të TVSH-së. Me të dhënat e variablave përfitojmë tabelën e mëposhtme sipas analizës OLS:

Tabela 37- Analiza OLS, Vëzhgimet 2002-2017 (T=16)

Variabël i varur: Të ardhurat e TVSH-së (Rasti i Shqipërisë)

	<i>Coefficient</i>	<i>Std. Error</i>	<i>t-ratio</i>	<i>p-value</i>	
const	-8.57192e+010	1.84952e+010	-4.6347	0.00039	***
Korrupsioni	5.97619e+09	5.92359e+08	10.0888	<0.00001	***

Mean dependent var	9.88e+10	S.D. dependent var	3.06e+10
Sum squared resid	1.70e+21	S.E. of regression	1.10e+10
R-squared	0.879085	Adjusted R-squared	0.870448
F(1, 14)	101.7838	P-value(F)	8.37e-08
Log-likelihood	-391.5945	Akaike criterion	787.1889
Schwarz criterion	788.7341	Hannan-Quinn	787.2681
rho	0.391548	Durbin-Watson	1.034660

* tregues të rëndësishëm në nivel rëndësie 10%

** tregues të rëndësishëm në nivel rëndësie 5%

*** tregues të rëndësishëm në nivel rëndësie 1%.

Burimi: Llogaritje të autorit

Siç e shohim nga analiza OLS, për modelin me 16 vëzhgime gjithsej, kemi një $R^2 = 87.91\%$, ose e thënë ndryshe 87.91% e variacionit të të ardhurave të TVSH-së, shpjegohet nga ndikimi i variablit të indeksit të përceptuar të korrupsionit. Variabli ‘Indeksi i përceptuar i korrupsionit’ është statistikisht domëthënës në nivelin e rëndësisë 1% .

Për vlera të p-së (niveli i vrojtuar i rëndësisë) më të mëdha se 0.05 ndikimi i variablit të pavarur mbi variablin e varur është i parëndësishëm në kushtet kur variablat e tjerë mbeten të pandryshuar në ekuacion dhe për vlera të p-së më të vogla se 0.05 hipoteza

zero mbi mungesën e lidhjes do të refuzohet, pra lidhja midis variablave është e rëndësishme. Analizojmë hipotezën sipas vlerës së p-së:

H_{0,1}: Indeksi i përceptuar i korrupsionit nuk ndikon në të ardhurat e TVSH-së.

H_{a,1}: Indeksi i përceptuar i korrupsionit ka ndikim tek të ardhurat e TVSH-së.

Vlera e 'p' e variablit 'Indeksi i përceptuar i korrupsionit' është <0.00001, që do të thotë edhe më e vogël se 0.05 (vlera tepër e ulët e 'p-së' tregon rëndësinë e modelit të studjuar) dhe për rrjedhojë bie hipoteza zero e vërtetohet hipoteza alternative, d.m.th. 'Indeksi i përceptuar i korrupsionit' ka ndikim tek të ardhurat e TVSH-së, dhe ky variabël duhet të qëndrojë në model.

Modeli që përfitohet merr formën siç më poshtë:

Të ardhurat e TVSH-së = (-8.57e +010) + (5.97e +09) Indeksi i përceptuar i korrupsionit

Interpretimi i koeficientave të regresionit:

- Konstantja -8.57e +010³³ konsiderohet si intercepti, e cila tregon mesatarisht vlerën e të ardhurave të TVSH-së, kur indeksi i përceptuar i korrupsionit merr vlerën 0 (Rasti kur indeksi i përceptuar i korrupsionit merr vlerën 0, tregon nivelin maksimal të korrupsionit të atij vendi, nga kjo shpjegohet vlera negative e intercepsit).
- Koeficienti 5.97e +09³⁴ pranë variablit 'Indeksi i përceptuar i korrupsionit', tregon për një lidhje pozitive ndërmjet indeksit të përceptuar të korrupsionit dhe të ardhurave të TVSH-së. Pra një rritje prej 1 njësi e indeksit të përceptuar të korrupsionit sjell një rritje prej 5.97e +09 njësi të të ardhurave të TVSH-së. Por

³³ -8.57e + 010 = -8.57 x 10¹⁰

³⁴ 5.97e + 09 = 5.97 x 10⁹

duhet të mbahet parasysh se rritja e vlerës së indeksit tregon për një nivel të ulët korrupsioni. Ky përfundim është në përputhje me rezultatet e (Sarmiento, 2016), i cili pohon se një nivel më i ulët i korrupsionit dhe një sistem më i mirë ligjor dhe gjyqësor tentojnë të ndikojnë pozitivisht në të ardhurat e TVSH-së. Gjithashtu rezultatet janë në përputhje edhe me teorinë e (Oordt, 2016), i cili pohon se për vendet në tranzicion dhe të zhvilluara argumentohet se stabiliteti politik, zvogëlimi i dhunës dhe korrupsionit mund të rrisë të ardhurat e TVSH-së.

Nga analiza e mësipërme, arrijmë në konkluzionin se modeli i ndikimit të indeksit të perceptuar të korrupsionit tek të ardhurat e TVSH-së referuar të dhënave të Shqipërisë, është i rëndësishëm me nivel besueshmërie 99%. Për më tepër, rezultatet e këtij studimi janë në përputhje me teoritë nga (Sarmiento, 2016) dhe (Oordt 2016), të cilët pohojnë se një nivel i ulët i korrupsionit rrit të ardhurat e TVSH-së.

Tabela 38- Përmbledhje e rezultateve për Grupin e dytë të hipotezave, Modeli i katërt, rasti i Shqipërisë

Nr.	Përshkrimi i hipotezës	Rezultati
1	Indeksi i perceptuar i korrupsionit ka ndikim tek të ardhurat e TVSH-së.	Pranohet

Burimi: Llogaritje të autorit

KAPITULLI VII: KONKLUSIONE & REKOMANDIME

7.1 Konkluzione të përgjithshme

Nga shfletimi i literaturës shqiptare dhe të huaj vihet në pah rëndësia e mekanizmit të TVSH-së në ekonomi. Mënyrat e përfshirjes së saj në ekonominë e një vendi, mënyrat e llogaritjes, ndikimet që ka ky tatim tek madhësitë e sektorëve dhe shumë dimensione të tjera diskutohen nga analizues të ndryshëm të financave dhe tatimeve. Nga dëshmitë empirike të studjuesve pohohet se TVSH-ja mund të përmirësojë ndjeshëm sistemin tatimor, efikasitetin dhe rimbëkëmbjen ekonomike.

Studimet tregojnë edhe se si të ardhurat dhe efikasiteti i TVSH-së varen nga zhvillimi i vendeve, i kulturës tatimore dhe i besimit të qytetarëve tek fortësia e sistemit ligjor.

Tatimi mbi vlerën e shtuar është sistemi më i përdorur rreth botës me një shpërndarje në 162 ekonomi të ndryshme sipas “Pagimit të Taksave 2017”. Gjithashtu një fakt i rëndësishëm sipas publikimit të tyre, është se shpenzohet mesatarisht 27% më pak kohë në lidhje me detyrimet e TVSH-së në vendet ku bizneset paguajnë dhe depozitojnë deklaratën e TVSH-së online.

Që nga viti 2008, 26 vende më shumë kanë miratuar paketën elektronike dhe sistemet e pagesave për të bërë pajtueshmërinë e TVSH-së më efikase dhe për të ndihmuar në uljen e mashtrimit dhe evazionit.

Përsa i përket historisë së harmonizimit të TVSH-së europiane, dokumenti i parë që përmendi konvergjencën e strukturave të taksave evropiane ishte tashmë Traktati i Romës (EEC, 1962), i aprovuar në epokën e pionierit të Bashkimit Evropian (1957).

Reformimi i sistemit tatimor në Shqipëri ka ndeshur në problematika të shumta, ku baza ishte mungesa e një kuadri ligjor rregullues.

Pesha e TVSH-së ndaj ndaj totalit të të ardhurave në buxhetin e shtetit në Shqipëri është më e lartë se mesatarja e vendeve anëtare në BE. Në Shqipëri vlerat luhaten ndërmjet 31.5% dhe 36.8%, përkundrejt vlerave 30.4% dhe 31.8% të vendeve anëtare të BE-së, për serinë kohore 2004-2012.

Norma standarte e TVSH-së në Shqipëri është 20%, ndërsa norma e reduktuar e TVSH-së është 6%. Në Kosovë norma standarte e e TVSH-së është 18%, ndërsa norma e reduktuar e TVSH-së është 8%.

Në Shqipëri nga data 1 shkurt 2011 ka hyrë në fuqi ligji për tatimin e furnizimit të barnave dhe shërbimeve shëndetësore nga institucionet shëndetësore publike dhe private në nivelin 10%. Ndërkohë nga data 1 prill 2014, ka hyrë në fuqi ligji për përjashtimin e barnave, nga norma 10% në 0%, ndërsa në Kosovë ka ndodhur pak a shumë e kundërta. Nga 1 shtatori 2015, norma e TVSH-së për barnat në Kosovë ka ndryshuar nga 0% në 8%.

Një problem që kam identifikuar nga analiza është se subjektet nuk i kanë të depozituara të gjitha pasqyrat financiare vjetore edhe pse një fakt i tillë konsiderohet si kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 15 000 lekë, sipas pikës 3 të Nenit 74 të ligjit 9723/2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Për vitin 2017 Rumania, Bullgaria, Maqedonia, Shqipëria dhe Kosova kanë pasur një vlerë të barrës tatimore në përqindje të PBB-së ndërmjet vlerave 25%-28%.

Shqipëria rënditet e dyta në Ballkan për kostot më të lira tatimore, ndërsa Kosova e katërta.

Një nga kriteret që një person i tatueshëm të kërkojë rimbursim të tepricës së kreditimit tatimor të TVSH-së, është që TVSH-ja e kërkuar për t’u rimbursuar të tejkalojë shumën

prej 400 000 (katërqind mijë) lekësh. Ndërsa në Kosovë shuma e kërkuar duhet të kalojë vlerën 3 000€ (tremijë euro). Nëse marrim kursin mesatar të këmbimit të lekut me euron për vitin 2017, sipas Bankës së Shqipërisë, marrim vlerën 134.25 ALL/€. Nëse bëjmë konvertimin në lekë, për Kosovën do të jenë afërsisht 402 750 (katërqind e dymijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë të kërkuara si kriter për rimbursimin. Kjo do të thotë se ka një ngjashmëri ndërmjet këtyre vendeve. Ndërkohë sipas “Pagimit të Takasve për vitin 2017”, në nivel botëror, koha për të marrë një rimbursim varion nga pak mbi 3 javë në rreth 106 javë me një mesatare globale prej 21.6 javësh.

7.2 Konkluzione nga analizat e modeleve

Treguesi i hapjes ekonomike për Shqipërinë përgjithësisht është në rritje, ndonjëherë edhe me luhatje poshtë ose lart, sepse tregu ynë nuk është i mjaftueshëm për të mbuluar të gjitha fushat e mallrave dhe shërbimeve. Për periudhën e marrë në shqyrtim vlera e rimbursimit të TVSH-së është luhatur rreth vlerave 2,050,842,190 ALL dhe 13,891,130,000 ALL.

Nga analiza e kryer për periudhën 2007-2017 për Shqipërinë, u arrit në konkluzionin se hapja ekonomike ndikon në rimbursimin e TVSH-së. Ndërsa ndryshimi i PBB reale sipas modelit të zhvilluar, rezultoi me një lidhje negative dhe nuk ka ndikim në rimbursimin e TVSH-së. Në rastin e parë me dy variabla, variabli i hapjes ekonomike ishte i rëndësishëm në nivelin e rëndësisë 5%, ndërsa në modelin e përmirësuar variabli rezultoi statistikisht i rëndësishëm në nivelin e rëndësisë 1%.

Nga analiza e kryer për periudhën 2007-2017 për Kosovën, u arrit në konkluzionin se hapja ekonomike nuk ndikon në rimbursimin e TVSH-së, në ndryshim nga rasti i Shqipërisë. Ndërsa ndryshimi i PBB reale ka rezultuar statistikisht domethënës në nivelin e rëndësisë

5%. Ky rezultat gjithashtu është i ndryshëm nga rasti i Shqipërisë, përveç ngjashmërisë që edhe për Kosovën, ky variabël ka lidhje negative.

Për vitin 2017 në Shqipëri, përqindja e të ardhurave të TVSH-së të mbledhura në doganë është mesatarisht 74.95%. Ndërsa për Kosovën kjo vlerë, sipas së njëjtës periudhë është 73.77%. Këto rezultate janë në përputhje me teorinë nga (Ebrill, Keen, Bodin dhe Summers, 2001), të cilët pohojnë se zakonisht të ardhurat nga TVSH-ja nga mallrat e importuara përbëjnë një përqindje të madhe e të ardhurave të TVSH-së.

Nga viti 2015 deri në 30 prill 2018, që janë marrë të dhënat, numri i bizneseve mbi pragun e regjistrimit të TVSH-së ka qenë në rritje duke mbajtur një përqindje prej 11% afërsisht ndaj totalit të bizneseve në Kosovë.

Duke përmbledhur rezultatet e 25-së farmacive të marra në studim, vihet re se në vitin 2011, kur një pjesë e barnave janë përfshirë me normën 10% të TVSH-së, fitimi marxhinal është rritur në 76% të farmacive të analizuara (19 farmaci nga 25 gjithsej). Një fitim marxhinal i lartë është i preferueshëm sepse ky raport tregon sa lekë gjenerohen si fitim për çdo lekë shitje. Ndërsa për vitin 2014, kur barnat janë përjashtuar nga TVSH-ja, vetëm 28% e farmacive që janë marrë për analizë (7 farmaci nga 25 gjithsej), kanë pasur rritje të raportit të fitimit marxhinal. Ndërsa pjesa tjetër konkretisht 72% kanë pasur rënie të raportit të fitimit marxhinal, që do të thotë se ndryshimi tatimor në lidhje me TVSH-në ka ndikuar negativisht në fitueshmërinë e pjesës më të madhe të farmacive. Ndryshimet e raportit për këtë vit luhaten nga 0.28% në 18.32%.

Për vitet 2011 dhe 2014, 24% e farmacive të marra në studim kanë shfaqur të njëjtën sjellje, e shoqëruar me rritje të raportit të fitimit marxhinal, pavarësisht ndryshimeve tatimore. 20% e farmacive të marra në studim kanë shfaqur sjellje të njëjtë në vitet 2011 dhe 2014, por e

reflektuar me rënien e raportit të fitimit marxhinal. 52% e farmacive të marra në studim kanë pasur rritje të raportit të fitimit marxhinal kur një pjesë e barnave janë përfshirë në normën 10% të TVSH-së dhe kanë pasur rënie të raportit të fitimit marxhinal kur barnat janë përjashtuar nga TVSH-ja. Ndërsa 4% e farmacive të marra në studim, kanë pësuar rënie të raportit të fitimit marxhinal kur një pjesë e barnave janë përfshirë në normën 10% të TVSH-së dhe kanë pësuar rritje të raportit të fitimit marxhinal kur barnat janë përjashtuar nga TVSH-ja.

Ndërsa vlera më e ulët e raportit të keshit është -10.02 herë, ndërkohë që vlera më e lartë e raportit të keshit është 84.92 herë. Në vitin 2011, kur një pjesë e barnave janë përfshirë në normën 10% të TVSH-së, 52% e farmacive të marra në studim (13 farmaci nga 25 gjithsej) kanë pësuar një rritje të raportit të keshit. Kjo rritje e raportit të keshit tregon edhe rritje të likuiditetit dhe siç dihet sa më likuid të jetë një biznes, aq më pak mundësi ka të përjetojë vështirësi në kryerjen e aktiviteteve të tij. Ndërsa në vitin 2014, kur barnat u përjashtuan nga TVSH-ja, 60% e farmacive të marra në studim (15 farmaci nga 25 gjithsej) kanë pësuar rritje të raportit.

32% e farmacive të marra në studim, kanë shfaqur sjellje të njëjtë e reflektuar me rritjen e raportit të keshit në vitin 2011 dhe në vitin 2014. 20% e farmacive të marra në studim kanë shfaqur sjellje të njëjtë në vitet 2011 dhe 2014, por e reflektuar me rënien e raportit të keshit. Po 20% e farmacive të marra në studim kanë pasur rritje të raportit të keshit kur një pjesë e barnave janë përfshirë në normën 10% të TVSH-së dhe kanë pasur rënie të raportit të keshit kur barnat janë përjashtuar nga TVSH-ja. Ndërsa 28% e farmacive të marra në studim, kanë pësuar rënie të raportit të keshit kur një pjesë e barnave janë përfshirë në

normën 10% të TVSH-së dhe kanë pësuar rritje të raportit të keshit kur barnat janë përjashtuar nga TVSH-ja.

Përsa i përket pyetjes kërkimore kryesore janë identifikuar 11 variabla të ndarë në katër modele hipotezash.

Tek grupi i dytë i hipotezave, për Shqipërinë kam arritur rezultatet përkatëse:

Në modelin e parë të përcaktuesve të të ardhurave të TVSH-së, në lidhje me komponentët e tregtisë ndërkombëtare u arritën konkluzionet e mëposhtme:

Për periudhën e marrë në studim 2005-2017, variablat e marrë në studim: hapja ekonomike, rritja e importeve në përqindje, rritja e eksporteve në përqindje dhe volumi tregtar rezultuan se kanë ndikim tek të ardhurat e TVSH-së nga vërtetimi i hipotezave. Për modelin e parë rreth 99% e variacionit të variablit të varur arrihet të shpjegohet nga variacioni i variablave të pavarur, ndërsa pjesa tjetër mbetet e pashpjegueshme. Meqënëse vlera e përllogaritur nga modeli i regresionit është $d = 0.8626$ (zona midis d_L dhe d_U nuk mund të merret ndonjë vendim për të treguar nëse në këtë model ka prani të autokorrelacionit.

Në modelin e dytë të përcaktuesve të të ardhurave të TVSH-së, në lidhje me komponentët e tregut të punës dhe konsumit u arritën konkluzionet e mëposhtme:

Për periudhën e marrë në studim 2005-2016, u vërtetua hipoteza se papunësia dhe konsumi i familjeve kanë ndikim tek të ardhurat e TVSH-së dhe janë statistikisht të rëndësishëm në nivelet e rëndësisë përkatësisht 10% dhe 1%. Ndërsa për variablin e rritjes së PBB-së për frymë, u zbulua një lidhje pozitive me të ardhurat e TVSH-së, por që nuk kishin ndikim tek këto të fundit. U zhvillua një model tjetër i përmirësuar, me largimin e variablit të rritjes së PBB-së për frymë dhe rreth 97% e variacionit të variablit të varur arrihet të shpjegohet nga

variacioni i variablave të pavarur, ndërsa pjesa tjetër mbetet e pashpjegueshme. Edhe në këtë model meqënëse vlera e përlllogaritur nga modeli i regresionit është $d = 1.467$ (zona midis d_L dhe d_U nuk mund të merret ndonjë vendim për të treguar nëse në këtë model ka prani të autokorrelacionit.

Në modelin e tretë të përcaktuesve të të ardhurave të TVSH-së, në lidhje me komponentët makroekonomikë u arritën konkluzionet e mëposhtme:

Për periudhën e marrë në studim 2005-2017, u vërtetua hipoteza se PBB-ja reale nuk ka ndikim tek të ardhurat e TVSH-së. Ndërsa për dy variablat e tjerë inflacioni dhe shpenzimet qeveritare u vërtetua hipoteza se kanë ndikim tek të ardhurat e TVSH-së dhe janë statistikisht të rëndësishëm në nivelet e rëndësisë 5% dhe 1%. Meqëse variabli i PBB-së reale duhet të largohet nga modeli, kam zhvilluar një model të përmirësuar me të dhënat e mëparshme dhe rezulton se rreth 97% e variacionit të variablit të varur arrihet të shpjegohet nga variacioni i variablave të pavarur, ndërsa pjesa tjetër mbetet e pashpjegueshme. Përsa i përket autokorrelacionit, vlera e përlllogaritur nga modeli i regresionit është $d = 1.8206$ (zona midis d_U dhe $4 - d_U$ pranohet hipoteza zero, dmth në këtë model nuk kemi prani të autokorrelacionit dhe ky është një tregues i mirë.

Në modelin e katërt të përcaktuesve të të ardhurave të TVSH-së, në lidhje me komponentët e evazionit fiskal u arritën konkluzionet e mëposhtme:

Për periudhën e marrë në studim 2002-2017, u vërtetua hipoteza se indeksi i përceptuar i korrupsionit ka ndikim tek të ardhurat e TVSH-së dhe është statistikisht i rëndësishëm në nivelin e rëndësisë 1%. Rezultatet e këtij studimi ishin në përputhje me teoritë nga (Sarmiento, 2016) dhe (Oordt, 2016), të cilët pohojnë se një nivel i ulët i korrupsionit rrit të ardhurat e TVSH-së.

Në përfundim të konkluzioneve kam vendosur tabelat përmbledhëse të rezultateve të modeleve të hipotezave. Në secilën prej tyre përshkruhen variablat sipas modeleve të veçanta, shenja që ka rezultuar nga punimi im dhe shenja e pritshme e lidhjes referuar literaturës. Gjithashtu specifikohet nëse rezultati është statistikisht domëthënës ose jo domëthënës.

Tabela 39- Krahاسimi i shenjave të variablave, Grupi i parë i hipotezave, Rasti i Shqipërisë

Nr.	Përshkrimi i variablilit	Shenja e rezultuar	Shenja e pritshme	Rezultati
1	Hapja ekonomike	Pozitive	- Nina Legeida, Dmitry Sologoub, 2003 (Pozitive)	Statistikisht domëthënës
2	PBB reale	Negative	- Nina Legeida, Dmitry Sologoub, 2003 (Pozitive)	Jo domëthënës

Burimi: Ilustrim nga autori

Tabela 40- Krahاسimi i shenjave të variablave, Grupi i parë i hipotezave, Rasti i Kosovës

Nr.	Përshkrimi i variablilit	Shenja e rezultuar	Shenja e pritshme	Rezultati
1	Hapja ekonomike	Pozitive	Nina Legeida, Dmitry Sologoub, 2003 (Pozitive)	Jo domëthënës
2	PBB reale	Negative	Nina Legeida, Dmitry Sologoub, 2003 (Pozitive)	Statistikisht domëthënës

Burimi: Ilustrim nga autori

Tabela 41- Krahاسimi i shenjave të variablave, Grupi i dytë i hipotezave, Modeli i parë, Rasti i Shqipërisë

Nr.	Përshkrimi i variablilit	Shenja e rezultuar	Shenja e pritshme	Rezultati
1	Hapja ekonomike	Negative	- Godin & Hindriks (2015) Pozitive - Azaria & Robinson (2005) Pozitive	Statistikisht domëthënës
2	Importet	Pozitive	- Bikas & Andruskaite (2013), Pozitive	Statistikisht domëthënës
3	Eksportet	Pozitive	- Bikas & Andruskaite (2013), Negative	Statistikisht domëthënës
4	Volumi tregtar	Negative	- Wawire (2011), Pozitive	Statistikisht

Burimi: Ilustrim nga autori

Tabela 42- Krahاسimi i shenjave të variablave, Grupi i dytë i hipotezave, Modeli i dytë, Rasti i Shqipërisë

Nr.	Përshkrimi i variablilit	Shenja e rezultuar	Shenja e pritshme	Rezultati
1	Papunësia	Negative	- (Bikas & Rashkauskas 2011), Negative	Statistikisht domëthënës
2	Konsumi i familjeve	Pozitive	- Bikas & Rashkauskas (2011), Pozitive	Statistikisht domëthënës
3	PBB-ja për frymë	Pozitive	- Bikas & Andruskaite (2013), Pozitive - Azaria & Robinson (2005), Negative	Jo domëthënës

Burimi: Ilustrim nga autori

Tabela 43- Krahاسimi i shenjave të variablave, Grupi i dytë i hipotezave, Modeli i tretë, Rasti i Shqipërisë

Nr.	Përshkrimi i variablilit	Shenja e rezultuar	Shenja e pritshme	Rezultati
1	PBB reale	Pozitive	- Bikas & Andruskaite (2013), Pozitive - Wawire (2011), Pozitive	Jo domëthënës
2	Inflacioni	Pozitive	- (Pagán, 2001), Pozitive	Statistikisht domëthënës
3	Shpenzimet qeveritare	Pozitive	- Pagán, 2001), Pozitive - Dominic Adamnor Nartey, 2011, Pozitive	Statistikisht domëthënës

Burimi: Ilustrim nga autori

Tabela 44- Krahاسimi i shenjave të variablave, Grupi i dytë i hipotezave, Modeli i katërt, Rasti i Shqipërisë

Nr.	Përshkrimi i variablilit	Shenja e rezultuar	Shenja e pritshme	Rezultati
1	Indeksi i përceptuar i korrupsionit	Pozitive ³⁵	- (Joaquim Sarmiento), 2016, Pozitive - (Marius van Oordt 2016, Pozitive	Statistikisht domëthënës

³⁵ Duhet të mbahet parasysh se rritja e vlerës së indeksit tregon për një nivel të ulët korrupsioni siç është treguar gjatë punimit. Sa më afër 0 të jetë vlera e korrupsionit e një shteti, aq më i korruptuar është ai vend. E kundërta, sa më afër vlerës 100, aq më i ulët është niveli i korrupsionit për atë vend.

Burimi: Ilustrim nga autori

7.3 Rekomandime

Kthimi prapa në histori është një mënyrë efektive për të nxjerrë tiparet më të mira të politikës ekonomike dhe tatimore në vite, sepse është pikërisht e kaluara e cila mund të nxjerrë leksionet për të ardhmen e tatimeve. Prandaj politikbërësit mund të përshtasin nga e kaluara specifikime ligjore në bashkërendim me sjelljen e komponentëve të tjerë.

Rritjen e efikasitetit të administratës tatimore për mbledhjen e të ardhurave tatimore, me një vëmendje të veçantë tek TVSH-ja, e cila përbën peshën më të madhe të të ardhurave.

Një administrim eficient nevojitet edhe në dogana, meqenëse në Shqipëri mbledhen mesatarisht 75% e të ardhurave totale të TVSH-së në dogana për një vit, ndërsa në Kosovë mbledhen mesatarisht 74%, referuar të dhënave për vitin 2017.

Evazioni fiskal me mënyrat e shumta të ndërveprimit të tij prodhon efekte negative në ekonomi. Mbledhja e të ardhurave më të ulëta krijon vështirësi në shpërndarjen e këtyre burimeve për financimin e shërbimeve publike. Ndaj, një vëmendje e veçantë i duhet kushtuar, jo vetëm subjekteve tregtare, por edhe nëpunësve publikë.

Nëse në një vend rritet kultura për të paguar tatimet dhe taksat, shumë procese do të kishin një funksionim më të mirë. Një nxitje e kulturës tatimore, ose për më tepër rritja e besimit të qytetarëve tek fortësia e sistemit ligjor nga institucionet përkatëse sjell për ekonominë e vendit të ardhura edhe më të larta, prandaj kjo çështje duhet të shihet me përparësi.

Mosdepozitimi i pasqyrave financiare vjetore në QKB nga ana e subjekteve, përveç faktit që përbën kundërvajtje administrative, krijon mangësi në kryerjen e analizave nga studjuesit e ndryshëm, studentët, akademikët, etj. Ligji ka përcaktuar masën e gjobës që është 15000 lekë, por përsëri kjo shkelje ligjore vazhdon të ndodhë. Përveç kornizës ligjore

që mundohet ta zvogëlojë këtë kundërvajtje administrative, duhet rritur edhe përgjegjshmëria e subjekteve për të kryer deklaratimet e nevojshme.

TVSH-ja me specifikimet e saj ligjore, përse i përket normës standarte, të reduktuar, aplikimit etj., të jetë një tatim favorizues për krijimin e firmave të reja, thithjen e investimeve të huaja direkte, si edhe për vazhdimësinë me sukses të firmave ekzistuese.

Në rastet e ndryshimeve dhe transformimeve të rëndësishme në lidhje me tatimet në përgjithësi, si edhe me TVSH-në në veçanti, duhet të promovohen më përpara që menaxherëve dhe financierëve t'iu jepet mundësia për të kryer rregullimet e duhura dhe ristrukturimet financiare, në mënyrë të tillë që ndryshimi të mos ndikojë negativisht në performancën dhe raportet financiare.

Farmacitë janë një biznes i cili aktualisht ka prespektivë për zhvillim, por një ndërhyrje e institucioneve përkatëse për një shpërndarje optimale do të ndihmonte në optimizimin e këtij tregu.

Meqënëse pesha e TVSH-së ndaj totalit të të ardhurave në buxhetin e shtetit në Shqipëri është më e lartë se mesatarja e vendeve anëtare në BE, kjo është një sinjal që politikat dhe strategjitë lidhur me këtë tatim, duhet të kenë vëmendjen e duhur në raste ndryshimesh.

Rritja e të ardhurave të TVSH-së të përdoret për rishpërndarjen e duhur të të ardhurave.

Një rekomandim tjetër do të ishte krijimi i sistemeve monitoruese për të parashikuar fondet e mjaftueshme për rimbursimet e TVSH-së në rastet kur ka pretendime.

Gjetjet e analizës së rimbursimit të TVSH-së mund të jenë objekt hulumtimi për studime më të thelluara nga akademikët nisur nga rezultatet e kundërta të ndikimit të hapjes ekonomike dhe PBB-së reale tek rimbursimi i TVSH-së në Shqipëri dhe Kosovë. Ndonëse dy shtete me pozicione gjeografike të afërta, ndërveprimi i komponentëve makroekonomikë

të tyre sjell rezultate të ndryshme dhe kjo mund të jetë një pikënisje për studim akademik. Konkluzionet e kësaj teze të argumentuara akademikisht, sado modeste, duhet t'iu shërbejnë politikbërësve për një administrim më të mirë të TVSH-së për prespektiva afatgjata. Ky punim duhet t'iu shërbejë gjithashtu edhe menaxherëve të firmave, të cilët mund të planifikojnë mbarëvajtjen e performacës financiare, si edhe të ecurisë së komponentëve të cilët ndikojnë në të ardhurat dhe rimbursimin e TVSH-së.

7.4 Sugjerime për studime të mëtejshme

Në fund të këtij disertacioni kam vendosur disa sugjerime për studime të mëtejshme.

Ndikimet e transformimit të TVSH-së shfaqen në dimensione të ndryshme për sektorë të ndryshëm. Gjatë këtij punimi është paraqitur një analizë e studimit të transformimit të TVSH-së për 25 farmaci në një seri kohore prej tetë vitesh. Një sugjerim i imi do të ishte studimi i kësaj çështjeje më gjërësisht si një temë me vete, për një seri kohore më të gjatë pas disa vitesh, duke marrë në konsideratë një numër më të madh farmacish për të analizuar efektin në një sasi më të madhe.

Në këtë punim janë ndërtuar modelet e hipotezave dhe të analizave në nivel kombëtar. Mendoj se do të ishte me interes studimi i këtyre modeleve, aty ku është e mundur, sipas 12-të qarqeve për të gjithë Shqipërinë. Analizat e kryera sipas njësive administrative mund t'iu shërbejnë më mirë drejtorive tatimore rajonale, subjekteve tregtare sepse janë të më fokusuara. Për më tepër, rezultatet e këtyre modeleve mund të krahasohen në nivel kombëtar, duke krijuar mundësitë për përmirësime aty ku duhet.

REFERENCAT

Literaturë

1. Bird R. M. & Gendron P-P., (2007). The Vat in Developing and Transitional Countries. New Issues in VAT Design. New York: Cambridge University Press.
2. Bundo Sh., (2012). Fiskalitete, Tiranë, albPAPER.
3. Dharmo S., (2010). Kontabiliteti Financiar, 1^o. Tiranë, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë.
4. Encyclopedia.com, (2009). Value-Added Tax. Marrë nga Encyclopedia.com: <https://www.encyclopedia.com/social-sciences-and-law/economics-business-and-labor/businesses-and-occupations/value-added-tax> (parë më 02 prill 2018).
5. Gujarati D. (2004) Basic Econometrics, Fourth Edition. Marrë nga: https://himayatullah.weebly.com/uploads/5/3/4/0/53400977/gujarati_book.pdf (parë më 03 shkurt 2018).
6. Le T. M., (2003). Value Added Taxation: Mechanism, Design, and Policy Issues. Marrë nga: <http://citeseerx.ist.psu.edu/viewdoc/download;jsessionid=814ABE96DD3306A9BF313184B323020A?doi=10.1.1.197.4742&rep=rep1&type=pdf> (parë më 05 prill 2018).
7. Palokaj A. & Tuhina Gj., (2016). Çfarë pas MSA: Raportet Kosovë-BE. Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur. Marrë nga: http://kfos.org/wp-content/uploads/2016/11/MSA-shqip_TEXT-2.compressed.pdf (parë më 08 shkurt 2018).

8. Shtetiweb (2012). Ç'janë tatimet dhe taksat? Marrë nga Shtetiweb:
<http://shtetiweb.org/2012/09/29/cjane-tatimet-dhe-taksat/> (parë më 04 shkurt 2018).
9. Shtetiweb (2014). Evazioni fiskal. Marrë nga Shtetiweb:
<http://shtetiweb.org/2014/11/03/evazioni-fiskal/> (parë më 04 maj 2018).

Burime parësore

1. Administrata Tatimore e Kosovës, (2018). Të dhëna mbi numrin e bizneseve nën/mbi pragun e TVSH-së, (E.Sele, Interviewer).
2. Agjensia e Statistikave të Kosovës, (2018). Eksporti dhe importi sipas vendeve, 2010-2017. Marrë nga Agjensia e Statistikave të Kosovës: http://askdata.rks-gov.net/PXWeb/pxweb/sq/askdata/askdata__External%20trade__Yearly%20indicators/tab02.px/?rxid=f89166dc-7d99-4e30-86a7-ce5e6344a83e (parë më 20 prill 2018).
3. AIDA, (2018). Treguesit makroekonomik. Marrë nga AIDA:
<http://aida.gov.al/faqe/treguesit-makroekonomik> (parë më 25 maj 2018).
4. ALTAX, (2018). Barra Tatimore Në Shqipëri, Kosovë dhe Ballkan, 2018.
5. Banka Qëndrore e Kosovës. Raporti i zhvillimeve makroekonomike, 2007-2016.
6. Buettner Th., Madzharova B., (2016). Pre-announced VAT Increases and the Sales of Consumer Durables. CESifo Area Conference on Public Sector Economics.
7. Deloitte, (2015). Udhëzimi Administrativ 03/2015 për zbatimin e Ligjit 05/L-037 mbi TVSh. Marrë nga Deloitte:

https://www2.deloitte.com/content/dam/Deloitte/al/Documents/tax/Deloitte%20Kosova%20-%20Tax%20News%20October%202015.pdf_ALB.pdf (parë më 14 prill 2018).

8. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (2018). Deklarimi Individual Vjetor i të Ardhurave në 2018, mbi 8,700 individë dorëzuan deklaratën. Marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve: <https://www.tatime.gov.al/d/8/45/0/590/deklarimi-individual-vjetor-i-teardhurave-ne-2018-mbi-8700-individe-dorezuan-deklaraten->. (parë më 18 korrik 2018).
9. European Commission (2003). Reduced rates of VAT: frequently asked questions. MEMO/03/149. Marrë nga: http://europa.eu/rapid/press-release_MEMO-03-149_en.htm?locale=en (parë më 17 maj 2018).
10. European Commission (2018). Vat rates applied in the Member States of the European Union. Marrë nga: https://ec.europa.eu/taxation_customs/sites/taxation/files/resources/documents/taxation/vat/how_vat_works/rates/vat_rates_en.pdf (parë më 08 gusht 2018).
11. Farmaci A F A - Farma, Pasqyrat Financiare, 2009-2016. Marrë nga QKB-ja.
12. Farmaci Albpharma Canada, Pasqyrat Financiare, 2009-2016. Marrë nga QKB-ja.
13. Farmaci Aldosch - Farma, Pasqyrat Financiare, 2009-2016. Marrë nga QKB-ja.
14. Farmaci Almegipharma, Pasqyrat Financiare, 2009-2016. Marrë nga QKB-ja.
15. Farmaci "Ana 12", Pasqyrat Financiare, 2009-2016. Marrë nga QKB-ja.
16. Farmaci Anipharma, Pasqyrat Financiare, 2010-2009. Marrë nga QKB-ja.
17. Farmaci Bylis Pharma Shpk, Pasqyrat Financiare, 2009-2016. Marrë nga QKB-ja.

18. Farmaci CFO Pharma Kashar, Pasqyrat Financiare, 2009-2016. Marrë nga QKB-ja.
19. Farmaci Dispers Farma, Pasqyrat Financiare, 2009-2016. Marrë nga QKB-ja.
20. Farmaci "Farma - Shqip" Shpk, Pasqyrat Financiare, 2009-2016. Marrë nga QKB-ja.
21. Farmaci Florifarma, Pasqyrat Financiare, 2009-2016. Marrë nga QKB-ja.
22. Farmaci Fufarma, Pasqyrat Financiare, 2009-2016. Marrë nga QKB-ja.
23. Farmaci Gen - Alb Farma, Pasqyrat Financiare, 2009-2016. Marrë nga QKB-ja.
24. Farmaci Genericspharma, Pasqyrat Financiare, 2009-2016. Marrë nga QKB-ja.
25. Farmaci Gerifarma, Pasqyrat Financiare, 2009-2016. Marrë nga QKB-ja.
26. Farmaci Mati-Farma, Pasqyrat Financiare, 2009-2016. Marrë nga QKB-ja.
27. Farmaci Megapharma, Pasqyrat Financiare, 2009-2016. Marrë nga QKB-ja.
28. Farmaci Onovo Pharma, Pasqyrat Financiare, 2009-2016. Marrë nga QKB-ja.
29. Farmaci Pharma One Shpk, Pasqyrat Financiare, 2009-2016. Marrë nga QKB-ja.
30. Farmaci Profarma, Pasqyrat Financiare, 2009-2016. Marrë nga QKB-ja.
31. Farmaci Rejsi Farma Shpk, Pasqyrat Financiare, 2009-2016. Marrë nga QKB-ja.
32. Farmaci Sat Farm Shpk, Pasqyrat Financiare, 2009-2016. Marrë nga QKB-ja.
33. Farmaci Shkozeti, Pasqyrat Financiare, 2009-2016. Marrë nga QKB-ja.
34. Farmaci Veco Pharma, Pasqyrat Financiare, 2009-2016. Marrë nga QKB-ja.
35. Farmaci Zhani Farmaci, Pasqyrat Financiare, 2009-2016. Marrë nga QKB-ja.
36. Gashi P. & Pugh G. (2015). Marrëdhëniet Tregtare mes Kosovës dhe Bashkimit Evropian – Shikim përtej Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asocim. Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur. Marrë nga:

http://kfos.org/wp-content/uploads/2015/04/Marr%C3%ABdh%C3%ABniet-Tregtare-mes-Kosov%C3%ABs-dhe-Bashkimit-Evropian_E-KOMPLETUAR.compressed.pdf (parë më 18 mars 2018).

37. Instat, (2016). Anketa e Buxhetit të Familjes. Marrë nga Instat:

<http://www.instat.gov.al/media/3490/anketa-e-buxhetiti-te-familjeve-2016.pdf>
(parë më 09 prill 2018).

38. INSTAT, (2018). Import/Eksport sipas vendeve partnereve 2005-2017. Marrë nga Instat:

http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/START__FT__FTY/NewFTY001/?rxid=04d3452f-64d6-4e0a-9a56-2d03fccf378e (parë më 02 prill 2018).

39. INSTAT, (2018). Konsumi final i familjeve 1996-2016. Marrë nga Instat:

http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/START__NA__NAY__NAY1/NASH_2/?rxid=04d3452f-64d6-4e0a-9a56-2d03fccf378e (parë më 02 prill 2018).

40. INSTAT, (2018). Prodhimi i brendshëm bruto sipas metodës së prodhimit 1996-2016. Marrë nga Instat:

http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/START__NA__NAY__NAYPA/NAYPA1/?rxid=04d3452f-64d6-4e0a-9a56-2d03fccf378e (parë më 02 prill 2018).

41. ITD (2005). The Value Added Tax Experiences and Issues Background Paper Prepared for the International Tax Dialogue Conference on the VAT Rome, March 15–16.

42. Macharia W. B., (2014). Factors influencing adoption of value added tax (vat) in social commerce in Kenya: A case of Kenya Revenue Authority. Projekt kërkimor. United States International University. p. 73-87.
43. Ministria e Ekonomisë dhe Financave RK, (2008). TVSH – Ndryshimi I Normës Prej 15% Në 16%. Udhëzues Për Bizneset E Regjistruara Për Tvsh. Marrë nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave RK:
http://www.atk-ks.org/wp-content/uploads/2017/08/Ndryshimi_normave_TVSH.pdf (parë më 02 korrik 2018).
44. Ministria e Financave RK, (2018). Seritë fiskale mujore. Marrë nga Ministria e Financave RK: <https://mf.rks-gov.net/Page.aspx?id=1,125> (parë më 14 korrik 2018).
45. Ministria e Financave RSH (Treguesit makroekonomik), 2005-2017.
46. Ministria e Financave RSH, (2018). Treguesit Analitik Fiskal Dhjetor 2017. Marrë nga Ministria e Financave RSH:
http://www.financa.gov.al/wp-content/uploads/2018/07/Treguesit_analitik_fiskal_-_dhjetor_2017.pdf (parë më 15 prill 2018).
47. Moździerz A., (2017). The Impact of Changes in Indirect Tax Rates on Inflation in Selected EU Countries. Marrë nga:
http://dlibra.umcs.lublin.pl/Content/28750/czas9547_51_4_2017_26.pdf (parë më 14 janar 2018).
48. Oordt M. V. (2016). Value Added Tax Effort and the Influence of Governance. Paper presented at the VAT in Developing Countries: Policy, Law and Practice Symposium, 4-28.

49. Open Data Albania, (2011). Historik i Inflacionit ne Shqiperi. Marrë nga Open Data Albania: <http://open.data.al/sq/lajme/lajm/lang/sq/id/71/Historik-i-Inflacionit-ne-Shqiperi>. (parë më 24 janar 2018).
50. PBM, (2011). Tax Alert Shkurt 2011. Marrë nga: PBM: http://www.pbm.al/web/pub/tax_alert_shqip_feb_2011_38_1.pdf (parë më 23 shkurt 2018).
51. Pwc (2018). Paying Taxes 2017. VAT compliance The impact on business and how technology can help. Marrë nga: <https://www.pwc.at/de/publikationen/umsatzsteuer/vat-compliance-paying-taxes2017.pdf> (parë më 20 korrik 2018).
52. Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2000/20, e datës 12 prill 2000, “Mbi Administratën dhe Procedurat Tatimore”.
53. Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2000/3, e datës 22 Janar 2000 “Mbi Tatimin në Shitje në Kosovë”.
54. Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/11, e datës 31 maj 2001, ‘Për Tatimin Mbi Vlerën E Shtuar’.
55. Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/41, e datës 31 dhjetor 2001, “Ndryshimi i Rregullores së Unmiku-ut Nr. 2001/11 Për Tatimin Mbi Vlerën e Shtuar Në Kosovë”.
56. Rregullorja e UNMIK-ut Nr.2000/5, e datës 1 Shkurt 2000, “Mbi Vendosjen e Tatimit në Hotele, Ushqim dhe Pije në Kosovë.

57. Sekwati L., Malema B. W., (2011). Potential Impact of The Increase In Vat On Poor Households In Botswana. Marrë nga:
<http://www.ijeronline.com/documents/volumes/vol2issue1/ijer2011020105.pdf>
(parë më 30 prill 2018).
58. Toma D., (2018). Intervistë e Presidentes së Urdhrit të Farmacistit në lidhje me 8 problemet e mëdha të tregut të farmacive. Marrë nga Monitor:
<http://www.monitor.al/toma-biznesi-veshtire-farmacise-8-problemet-e-medha-te-tregut-2/> (parë më 07 gusht 2018).
59. Transparency International (2018). Corruption Perceptions Index 2017. Marrë nga Transparency International:
https://www.transparency.org/news/feature/corruption_perceptions_index_2017
(parë më 29 qershor 2018).
60. Udhëzim Nr.17 Datë 13.05.2008 “Për Tatimin Mbi Vlerën E Shtuar i Ndryshuar”.
61. Udhëzimi Nr. 6, Datë 30.01.2015, “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”.
62. Xprimm.com, (2018). About Commonwealth of Independent States (CIS). Marrë nga Xprimm.com: <http://www.xprimm.com/CIS-Countries-2,12.htm>. (parë më 12 gusht 2018).

Ligjet:

1. Ligji nr. 05/L-037 për ‘Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Kosovës’.
- Ligji nr. 10363, datë 16.12.2010, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar.

2. Ligji Nr. 140/2016 “Për Disa Ndryshime në Ligjin Nr. 155/2015 Për Lojërat E Fatit Në Republikën E Shqipërisë”.
3. Ligji nr. 7928, dt. 27.04.1995“Për tatimin mbi vlerën e shtuar”.
4. Ligji Nr. 8438, Datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat në Republikën e Shqipërisë i Ndryshuar”.
5. Ligji Nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
6. Ligji Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore Në Republikën e Shqipërisë”. Ligji Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore i ndryshuar”.
7. Ligji Nr. 9723/2007, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.
8. Ligji 99/2015 "Për Procedurat Tatimore", i botuar në Fletoren Zyrtare nr. 187, datë 28 Tetor, 2015, dhe që ka hyrë në fuqi më 12 Nëntor, 2015.

Burime sekondare

1. Aamir M., Qayyum A., Nasir A., Hussain Sh., Khan K. I. & Butt S., (2011). Determinants of Tax Revenue: A Comparative Study of Direct taxes and Indirect taxes of Pakistan and India. International Journal of Business and Social Science, 173-177.
2. Acp.al, (2018). 2017, rimbursimi i TVSH rritet me 56 per qind prej projekteve te medha. Marrë nga Acp.al: <http://acp.al/news/4138/2017,-rimbursimi-i-TVSH-rritet-me-56-per-qind-prej-projekteve-te-medha/> (parë më 18 janar 2019).

3. Adejare A. T. & Akande Sh. S., (2017). The Impact of Value Added Tax on Private Investment in Nigeria Adegbite. *Account and Financial Management Journal*, 644-650.
4. Ahmetaj A. (2018). Deklaratë e Ministrit të Financave: TVSH e biznesit të vogël për ta vjelë nga biznesi i madh. Marrë nga Shekulli: <http://shekulli.com.al/ahmetaj-tvsh-e-biznesit-te-vogel-per-ta-vjele-nga-biznesi-i-madh/> (pare më 30 korrik 2018).
5. Alavuotunki K., Haapanen M. & Pirttilä J. (2018). The Effects of the Value-Added Tax on Revenue and Inequality, *The Journal of Development Studies*, 15.
6. Alm J., & El-Ganainy A., (2012). Value-added taxation and consumption. *International Tax and Public Finance* 20 (1): 124–126.
7. Ana Lucia Alvarez Vijil, (2017). Incidence of The Value- Added Tax On Men and Women in Nicaragua. Tezë Masteri: Universiteti Cornell, Instituti Cornell për Çështje Publike.
8. Andrejovská A., Mihóková L., (2015). Developments of Vat Rates in EU Countries In The Context Of Harmonization And Fiscal Consolidation. *Acta Universitatis Agriculturae Et Silviculturae Mendelianae Brunensis*, Volume 63, 487-496.
9. Anojan V. (2015) Value Added Tax (Vat), Gross Domestic Production (GDP) And Budget Deficit (Bd): A Case Study in Sri Lanka. Marrë nga: <https://doctiktak.com/value-added-tax-vat-gross-domestic-production-gdp-and-budget-deficit-bd-a-case-s.html> (parë më 05 mars 2018).
10. Asatryan Z. & Peichl A., (2016). Responses of Firms to Tax, Administrative and Accounting Rules: Evidence from Armenia. Discussion Paper No. 16-065, ZEW, Centre for European Economic Research, 25-31.

11. Auziņš A., Nipers A., Kozlinskis V. (2008). Effect of value Added Tax Rate Changes on Market Equilibrium. *Management Theory and Studies for Rural Business and Infrastructure Development*, 15- 23.
12. Azaria, N. T. & Robinson, Z. (2005). The Revenue Raising Capabilities of a VAT System in Developing Countries. *South African Journal of Economic and Management Sciences* 8 (1), 63-76.
13. Barrell R. & Weale M., (2009). The Economics of a Reduction in VAT. Paper No 325, National Institute of Economic and Social Research, 8-10.
14. Bikas E. & Rashkauskas J. (2011). Value Added Tax Dimension: The CASE of Lithuania. *Ekonomika* Vol. 90(1), 22-37.
15. Bikas E., & Andruskaite E.,(2013) “Factors Affecting Value Added Tax Revenue” 1st Annual International Interdisciplinary Conference, Marrē nga: <https://eujournal.org/index.php/esj/article/view/1230/1239> (parē mē 17 shkurt 2018).
16. Boadway R. & Sato M. (2008). Optimal Tax Design and Enforcement with an Informal Sector. Working Paper No. 1168: Queen’s University, Departamenti i Ekonomisë, 27-31.
17. Boeters S., Böhringer C., Büttner Th. & Kraus M., (2006). Economic Effects of VAT Reform in Germany. Discussion Paper No. 06-030, ZEW, Centre for European Economic Research, 18-20.
18. Bonga W. G., (2017). Empirical Examination of the Link between Value Added Tax and Total Tax Revenues in Zimbabwe. *Dynamic Research Journals, Journal of Economics and Finance*, 5-12.

19. Bubić J., Mladineo L. & Šušak T., (2016). Vat Rate Change and Its Impact On Liquidity. Management, Vol. 21, 151-163.
20. Chen D., (2015). The Framework for Assessing Tax Incentives: A CostBenefit Analysis Approach. Paper for Workshop on Tax Incentives and Base Protection New York, 23-24 April. Marrë nga:
http://www.un.org/esa/ffd/wp-content/uploads/2015/04/2015TIBP_PaperChen.pdf
(parë më 08 qershor 2018).
21. Chigbu E. E. & Ali P. I. (2014). Econometric Analysis of the Impact of Value Added Tax on Economic Growth in Nigeria. Research Journal of Finance and Accounting, Vol.6, No.18, 31-35.
22. Da Silva C.S.F., (2016), The determinants of value added tax revenues in Portugal. Tezë Masteri: Lisboa School of Economics & Management, 4-17.
23. Daude, C., Gutiérrez, H. & Melguizo Á., (2012). “What Drives Tax Morale”, OECD Development Centre, Working Paper 315, 1-38.
24. De la Feria R. & Krever R. (2012). Ending VAT Exemptions: Towards A Post-Modern VAT. Working Paper 12/28: Qendra e Universitetit të Oxfordit për Taksën e Biznesit, 23- 27.
25. Desai M. A. & Hines J. R. Jr., (2005) Value-Added Taxes and International Trade: The Evidence. Working Paper: Universiti i Michigan-it, Shkolla e Drejtësisë, 20-21.
26. Dijkstra J., (2013). The influence of the VAT increase on consumer prices. Tezë Masteri në Ekonomi dhe Taksim.
27. Dobrowolska B., (2008). Value Added Tax In European Union Countries - Comparative Analysis. Acta Universitatis Lodziensis Folia Oeconomica 223, 79-93.

28. Ebeke, C. H. & Ehrhart, H. (2011). Does VAT Reduce the Instability of Tax Revenues?. CERDI- Centre d'études et de Recherches sur le Developpement International, Etudes et Documents E 2011.24, 1-15.
29. Epaphra M., (2015). The Revenue Implications of Trade Liberalization in Tanzania. Paper No. 62330, Munich Personal RePEc Archive, 28-43.
30. Erero J. L. (2015). Effects of Increases in Value Added Tax: A Dynamic CGE Approach. Working Paper 558, Economic Research Southern Africa, 15-16.
31. Esmaeel E. S., (2013). The impact of direct-indirect taxation on consumer. IOSR Journal of Engineering, 8-13.
32. Fáilte Ireland (2014). Analysis of the Impact of the VAT Reduction on Irish Tourism & Tourism Employment. Marrë nga:

http://www.failteireland.ie/FailteIreland/media/WebsiteStructure/Documents/3_Research_Insights/3_General_SurveysReports/FA%C2%A1ilte-Ireland-Tourism-VAT-Study-Report-2014.pdf?ext=.pdf (parë më 16 prill 2018).
33. Feld, L.P., Frey B.S., & Torgler B., (2006). "Rewarding Honest Taxpayers? Evidence on the Impact of Rewards from Field Experiments," CREMA Working Paper Series, No: 2006-16, 1-20.
34. Financieri, (2011). Shëndetësia: 10% TVSH për barnat, ja si do të aplikohet. Marrë nga Financieri:<http://financieri.blogspot.com/2011/02/shendetesia-10-tvsh-per-barnat-ja-si-do.html> (parë më 30 mars 2018).
35. Fjeldstad O-H., (1995). Value-Added Taxation in Tanzania? WP 1995: 5, Development Studies and Human Rights, 1-25.

36. Gacanja E. W. (2012). Tax Revenues And Economic Growth: An Empirical Case Study of Kenya. Document kërkimor: Universiteti i Nairobit.
37. Gebresilasse M. M. & Sow S., (2015). Firm Response to VAT Registration Threshold in Ethiopia. Marrë nga:
<http://www.columbia.edu/~ss3721/EthiopiaVAT1.pdf> (parë më 20 prill 2018).
38. Gerger G. Ç., Gerçek A., Taşkın Ç., Bakar F. & Güzel S., (2014). Determining The Factors That Affect Taxpayers' Perspective On Tax Administration: Research in Turkey. International Journal of Economics And Finance Studies, Vol 6, No 1, 18-26.
39. Giesecke J. A. & Nhi T. H. (2009). Modelling Value-Added Tax in the Presence of Multiproduction and Differentiated Exemptions. General Paper No. G-182, The Centre of Policy Studies, 2-5.
40. Go D. S., Kearney M., Robinson Sh., Thierfelder K., (2005). An Analysis of South Africa's Value Added Tax. Working Paper 3671, World Bank Policy Research, 17-19.
19. Goyette J. (2012). Optimal VAT Threshold: Official vs. Effective Enforcement. Marrë nga:
https://editorialexpress.com/cgi-bin/conference/download.cgi?db_name=CSAE2012&paper_id=333 (parë më 21 maj 2018).
41. Greci C., (2015). Efficiency or redistribution? An empirical study of the implications of VAT design. Tezë Doktorature: Universiteti "Roma Tre", Departamenti i Ekonomisë.

42. Hajdúchová I., Sedliačiková M., and Viszlai I., (2015) “Value-added Tax Impact on the State Budget Expenditures and Incomes” *Procedia Economics and Finance* 34, 676 – 681.
43. Hansson Å., Porter S. & Williams S. P. (2012). The Effect of Political and Economic Factors on Corporate Tax Rates. Working Paper No. 942, Research Institute of Industrial Economics, 1-19.
44. Harrison G. & Krelove R., (2005). VAT Refunds: A Review of Country Experience. WP/05/218, International Monetary Fund, 1-36.
45. Hashimzade, N., Myles, G., & Binh T-N., (2010). New Approaches to the Economics of Tax Evasion. Marrë nga: <http://people.exeter.ac.uk/gdmyle/papers/pdfs/Non-euEva.pdf> (parë më 17 qershor 2018).
46. Hiadlovský V., Rybovičová I. & Vinczeová M., (2016). Importance Of Liquidity Analysis In The Process Of Financial Management Of Companies Operating In The Tourism Sector In Slovakia: An Empirical Study. *International Journal for Quality Research* 10(4) 799–812.
47. Hodzic S. & Celebi H., (2017). Value-Added Tax And Its Efficiency: EU–28 And Turkey. *Journal of Economics* 8 (2): 79–83.
48. Instituti GAP, (2016). Efektet e ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar. Marrë nga Instituti GAP: http://www.institutigap.org/documents/13679_Ligji%20p%C3%ABr%20TVS-H-%20final1.pdf (parë më 03 maj 2018).

49. Ironkwe U. & Peter G. T., (2015). Value added tax and the financial performance of quoted Agribusinesses in Nigeria. *International Journal of Business and Economic Development* Vol. 3 Number 1, 78-86.
50. James K., (2011). Exploring the Origins and Global Rise of VAT. *Tax Analysts*, 15-22.
51. Jansen A. & Calitz, E. (2015). How effective is VAT zero rating as a pro-poor policy? Marrë nga: <http://www.econ3x3.org/article/how-effective-vat-zero-rating-pro-poor-policy> (parë më 15 prill 2018).
52. Jitsing A. & Stern M. (2008). VAT Practices within SACU and possibilities for harmonization. Southern African Regional Integration Project, World Bank, 6-12.
53. Juddoo K. (2014). The compliance costs of Value Added Tax (VAT): The case of the Republic of Mauritius. *eJournal of Tax Research*, 499-510.
54. Kabátek J. (2009). The effects of VAT harmonisation on taxrevenue in the European Union. Tezë Bachelor-i: Universiteti Charles në Pragë, Fakulteti i Shkencave Sociale, Instituti i Studimeve Ekonomike.
55. Kalaš B. & Milenković N., (2017). The Role Of Value Added Tax In The Economy Of Serbia. *Ekonomika*, 69-78.
56. Kalaš B., Milenković I., Pjanić M., Andrašić J. & Milenković N., (2017). The Impact of Tax Forms on Economic Growth - Evidence from Serbia. *Industrija* 45 (2), 113-125.
57. Kanbur, R. & Keen M., (2014). "Thresholds, informality, and partitions of compliance," Charles H. Working Paper No: 11, Dyson School of Applied Economics and Management Cornell University, Ithaca, New York, 1- 24.

57. Kearney, M. (2003). Restructuring Value-Added Tax In South Africa A Computable General Equilibrium Analysis. Tezë Doktorature: University Of Pretoria.
58. Keen M. & Lockwood B. (2007). The Value Added Tax: Its Causes and Consequences. Working Paper 07/183, International Monetary Fund, Washington, DC, 19-26.
59. Keen M. & Smith S. (2007). VAT Fraud and Evasion: What Do We Know, and What Can be Done? Working Paper 07/31, International Monetary Fund, Washington, DC, 7-10.
60. Khwaja M. S. & Iyer I. (2014). Revenue Potential, Tax Space, and Tax Gap, A Comparative Analysis. Policy Research Working Paper 6868, World Bank, 13-22.
- Kindsfaterienė K. & Lukaševičius K., (2008). The Impact of the Tax System on Business Environment. Engineering Economics, No 2 (57), 70-75.
61. Koha.net, (2018). Sot 18 vjet që kur Shqipëria iu bashkua OBT-së. Marrë nga Koha.net: <https://www.koha.net/arberi/115857/sot-18-vjet-qe-kur-shqiperia-iu-bashkua-obt-se/> (parë më 15 prill 2018).
62. La Porta, R. & Shleifer A., (2014). "Informality and Development," Journal of Economic Perspectives, American Economic Association, Vol. 28(3), pp. 109–126.
63. Laborda & Peña, (2016). Is Financial VAT Neutral to Financial Sector Size? Discussion Paper 2016-31, Economics, 1-23.
64. Legeida N. and Sologoub D. (2003) “Modeling Value Added Tax (VAT) Revenues in a Transition Economy: Case of Ukraine,” Working Paper No. 22, Institute For Economic Research And Policy Consulting, 4-10.

65. Luttmer, E.F.P. & Singhal M., (2014). "Tax Morale," Journal of Economic Perspectives, American Economic Association, Vol. 28(4), pp. 149–168.
66. Marku A. (2018). Evazioni fiskal: Hetim jo vetëm subjektit, por dhe zyrtarëve të tatimeve. Marrë nga Top-Channel: <http://top-channel.tv/2018/02/09/evazioni-fiskal-marku-hetim-jo-vetem-subjektit-por-dhe-zyrtareve-te-tatimeve/> (parë më 16 korrik 2018).
67. Mehrara M. & Farahani Y. G. (2016) The study of the effects of tax evasion and tax revenues on economic stabilities in OECD countries. World Scientific News 33, 47-54.
68. Monitor, (2016). Banka Botërore ekzaminon 10 simptomat e papunësisë ndër të rinjtë e Shqipërisë dhe Rajonit. Marrë nga Monitor: <http://www.monitor.al/banka-boterore-ekzaminon-10-simptomat-e-papunesise-nder-te-rinjte-e-shqiperise-dhe-rajonit/> (parë më 17 prill 2018).
69. Monitor, (2017). Trading Economics: PBB për frymë e shqiptarëve më 2016 sa 37% e mesatares së globale, ja ecuria që nga viti 1980. Marrë nga Monitor: <http://www.monitor.al/trading-economics-pbb-per-fryme-e-shqiptareve-me-2016-sa-37-e-mesatares-se-globale-ja-ecuria-qe-nga-viti-1980/> (parë më 11 qershor 2018).
70. Mustapha M. Z., Koh E. H. Y., Chan. S-G., & Ramly Z. (2017). The Role of Corruption Control in Moderating the Relationship Between Value Added Tax and Income Inequality. International Journal of Economics and Financial Issues 7(4), 459-467.

71. Nacional Albania, (2016). Banka Botërore ekzaminon 10 simptomat e papunësisë ndër të rinjtë e Shqipërisë dhe Rajonit. Marrë nga Nacional Albania:
<http://www.nacionalalbania.al/2016/12/banka-boterore-ekzaminon-10-simptomat-e-papunesise-nder-te-rinjte-e-shqiperise-dhe-rajonit/> (parë më 19 janar 2018).
72. Nartey D. A., (2011). Effects Of Changes In The Rates Of Value Added Tax On Vat Revenue In Ghana From 2003 To 2010. Marrë nga:
<http://dspace.knust.edu.gh/bitstream/123456789/4280/1/Dominic%20A.%20Nartey.pdf> (parë më 22 shkurt 2018).
73. Njogu, L. K. (2015). The effect of value added tax on economic growth in Kenya. International Academic Journal of Economics and Finance, 1 (5), 10-27.
74. Nyaga, J. N. & Omwenga, J. (2016). Factors influencing tax revenue growth at Kenya Revenue Authority: A case of Meru station. International Academic Journal of Economics and Finance, 2 (1), 13-14.
75. Ofishe, O. W. (2015). The Impact of Value Added Tax on Economic Growth in Nigeria (1994 - 2012). Research Journal of Finance and Accounting, Vol.6, No.23, 34-44.
76. Onaolapo, A. A-R., Aworemi R. J. & Ajala, O. A. (2013). Assessment of Value Added Tax and Its Effects on Revenue Generation in Nigeria. International Journal of Business and Social Science Vol. 4 No. 1, 220-224.
77. Ora News (2018). Evazioni fiskal, në 2017 dëmi në buxhet 6.2 mld lekë. Marrë nga Ora News: <http://www.oranews.tv/article/evazioni-fiskal-ne-2017-demi-ne-buxhet-62-mld-leke> (parë më 19 korrik 2018).

78. Ora News, (2015). Loja e kuponit tatimor, Ministria e Financave shpërblen konsumatorët. Marrë nga Ora News: <http://www.oranews.tv/article/loja-e-kuponit-tatimor-ministria-e-financave-shperblen-konsumatoret> (parë më 27 mars 2018).
79. Palczewska O. (2016). Value Added Tax in Poland – Basis of Functioning and its Efficiency. Athens Journal of Business & Economics - Volume 2, Issue 4, 405-416.
80. Radeke J., Petersen H-G., Giucci R., (2015). Trade liberalisation in Transnistria. Estimated impact of an import tariff reduction and proposals for alternative revenue sources. Marrë nga: https://berlin-economics.com/download/studien/2015.07.01_Transnistria_Import_Tariff_Impact_en.pdf (parë më 06 prill 2018).
81. Sarmiento J., (2016). The Determinants of Value Added Tax Revenues In The European Union. European Journal of Management Studies, 82-95.
82. Scan, (2018). A ka mjaftueshëm farmaci? – Në Shqipëri 58.5 për 100 mijë banorë, të tretët nga fundi në Europë. Marrë nga Scan: <https://www.scan-tv.com/ka-mjaftueshem-farmaci-ne-shqiperi-58-5-per-100-mije-banore-te-tretet-nga-fundi-ne-europe/> (parë më 30 korrik 2018).
83. Shahrian S. & Hamedpoor Z. (2017). The Economic Impact of VAT on Fair Distribution of Income. Journal of Engineering Technology, 180-181.
84. Shekulli, (2014). TVSH-ja për barnat, ministria shpjegon skemën. Marrë nga Shekulli: <http://shekulli.com.al/43957/> (parë më 09 mars 2018).

85. Shojae T. (2016). Factors affecting the efficiency of the tax system from the perspective of tax experts of Tehran City Tax Affairs. *International Journal Of Humanities And Cultural Studies*, 1884-1892.
86. Smith A. M. C., Islam A. & Moniruzzaman M. (2011). Consumption Taxes in Developing Countries – The Case of the Bangladesh VAT. Working Paper No. 82: Universiteti Victoria i Wellingtonit, Qendra për Studime të Kontabilitetit, Qeverisjes dhe Taksave, Shkolla e Kontabilitetit dhe e Drejtës Tregtare.
87. Sørensen C. (2017). Taxing value added in the financial sector, An input-output approach and effects of the Norwegian VAT. Tezë Masteri: Universiteti i Oslo-s, Departamenti i Ekonomisë.
88. Stevanović M. , Minkov D. , Stojanović S., (2015) The Significance of VAT Revenue Streams for the Budget of the Republic of Serbia, *Faculty of Business Economics and Entrepreneurship International Review* (No.1-2), 103-111. Marrë nga:
http://www.international-review.com/wp-content/uploads/2016/03/ir_no1-2-2015.pdf. (parë më 07 prill 2018).
89. Stoilova D. & Patonov N., (2012). An Empirical Evidence For The Impact Of Taxation On Economy Growth In The European Union. *Book of Proceedings. Tourism and Management Studies International Conference Algarve*, 1032-1038.
90. Tanzi V. & Davoodi H. R., (2000). Corruption, Growth and Public Finances. Working Paper 00/182, International Monetary Fund, 16-21.

91. Terfa A., Ereso T., Kebede M. D., Rajendran M.M.A & Nedelea A-M., (2017).
Assessment Of The Effect Of Value Added Tax On Consumption Behavior: The
Case Of Nekemte Town, Wollega. ECOFORUM, Volumi 6, 1 (10), 2.
92. Terzić S. (2017). Model for determining subjective and objective factors of tax
evasion. Notitia - Journal For Sustainable Development, No 3, 53-57.
93. Tripathi R., Sinha A., & Agarwal S., (2011) “The effect of value added taxes on the
Indian society”, Journal of Accounting and Taxation, 32-34.
94. Vadinaj E.,(2017). Modelet E Dyfishta Të Raportimit Kontabël Dhe Fiskal. Tezë
Doktorature: Universiteti Aleksandër Moisiu.
95. Wawire, N. H. W. (2011). Determinants of Value Added Tax in Kenya. CSAE
Conference Paper. Marrë nga:

[https://pdfs.semanticscholar.org/057a/51d04be780df1b0244517fdb408ba57490a7.p
df](https://pdfs.semanticscholar.org/057a/51d04be780df1b0244517fdb408ba57490a7.pdf)
96. Wulandari H. & Andyarini K. T., (2015). The Effect Of Gross Domestic Product
Constant Prices And Inflation On Value Added Tax Revenue In Indonesia. I J A B
E R, Vol. 13, No. 7, 5155.
97. Yan X., (2011). Reforming Value Added Tax in Mainland China: A Comparison
with the EU. Revenue Law Journal, Vol. 20, Iss. 1, Art. 4, 1-31.
98. Yesegat W. A., (2008) Value Added Tax Administration in Ethiopia: A Reflection
of Problems. eJournal of Tax Research, 145-168.

99. Zimmermannova, J., Skalickova, J., Siroky, J. (2016), What Can Tax Revenues Tell us about the Economic Activity of Regions? *Economics and Sociology*, Vol. 9, No 1, 114-128.

APENDIKS

Tabela 1- Raporti i fitimit marxhinal për vitin 2016

Nr.	Emri i Firmës	EAN	SHITJE	Raporti
1	Florifarma	34,918,076	440,757,210	7.92%
2	Cfo Pharma Kashar	9,139,553	290,543,470	3.15%
3	Rejsi Farma Shpk	130,482,220	3,595,753,229	3.63%
4	Fufarma	31,515,650	1,156,973,486	2.72%
5	Sat Farm Shpk	569,447	65,708,088	0.87%
6	Pharma One Sh.P.K.	39,154,940	2,743,410,097	1.43%
7	Gen - Alb Farma	32,475,872	173,365,503	18.73%
8	Megapharma"	86,381,127	1,811,718,834	4.77%
9	Albpharma Canada	3,552,733	35,035,891	10.14%
10	Anipharma	2,859,618	71,352,467	4.01%
11	Almegipharma	12,183,333	218,557,784	5.57%
12	A F A - Farma	4,936,388	20,269,647	24.35%
13	Aldosch - Farma	107,486,266	1,542,828,104	6.97%
14	Dispers Farma	67,906	44,576,315	0.15%
15	Farmaci "Ana 12"	1,208,709	22,666,897	5.33%
16	Onovo Pharma	5,829,060	20,849,791	27.96%
17	Zhani Farmaci	174,437	9,381,334	1.86%
18	Profarma	315,395,042	2,005,125,804	15.73%
19	Mati-Farma	731,732	24,671,634	2.97%
20	Gerifarma	4,721,246	69,903,001	6.75%
21	Veco Pharma	6,670,935	36,168,098	18.44%
22	Genericspharma	9,731,009	487,702,561	2.00%
23	Bylis Pharma Shpk	16,055,391	219,566,292	7.31%
24	"Farma - Shqip" Shpk	2,279,706	39,331,290	5.80%
25	Farmaci Shkozeti	1,974,759	37,806,336	5.22%

Burimi: Qendra Kombëtare e Biznesit & Ilogaritje të autorit

Tabela 2- Raporti i fitimit marxhinal për vitin 2015

Nr.	Emri i Firmës	EAN	SHITJE	Raporti
1	Florifarma	15,225,427	376,988,862	4.04%
2	Cfo Pharma Kashar	3,620,605	43,928,294	8.24%
3	Rejsi Farma Shpk	86,263,821	3,154,988,300	2.73%

4	Fufarma	17,193,261	948,035,019	1.81%
5	Sat Farm Shpk	1,435,137	90,935,862	1.58%
6	Pharma One Sh.P.K.	21,362,358	2,670,232,786	0.80%
7	Gen - Alb Farma	10,989,650	107,261,555	10.25%
8	Megapharma"	28,876,132	1,208,126,331	2.39%
9	Albpharma Canada	5,225,561	97,319,056	5.37%
10	Anipharma	3,016,874	57,570,350	5.24%
11	Almegipharma	6,575,760	251,806,040	2.61%
12	A F A - Farma	4,816,536	16,427,207	29.32%
13	Aldosch - Farma	151,810,051	2,137,754,735	7.10%
14	Dispers Farma	556,966	46,950,261	1.19%
15	Farmací "Ana 12"	1,244,057	22,555,472	5.52%
16	Onovo Pharma	2,571,794	21,841,834	11.77%
17	Zhani Farmaci	391,399	11,658,939	3.36%
18	Profarma	310,325,702	1,888,611,012	16.43%
19	Mati-Farma	832,347	27,581,945	3.02%
20	Gerifarma	3,791,072	51,421,836	7.37%
21	Veco Pharma	1,868,493	32,971,125	5.67%
22	Genericspharma	9,931,269	447,257,454	2.22%
23	Bylis Pharma Shpk	23,017,805	216,848,003	10.61%
24	"Farma - Shqip" Shpk	1,711,407	40,234,096	4.25%
25	Farmací Shkozeti	1,157,091	27,214,276	4.25%

Burimi: Qendra Kombëtare e Biznesit & llogaritje të autorit

Tabela 3- Raporti i fitimit marxhinal për vitin 2014

Nr.	Emri i Firmës	EAN	SHITJE	Raporti
1	Florifarma	9,707,878	3,411,244,840	0.28%
2	Cfo Pharma Kashar	2,424,936	97,296,215	2.49%
3	Rejsi Farma Shpk	182,463,993	3,342,767,360	5.46%
4	Fufarma	13,072,882	794,359,536	1.65%
5	Sat Farm Shpk	548,744	41,962,555	1.31%
6	Pharma One Sh.P.K.	36,696,525	2,749,189,363	1.33%
7	Gen - Alb Farma	11,033,826	99,028,381	11.14%
8	Megapharma"	23,480,694	896,518,571	2.62%
9	Albpharma Canada	988,114	29,534,197	3.35%
10	Anipharma	1,979,464	40,081,914	4.94%
11	Almegipharma	7,310,000	286,789,620	2.55%
12	A F A - Farma	1,347,743	14,544,057	9.27%

13	Aldosch - Farma	110,322,862	1,254,581,516	8.79%
14	Dispers Farma	645,079	58,378,193	1.10%
15	Farmaci "Ana 12"	1,704,175	25,804,808	6.60%
16	Onovo Pharma	1,077,853	18,745,288	5.75%
17	Zhani Farmaci	631,342	12,435,485	5.08%
18	Profarma	185,328,137	1,011,353,479	18.32%
19	Mati-Farma	1,080,009	37,510,406	2.88%
20	Gerifarma	4,456,729	54,185,838	8.22%
21	Veco Pharma	1,743,615	65,102,282	2.68%
22	Genericspharma	19,321,057	579,802,147	3.33%
23	Bylis Pharma Shpk	21,044,845	223,606,448	9.41%
24	"Farma - Shqip" Shpk	2,452,779	39,236,161	6.25%
25	Farmaci Shkozeti	1,262,836	25,857,687	4.88%

Burimi: Qendra Kombëtare e Biznesit & Ilogaritje të autorit

Tabela 4- Raporti i fitimit marxhinal për vitin 2013

Nr.	Emri i Firmës	EAN	SHITJE	Raporti
1	Florifarma	12,186,081	370,484,984	3.29%
2	Cfo Pharma Kashar	5,955,584	141,574,032	4.21%
3	Rejsi Farma Shpk	323,587,906	3,799,673,436	8.52%
4	Fufarma	14,761,335	757,841,196	1.95%
5	Sat Farm Shpk	147,307	33,062,238	0.45%
6	Pharma One Sh.P.K.	58,267,479	3,048,114,382	1.91%
7	Gen - Alb Farma	5,073,239	84,258,703	6.02%
8	Megapharma"	18,919,335	862,967,569	2.19%
9	Albpharma Canada	1,126,831	45,478,303	2.48%
10	Anipharma	2,066,565	29,992,070	6.89%
11	Almegipharma	25,028,037	274,162,715	9.13%
12	A F A - Farma	1,700,132	16,678,155	10.19%
13	Aldosch - Farma	192,465,653	1,103,764,140	17.44%
14	Dispers Farma	1,192,006	80,327,240	1.48%
15	Farmaci "Ana 12"	1,922,918	27,554,108	6.98%
16	Onovo Pharma	2,637,208	19,378,726	13.61%
17	Zhani Farmaci	1,170,953	9,639,751	12.15%
18	Profarma	149,496,742	1,084,933,830	13.78%
19	Mati-Farma	2,436,462	51,474,177	4.73%
20	Gerifarma	6,014,674	46,170,943	13.03%
21	Veco Pharma	967,841	52,871,634	1.83%

22	Genericspharma	20,902,426	662,152,997	3.16%
23	Bylis Pharma Shpk	35,308,155	259,064,326	13.63%
24	"Farma - Shqip" Shpk	3,294,193	38,006,049	8.67%
25	Farmaci Shkozeti	1,557,040	24,548,881	6.34%

Burimi: Qendra Kombëtare e Biznesit & Ilogaritje të autorit

Tabela 5- Raporti i fitimit marxhinal për vitin 2012

Nr.	Emri i Firmës	EAN	SHITJE	Raporti
1	Florifarma	9,142,124	361,173,463	2.53%
2	Cfo Pharma Kashar	7,310,257	218,814,819	3.34%
3	Rejsi Farma Shpk	378,475,462	3,606,166,848	10.50%
4	Fufarma	23,721,310	706,404,503	3.36%
5	Sat Farm Shpk	1,288,225	50,931,299	2.53%
6	Pharma One Sh.P.K.	62,404,371	3,361,825,811	1.86%
7	Gen - Alb Farma	3,661,758	62,972,610	5.81%
8	Megapharma"	34,434,855	912,057,912	3.78%
9	Albpharma Canada	1,296,740	50,636,349	2.56%
10	Anipharma	1,450,343	28,586,690	5.07%
11	Almegipharma	37,276,839	360,309,564	10.35%
12	A F A - Farma	1,715,077	16,396,911	10.46%
13	Aldosch - Farma	166,197,872	1,268,085,995	13.11%
14	Dispers Farma	1,841,407	97,428,917	1.89%
15	Farmaci "Ana 12"	1,760,244	29,749,157	5.92%
16	Onovo Pharma	1,897,611	13,237,835	14.33%
17	Zhani Farmaci	(35,551)	10,103,078	-0.35%
18	Profarma	169,346,366	950,298,304	17.82%
19	Mati-Farma	2,164,277	59,571,269	3.63%
20	Gerifarma	6,014,674	46,170,943	13.03%
21	Veco Pharma	874,706	36,495,007	2.40%
22	Genericspharma	24,764,981	697,207,449	3.55%
23	Bylis Pharma Shpk	43,270,373	243,720,057	17.75%
24	"Farma - Shqip" Shpk	3,280,374	36,356,412	9.02%
25	Farmaci Shkozeti	1,715,404	28,693,128	5.98%

Burimi: Qendra Kombëtare e Biznesit & Ilogaritje të autorit

Tabela 6- Raporti i fitimit marxhinal për vitin 2011

Nr.	Emri i Firmës	EAN	SHITJE	Raporti
1	Florifarma	11,350,029	391,818,433	2.90%
2	Cfo Pharma Kashar	9,339,671	240,811,454	3.88%
3	Rejsi Farma Shpk	397,806,540	3,492,143,290	11.39%
4	Fufarma	20,104,570	752,361,450	2.67%
5	Sat Farm Shpk	12,528,535	81,902,126	15.30%
6	Pharma One Sh.P.K.	75,871,309	3,249,756,268	2.33%
7	Gen - Alb Farma	4,296,938	54,270,945	7.92%
8	Megapharma"	32,178,746	886,514,403	3.63%
9	Albpharma Canada	1,826,173	26,877,633	6.79%
10	Anipharma	4,112,766	28,856,087	14.25%
11	Almegipharma	33,283,031	276,851,350	12.02%
12	A F A - Farma	(1,285,042)	6,001,337	-21.41%
13	Aldosch - Farma	132,214,545	1,126,919,850	11.73%
14	Dispers Farma	2,218,293	112,035,044	1.98%
15	Farmaci "Ana 12"	1,255,639	21,270,085	5.90%
16	Onovo Pharma	3,750,570	21,223,729	17.67%
17	Zhani Farmaci	344,083	8,491,246	4.05%
18	Profarma	202,493,043	857,021,600	23.63%
19	Mati-Farma	3,098,522	59,570,971	5.20%
20	Gerifarma	4,850,134	63,518,960	7.64%
21	Veco Pharma	1,175,595	39,087,084	3.01%
22	Genericspharma	22,876,563	704,017,412	3.25%
23	Bylis Pharma Shpk	43,067,850	215,052,332	20.03%
24	"Farma - Shqip" Shpk	3,738,402	35,161,658	10.63%
25	Farmaci Shkozeti	1,866,560	25,638,043	7.28%

Burimi: Qendra Kombëtare e Biznesit & Ilogaritje të autorit

Tabela 7- Raporti i fitimit marxhinal për vitin 2010

Nr.	Emri i Firmës	EAN	SHITJE	Raporti
1	Florifarma	7,223,773	343,900,550	2.10%
2	Cfo Pharma Kashar	2,257,818	236,059,511	0.96%
3	Rejsi Farma Shpk	259,774,203	2,799,770,927	9.28%
4	Fufarma	8,006,279	608,754,987	1.32%
5	Sat Farm Shpk	5,061,090	108,819,616	4.65%
6	Pharma One Sh.P.K.	52,859,923	2,764,116,286	1.91%

7	Gen - Alb Farma	3,881,279	64,170,367	6.05%
8	Megapharma"	27,728,326	944,450,819	2.94%
9	Albpharma Canada	2,871,749	47,091,205	6.10%
10	Anipharma	1,753,799	18,923,983	9.27%
11	Almegipharma	9,155,499	309,213,475	2.96%
12	A F A - Farma	13,354	2,607,346	0.51%
13	Aldosch - Farma	122,534,720	1,003,857,019	12.21%
14	Dispers Farma	3,815,111	119,754,703	3.19%
15	Farmaci "Ana 12"	1,628,505	20,785,444	7.83%
16	Onovo Pharma	1,000,395	38,769,264	2.58%
17	Zhani Farmaci	977,855	27,355,726	3.57%
18	Profarma	132,227,513	834,177,476	15.85%
19	Mati-Farma	2,973,432	70,385,288	4.22%
20	Gerifarma	1,859,120	29,232,632	6.36%
21	Veco Pharma	1,765,895	22,493,440	7.85%
22	Genericspharma	21,442,284	699,974,950	3.06%
23	Bylis Pharma Shpk	37,593,088	353,598,358	10.63%
24	"Farma - Shqip" Shpk	3,924,002	32,020,740	12.25%
25	Farmaci Shkozeti	1,747,219	26,341,601	6.63%

Burimi: Qendra Kombëtare e Biznesit & Ilogaritje të autorit

Tabela 8- Raporti i fitimit marxhinal për vitin 2009

Nr.	Emri i Firmës	EAN	SHITJE	Raporti
1	Florifarma	5,320,242	237,506,407	2.24%
2	Cfo Pharma Kashar	3,411,456	257,683,336	1.32%
3	Rejsi Farma Shpk	154,881,569	2,140,331,474	7.24%
4	Fufarma	989,747	294,950,238	0.34%
5	Sat Farm Shpk	79,694	2,411,508	3.30%
6	Pharma One Sh.P.K.	42,034,984	1,787,868,912	2.35%
7	Gen - Alb Farma	3,555,344	40,888,715	8.70%
8	Megapharma"	10,011,235	396,083,501	2.53%
9	Albpharma Canada	2,975,993	62,090,321	4.79%
10	Anipharma	2,083,492	24,213,740	8.60%
11	Almegipharma	28,740,209	233,773,495	12.29%
12	A F A - Farma	(1,530,862)	13,312,802	-11.50%
13	Aldosch - Farma	8,802,393	730,957,038	1.20%
14	Dispers Farma	4,305,504	113,902,215	3.78%
15	Farmaci "Ana 12"	1,627,756	21,596,847	7.54%

16	Onovo Pharma	910,432	48,610,559	1.87%
17	Zhani Farmaci	1,885,569	38,087,047	4.95%
18	Profarma	123,748,614	651,491,560	18.99%
19	Mati-Farma	1,805,728	78,665,910	2.30%
20	Gerifarma	1,028,844	13,940,506	7.38%
21	Veco Pharma	(559,989)	4,529,600	-12.36%
22	Genericspharma	17,592,267	612,355,977	2.87%
23	Bylis Pharma Shpk	262,866,140	262,866,140	100.00%
24	"Farma - Shqip" Shpk	4,051,743	33,488,244	12.10%
25	Farmaci Shkozeti	1,638,599	31,241,703	5.24%

Burimi: Qendra Kombëtare e Biznesit & Ilogaritje të autorit

Tabela 9- Raporti i keshit për vitin 2016

Nr.	Emri i Firmës	Mjete monetare	Det. Korente	Raporti
1	Florifarma	7,493,162	143,015,866	0.0524
2	Cfo Pharma Kashar	17,178,149	1,064,002,344	0.0161
3	Rejsi Farma Shpk	58,407,864	583,033,109	0.1002
4	Fufarma	126,029,125	557,948,352	0.2259
5	Sat Farm Shpk	5,286,828	8,907,209	0.5935
6	Pharma One Sh.P.K.	53,509,857	692,257,133	0.0773
7	Gen - Alb Farma	44,157,987	135,636,096	0.3256
8	Megapharma"	40,021,354	545,501,965	0.0734
9	Albpharma Canada	353,831	7,868,734	0.0450
10	Anipharma	4,498,841	11,760,002	0.3826
11	Almegipharma	67,732,872	87,565,994	0.7735
12	A F A - Farma	1,585,653	609,682	2.6008
13	Aldosch - Farma	9,727,135	349,583,746	0.0278
14	Dispers Farma	6,436	147,175	0.0437
15	Farmaci "Ana 12"	77,692	1,425,046	0.0545
16	Onovo Pharma	485,355	7,694,924	0.0631
17	Zhani Farmaci	1,081,124	440,803	2.4526
18	Profarma	21,591,978	1,497,675,090	0.0144
19	Mati-Farma	1,465,262	736,057	1.9907
20	Gerifarma	10,573,495	9,295,885	1.1374
21	Veco Pharma	2,684,525	8,308,835	0.3231
22	Genericspharma	7,785,137	222,358,057	0.0350
23	Bylis Pharma Shpk	1,622,590	39,175,664	0.0414
24	"Farma - Shqip" Shpk	7,918,882	3,265,779	2.4248

25	Farmaci Shkozeti	6,554,330	599,092	10.9404
----	------------------	-----------	---------	----------------

Burimi: Qendra Kombëtare e Biznesit & Ilogaritje të autorit

Tabela 10- Raporti i keshit për vitin 2015

Nr.	Emri i Firmës	Mjete monetare	Det. Korente	Raporti
1	Florifarma	4,217,133	131,059,249	0.0322
2	Cfo Pharma Kashar	12,122,708	25,913,543	0.4678
3	Rejsi Farma Shpk	89,310,360	693,537,152	0.1288
4	Fufarma	90,411,346	282,374,257	0.3202
5	Sat Farm Shpk	90,411,346	282,374,257	0.3202
6	Pharma One Sh.P.K.	24,710,920	612,582,017	0.0403
7	Gen - Alb Farma	25,079,360	126,674,648	0.1980
8	Megapharma"	99,548,188	508,187,724	0.1959
9	Albpharma Canada	3,762,226	2,232,846	1.6849
10	Anipharma	4,936,049	16,750,899	0.2947
11	Almegipharma	60,728,720	12,250,808	4.9571
12	A F A - Farma	138,746	330,223	0.4202
13	Aldosch - Farma	15,059,340	536,842,333	0.0281
14	Dispers Farma	197,009	1,753,397	0.1124
15	Farmaci "Ana 12"	21,624	1,545,089	0.0140
16	Onovo Pharma	4,553,906	3,614,208	1.2600
17	Zhani Farmaci	1,755,259	30,070	58.3724
18	Profarma	755,970	951,061,227	0.0008
19	Mati-Farma	1,160,139	1,709,313	0.6787
20	Gerifarma	246,914	6,938,438	0.0356
21	Veco Pharma	289,904	9,434,415	0.0307
22	Genericspharma	5,314,644	178,646,709	0.0297
23	Bylis Pharma Shpk	11,690,398	33,927,973	0.3446
24	"Farma - Shqip" Shpk	5,267,581	3,086,863	1.7065
25	Farmaci Shkozeti	1,322,609	643,666	2.0548

Burimi: Qendra Kombëtare e Biznesit & Ilogaritje të autorit

Tabela 11- Raporti i keshit për vitin 2014

Nr.	Emri i Firmës	Mjete monetare	Det. Korente	Raporti
1	Florifarma	14,839,799	37,089,799	0.4001
2	Cfo Pharma Kashar	6,956,746	46,337,688	0.1501
3	Rejsi Farma Shpk	140,529,868	1,273,773,780	0.1103
4	Fufarma	99,305,925	392,794,697	0.2528

5	Sat Farm Shpk	3,469,460	35,872,961	0.0967
6	Pharma One Sh.P.K.	49,814,737	517,502,340	0.0963
7	Gen - Alb Farma	45,309,113	130,293,209	0.3477
8	Megapharma"	94,666,073	456,335,864	0.2074
9	Albpharma Canada	818,446	27,786,904	0.0295
10	Anipharma	1,834,705	29,546,964	0.0621
11	Almegipharma	37,399,470	64,649,990	0.5785
12	A F A - Farma	403,733	419,814	0.9617
13	Aldosch - Farma	(84,543,833)	352,974,870	-0.2395
14	Dispers Farma	28,150	971,756	0.0290
15	Farmaci "Ana 12"	1,199,434	463,978	2.5851
16	Onovo Pharma	1,216,062	3,910,285	0.3110
17	Zhani Farmaci	3,714,127	245,763	15.1126
18	Profarma	4,022,823	1,119,829,782	0.0036
19	Mati-Farma	5,156,528	1,808,649	2.8510
20	Gerifarma	5,924,158	7,899,509	0.7499
21	Veco Pharma	4,240,924	11,130,032	0.3810
22	Genericspharma	7,106,253	190,043,361	0.0374
23	Bylis Pharma Shpk	879,285	17,630,090	0.0499
24	"Farma - Shqip" Shpk	5,636,813	3,096,116	1.8206
25	Farmaci Shkozeti	882,728	751,967	1.1739

Burimi: Qendra Kombëtare e Biznesit & llogaritje të autorit

Tabela 12- Raporti i keshit për vitin 2013

Nr.	Emri i Firmës	Mjete monetare	Det. Korente	Raporti
1	Florifarma	11,416,238	32,283,699	0.3536
2	Cfo Pharma Kashar	10,790,711	42,558,300	0.2536
3	Rejsi Farma Shpk	228,870,175	1,728,354,767	0.1324
4	Fufarma	54,243,300	486,101,960	0.1116
5	Sat Farm Shpk	2,601,200	43,822,243	0.0594
6	Pharma One Sh.P.K.	62,855,085	712,266,180	0.0882
7	Gen - Alb Farma	13,774,214	160,751,864	0.0857
8	Megapharma"	7,779,266	699,951,816	0.0111
9	Albpharma Canada	976,018	25,398,598	0.0384
10	Anipharma	2,375,903	23,567,735	0.1008
11	Almegipharma	45,834,526	103,447,071	0.4431
12	A F A - Farma	80,713	12,826,023	0.0063
13	Aldosch - Farma	20,755,500	260,444,030	0.0797

14	Dispers Farma	12,100	4,025,017	0.0030
15	Farmaci "Ana 12"	667,762	1,941,010	0.3440
16	Onovo Pharma	9,237,946	5,001,490	1.8470
17	Zhani Farmaci	403,471	28,138	14.3390
18	Profarma	5,132,157	140,870,949	0.0364
19	Mati-Farma	5,132,284	3,589,519	1.4298
20	Gerifarma	11,905,267	4,412,113	2.6983
21	Veco Pharma	199,726	21,637,105	0.0092
22	Genericspharma	9,950,158	218,616,711	0.0455
23	Bylis Pharma Shpk	2,548,222	20,559,188	0.1239
24	"Farma - Shqip" Shpk	5,051,307	3,173,158	1.5919
25	Farmaci Shkozeti	940,773	1,334,174	0.7051

Burimi: Qendra Kombëtare e Biznesit & Ilogaritje të autorit

Tabela 13- Raporti i keshit për vitin 2012

Nr.	Emri i Firmës	Mjete monetare	Det. Korente	Raporti
1	Florifarma	6,148,640	48,746,742	0.1261
2	Cfo Pharma Kashar	7,347,584	46,653,910	0.1575
3	Rejsi Farma Shpk	198,255,062	1,605,240,529	0.1235
4	Fufarma	50,717,787	422,498,133	0.1200
5	Sat Farm Shpk	2,539,350	70,768,788	0.0359
6	Pharma One Sh.P.K.	26,511,947	667,649,975	0.0397
7	Gen - Alb Farma	4,015,082	148,079,439	0.0271
8	Megapharma"	15,382,727	521,024,214	0.0295
9	Albpharma Canada	319,738	74,711,845	0.0043
10	Anipharma	1,575,445	9,946,298	0.1584
11	Almegipharma	2,621,309	191,605,641	0.0137
12	A F A - Farma	245,244	13,268,812	0.0185
13	Aldosch - Farma	43,645,288	280,378,153	0.1557
14	Dispers Farma	25,400	7,232,874	0.0035
15	Farmaci "Ana 12"	521,098	1,216,147	0.4285
16	Onovo Pharma	546,218	20,570,228	0.0266
17	Zhani Farmaci	4,352,404	360,927	12.0590
18	Profarma	4,970,937	104,577,398	0.0475
19	Mati-Farma	1,330,379	5,953,778	0.2235
20	Gerifarma	20,620	8,690,325	0.0024
21	Veco Pharma	1,781,884	30,241,940	0.0589
22	Genericspharma	7,326,761	165,534,378	0.0443

23	Bylis Pharma Shpk	870,745	47,906,449	0.0182
24	"Farma - Shqip" Shpk	1,267,129	2,757,018	0.4596
25	Farmaci Shkozeti	1,774,976	1,312,637	1.3522

Burimi: Qendra Kombëtare e Biznesit & llogaritje të autorit

Tabela 14- Raporti i keshit për vitin 2011

Nr.	Emri i Firmës	Mjete monetare	Det. Korente	Raporti
1	Florifarma	10,541,442	62,989,851	0.1674
2	Cfo Pharma Kashar	4,319,558	35,221,796	0.1226
3	Rejsi Farma Shpk	186,390,005	1,428,659,773	0.1305
4	Fufarma	27,004,925	390,254,609	0.0692
5	Sat Farm Shpk	2,035,400	76,210,407	0.0267
6	Pharma One Sh.P.K.	26,690,610	656,927,613	0.0406
7	Gen - Alb Farma	3,224,037	122,209,989	0.0264
8	Megapharma"	8,235,004	514,754,392	0.0160
9	Albpharma Canada	5,030,612	86,311,928	0.0583
10	Anipharma	568,062	8,131,786	0.0699
11	Almegipharma	239,724	13,617,133	0.0176
12	A F A - Farma	59,729	16,462,080	0.0036
13	Aldosch - Farma	18,802,222	442,818,945	0.0425
14	Dispers Farma	18,200	7,228,194	0.0025
15	Farmaci "Ana 12"	-	4,454,050	0.0000
16	Onovo Pharma	34,159	20,742,588	0.0016
17	Zhani Farmaci	2,373,080	27,946	84.9166
18	Profarma	1,885,507	111,812,690	0.0169
19	Mati-Farma	5,529,954	10,973,281	0.5039
20	Gerifarma	13,361,736	25,403,027	0.5260
21	Veco Pharma	1,867,869	53,640,402	0.0348
22	Genericspharma	20,340,118	189,369,142	0.1074
23	Bylis Pharma Shpk	2,413,637	74,270,211	0.0325
24	"Farma - Shqip" Shpk	5,059,391	130,251	38.8434
25	Farmaci Shkozeti	676,040	3,177,163	0.2128

Burimi: Qendra Kombëtare e Biznesit & llogaritje të autorit

Tabela 45- Raporti i keshit për vitin 2010

Nr.	Emri i Firmës	Mjete monetare	Det. Korente	Raporti
1	Florifarma	11,028,008	91,572,558	0.1204
2	Cfo Pharma Kashar	5,187,079	46,671,312	0.1111

3	Rejsi Farma Shpk	101,059,419	1,453,339,870	0.0695
4	Fufarma	17,107,443	259,982,118	0.0658
5	Sat Farm Shpk	2,756,380	92,378,397	0.0298
6	Pharma One Sh.P.K.	10,191,037	1,031,104,029	0.0099
7	Gen - Alb Farma	1,414,948	12,213,865	0.1158
8	Megapharma"	9,136,739	334,658,184	0.0273
9	Albpharma Canada	545,702	91,234,553	0.0060
10	Anipharma	978,267	10,951,184	0.0893
11	Almegipharma	428,329	45,058,942	0.0095
12	A F A - Farma	20,997	12,832,529	0.0016
13	Aldosch - Farma	7,614,634	407,570,479	0.0187
14	Dispers Farma	15,200	8,228,337	0.0018
15	Farmaci "Ana 12"	112,439	1,118,482	0.1005
16	Onovo Pharma	265,822	18,509,575	0.0144
17	Zhani Farmaci	4,792,450	211,340	22.6765
18	Profarma	1,175,567	53,099,198	0.0221
19	Mati-Farma	5,611,730	8,973,444	0.6254
20	Gerifarma	1,407,433	28,979,421	0.0486
21	Veco Pharma	4,689,069	34,745,007	0.1350
22	Genericspharma	22,840,944	167,457,472	0.1364
23	Bylis Pharma Shpk	7,172,834	94,270,535	0.0761
24	"Farma - Shqip" Shpk	1,792,334	(1,867,996)	-0.9595
25	Farmaci Shkozeti	460,408	2,213,831	0.2080

Burimi: Qendra Kombëtare e Biznesit & Ilogaritje të autorit

Tabela 16- Raporti i keshit për vitin 2009

Nr.	Emri i Firmës	Mjete monetare	Det. Korente	Raporti
1	Florifarma	5,184,640	57,545,289	0.0901
2	Cfo Pharma Kashar	4,996,646	54,637,951	0.0915
3	Rejsi Farma Shpk	118,332,667	854,463,279	0.1385
4	Fufarma	38,240,735	208,277,852	0.1836
5	Sat Farm Shpk	659,489	24,770	26.6245
6	Pharma One Sh.P.K.	9,943,770	588,561,522	0.0169
7	Gen - Alb Farma	3,135,110	13,492,372	0.2324
8	Megapharma"	18,613,755	138,960,482	0.1339
9	Albpharma Canada	3,578,547	67,496,185	0.0530

10	Anipharma	283,566	8,299,326	0.0342
11	Almegipharma	6,451,741	49,014,766	0.1316
12	A F A - Farma	355,056	11,911,173	0.0298
13	Aldosch - Farma	66,460,127	341,023,138	0.1949
14	Dispers Farma	328,387	6,200,487	0.0530
15	Farmaci "Ana 12"	1,259,895	1,673,010	0.7531
16	Onovo Pharma	844,993	12,241,472	0.0690
17	Zhani Farmaci	22,648	205,048	0.1105
18	Profarma	19,529,330	31,647,769	0.6171
19	Mati-Farma	5,268,438	14,822,576	0.3554
20	Gerifarma	3,562,959	22,412,632	0.1590
21	Veco Pharma	304,780	4,121,892	0.0739
22	Genericspharma	19,375,020	157,602,132	0.1229
23	Bylis Pharma Shpk	1,047,005	164,656,509	0.0064
24	"Farma - Shqip" Shpk	7,910,165	(789,244)	-10.0225
25	Farmaci Shkozeti	157,239	648,656	0.2424

Burimi: Qendra Kombëtare e Biznesit & Ilogaritje të autorit